FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 167

Tiranë – E mërkurë, 14 dhjetor 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 765, datë 12.12.2022	Për miratimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë, për vitin 2021, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA III).....	19407

VENDIM
Nr. 765, datë 12.12.2022

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, DHE KOMISIONIT EVROPIAN, NË LIDHJE ME PROGRAMIN VJETOR KOMBËTAR PËR SHQIPËRINË, PËR VITIN 2021, NË KUADËR TË INSTRUMENTIT TË ASISTENCËS SË PARAANËTARËSIMIT (IPA III)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë, për vitin 2021, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA III), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

MARRËVESHJA E FINANCIMIT
KUSHTET E VEÇANTA

Komisioni Evropian, këtej e tutje referuar si **"Komisioni"**, i cili vepron në emër të Bashkimit Evropian, këtej e tutje referuar si **"BE "**

nga njëra anë dhe

Republika e Shqipërisë, këtej e tutje referuar si **"përfituesi IPA III"**, e përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë,

nga ana tjetër,

bien dakord si më poshtë:

Neni 1 - Programi

(1) BE-ja bie dakord të financojë dhe përfituesi IPA III bie dakord të pranojë financimin e Programit në vijim:
Plani Vjetor i Veprimit në favor të Shqipërisë për vitin 2021
që konsiston në këto veprime:
Veprimi 1: BE-ja për Drejtësinë
Veprimi 2: BE-ja për Të Drejtat e Pronësisë - Faza II
Veprimi 3: BE-ja për Natyrën
Veprimi 4: BE-ja për Ekonominë Qarkulluese dhe Rritjen e Gjelbër
Veprimi 5: BE-ja për Novacionin - Faza II

Numri i angazhimit global: SCR.DEC.043666.01

Ky Program financohet nga buxheti i BE-së sipas aktit bazë: Instrumenti për Asistencën e Para-anëtarësimit, IPA III.[1]

(2) Kostoja totale e llogaritur për këtë Program është 64 900 000 Euro
dhe kontributi maksimal i BE-së për këtë Program është vendosur të jetë 64 900 000 Euro.

Nuk kërkohet kontribut financuar nga përfituesi IPA III.

(3) Programi zbatohet në përputhje me dokumentet e Veprimit në Shtojcën I.

Neni 2 – Periudha e ekzekutimit dhe periudha e zbatimit operacional

(1) Periudha e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje Financimi është 12 vjet nga nënshkrimi i saj, siç përcaktohet në nenin 12 të Shtojcës II (Kushtet e Përgjithshme.

[1] Rregullorja (BE) 2021/1529 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 shtator 2021 që krijon Instrumentin për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA III), GZ L 330, 20.9.2021, fq. 1.

(2) Kohëzgjatja e periudhës së zbatimit operacional është 6 vjet nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi, siç përcaktohet në nenin 12 të Shtojcës II (Kushtet e Përgjithshme).

Neni 3 – Adresat dhe Komunikimi

Të gjitha komunikimet në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi bëhen në formë të shkruar, i referohen shprehimisht këtij Programi siç përcaktohet në nenin 1(1) dhe dërgohen në adresat më poshtë:

(1) **për Komisionin**

Bashkimi Evropian
Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit
Drejtoria D
Rue de la Loi 15
B -1049 Brussels, Belgium
E-mail: NEAR-D@ec.europa.eu

(2) **për përfituesin IPA III**

Koordinatori Kombëtar i IPA-s
Kryeministria
Blvd. "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Shqipëri
E-mail: eufa@saspac.gov.al

Neni 4 – Pikat e kontaktit të OLAF-it

Pika e kontaktit e përfituesit IPA III që ka tagrin e duhur për të bashkëpunuar drejtpërdrejt me Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF), me qëllim lehtësimin e aktiviteteve operacionale është: Znj. Blerina NASKA, Përgjegjëse e Sektorit të Inspektimit Financiar pranë Drejtorisë së Inspektimit të Financave Publike, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Neni 5 – Marrëveshja Financiare Kuadër për Partneritetin

Programi zbatohet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Financiare Kuadër për Partneritetin (MFKP) ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë për modalitetet e zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Shqipërinë në kuadrin e Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit (këtej e tutje referuar si "MFKP"). Kjo Marrëveshje Financimi plotëson dispozitat e MFKP-së. Në rast konflikti midis dispozitave të kësaj Marrëveshjeje Financimi dhe dispozitave të MFKP-së, kanë përparësi dispozitat e kësaj të fundit.

Neni 6 - Shtojcat

(1) Kjo Marrëveshje Financimi përbëhet nga:

(a) këto Kushte të Veçanta;

(b) Shtojca I: Dokumentet e Veprimit që detajojnë objektivat, rezultatet e pritshme, aktivitetet, metodat e zbatimit dhe buxhetin;

- Shtojca I.1 Veprimi 1: BE-ja për Drejtësinë
- Shtojca I.2 Veprimi 2: BE-ja për Të Drejtat e Pronësisë - Faza II

- Shtojca I.3 Veprimi 3: BE-ja për Natyrën
- Shtojca I.4 Veprimi 4: BE-ja për Ekonominë Qarkulluese dhe Rritjen e Gjelbër
- Shtojca I.5 Veprimi 5: BE-ja për Novacionin - Faza II
- Shtojca IA: Tabela e Buxhetit

(c) Shtojca II: Kushtet e Përgjithshme;

(2) Në rast konflikti midis dispozitave të Shtojcave dhe dispozitave të këtyre Kushteve të Veçanta, këto të fundit kanë përparësi. Në rast konflikti midis dispozitave të Shtojcës I dhe dispozitave të Shtojcës II, këto të fundi kanë përparësi.

Neni 7 – Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Financimi konsiderohet e nënshkruar në datën kur nënshkruhet nga pala e fundit, jo më vonë se 31 dhjetori 2022.

Kjo Marrëveshje Financimi hyn në fuqi në datën kur Komisioni merr njoftim nga përfituesi IPA III në të cilin konfirmon përfundimin e procedurave të brendshme të përfituesit IPA III që janë të nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Financimit. Komisioni e informon përfituesin IPA III për datën e marrjes së këtij njoftimi.

Kjo Marrëveshje Financimi hartohet në dy kopje origjinale në gjuhën angleze, nga të cilat njëra i dorëzohet Komisionit dhe tjetra përfituesit IPA III.

Për përfituesin IPA III	Për Komisionin
Ilir Beqaj Koordinator Kombëtar i IPA-s Tiranë	Michela Matuella Drejtore e Komanduar e DG NEAR Directorate D Bruksel
Datë:	Datë: **8/8/2022**
Nënshkrimi:	Nënshkrimi: (Michaela Matuella)

SHTOJCA I.1
e Marrëveshjes së Financimit për planin vjetor të veprimit në favor të Shqipërisë për vitin 2021
Dokumenti i Veprimit për "BE-ja për Drejtësinë"

1. SINOPS

1.1. Tabela Përmbledhëse e Veprimit

Titulli	**BE për Drejtësi** Plani Vjetor i Veprimit në favor të Shqipërisë për vitin 2021			
Numri *CRIS*	IPA III/2021/ 043-666/1			
Akti bazë	Financuar në kuadrin e Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA III)			
Nismë *Team Europe*	Jo			
Zona që përfiton nga veprimi	Veprimi zbatohet në Shqipëri			
Dokumenti programues	Kuadri Programues IPA III			
FUSHAT PRIORITARE DHE INFORMACIONI SEKTORIAL				
Dritarja dhe prioriteti tematik	D1: Shteti i Së Drejtës, Të Drejtat Themelore dhe Demokracia PT1: Gjyqësori			
Objektivat e Zhvillimit të qëndrueshëm (OZhQ)	OZhQ kryesor (vetëm 1): 16: Paqja, Drejtësia dhe Institucione të Forta. OZhQ të tjera të rëndësishme (deri në 9) dhe synime, sipas rastit: 5: Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave.			
Kodi(et) *DAC*	Kodi DAC kryesor: 15130 – Zhvillimi juridik dhe gjyqësor (100%)			
Kanali Kryesor i Zbatimit	12000 – Qeveria Përfituese			
Treguesit **(nga formulari DAC)**	**Objektivi i përgjithshëm i politikës**	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	Zhvillimi i pjesëmarrjes/ qeverisja e mirë	☐	☐	☒
	Ndihmë për mjedisin	☒	☐	☐
	Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave	☐	☒	☐
	Zhvillimi i tregtisë	☒	☐	☐
	Shëndeti riprodhues, i mëmësisë, të sapolindurve dhe fëmijëve	☒	☐	☐
	Reduktimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore	☒	☐	☐
	Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara	☐	☒	☐

	Ushqyerja	☒	☐	☐
	Treguesit e Konventës RIO	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	Diversiteti biologjik	☒	☐	☐
	Lufta ndaj shkretimit	☒	☐	☐
	Zbutja e ndryshimeve klimatike	☒	☐	☐
	Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike	☒	☐	☐
Tregues të brendshëm	**Objektivat e politikës**	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	Dixhitalizimi	☐	☐	☒
	Migrimi	☒	☐	☐
	COVID-19	☒	☐	☐
INFORMACION PËR BUXHETIN				
Shumat përkatëse	Linja e buxhetit: 15.020101.01 Kostoja totale e vlerësuar: 8 000 000 Euro Kontributi total i buxhetit të BE-së: 8 000 000 Euro			
MENAXHIMI DHE ZBATIMI				
Lloji i financimit dhe metoda(t) e zbatimit	Me Projekt **Menaxhim Direkt** përmes granteve të binjakëzimit, prokurimit			
Prioritetet përkatëse dhe programet nga Plani Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor	Prioritetet: "Qeverisja, Shteti i Së Drejtës, RAP"			
Afati për lidhjen e Marrëveshjes së Financimit	deri më 31 dhjetor N+1			
Afati për lidhjen e marrëveshjeve të kontributit /delegimit, prokurimeve dhe kontratave grant	3 vite pas datës së lidhjes së Marrëveshjes së Financimit, me përjashtim të rasteve të renditura në nenin 114(2) të Rregullores Financiare			
Periudha indikative e zbatimit operacional	72 muaj pas lidhjes së Marrëveshjes së Financimit			
Afati për zbatimin e Marrëveshjes së Financimit	12 vite pas lidhjes së Marrëveshjes së Financimit			

1.2. Përmbledhja e Veprimit

Veprimi synon të mbështesë autoritetet shqiptare nëpërmjet investimeve kyçe dhe ngritjes së kapaciteteve në zbatimin e reformës ambicioze në drejtësi, me fokus të veçantë në rritjen e efikasitetit dhe transparencës së sistemit të drejtësisë dhe në përmirësimin e mëtejshëm të profesionalizmit të sistemit të drejtësisë shqiptare.

Një nga prioritetet aktuale të reformës në drejtësi është nevoja urgjente për modernizimin e teknologjisë së informacionit të përdorur nëpërmjet Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Çështjeve, me qëllim që të ndërlidhet me bazat e tjera të të dhënave. Synimi thelbësor i këtij prioriteti është që teknologjia e informacionit të mundësojë gjenerimin e statistikave të nevojshme për të ndjekur ecurinë e funksionimit të gjykatave dhe organeve të tjera të drejtësisë përkundër standardeve më të mira evropiane. Këto statistika duhet të mundësojnë matjen e qartë të efikasitetit dhe transparencës së sistemit të drejtësisë përmes të dhënave automatike që tregojnë nivelin e trajtimit të çështjeve, numrin e çështjeve të prapambetura, numrin e çështjeve për çdo gjyqtar, kohëzgjatjen mesatare të çështjeve dhe kohëzgjatjen e çështjeve në proces. Ky Veprim mbështet krijimin e një sistemi të integruar modern për menaxhimin e çështjeve; këtu përfshihen, përveç zgjidhjeve teknike dhe harduerit, edhe rregullat e funksionimit të sistemit, trajnimin e personelit dhe përdoruesve, si dhe ndihmën në organizimin e mirëmbajtjes dhe sigurisë afatgjatë të sistemit.

Veprimi do të rritë edhe profesionalizmin e sistemit të drejtësisë shqiptare duke mbështetur Ministrinë e Drejtësisë (MD) në adresimin e nevojave analitike dhe të hartimit të legjislacionit, si dhe duke ndihmuar procesin e përgjithshëm të përafrimit të legjislacionit. Veprimi do të kontribuojë në përditësimin e kuadrit ligjor dhe kapaciteteve të Ministrisë së Drejtësisë ndërsa Shqipëria përgatitet për anëtarësim në BE dhe harmonizon legjislacionin e brendshëm me *acquis* të BE-së në fushën e drejtësisë.

2. ARGUMENTIMI

2.1. Analiza e Kontekstit

Procesi i reformës në drejtësi po ndërton një sistem drejtësie të pavarur, llogaridhënës dhe efikas. Përveç miratimit të legjislacionit përkatës, është krijuar një strukturë koherente institucionale e cila tashmë ka prodhuar rezultate konkrete. Disa nga arritjet kryesore të reformës në drejtësi në këto katër vitet e fundit janë përmbledhur më poshtë.

Procesi i rivlerësimit (*veting)* ka ecur në mënyrë të qëndrueshme. Deri më 15 shtator 2021, institucionet e *vetingut* kanë përfunduar 437 çështje rivlerësimi në shkallë të parë, përfshirë të gjitha dosjet me përparësi. Nga 437 vendime, 298 vendime janë të formës së prerë (d.m.th. pas ankimimit). Në total, rreth 62 % e dosjeve të *vetingut* të shqyrtuara deri tani, kanë rezultuar në shkarkime dhe përfundim të rivlerësimit për shkak të dorëheqjeve nga subjektet apo arritjes së moshës për pension. Për 23 subjekte të shkarkuara, Prokuroria e Posaçme ka çelur hetime penale për deklaratat e pasurisë. Procesi i krijimit të institucioneve të pavarura të qeverisjes së gjyqësorit, si Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) ka përfunduar me sukses dhe këto institucione janë plotësisht funksionale. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi është mbledhur dhe ka përfunduar me sukses procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve për gjashtë pozicione gjyqtari në Gjykatës Kushtetuese dhe në ILD. Është ngritur një arkitekturë gjithëpërfshirëse institucionale për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Struktura Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar përbëhet nga Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH), prokuroritë e posaçme, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për gjykimin e rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Prokurori i Përgjithshëm u emërua me një procedurë transparente në dhjetor 2019, ndër kandidatët që kishin kaluar procesin e rivlerësimit (*vetingut).* Me emërimin e gjashtë gjyqtarëve, Gjykata Kushtetuese është tashmë plotësisht funksionale. Procesi i ringritjes së Gjykatës së Lartë u përfundua me ngritjen në detyrë nga KLGj të gjashtë gjyqtarëve të rinj në mars dhe korrik 2021. Me nëntë gjyqtarë në detyrë, Gjykata e Lartë e ka kuorumin e nevojshëm për të ushtruar funksionet juridiksionale, përfshirë vendimmarrjen për rekurset kundër vendimeve të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe unifikimin e praktikës gjyqësore. Pas emërimeve të reja në Gjykatën e Lartë, niveli i përfundimit të çështjeve u rrit ndjeshëm me 46% krahasuar me një vit më parë. Gjykata e Lartë ka dhënë 3 690 vendime qëkur u bë funksionale në mars 2020 deri në qershor 2021. Gjatë tremujorit të parë të vitit 2021, Gjykata e Lartë ka dhënë 647 vendime të formës së prerë, nga të cilat: 145 të miratuara nga kolegji administrativ, 241 nga kolegji civil dhe 261 nga kolegji penal. Në korrik 2020, Gjykata e Lartë miratoi udhëzime për reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit të vet. Që nga viti 2016, në gjyqësor janë punësuar 869 punonjës shtesë. Gjithashtu, janë realizuar investime infrastrukturore të mëdha, siç është rasti i godinës së Polit të Drejtësisë dhe investimet thelbësore në ambientet e organeve të *vetingut,* SPAK dhe ILD.

KLGJ dhe KLP në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës po shumëfishojnë përpjekjet për plotësimin e vendeve vakante në drejtësi. Emërimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve menaxhohen ekskluzivisht nga institucionet e reja dhe të

pavarura të gjyqësorit, me kusht që të kryhet trajnimi i detyrueshëm fillestar në Shkollën e Magjistraturës, si një garanci e rëndësishme shtesë për pavarësinë e magjistratëve. Procesi i rekrutimit në Shkollën e Magjistraturës është përmirësuar. KLGJ dhe KLP kontrollojnë aftësitë dhe pasuritë e kandidatëve përpara pranimit të tyre. KLGJ dhe KLP kanë punuar për krijimin e kuadrit të përshtatshëm për vlerësimin etiko-profesional të magjistratëve, me qëllim që të garantohet llogaridhënia e tyre.

Problematik mbetet numri i çështjeve të prapambetura, me 77 853 të tilla deri në vitin 2019, nga të cilat 72% janë regjistruar në gjykatat e Tiranës. Shumica janë çështje civile (48.1%) dhe çështje tregtare (33.5%). Shumica e çështjeve konstatohet në gjykatat e apelit (58% e çështjeve në Tiranë). Nisma për riorganizimin e sistemit gjyqësor përmes një Harte Gjyqësore synon rritjen e efikasitetit në sistemin e drejtësisë. Procesi bazohet në një vlerësim të nevojës për rishpërndarjen e burimeve njerëzore në gjykata, parë në lidhje me numrin e çështjeve të regjistruara në çdo rreth të veçantë si dhe numrin e çështjeve të prapambetura, duke evidentuar rëndësinë e të dhënave statistikore në hartimin e Hartës Gjyqësore. Qëllimi është të maksimizohen burimet njerëzore dhe financiare, të rritet efikasiteti i gjykatave, të përmirësohet kohëzgjatja dhe përfundimi i shqyrtimit të çështjeve, si dhe të përmirësohet aksesi në drejtësi për qytetarët. Grupi Ndërinstitucional i Punës që konsiston në përfaqësues të gjykatave vendase, KLGJ, Ministria e Drejtësisë dhe partnerë ndërkombëtarë si Këshilli i Evropës, EURALIUS dhe Projekti i USAID "Drejtësi për të Gjithë“ po punon për finalizimin e Hartës së re Gjyqësore.

Po ashtu, po punohet për krijimin e një sistemi të ri modern e gjithëpërfshirës dhe të integruar të menaxhimit të çështjeve, (ICMS) i cili të ndërlidhet me bazat e tjera të të dhënave publike. Sipas dispozitave ligjore në fuqi, KLGJ ka përgjegjësinë për zhvillimin, koordinimin dhe mirëmbajtjen e sistemit elektronik të TI-së. Kjo shërben për ngritjen e sistemit të menaxhimit të çështjeve dhe miratimin e rregullave për funksionimin dhe sigurinë e këtij sistemi, si dhe për mbrojtjen e të dhënave personale që hidhen dhe ruhen në sistem. Në dhjetor 2019, KLGJ miratoi organikë të re, e cila përfshin një drejtori të posaçme të sistemeve të TI-së për gjykatat dhe postin e drejtorit të përgjithshëm. Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është ngritur me vendim të Këshillit të Ministrave, me pjesëmarrje shumëdisiplinore nga institucionet e drejtësisë. Me mbështetjen e Misionit EURALIUS V, KLGJ realizoi një studim që rezultoi në disa alternativa se si të zhvillohet sistemi ICMS dhe si të ndërlidhet me të gjitha bazat e tjera të të dhënave publike. Hapi i radhës i takon Qendrës së TI-së që të miratojë një plan të konsoliduar veprimi/udhërrëfyes për dixhitalizimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri dhe të fillojë implementimin e sistemit të ri ICMS. Në tetor 2021, KLGJ, në koordinim të ngushtë me institucionet e pavarura të qeverisjes së gjyqësorit, hartoi një projekt-udhërrëfyes që përcakton hapat konkretë për funksionimin efektiv të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve.

Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim m të gjitha institucionet e reja të drejtësisë dhe me ndihmën e ekspertëve të EURALIUS V, po harton një Strategji ndërsektoriale të Drejtësisë për periudhën 2021-2025 dhe Planin e saj të Veprimit, bashkë me pasaportën e indikatorëve, me qëllim që të adresojë sfidat e reja që paraqet faza e dytë e zbatimit të reformës në drejtësi në Shqipëri. Procesi filloi në maj 2020 me përgatitjen e një vlerësimi afatmesëm të Strategjisë në fuqi, bazuar në situatën aktuale. Strategjia e re ndërsektoriale e Drejtësisë 2021-2025 – e cila pritet të miratohet në fund të vitit 2021 – bazohet në vizionin e qartë për rritjen e efektivitetit të sistemit të reformuar gjyqësor dhe për përmirësimin e shërbimeve në përputhje me standardet evropiane.

Ministria e Drejtësisë është institucioni kryesor përgjegjës për kapitullin 23 të negociatave të anëtarësimit me BE-në. Kjo Ministri është përgjegjëse edhe për zbatimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKI), përkatësisht Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” i cili është seksion kyç për negociatat e anëtarësimit. Duhet të shqyrtohen 126 akte (61 akte nga "*acquis* e fortë" dhe 65 akte nga "*acquis* e butë") dhe të identifikohen dhe mbushjen boshllëqet ligjore në përafrimin me *acquis* të BE-së. Sektori i drejtësisë është pjesë e Programeve Buxhetore Afatmesme të Qeverisë, ku Ministria e Drejtësisë ka 8 programe buxhetore dhe Institucionet e Pavarura të Sistemit të Gjyqësorit po 8 të tilla. Alokimi financiar total në vitin 2020 ishte rreth 115 milion Euro, ose 4% e shpenzimeve buxhetore totale. Për më tepër, prioritetet e reformës në drejtësi të përcaktuara në projekt-Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë janë duke u marrë në konsideratë për hartimin e Programit të ri Buxhetor Afatmesëm për vitet 2022-2024.

2.2. Analiza e problematikave në fushat që do të mbështeten

Fusha e Mbështetjes #1: Efikasiteti dhe transparenca e sistemit të drejtësisë

Sistemi gjyqësor ka nevojë urgjente për një sistem adekuat dhe plotësisht funksional të menaxhimit të çështjeve (ICMS). Sistemi i parë i menaxhimit të çështjeve në Shqipëri u krijua në vitin 2007 (ICMIS) dhe përdoret nga të gjitha gjykatat, me përjashtim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Raporti i Komisionit Evropian 2021[1] vuri në dukje se sistemi

[1] SWD(2021) 289 final

aktual elektronik i menaxhimit të çështjeve ka shumë mangësi: "Shqipëria ka bërë përparim të kufizuar në rekomandimin e vitit 2020 për të përmirësuar sistemin e menaxhimit të çështjeve, i cili mbetet i paplotësuar". Komisioni i rekomandoi Shqipërisë të ndërmarrë hapa vendimtarë vitin pasues drejt një sistemi të ri të integruar të menaxhimit të çështjeve dhe të sigurojë ndërveprimin e sistemit në të gjithë sistemin e drejtësisë, në përputhje me metodologjinë e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ). Kapacitetet aktuale buxhetore dhe burimet njerëzore të alokuara për ICMS janë të pamjaftueshme për një *remont* të plotë të sistemit ekzistues dhe për të krijuar një sistem gjithëpërfshirës të menaxhimit të çështjeve. Gjykatat e rretheve dhe të apelit kanë nevojë për mbështetje për të rritur efikasitetin në gjykime, pasi qytetarët presin shërbime më të shpejta dhe më efektive nga gjykatat. Sistemit aktual i mungojnë shumë funksionalitete dhe nuk ofron të dhëna statistikore të shëndosha, të besueshme dhe koherente bazuar në metodologjinë e CEPEJ. Gjithashtu, i mungon ndërveprimi (ndërlidhja) e duhur me sistemet/bazat e të dhënave shtetërore. Për më tepër, mungon personeli teknik i trajnuar mjaftueshëm. Mosfunksionimi i duhur i sistemit të menaxhimit të çështjeve ndikon te mekanizmat e mbledhjes së të dhënave që shërbejnë për qëllime statistikore. Caktimi rastësor i çështjeve nëpër prokurori mbetet ende një çështje që duhet zbatuar me prioritet.

KLGj ka hartuar një projekt-plan veprimi/udhërrëfyes për dixhitalizimin e sistemit gjyqësor në Shqipëri (projekt-udhërrëfyesi ICMS), sipas të cilit ngritja e ICMS të ri duhet të ndjekë katër hapa: 1) ngritjen e sistemit të menaxhimit të çështjeve (softueri); 2) ngritjen e Qendrës së Të Dhënave (hardueri); 3) ngritjen e infrastrukturës së komunikimit ndërmjet gjykatave (hardueri dhe softueri); dhe 4) përmirësimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në secilën gjykatë (hardueri). Zhvillimi i softuerit (hapi 1) ka filluar pjesërisht, por kërkon edhe finalizimin e kuadrit të nevojshëm ligjor (akte nënligjore) që përcakton funksionet kryesore të ICMS. Këtu përfshihen nivelet e ndërlidhjes së sistemeve dhe ndërfaqjeve të gjykatave, prokurorive dhe ndoshta policisë me sistemet TI dhe bazat e të dhënave të tjera, si p.sh. me sistemin ALBIS (sistemi i menaxhimit elektronik të çështjeve të përmbarimit gjyqësor), me sistemin e Njësisë së Inteligjencës Financiare, me kadastrën dixhitale të pronave, me regjistrat dixhitale të noterisë, apo me bazën e të dhënave të Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI). Edhe pse është përgatitur projekt-plani i veprimit/udhërrëfyesi, disa elementë ende nuk janë adresuar. Përcakton një kohë jashtëzakonisht të gjatë për zbatimin dhe i mungon një mekanizëm monitorimi efektiv. Gjithashtu, miratimi i udhërrëfyesit u vonua nga mosemërimi i kandidatëve për bordin e Qendrës TI dhe i Drejtorit të saj. Zbatimi i planit të veprimit/udhërrëfyesit duhet të fillojë në vitin 2022.

Në fund të vitit 2020, Këshilli i Ministrave (VKM nr. 972, datë 02.12.2020) miratoi rregullat për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin Gjyqësor. Qendra do ta ketë vendndodhjen në Tiranë dhe do të drejtohet administrativisht nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Qendra ka një buxhet të posaçëm që miratohet çdo vit. Funksioni kryesor i Qendrës është përcaktimi i standardeve dhe politikave në përputhje me rregullat mbi politikat e përgjithshme shtetërore për sistemin e teknologjisë së informacionit në sistemin e drejtësisë, me qëllim funksionimin efektiv të teknologjisë së përpunimit të informacionit dhe sistemeve të të dhënave (harduerë dhe softuerë), duke garantuar plotësim të nevojave të institucioneve të sistemit të drejtësisë. Rregulla të tilla përfshijnë strategjinë për teknologjinë TI në sistemin e drejtësisë, rregullat për mbrojtjen e të dhënave, politikat e përgjithshme për kapacitetet e personelit të TI-së, prioritetet e projekteve të reja për dixhitalizimin dhe kompetenca të ngjashme. Qendra e TI-së është strukturë ndërinstitucionale e përbërë me përfaqësues nga të gjitha institucionet e drejtësisë, përfshirë gjykatat dhe prokuroritë, si dhe nga Ministria e Drejtësisë dhe Shkolla e Magjistraturës. Qendra ende nuk është ngritur (ngritja e Bordit Drejtues dhe emërimi i Drejtorit Ekzekutiv priten të finalizohen në fund të vitit 2021). Qendra e TI-së do të asistohet nga Trupa Këshillimore e përbërë nga personeli më i lartë i TI-së prej secilit institucion të drejtësisë.

Palët kryesore të interesit janë: Këshilli i Lartë Gjyqësor (dhe Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë), Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokuroria e Përgjithshme, gjykatat dhe prokuroritë në të gjitha nivelet, përfshirë strukturat e specializuara kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Këto institucione janë përdoruesit e ardhshëm të sistemit ICMS: Byroja Kombëtare e Hetimit, Policia e Shtetit, Sistemi i Menaxhimit Elektronik të Çështjeve të Përmbarimit Gjyqësor (ALBIS) dhe Njësia e Inteligjencës Financiare (NjIF). Palë të interesuara janë edhe janë Ministria e Drejtësisë, Komisioneri për Të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e Të Dhënave Personale, Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Këshilli i Ministrave. Akses i veçantë duhet të sigurohet në bazën e të dhënave për çështjet e unifikuara të Gjykatës Gjyqësore dhe Praktikën Gjyqësore për Shkollën e Magjistraturës.

Ky Veprim është në përputhje të plotë me rekomandimet e Komisionet si dhe me Strategjinë (aktuale dhe projekt) ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025, Objektivi Specifik 4.1: Zhvillimi i plotë i Sistemit të integruar të e-drejtësisë me një identifikues të unifikuar, sistemeve të përditësuara të menaxhimit të çështjeve, regjistrimit elektronik të bazuar në internet për të tre fushat ligjore (penale, administrative, civile) dhe lidhjeve me regjistrat dhe bazat e të dhënave përkatëse kombëtare (duke përfshirë zhvillimin e kapaciteteve institucionale, pajisjet, programet kompjuterike). Për më tepër, lidhet me Objektivin Specifik 2.4: Përmirësimi i sistemit gjyqësor me qëllim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të të gjitha niveleve të sistemit gjyqësor, duke përfshirë GJL-në, dhe sigurimi i ofrimit të drejtësisë transparente, pa vonesa dhe të aksesueshme për qytetarët.

Fusha e Mbështetjes #2: Forcimi i profesionalizmit të sistemit të drejtësisë.

Ministria e Drejtësisë vepron si koordinatore e reformës në drejtësi, me përgjegjësinë për analizimin, hartimin e legjislacionit dhe koordinimin e palëve të interesuara, në kuadrin e negociatave të anëtarësimit në BE. Por, Ministria e Dreqësisë ka kapacitete të pamjaftueshme, si për zbatimin e politikave, ashtu edhe për përfarimin ligjor dhe përgatitjet për negociatat e anëtarësimit, me qëllim që të garantohet përputhshmëri dhe harmonizim i plotë i legjislacionit në fushën e gjyqësorit dhe, ndër të tjera, i *acquis* të BE-së në këtë fushë. MD e ka evidentuar faktin që duhet të përmirësojë kapacitetet e veta me qëllim që të përballojë hartimin e politikave dhe procesin a anëtarësimit, në kuadër të të cilit aktet ligjore do të analizohen dhe boshllëqet ligjore në përafrimin me *acquis* të BE-së do të identifikohen dhe plotësohen. Drejtoria e Kodifikimit, e cila do të jetë përgjegjëse për përafrimin ligjor, ka nevojë për mbështetje. Për më tepër, pjesëtarëve të Grupit Ndërinstitucional të Punës për Kapitullin 23 (GNPIE 23) u mungon ekspertiza lidhur me analizën e legjislacionit, hartimin e legjislacionit dhe përkthimet.

Në Ministrinë e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Drejtoria e Kodifikimit janë përgjegjëse për strategjitë lidhur me sistemin e drejtësisë si dhe për tërë procesin e hartimit të legjislacionit. Palë të tjera të rëndësishme në këtë proces janë edhe anëtarët e GNPIE 23.

Ky Veprim është në përputhje të plotë me Strategjinë (aktuale dhe projekt) ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025, Objektivi Specifik 4.4: Përditësimi i kuadrit ligjor dhe kapaciteteve të MD-së dhe përmirësimet në fushën e bashkëpunimit ligjor ndërkombëtar global, dhe Shqipëria përgatitet për anëtarësimin në BE me anë të harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me *acquis* e BE dhe aktet e tjera të integrimit me BE dhe shtetet anëtare në fushën e drejtësisë. Raporti i Komisionit Evropian 2021[2] rekomandon miratimin në kohë të Strategjisë ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 dhe Planit të Veprimit të saj.

Për më tepër, strategjia kombëtare përcakton nevojën për të përmirësuar funksionimin e sistemit të drejtësisë, duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe aksesueshmërinë sipas standardeve, duke qenë në përputhje të plotë e objektin e këtij Veprimi.

2.3. Relevanca dhe komplimentariteti me strategjitë e mbështetura nga palët e interesuara kryesore kombëtare

Shqipëria ka krijuar një sistem gjithëpërfshirës për politikëbërjen dhe koordinimin. Sistemi i Planifikimit të Integruar (IPS) ofron arkitekturën e përgjithshme për të siguruar që planifikimi, buxhetimi dhe monitorimi i politikave të qeverisë të jenë të lidhura dhe të funksionojnë në mënyrë efikase. SPI përbëhet nga tri shtylla: strategjitë kombëtare dhe sektoriale që ofrojnë udhëzime për politikëbërjen e nivelit të lartë; procesi i integrimit evropian që përshkruan planifikimin dhe burimet për të arritur objektivat sipas agjendës së integrimit në BE; dhe procesi i buxhetimit afatmesëm që detajon planifikimin afatshkurtër dhe afatmesëm si dhe modalitetet financiare për zbatimin e politikave nga çdo ministri institucion shtetëror. Politikat në këtë sektor monitorohen dhe raportohen nëpërmjet raporteve të monitorimit për ecurinë e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZhI). Mekanizmi kryesor i koordinimit të politikave të Qeverisë është Grupit i Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) për konsultim, monitorim dhe koordinim të politikave për integrimin në BE dhe të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian i cili u riaktivizua në fund të vitit 2018, me Urdhër të Kryeministrit. nr. 157, datë 22.10.2018. GMIP-të kanë rol vendimtar në programimin dhe monitorimin e zbatimit të strategjive sektoriale në Shqipëri, duke përfshirë koordinimin e palëve të ndryshme, diskutimin dhe sigurimin e përqasjeve të qëndrueshme dhe të harmonizuara në përputhje me SKZHI-në dhe planifikimin buxhetor afatmesëm.

Sa i përket sektorit të drejtësisë, raporti i fundit i monitorimit sektorial evidentoi nevojën për fuqizim të konsiderueshëm të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të MD-së, Shkollës së Magjistraturës dhe institucioneve të pavarura; si dhe nevojën për një sistem të integruar të menaxhimit të çështjeve me qëllim që gjykatat e rrethit dhe të apelit të rifitojnë efikasitetin. Përqasja sektoriale për Strategjinë e Drejtësisë drejtohet nga Komiteti Drejtues Sektorial për Reformën në Drejtësi. Raporti i fundit i monitorimit për strategjinë e sektorit të drejtësisë (maj 2021) identifikon si mangësi kryesore mungesën e një sistemi plotësisht të integruar të menaxhimit të çështjeve dhe të burimeve njerëzore dhe buxhetore për zbatimin e fushave kryesore prioritare. Ministria e Drejtësisë, përgjegjëse për zbatimin dhe koordinimin e Strategjisë, ka përgatitur projekt-strategjinë për sektorin e drejtësisë 2021-2025. Prioriteti kryesor i kësaj strategjie është krijimi i një sistemi të ri të integruar të menaxhimit të çështjeve – siç pasqyrohet në objektivat 1, 4 dhe 5. Sistemi i ri fokusohet te efikasiteti i sistemit, menaxhimi i përgjithshëm i gjykatave dhe i dosjeve gjyqësore, po aq sa edhe te kapacitetet e MD-së dhe institucioneve të tjera për të përgatitur analiza cilësore mbi bazën e të dhënave të besueshme.

[2] SWD(2021) 289 final

Sistemi SPI siguron që politikat e gjyqësorit të jenë të lidhura me Planifikimin Buxhetor Afatmesëm (PBA), në kuadër të programeve buxhetore specifike të Ministrisë së Drejtësisë dhe programeve të dedikuara për institucionet e pavarura (KLGJ, KLP, Prokuroria, ILD. etj.), duke detajuar rezultatet afatshkurtra dhe afatmesme dhe kostot e tyre.

2.4. Relevanca dhe komplimentariteti me politikën e BE-së dhe asistencën e BE-së dhe donatorëve të tjerë

Objektivat dhe rezultatet e pritshme të Veprimit janë plotësisht në përputhje me synimin e **Kuadrit Programues IPA III** për të kontribuar në përmirësimin e efikasitetit, llogaridhënies dhe profesionalizmit të sistemit të drejtësisë në tërësi, si dhe për të ofruar shërbime për qytetarët bazuar në standardet më të mira të BE-së. Për më tepër, Veprimi është koherent me mbështetjen e parashikuar nga IPA III për aspektet organizative, që parashikon futjen e një sistemi modern të menaxhimit të çështjeve, rritjen e kapaciteteve për monitorimin dhe vlerësimin e performancës, përdorimin e të dhënave në mënyrë proaktive dhe për qëllime planifikimi, si dhe përdorimin e të dhënave dhe mjeteve TIK si p.sh. dixhitalizimi i sistemeve të menaxhimit. Kjo mbështetje është thelbësore që proceset gjyqësore të jenë të drejta dhe të realizohen në kohë, si dhe që të përmirësohet efikasiteti i ofrimit të shërbimeve dhe parashikueshmëria ligjore për profesionistët dhe përdoruesit e gjykatave. Në koherencë me Prioritetin Tematik 1, ky Veprim forcon sistemet për garantimin dhe monitorimin e integritetit të magjistratëve, përmirëson transparencën e sistemit të drejtësisë dhe sjell komunikimin më të mirë me publikun mbi funksionimin e sistemit të drejtësisë.

Veprimi është në përputhje me **Strategjinë për Ballkanin Perëndimor**[3] që kërkon arritjen e rezultateve konkrete në reformën në drejtësi dhe forcimin e institucioneve në të gjitha nivelet e administrimit të drejtësisë në veçanti, si dhe në zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA, 2009) e cila, sipas nenit 78, kërkon që Shqipëria të forcojë pavarësinë e gjyqësorit.

Sa i përket funksionimit të gjyqësorit, **Raporti i Komisionit Evropian 2021**[4] thekson se është bërë progres i kufizuar në rekomandimin për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve, i cili mbetet i parealizuar, si dhe rekomandon që në të ardhmen e afërt Shqipëria të ndërmarrë hapa vendimtarë drejt realizimit të një sistemi të ri të integruar të menaxhimit të çështjeve dhe të garantojë ndërlidhjen e tij në të gjithë sistemin e drejtësisë, në përputhje me metodologjinë e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ).

Veprimi është gjithashtu në linjë me prioritetet kryesore për sektorin e drejtësisë sipas **Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2021-2023** / Kapitulli 23 "Gjyqësori dhe Të Drejtat Themelore": miratimi i hartës së re gjyqësore dhe forcimi i përdorimit efektiv të një sistemi të përmirësuar të menaxhimit të çështjeve, me kapacitet të shëndoshë statistikor bazuar në metodologjinë CEPEJ, e cila siguron rastësinë në caktimin e çështjeve.

Veprimi është komplementar me **projektet e tjera të financuara prej BE-së** në mbështetje të reformës në drejtësi, konkretisht Euralius V dhe Pameca V që kanë ndihmuar përkatësisht në sistemet e menaxhimit të çështjeve në gjyqësor (ICMIS) dhe Prokurori (CAM); projekt SEJ në kuadrin e Instrumentit Horizontal BE-Këshilli i Evropës, që është fokusuar në efikasitetin e drejtësisë dhe sidomos në standardizimin e statistikave dhe bazën ligjore, si edhe mbështetja vijuese për Këshillin e Lartë Gjyqësor (IPA 2020) që do të vazhdojë punën e nisur nga Euralius V në mbështetje të këtij Këshilli. Veprimi është komplementar edhe me asistencën teknike për Ministrinë e Drejtësisë në lidhje me koordinimin dhe monitorimin e reformës në drejtësi, si edhe binjakëzimit vijues për Shkollën e Magjistraturës (IPA 2020). Falë këtyre ndërhyrjeve si Kontrata e Reformës Sektoriale në mbështetje të reformës në drejtësi dhe Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit për procesin e rivlerësimit (*vetingut)*, BE-ja ofron mbështetje gjithëpërfshirëse për të gjitha institucionet kryesore dhe organet e pavarura të sistemit të drejtësisë në Shqipëri.

2.5. Mësimet e nxjerra dhe lidhjet me asistencën financiare të mëparshme

BE-ja u ka dhënë mbështetje të qenësishme autoriteteve shqiptare në fushat e Shtetit të Së Drejtë dhe Reformës në Drejtësi. Mësimi më domethënës ndërsektorial i nxjerrë nga zbatimi i asistencës së mëparshme financiare është se maksimizimi i përfitimeve të asistencës kërkon angazhim të plotë të palëve të interesuara dhe koordinim, monitorim dhe ndjekje të fortë nga institucionet kryesore përfituese.

Kontrata e Reformës Sektoriale sipas IPA 2018 në mbështetje të reformës në drejtësi fokusohet në reformat kryesore institucionale dhe në forcimin e kapaciteteve të palëve të ndryshme të gjyqësorit dhe të shtetit të së drejtës, kryesisht përmes asistencës për modernizimin e sistemit të drejtësisë dhe mbështetjes për rritjen e efikasitetit të agjencive ligjzbatuese dhe prokurorive. Mësimet kryesore të nxjerra përmes asistencës IPA është nevoja për një nivel më të lartë "pronësie" nga vendi përfitues për të garantuar si shënjestrimin e duhur të fondeve si dhe zbatimin efektiv. Ndërhyrjet

[3] COM(2018) 65 final
[4] SWD(2021) 289 final

e donatorëve nuk mund të zëvendësojnë sistemet në vend dhe mospërdorimin e mjaftueshëm të tyre në dobi të dhënies dhe administrimit të drejtësisë. Këtu përfshihet forcimi i vazhdueshëm i statistikave, kapaciteteve raportuese dhe monitoruese, si edhe aftësitë analizuese. Kjo vlen sidomos për Ministrinë e Drejtësisë e cila ka përgjegjësinë kryesore për koordinimin dhe hartimin e politikave.

Raporti përfundimtar "Vlerësimi i programeve IPA në sektorin e Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme (DÇB) në Shqipëri" arriti në përfundimin se ndikimi i mbështetjes së BE-së në përmirësimin e standardeve të sundimit të ligjit dhe ligjzbatimit kufizohet nga dobësitë sistemike, por do të përmirësohet sapo reforma në drejtësi të heqë pengesat strukturore ekzistuese. Raporti thekson se seria e projekteve EURALIUS dhe PAMECA kanë një historik të suksesshme arritjesh në sektorët e drejtësisë dhe ligjzbatimit. Nevojitet koordinim më i mirë i rezultateve të ndërhyrjeve të kaluara në infrastrukturën teknike. Raporti rekomandon që mbështetja e EURALIUS dhe PAMECA të fokusohet në të ardhmen në monitorimin e performancës së gjykatave dhe prokurorive. Fusha të tjera të rëndësishme të ndërhyrjes janë: (i) ngritja e kapaciteteve për zbatimin e strategjisë së re të sektorit të drejtësisë në lidhje me planifikimin, monitorimin, hartimin e legjislacionit dhe vlerësimin legjislativ/rregullator; (ii) zhvillimin e një sistemi karriere gjyqësore; (iii) përmirësimi i sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve; (iv) vlerësimi i cilësisë dhe rishikimi i kuadrit legjislativ në disa fusha për të siguruar përputhshmërinë me *acquis* dhe praktikat më të mira të BE-së; dhe (v) forcimi i sistemit statistikor për të dhënat gjyqësore.

Përvoja e mëparshme me zbatimin e softuerit të integruar të menaxhimit të çështjeve ka treguar se një faktor vendimtar është disponueshmëria e një numri të mjaftueshëm të personelit teknik të trajnuar, të cilët ndihmojnë përdoruesit se si të përdorin sistemin në mënyrë efektive dhe të kontribuojnë në zhvillimin e tij. Fushat që theksohen në këtë dokument për t'u mbështetur në të ardhmen, janë gjerësisht në përputhje me shumicën e masave të propozuara në këtë dokument.

3. PËRSHKRIMI I VEPRIMIT

3.1. Rezultat e planifikuara dhe logjika e ndërhyrjes

Veprimi kontribuon në forcimin e shtetit të së drejtës dhe në rritjen e besimit të sistemi i drejtësisë në Shqipëri.

Rezultati 1 – Ngritja e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve realizohet përmes tre produkteve:
Produkti 1 – Miratohet kuadrit ligjor dhe i politikave për ICMS;
Produkti 2 – ICMS ngrihet dhe bëhet funksionale; dhe
Produkti 3 – Personeli TI trajnohet dhe strategjia e mirëmbajtjes miratohet.

Këto produkte do të kontribuojnë në rritjen e efikasitetit dhe transparencës së sistemit të drejtësisë. Këtu përfshihet ngritja e kuadrit ligjor dhe të politikave, përcaktimi i softuerit dhe sigurimi i harduerit përkatës, si edhe trajnimi i përdoruesve të sistemit. Për të garantuar qëndrueshmërinë e sistemit, do të miratohet një politikë e qëndrueshme mirëmbajtjeje tërësore për sistemin dhe do të trajnohet personeli i dedikuar TI mbi mirëmbajtjen afatgjatë të Sistemit të Integrues të Menaxhimit të Çështjeve. Për mirëmbajtjen e sistemit, do të forcohen kapacitetet e brendshme për të garantuar efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e sistemit në të ardhmen.

Fokusi është te krijohet një sistemi menaxhimi të çështjeve që është efektiv dhe plotësisht i integruar, i përditësuar në përputhje me kuadrin legjislativ aktual, i cili garanton caktim të rastësishëm të çështjeve dhe që ndërvepron me të tjera baza të dhënash publike. Sistemi i ri i menaxhimit të integruar të çështjeve do të garantojë mekanizma të duhur të mbledhjes së të dhënave për qëllime statistikore bazuar në metodologjinë e CEPEJ-it dhe standardet për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave. Bashkëpunimi në këtë drejtim me Këshillin e Evropës ka nisur tashmë në kuadrin e Instrumentit Horizontal BE-KiE, Forcimi i Cilësisë dhe Efikasitetit të Drejtësisë në Shqipëri (SEJ III) dhe do të vazhdojë, veçanërisht në ngritjen e bazës ligjore dhe harmonizimin e të gjitha institucioneve përgjegjëse për integrimin e sistemeve (KLP, MD, KLGj).

Rezultati 2 – Përmirësimi i hartimit të legjislacionit dhe harmonizimit ligjor me *acquis* të BE-së – arrihet përmes dy produkteve:

Produkti 1 – Përmirësohen kapacitet e MD-së për analiza, hartimin e legjislacionit dhe procesin e koordinimit me BE-në;

Produkti 2 – Forcohet harmonizimi ligjor me *acquis* të BE-së në fushën e gjyqësorit.

Kapacitetet e personelit të Ministrisë së Drejtësisë në analiza, hartim legjislacioni dhe koordinimin e procesit të integrimit në BE do të përmirësohen nëpërmjet *coaching* dhe trajnimeve, kryesisht të Departamentit të Kodifikimit. Kapacitetet për harmonizimin ligjor dhe përafrimin me *acquis* përkatëse të BE-së do të përmirësohen nëpërmjet: miratimit të një metodologjie për hartimin e legjislacionit, mbështetjes për rishikimin e dokumenteve strategjike brenda Kapitullit 23 sipas grupimit përkatës, dhe përgatitjes së legjislacionit parësor dhe akteve nënligjore në përputhje me *acquis* të BE-së. Për më tepër, kapacitetet e brendshme dhe koordinuese në MD si dhe kapacitetet e GNPIE 23 për negociatat e anëtarësimit do të përmirësohen përmes trajnimeve dhe *coaching*.

3.2. Aktivitetet indikative

Veprimi do të mbështetë arritjen e Produktit 1, Produktit 2 dhe Produktit 3 në kuadrin e Rezultatit 2, me **asistencë teknike** dhe **investime (furnizime)** si vijon:

- Finalizimi i analizës së nevojave dhe mangësive teknike aktuale të Sistemit të Menaxhimit të Integruar të Çështjeve si edhe asistenca në finalizimin e politikës korresponduese;
- Asistencë për departamentet TI që të përmirësojnë/adresojnë mangësitë e identifikuara;
- Finalizimi i kuadrit rregullator;
- Dizenjimi i sistemit të ri (zhvillimi i softuerit);
- Prokurimi i komponentëve të nevojshëm për funksionimin e plotë dhe ndërlidhjen e Sistemit të Menaxhimit të Integruar të Çështjeve;
- Hartimi dhe zbatimi i një plani trajnimi për përdoruesit e sistemit ICMS;
- Dhënia e trajnimit për personelin e Qendrës TI të sistemit gjyqësor dhe për specialistët TI në të gjitha institucionet përkatëse, mbi mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit të Integruar të Çështjeve;
- Hartimi i një politike afatgjatë për mirëmbajtjen, e cila përfshin kostimin.

Produkti 1 dhe Produkti 2 të Rezultatit 2 do të realizohen përmes **binjakëzimit.** Aktivitetet e planifikuara janë:

- Mbështetje në nivel kolegësh (*peer-to peer*) në analizën dhe hartimin e legjislacionit.
- Përgatitja e një udhëzimi metodologjik mbi hartimin e legjislacionit, që do të miratohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit.
- Organizimi i seancave të *coaching* dhe trajnimit me grupin e punës të Kapitullit 23, me qëllim që të përmirësohet cilësia e dokumenteve strategjike në kuadrin e procesit të negociatave të para-anëtarësimit në BE për të gjithë pjesëtarët e GNPIE 23, si edhe metodologjia dhe teknikat e hartimit të legjislacionit.
- Ushtrime simuluese mbi analizimin dypalësh të legjislacionit (*screening*).
- Mbështetje në rishikimin e dokumenteve strategjike të Kapitullit 23 sipas grupimit përkatës.
- Mbështetje në përgatitjen dhe rishikimin e legjislacionit parësor dhe akteve nënligjore sipas *acquis* të BE-së.

3.3. Risqet dhe supozimet

Risqet	Niveli i Riskut (L/M/U)	Masat zbutëse
Prioriteti Tematik 1		
Risku 1: Mungesa ose pamjaftueshmëria e burimeve njerëzore, edhe për shkak të largimit së personelit	M	Forcimi i kapaciteteve
Risku 2: Mjete buxhetore të pamjaftueshme (Buxheti i Shtetit dhe/ose bashkëfinancime të tjera)	M	Monitorim i ngushtë dhe avokim për alokimin e buxhetit të përshtatshëm për Qendrën TI Takime periodike koordinuese mes donatorëve me qëllim grumbullimin e fondeve donatore
Risku 3: Institucionet përfituese të ICMS kanë ekspertizë teknike të brendshme të pamjaftueshme për të marrë pjesë në zhvillimin e sistemit.	L	Miratimi i rregulloreve të proceseve të punës, procedurave standarde të punës dhe manualeve. Zbatimi i një programi trajnimi gjithëpërfshirës për përdoruesit, në intervale kohore gjatë zbatimit dhe përtej.
Risku 4: Institucione të ndryshme që menaxhojnë baza të dhënash shtetërore mund të mos japin akses dhe të pengojnë ndërlidhjen	M	Krijimi i dialogut ndërinstitucional me AKSHI-n (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit) dhe administrues të tjerë të bazave të të dhënave shtetërore. Hartimi dhe miratimi i procedurave të qatra që garantojnë ndërlidhje të plotë të sistemeve sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe akteve të tjera në fuqi.
Risku 5: Mungesa ose pamjaftueshmëria e burimeve njerëzore në MD për përafrimin e legjislacionit.	M	Angazhimi në dialog ndërinstitucional ndërmjet MD dhe pjesëtarëve të tjerë të GNP për Kapitullin 23.
Risku 6: Vonesa në miratimin e ICMS-së.	U	Projekt-udhërrëfyesi ICMS është hartuar dhe pritet të miratohet së shpejti. DBE do të vazhdojë dialogun e politikave me KLGJ dhe MD në rast vonesash.

Supozimet

Supozimet për Rezultatin 1:

- Burime financiare të mjaftueshme vihen në dispozicion të ngritjes, mirëmbajtjes dhe përforcimit të Sistemit të Menaxhimit të Integruar të Çështjeve.

Supozime për Produktet 1, 2 dhe 3 të Rezultatit 1:

- Bashkëpunimi ndërinstitucional brenda sistemit të drejtësisë realizohet;
- Plani i veprimit/udhërrëfyesi për dixhitalizimin e sistemit gjyqësor në Shqipëri miratohet;
- Plani i Menaxhimit të Gjykatave përgatitet dhe miratohet në kohë;
- Shkolla e Magjistraturës mbetet burimi i vetëm dhe i centralizuar i formimit të magjistratëve të rinj në sistem, si edhe rrit kapacitetet e personelit.
- Politika e mbajtjes së personelit në gjyqësor miratohet, për të garantuar nivel të ulët largimesh të personelit.

Supozimet për Rezultatin 2:

- Ligjet konsultohen në koordinim me të gjitha organet gjyqësore, por nën koordinimin e MD-së.

Supozimet për Produktet 1 dhe 2 të Rezultatit 2:

- Mbështetje financiare e mjaftueshme vihet në dispozicion të harmonizimit me *acquis* përkatëse;
- Departamenti i Kodifikimit plotësohet me personelin e duhur;
- Politika e mbajtjes së personelit në gjyqësor garanton nivel të ulët largimesh të personelit.

3.4. Harmonizimi me sektorë të tjerë

Barazia Gjinore dhe Fuqizimi i Grave dhe Vajzave: Veprimi do të mbështesë barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave në të gjitha aktivitetet në përputhje me Planin e Veprimit të Barazisë Gjinore III (2021-2025), duke mundësuar zhvillimin profesional të grave në këtë sektor. Pabarazitë midis grave dhe burrave në Shqipëri, vazhdojnë ende. Paragjykimet dhe stereotipat gjinorë rezultojnë në akses të pabarabartë të grave dhe burrave në drejtësi. Aksesi në drejtësi për gratë paraqet pengesa të mëdha në fusha si: titulli i tokës, legalizimi/regjistrimi i pronës, trashëgimia, pjesëtimi i pasurisë gjatë divorcit dhe pagesat e kompensimit pas ndarjes dhe pensionit ushqimor për fëmijët. Mungesa e aksesit të duhur të grave në gjykata vjen nga mungesa e mjeteve financiare, mungesa e njohurive dhe perceptimi i shoqërisë për pozitën e gruas në familje. Është shënuar rritje e kallëzimeve të grave për dhunë në familje. Gratë gjithashtu janë më të rrezikuara nga trafikimi i qenieve njerëzore. Statistikat tregojnë se shumica e përfituesve të ndihmës ligjore janë gra.

Sistemi modern i menaxhimit të çështjeve lehtëson menaxhimin e rasteve, garanton shpërndarjen e rastësishme të çështjeve dhe rrit transparencën, sepse mundëson ndjekjen e secilës çështje dhe ofron informacion statistikore të saktë dhe të përditësuar mbi ecurinë, shpërndarjen dhe menaxhimin e çështjeve, mes të tjerash. Kjo kontribuon për të pasur akses të barabartë dhe trajtim të barabartë të gratë dhe burrave në sistemin e drejtësisë.

Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike: Veprimi kontribuon në reformën në drejtësi, objektivi kryesor i të cilës është forcimi i shtetit të së drejtësi dhe zbatimit të ligjit, si edhe ulja e nivelit të korrupsionit në institucionet shtetërore dhe në gjyqësor. Rritja e efikasitetit të sistemit të drejtësisë përmes menaxhimit më të mirë të fluksit të çështjeve, do të rrisë kapacitetet e sistemit të drejtësisë në trajtimin e çështjeve komplekse, siç janë ato për problematika mjedisore. Sistemi modern i menaxhimit të çështjeve do të zvogëlojë ndjeshëm nevojën për printimin dhe fotokopjimin e dokumenteve (rrjedhimisht, zvogëlohet nevoja për printerë, fotokopje, hapësira magazinimi, etj.).

Përqasja Bazuar në Të Drejta: Veprimi mbështet ngritjen e sistemit modern të menaxhimit të çështjeve i cili, në planin afatmesëm dhe afatgjatë, ndikon te funksionaliteti i sistemit dhe garanton akses më të mirë për të gjithë në drejtësi dhe informacion gjyqësor. Statistikat më të mira do ta bëjnë sistemin e drejtësisë më transparent dhe kontribuojnë në evidentimin e rutinave/modeleve dhe praktikave diskriminuese.

Angazhimi me Shoqërinë Civile: Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) luajnë rol të rëndësishëm në zbatimin e Reformës në Drejtësi përmes aktiviteteve të tyre dhe veçanërisht rolit të tyre në monitorimin aktiv të sistemit të drejtësisë. Krijimi i një sistemi modern të menaxhimit të çështjeve do të rrisë transparencën dhe do të prodhojë statistika të besueshme, duke rritur kështu mundësitë e OSHC-ve për të monitoruar sistemin.

Të tjera (si Rezistenca dhe Ndjeshmëria ndaj Konfliktit, romët, personat me aftësi të kufizuar dhe grupet e tjera të cenueshme): Veprimi përmban një komponent të rëndësishëm që fokusohet te përafrimi i legjislacionit në sektorin e drejtësisë me *acquis* të BE-së. Gjatë rishikimit të legjislacionit ekzistues apo hartimit të legjislacionit të ri, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet mbrojtjes së të drejtave dhe mundësimit të aksesit në drejtësi për grupe specifike, sidomos personat që u përkasin pakicave dhe personat në situata vulnerabël si romët dhe egjiptianët, personat me aftësi të kufizuar, LGBTI, të varfrit, komunitetet rurale, të moshuarit, si edhe personat e stigmatizuar nga shoqëria si p.sh. përdoruesit e drogës, mbartësit e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, si dhe punonjësit e seksit.

Sistemi modern i menaxhimit të çështjeve garanton shpërndarje të rastësishme të çështjeve dhe rrit transparencën, duke mundësuar ndjekjen e çdo çështjeve, gjë që kontribuon në akses të barabartë dhe trajtim të barabartë të grupeve të pafavorizuara. Përveç kësaj, gjatë fazës së hartimit do të hulumtohet se deri ku është i mundur raportimi statistikor i zbërthyer (bazuar në përkatësinë etnike, aftësi të kufizuar, etj.) brenda kufijve të ligjit.

3.5. Kushtet për zbatimin

Për zhvillimin e Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Çështjeve të përditësuar (Rezultati 1), zbatimi normal i aktiviteteve përkatëse kërkon krijimin e kushteve si vijon:

- Qendra e TI-së për Sistemin e Drejtësisë ngrihet dhe plotësohet me personel, pajisje të nevojshme dhe mjete buxhetore para nënshkrimit të Marrëveshjes së Financimit;
- Plani i veprimit/udhërrëfyesi për dixhitalizimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, duke përfshirë kostot, afatet kohore dhe hapat konkretë për finalizimin e Sistemit të ri të Menaxhimit të Integruar të Çështjeve, miratohet përpara nënshkrimit të Marrëveshjes së Financimit;
- Çdo përdorues që është përfitues i Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Çështjeve, cakton një pikë kontakti (përgjatë zbatimit të programit).

Për mbështetjen për kapacitetet e analizës, hartimit të legjislacionit dhe koordinimit me BE-në (Rezultati 2), zbatimi normal i aktiviteteve përkatëse kërkon krijimin e kushteve si vijon:

- Departamenti i Kodifikimit pranë Ministrisë së Drejtësisë duhet të ketë personel të kualifikuar të mjaftueshëm. Të paktën 17 specialistë të hartimit të legjislacionit merren në punë dhe Drejtori i Përgjithshëm i Departamentit emërohet me kohë të plotë (përgjatë zbatimit të programit).

Para fillimit të Veprimit, KKIPA, Ministria e Drejtësisë dhe institucionet e pavarura miratojnë rregulla specifike për të garantuar që institucionet e pavarura t'i japin KKIPA-s dhe Ministrisë së Drejtësisë informacion josensitiv për qëllime monitorimi në kohën e duhur dhe në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga KKIPA për monitorimin e përdorimit të asistencës financiare IPA III.

Mosrespektimi i kërkesave më lart mund të rezultojë në rikuperim të fondeve në kuadrin e këtij programi dhe rialokim të fondeve në fusha të tjera të identifikuara në të ardhmen. Përfituesi duhet vazhdimisht të përditësojë dhe të raportojë mbi këto kushte, në kontekstin e raportimit periodik të Komitetit Drejtues për Reformën në Drejtësi.

3.6 Kuadri Logjik

Rezultatet	Zinxhiri i rezultateve: rezultatet kryesore të pritshme (maks. 10)	Treguesit (të paktën një tregues për rezultat të pritshëm)	Viti bazë	Synimet dhe viti i synuar	Burimet e të dhënave	Supozimet
Ndikimi	Forcimi i shtetit të së drejtës dhe rritja e besimit në sistemin e drejtësisë në Shqipëri	Progresi në realizimin e kritereve të anëtarësimit, progresi në funksionimin e gjyqësorit.	Nivel i mirë përgatitjeje (2021)	Shprehet qartë se është arritur progres i mirë ose shumë i mirë në përgatitje (2025)	Raporti i Komisionit Evropian Instrumenti i Propozuar për IPA III Treguesit kyç të performancës	Metodologjia e Raportit të Komisionit nuk ndryshon.
		Indeksi WJP për Shtetin e Së Drejtës – renditja globale.	78/126 (2020)	60/126	Indeksi WJP për Shtetin e Së Drejtës	
		CEPEJ *Dashboard* – Përdorimi i sistemit TI	90% Gjykata, 20 % prokurori	100% 2027	CEPEJ *Dashboard*	Sistemi është ngritur deri në 2025 dhe është integruar në të gjitha nivelet.
Rezultati 1	**Ngritja e Sistemit të Menaxhimit të Integruar të Çështjeve (ICMS)**	Numri i raporteve (me të dhëna statistikore të sakta për çdo Gjykatë) që prodhohen nga ICMS	0 (2021)	20 (2027)	Raporti vjetor i KLGJ	Burime financiare të mjaftueshme alokohen për ngritjen, mirëmbajtjen dhe përforcimin e ICMIS-it.
		Raportim konsistent mbi rastet e dhunës në familje, diskriminimin dhe pretendime prone nga pronaret gra.	0 (2021)	1 (2027)	Raporti vjetor i KLGJ	
Produkti 1	Miratohet kuadri ligjor dhe i politikave për ICMS	Miratimi i rregulloreve për të unifikuar mbledhjen e të dhënave statistikore	2	6	Raportet vjetore të KLGJ/KLP/PP	Vendoset bashkëpunimi ndërinstitucional brenda sistemit gjyqësor
Produkti 2	ICMS ngrihet dhe bëhet funksionale (hardueri dhe softueri)	Numri i hetimeve të realizuara përmes ICMS	55% (2019)[5]	100% (2027)	Raportet e MD-së dhe KLGJ-së	Miratohet plani i veprimit/udhërrëfyesi për dixhitalizimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri. Plani i Menaxhimit të Gjykatave përgatitet dhe miratohet në kohë.
		Numri i kurrikulave të trajnimit vazhdues dhe bazë në Shkollën e Magjistraturës për drejtuesit e gjykatës, raportimi i të dhënave statistikore dhe analiza e të dhënave (përfshirë analizën e të dhënave statistikore sipas barazisë gjinore)	1 për drejtuesit e gjykatës (2021)	1 kurrikul për trajnim fillestar dhe 5 module për trajnim të vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve në vit (2027)	Raporti vjetor i Shkollës së Magjistraturës	Shkolla e Magjistraturës mjetet burimi i vetëm dhe i centralizuar për magjistratët e rinj që hyjnë në sistem. Kjo Shkollë rritet kapacitetet e personelit.

5 Numri i çështjeve në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve që do të inkorporohen në sistemin e ri ICMS.

Rezultatet	Zinxhiri i rezultateve: rezultatet kryesore të pritshme (maks. 10)	Treguesit (të paktën një tregues për rezultat të pritshëm)	Viti bazë	Synimet dhe viti i synuar	Burimet e të dhënave	Supozimet
Produkti 3	Personeli IT trajnohet dhe strategjia e mirëmbajtjes miratohet.	Numri (ndarë sipas seksit) i specialistëve TI të trajnuar për të mirëmbajtur sistemin në gjykata dhe prokurori.	10% e personelit TI të trajnuar në ICMS	100% e personelit TI të trajnuar në ICMS (2025)	Raporti i Monitorimit të Strategjisë ndërsektoriale të Drejtësisë; KLGJ, PP	Miratohet politika e mbajtjes së personelit në sistemin gjyqësor, e cila siguron largim të ulët të personelit.
Rezultati 2	**Përmirësimi i hartimit të legjislacionit dhe harmonizimit ligjor me *acquis* të BE-së**	Numri i projektligjeve të shoqëruara me relacion të detajuar dhe opinencë, me gjithë të redaktuar, me implikime financiare dhe komente të palëve të interesuara.	0	80% (2027)	Raporti vjetor i MD-së. Raporti javor i veprimtarisë së Parlamentit.	Ligjet konsultohen në koordinim me të gjitha organet e gjyqësorit, por nën koordinimin e MD-së.
Produkti 1	Përmirësohen kapacitet e MD-së për analiza, hartimin e legjislacionit dhe procesin e koordinimit me BE-në.	% e personelit të synuar (ndarë sipas seksit) të institucioneve përkatëse që trajnohen.	0	100% (2027)	Raportet e monitorimit të projektit; Raporti i MD-së për Strategjinë ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025	Alokohet mbështetje financiare e mjaftueshme për harmonizimin e *acquis* përkatëse. Departamenti i Kodifikimit plotësohet me personelin e duhur.
Produkti 2	Forcohet harmonizimi ligjor me *acquis* të BE-së në fushën e gjyqësorit	Niveli i përafrimit shprehur në % të akteve ligjore që janë në linjë me *acquis* të BE-së (Kapitulli 23).	26% e legjislacionit të brendshëm i përafruar (2019)	80% (2027)	Raportet e Komisionit Evropian	Miratohet politika e mbajtjes së personelit në sistemin gjyqësor, e cila siguron largim të ulët të personelit.

4. MODALITETET E ZBATIMIT

4.1. Marrëveshja e financimit

Për zbatimin e këtij Veprimi, parashikohet lidhja e një marrëveshjeje financimi me Republikën e Shqipërisë.

4.2. Zbatimi i komponentit të mbështetjes buxhetore

N/A

4.3. Modalitetet e zbatimit

Komisioni do të garantojë respektimin e rregullave dhe procedurave përkatëse të BE-së për dhënien e financimeve palëve të treta, përfshirë procedurat e rishikimit sipas rastit dhe përputhshmërinë e veprimit me masat shtrënguese të BE-së[6] .

4.3.1. Menaxhimi Direkt (Grantet)

Grantet: (menaxhim direkt)

(a) Qëllimi i grantit(eve)

Granti i binjakëzimit do të kontribuojë në realizimin e **Rezultatit 2** (Përmirësimi i hartimit të legjislacionit dhe harmonizimit ligjor me *acquis* të BE-së) dhe të dy produkteve përkatëse: 1) Përmirësohen kapacitet e MD-së për analiza, hartimin e legjislacionit dhe procesin e koordinimit me BE-në; dhe 2) Forcohet harmonizimi ligjor me *acquis* të BE-së në fushën e gjyqësorit.

(b) Lloji i aplikantëve të synuar
Aplikantët duhet të jenë administrata të Shteteve Anëtare të BE-ë ose organe të autorizuara prej tyre.

4.3.2. Menaxhim Direkt (Çmimet)

N/A

4.3.3. Menaxhim Direkt (Prokurimi)

Rezultati 1 dhe produktet e tij 1, 2 dhe 3 do të realizohen përmes kontratave të shërbimit dhe furnizimit. Qëllimi i prokurimit është të ofrojë asistencë teknik për dizenjimin (përfshirë softuerin) e sistemit të ri ICMS, të ofrojë harduerin e nevojshëm, të japë trajnime si për përdoruesit ashtu edhe për personelin TI dhe të sigurojë mbështetje fillestare për mirëmbajtjen.

Objekti	Lloji indikativ (punime, furnizime, shërbime)	Tremujori indikativ i

[6] www.sanctionsmap.eu Vini re se harta e sanksioneve është një mjet TI për identifikimin e regjimeve sanksionuese. Sanksionet burojnë nga aktet ligjore të publikuara në Gazetën Zyrtare (GZ). Në rast mospërputhjeje mes akteve ligjore të publikuara dhe përditësimeve në faqen e internetit, mbizotërojnë versionet e publikuara në GZ.

		shpalljes së procedurës
Sistemi i Menaxhimit të Integruar të Çështjeve (ICMS) ngrihet dhe ka ndërfaqe me bazat e tjera të të dhënave shtetërore, politika e mirëmbajtjet miratohet dhe personeli TI trajnohet mbi mirëmbajtjen e ICMS-së	Shërbime dhe furnizime	III/2022

4.3.4. Menaxhim indirekt me delegim te subjekti(e) (p.sh. organizatë e Shtetit Anëtar, vend i tretë donator, agjenci e specializuar (tradicionale/rregullatore) e BE-së, organizatë ndërkombëtare)

N/A

4.3.5. Menaxhim indirekt me një Përfitues IPA III

N/A

4.3.6. Kontribut për <emri i Instrumentit Miks Rajonal/Platformës >

N/A

4.3.7. EFSD+ operacionet që mbulohen me garanci buxhetore

N/A

4.3.8 Ndryshime nga menaxhimi direkt në modalitetin indirekt (dhe anasjelltas) për shkak të rrethanave përjashtimore (një alternativë, opsioni i dytë)

Në rrethana përjashtimore dhe me autorizim të Komisionit Evropian, lejohen ndryshimet nga menaxhimi indirekt në direkt (dhe anasjelltas), si dhe ndryshime të tjera në modalitetet e menaxhimit dhe prokurimit.

Nëse Veprimi zbatohet me menaxhim indirekt me një subjekt, ky i fundit përzgjidhet prej shërbimeve të Komisionit bazuar në kriteret e mëposhtme:

i. Mandati i subjektit të ngarkuar/deleguar që mbulon natyrën e veprimit;
ii. Përvoja e subjektit potencial, sidomos në kontekstin e Bashkimit Evropian dhe në Shqipëri;
iii. Kapacitetet operacionale/ekspertiza teknike, ligjore dhe kapacitetet menaxhuese, përfshirë ato në nivel vendor;
iv. Ndikimi, rezultatet, efekti levë i bashkëpunimit me subjekte të tjera/donatorët, si edhe efektiviteti i delegimit të detyrave, përfshirë edhe në Shqipëri;
v. Reduktimi i kostove të transaksioneve;
vi. Kapaciteti i subjektit për të dhënë bashkëfinancim të mundshëm;
vii. Përvoja në sektorin e drejtësisë dhe shtetit të së drejtës.

4.4. Shtrirja e pranueshmërisë gjeografike për prokurimet dhe grantet

Pranueshmëria gjeografike në kuptimin e vendit të vendosjes për pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit dhe të dhënies së granteve si dhe në kuptimin e origjinës së artikujve të blerë, sipas aktit bazë dhe dispozitave të dokumenteve kontraktuale, zbatohet sipas dispozitës së mëposhtme:

(1) Zyrtari përgjegjës autorizues i Komisionit mund të zgjerojë pranueshmërinë gjeografike në rast urgjence apo mungese të shërbimeve në tregjet e vendeve apo territoreve përkatëse, apo në situata të

tjera të justifikuara siç duhet, ku aplikimi i rregullave të pranueshmërisë do ta bënte realizimin e këtij Veprimi të pamundur ose tejet të vështirë.

4.5. Buxheti indikativ

	Kontributi i BE-së (në EUR)	Kontributi indikativ i palës së tretë (në EUR)
Rezultati 1: Rritja e efikasitetit të sistemit të drejtësisë, që konsiston në:	7 500 000	N.A.
Menaxhim direkt (Prokurim) – cf. seksioni 4.3.3	N.A.	
Rezultati 2: Forcimi i profesionalizmit të sistemit të drejtësisë, përbërë nga:	500 000	N.A.
Menaxhim direkt (grant binjakëzimi) – cf. seksioni 4.3.1	N.A.	
Grantet – buxheti total nën seksionin 4.3.1	**500 000**	N.A.
Prokurimi – buxheti total nën seksionin 4.3.3	**7 500 000**	N.A.
Vlerësimi (cf. seksioni 5.3)	mbulohet nga një tjetër vendim	N.A.
Auditi/Verifikimi i shpenzimeve (cf. Seksioni 6 6)	mbulohet nga një tjetër vendim	N.A.
Komunikimi dhe vizibiliteti (cf. Seksioni 7)	0	N.A.
Kontingjencat	0	N.A.
Totali	**8 000 000**	N.A.

4.6. Struktura organizative dhe përgjegjësitë

Veprimi mbështetet në një sërë partnerësh si autoritetet kombëtare, institucionet e pavarura të drejtësisë dhe një numër agjencish dhe organizatash.

Në rastin e menaxhimit direkt, Autoriteti Kontraktues do të jetë Delegacioni i BE-së në Shqipëri. DBE do të jetë përgjegjëse për të gjitha marrëveshjet kontraktuale me kontraktorët e përzgjedhur.

Homologët kryesorë të Autoritetit(eve) Kontraktues gjatë zbatimit të Veprimit janë: Këshillimi i Ministrave (KM), Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), Prokuroria e Përgjithshme (PP) dhe Ministria e Drejtësisë (MD) si Përfitues kryesorë të Veprimit. Për shkak të përfshirjes së ngushtë të një sërë institucionesh të pavarura dhe strukturave të tjera kombëtare dhe vendore – si dhe në përputhje me Kodin Evropian të Sjelljes për Partneritetin – KM, KLGJ dhe MD do të koordinohen ngushtë me të gjitha palët e interesuara gjatë zbatimit të aktiviteteve.

Një Komitet Drejtues Projekti (KDP) do të ngrihet për të drejtuar zbatimin. KDP do të përbëhet nga përfaqësues të palëve të interesuara kryesore, si edhe nga Koordinatori Kombëtar IPA (KKIPA) dhe DBE. Komiteti Drejtues i Projektit do të monitorojë nga afër përmbushjen e objektivave të kontratës dhe rezultatet e Veprimit.

KKIPA ka përgjegjësinë për koordinimin e përgjithshëm të programimit IPA dhe është homologu kryesor i Komisionit Evropian për të gjithë procesin e planifikimit strategjik, koordinimin e programimit,

monitorimin e zbatimit, vlerësimin dhe raportimin e asistencës IPA III në nivel programi. KKIPA do të ketë rolin e monitorimit të përmbushjes së objektivave të Veprimit dhe garanton respektimin e Kodit Evropian të Sjelljes për Partneritetin gjatë fazës së zbatimit.

Për koordinimin e përgjithshëm të politikave dhe asistencës së huaj, Qeveria e Shqipërisë ka ngritur një strukturë ndërinstitucionale dhe operacionale për menaxhimin e zbatimit të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) përmes përqasjes sektoriale dhe ndërsektoriale; SPI shërben si sistemi kryesor që përcakton instrumentet dhe mekanizmat për planifikim të integruar të politikave publike. Urdhri nr. 157, datë 22.10.2018 i Kryeministrit rishikoi Grupet e Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP-et) dhe ngarkoi strukturat e komiteteve drejtuese sektoriale për zbatimin e përqasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale me menaxhimin dhe koordinimin e politikave në fusha prioritare dhe sektorë me rëndësi të veçantë, si dhe me programimin ndërsektorial përmes krijimit të një mekanizmi menaxhimi sektorial /ndërsektorial. Komitetet Drejtuese Sektoriale (KDS-të) sigurojnë bashkëpunim në nivel drejtimi, brenda sektorëve me rëndësi të veçantë për reformat, si dhe koordinim ndërinstitucional. Grupet Tematike (GT-të) sigurojnë bashkëpunim në nivel teknik, përfshirë edhe me partnerët për zhvillim, brenda sektorëve specifikë të fushave prioritare. Zbatimin e këtij Veprimi do ta mbikëqyrë KDS për Reformën në Drejtësi nën përgjegjësinë e Ministrisë së Drejtësisë.

5. MONITORIMI DHE RAPORTIMI I PERFORMANCËS/REZULTATEVE

5.1. Monitorimi i brendshëm

Në nivel kombëtar, zbatimi i reformës bazohet në qëllimet e politikave dhe objektivat e programit, si pjesë e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) të Qeverisë të koordinuar nga Kryeministria si edhe e Strategjisë ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 që pritet të miratohet në prill 2021. Progresi në harmonizimin dhe përafrimin e kuadrit legjislativ me *acquis* të BE-së do të monitorohet çdo vit dhe do të raportohet në kuadrin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian.

Në zbatim të modaliteteve të zbatimit të përcaktuara në seksionin 4.6, Këshilli i Ministrave, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Ministria e Drejtësisë (MD) marrin përsipër përgjegjësinë për monitorimin dhe raportimin e progresit të aktiviteteve. Monitorimi i përditshëm teknik i zbatimit të këtij Veprimi do të jetë një proces i vazhdueshëm. Raportimi dhe analizimi periodik i progresit të Veprimit do të kryhet nga grupi ndërsektorial i punës për reformën në drejtësi, për të cilin MD kryen rolin e sekretariatit teknik bazuar në Dokumentin e Veprimit dhe qëllimet përkatëse të përcaktuara në matricën kuadër.

5.2. Rolet dhe përgjegjësitë për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave

Ky Veprim i nënshtrohet monitorimit të Delegacionit të BE-së në Shqipëri, në përputhje me rregullat dhe procedurat e Komisionit Evropian të përcaktuara në Marrëveshjen e Financimit.

Gjatë fazës së konceptimit, përfituesit e këtij Veprimi në marrëveshje me Delegacionin e BE-së miratojnë mjetet që do të përdoren për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave përkatëse. Rasti ideal do të ishte që sistemi(et) e mbledhjes së të dhënave që do të miratohen të garantojnë në të gjitha fazat informacionin e nevojshëm dhe në kohën e duhur, me qëllim që progresi të monitorohet dhe të shqyrtohet si dhe të përcaktohet nëse zotimet e marra përsipër janë përmbushur.

Progresi në realizimin e produkteve dhe rezultateve do të monitorohet nga Këshilli i Ministrave, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë, si dhe do të raportohet te Koordinatori Kombëtar IPA (KKIPA), Komitetet Monitoruese Sektoriale dhe Komiteti Monitorues IPA. KLGJ dhe MD kanë përgjegjësinë e përgjithshme për mbledhjen e të dhënave që kanë të bëjnë me treguesit dhe synimet, si edhe për raportimin në kohë te KKIPA.

Raportet e progresit në sektorin e drejtësisë publikohen nga Ministria e Drejtësisë çdo gjashtë muaj. Ministria e Drejtësisë është koordinatori i strategjisë së drejtësisë dhe autoriteti përgjegjës që mbledh, analizon, konsulton dhe publikon të dhënat. Çdo gjashtë muaj, MD mbledh komitetin drejtues të Strategjisë për të diskutuar mbi raportin e progresit. Strategjia e rishikuar do të përmbajë tregues në bazë të të cilëve bëhet raportimi, duke forcuar kështu monitorimin e përgjithshëm dhe raportimin në këtë sektor.

5.3. Vlerësimi

Nisur nga rëndësia e Veprimit, konsulentë të pavarur të kontraktuar prej Komisionit do të kryejnë një vlerësim përfundimtar për këtë Veprim në tërësi apo komponentë të tij.

Vlerësimi përfundimtar kryhet për qëllimet e llogaridhënies dhe nxjerrjes së mësimeve në nivele të ndryshme (edhe për rishikimin e politikave).

Komisioni informon partnerin zbatues të paktën një muaj përpara datave të planifikuara për misionet e vlerësimit. Partneri zbatues bashkëpunon në mënyrë efikase dhe efektive me ekspertët vlerësues si dhe u ofron atyre, ndër të tjera, të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, si edhe akses në ambientet dhe aktivitetet e projektit.

Raportet e vlerësimit u vihen në dispozicion vendit partner dhe palëve kryesore të interesit. Partneri zbatues dhe Komisioni analizojnë përfundimet dhe rekomandimet e vlerësimeve dhe, sipas rastit, vendosin bashkërisht mbi masat ndjekëse dhe rregullimet e nevojshme që mund të përfshijë edhe riorientimin e projektit.

6. AUDITI

Pa cenuar detyrimet e zbatueshme në kuadrin e kontratave të nënshkruara për zbatimin e këtij Veprimi, Komisioni mundet që mbi bazën e një vlerësimi risku të kontraktojë kryerjen e auditeve të pavarura apo verifikimin e shpenzimeve për një ose disa kontrata apo marrëveshje.

7. KOMUNIKIMI DHE VIZIBILITETI

Vizibiliteti i financimeve të BE-së dhe komunikimi mbi objektivat dhe ndikimin e Veprimeve janë detyrim ligjor për të gjitha Veprimet e financuara nga BE-ja, siç përcaktohet ne kërkesat në fuqi të komunikimit dhe vizibilitetit të BE-së.

Në veçanti, përfituesi i fondeve të BE-së pranon origjinën e fondeve të BE-së dhe garanton vizibilitetin e duhur të tyre përmes masave më poshtë:

- të gjitha dokumentet dhe materialet e komunikimit që lidhen me zbatimin e fondeve dhe faqja zyrtare e internetit duhet të përmbajnë në vend të dukshëm një pohim që nënvizon se fondet janë dhënë nga BE-ja;
- promovon masat dhe rezultatet e tyre, duke dhënë informacion të shënjestruar, proporcional, koherent dhe efektiv për audiencat e ndryshme, përfshirë median.

Masat e vizibilitetit dhe komunikimit zbatohen, sipas rastit, nga administratat kombëtare (p.sh., për reformat që mbështeten me buxhet të BE-së), subjektet e ngarkuara, kontraktorët dhe përfituesit e granteve. Detyrimet kontraktuale të përshtatshme përfshihen në marrëveshjet e financimit, në marrëveshjet e delegimit dhe në kontratat e prokurimit dhe ato grant.

Masat bazohen në një Plan Komunikimi dhe Vizibiliteti specifik, i cili zbatohet në përputhje me kërkesat në fuqi të komunikimit dhe vizibilitetit të BE-së. Plani përmban, ndër të tjera, një narrativë komunikimi dhe

mesazhe kryesore për Veprimin, të përshtatura sipas audiencave të synuara (palët e interesit, shoqëria civile, publiku i gjerë, etj.).

Masat e vizibilitetit dhe komunikimit specifike për këtë Veprim janë komplementare me aktivitetet e gjera të komunikimit që zbatohen direkt nga shërbimet e Komisionit Evropian dhe/ose Delegacioni i BE-së. Komisioni Evropian dhe Delegacioni i BE-së duhet të informohen plotësisht mbi planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve specifike të vizibilitetit dhe komunikimit, sidomos ato që kanë të bëjnë me narrativën e komunikimit dhe mesazhet kryesore.

8. QËNDRUESHMËRIA

"Pronësia" e plotë e institucioneve shqiptare mbi procesin e reformave në drejtësi dhe shtetin e së drejtës, bazuar në një strategji koherente në linje me *acquis* të BE-së dhe praktikat e mira ndërkombëtare, është gur themeli për qëndrueshmërinë. Për rrjedhojë, vëmendje e veçantë i kushtohet "pronësisë" së palëve të interesuara kombëtare gjatë hartimit të legjislacionit dhe procedurave që mbështeten me asistencë teknike. Qëndrueshmëria bazohet edhe te ekzistenca dhe mbajtja e burimeve njerëzore të kualifikuara. Forcimi i kapaciteteve në kuadrin e këtij Veprimi ka rëndësi themelore. Trajnimi i përdoruesve (përfshirë personelin administrativ dhe joadministrativ) dhe i profesionistëve TI dhe të mirëmbajtjes merr rëndësi parësore si një ndër mënyrat që garanton përdorimin e duhur dhe qëndrueshmërinë e sistemit të ri ICMS. Veprimi pasohet nga një fazë ndjekëse që parashikon që trajnimi për ICMS të përfshihet në kurrikulën që do të jepet nga ose në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës. Fokusi do të jetë te fuqizimi i personelit si dhe ruajtja e njohurive dhe kapaciteteve.

Për më tepër, qëndrueshmëria e kësaj ndërhyrjeje varet nga faktorë politikë, financiarë dhe strukturorë. Reforma në drejtësi e miratuar me ndryshimet ligjore në Kushtetutën e Shqipërisë është rezultat i negociatave dhe marrëveshjeve politike mes të majtës dhe të djathtës politikë. Ky Veprim përcaktohet qartë si një nga prioritetet e Strategjisë ndërsektoriale të Drejtësisë dhe është një pikënisje e shkëlqyer për zbatimin e tij. Mbështetja e vazhdueshme dhe e mirëkoordinuar e komunitetit ndërkombëtar për reformën në drejtësi është një element i rëndësishëm për qëndrueshmërinë e saj.

Qëndrueshmëria financiare e reformës kërkon kostim dhe buxhetim të duhur në mbështetje të kostove të rekrutimit, pagave dhe mirëmbajtjes për sistemet dhe infrastrukturën TI, si edhe investime në infrastrukturën e re dhe/ose rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve ekzistuese. Për të garantuar qëndrueshmërinë e plotë të këtij Veprimi, nevojitet angazhim i plotë i institucioneve shqiptare në garantimin e infrastrukturës, burimeve njerëzore dhe mjeteve financiare të duhura përmes planifikimit të përshtatshëm në Programin Buxhetor Afatmesëm.

SHTOJCA I.2
e Marrëveshjes së Financimit për planin vjetor të veprimit në favor të Shqipërisë për vitin 2021
Dokumenti i Veprimit për "BE-ja për Të Drejtat e Pronësisë – Faza II"

1. SINOPS

1.1. Tabela Përmbledhëse e Veprimit

Titulli	**BE-ja për Të Drejtat e Pronësisë – Faza II** Plani Vjetor i Veprimit në favor të Shqipërisë për vitin 2021			
Numri *CRIS*	IPA III/2021/ 043-666/2			
Akti bazë	Financuar në kuadrin e Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA III)			
Nisma *Team Europe*	Jo			
Zona që përfiton nga veprimi	Veprimi zbatohet në Shqipëri			
Dokumenti programues	Kuadri Programues IPA III			
FUSHAT PRIORITARE DHE INFORMACIONI SEKTORIAL				
Dritarja dhe prioriteti tematik	Dritarja 1: Shteti i Së Drejtës, Të Drejtat Themelore dhe Demokracia Prioriteti Tematik 5: Të drejtat themelore / Të Drejtat e Pronësisë			
Objektivat e Zhvillimit të qëndrueshëm (OZhQ)	OZhQ kryesor (vetëm 1): 11: qytete dhe komunitete të qëndrueshme OZhQ të tjera të rëndësishme: 5: Barazia Gjinore 16: Paqja, drejtësia dhe institucione të forta			
Kodi(et) *DAC*	Kodi DAC kryesor (60%): 15160 Të Drejtat e Njeriut Nënkodi (40%) : 25010 Politikat e Biznesit dhe Administrata (përfshi të drejtat e pronësisë)			
Kanali Kryesor i Zbatimit	12000 – Qeveria Përfituese			
Treguesit **(nga formulari DAC)**	**Objektivi i përgjithshëm i politikës**	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	Zhvillimi i pjesëmarrjes/ qeverisja e mirë	☐	☐	☒
	Ndihmë për mjedisin	☒	☐	☐
	Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave	☐	☒	☐
	Zhvillimi i tregtisë	☒	☐	☐

	Shëndeti riprodhues, i mëmësisë, të sapolindurve dhe fëmijëve	☒	☐	☐
	Reduktimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore	☒	☐	☐
	Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara	☒	☐	☐
	Ushqyerja	☒	☐	☐
	Treguesit e Konventës RIO	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	Diversiteti biologjik	☒	☐	☐
	Lufta ndaj shkretimit	☒	☐	☐
	Zbutja e ndryshimeve klimatike	☒	☐	☐
	Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike	☒	☐	☐
Tregues të brendshëm	**Objektivat e politikës**	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	Dixhitalizimi	☐	☒	☐
	Migrimi	☒	☐	☐
	COVID-19	☒	☐	☐
INFORMACION PËR BUXHETIN				
Shumat përkatëse	Linja e buxhetit: 15.020101.01 Kostoja totale e vlerësuar: 10 000 000 Euro Kontributi total i buxhetit të BE-së: 10 000 000 Euro			
MENAXHIMI DHE ZBATIMI				
Lloji i financimit dhe metoda(t) e zbatimit	Me Projekt **Menaxhim Direkt** përmes: Prokurimit			
Prioritetet përkatëse dhe programet nga Plani Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor	Prioritetet: Tranzicioni Dixhital; Qeverisja, Shteti i Së Drejtës, RAP			
Afati për lidhjen e Marrëveshjes së Financimit	deri më 31 dhjetor N+1			

Afati për lidhjen e marrëveshjeve të kontributit /delegimit, prokurimeve dhe kontratave grant	3 vite pas datës së lidhjes së Marrëveshjes së Financimit, me përjashtim të rasteve të renditura në nenin 114(2) të Rregullores Financiare
Periudha indikative e zbatimit operacional	72 muaj pas lidhjes së Marrëveshjes së Financimit
Afati për zbatimin e Marrëveshjes së Financimit	12 vite pas lidhjes së Marrëveshjes së Financimit

1.2. Përmbledhje e Veprimit

Reforma e tokës është prioritet kryesor për Qeverinë e Shqipërisë, siç evidentohet në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2014-2020). Ky Veprim do të kontribuojë në forcimin e mbrojtjes së të drejtës themelore të pronës në Shqipëri dhe kapaciteteve të Shqipërisë për të garantuar në praktikë këtë të drejtë - si një nga të drejtat themelore të njeriut - përmes një sistemi të rregulluar pronësie që siguron tituj pronësie të qartë dhe të sigurt. Aktualisht, mbrojtja e të drejtës themelore e pronës nuk mund të zbatohet për shkak të copëzimit të tokës, pasigurisë dhe kompleksitetit të ligjeve dhe akteve nënligjore, informalitetit, shtimit të ndërtimeve pa leje dhe procesit të dikurshëm të regjistrimit masiv të titujve të pronësisë që parashikonte kompensimin e pronarëve, duke i ngarkuar buxhetit të shtetit një barrë të madhe. Vëmendje duhet t'i kushtohet edhe respektimit të plotë të të drejtës së pronës për gratë.

Ky Veprim është faza e dytë e Programit IPA 2020, "BE-ja për të Drejtat e Pronës". Ai do të bazohet në përmirësimin e informacionit ligjor për të drejtat pronësore, i cili do të korrigjohet, përditësohet dhe bëhet i aksesueshëm për publikun, duke krijuar kështu një regjistrim efikas dhe transparent të pronës dhe një sistem të integruar të menaxhimit të tokës.

Programi "BE-ja për Të Drejtat e Pronës" financuar nga IPA 2021 do të realizohet përmes: (i) përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë të dhënave për pasuritë e paluajtshme, gjatë të cilit të dhënat hapësinore dhe informacioni ligjor për të drejtat pronësore do të korrigjohet, përditësohet dhe bëhet i aksesueshëm; (ii) rikonceptimit të shërbimeve publike të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; dhe (iii) masave përgatitore për ngritjen e sistemit të monitorimit bujqësor bazuar në parcelë toke, sipas standardeve të BE-së.

Gjithashtu, ky Veprim plotësohet nga një projekt paralel financuar nga BE-ja (Instrumenti Horizontal/D-Rex) që fokusohet në ndjekjen e zbatimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane të Të Drejtave të Njeriut (GjEDNj) lidhur me të drejtat e pronës në Shqipëri. Në fazën e tretë të këtij Instrumenti, projekti do të mbështetë ekzekutimin efektiv të vendimeve të GjEDNj-së dhe përmirësimin e zbatimit të Konventës Evropiane për Të Drejta e Njeriut (KEDNj) në Shqipëri.

Duke krijuar një kuadër të rregulluar dhe solid të të drejtave të pronësisë në Shqipëri dhe duke siguruar tituj pronësie të qartë dhe të sigurt për të gjithë titullarët, ndihma e BE-së do të kontribuojë në konsolidimin e të drejtës së pronës dhe gëzimin e saj nga njerëzit. Në mënyrë indirekte, do të kontribuojë në zhvillimin e vazhdueshëm të tregut të tokës në Shqipëri dhe konkurrueshmërinë e ekonomisë dhe, për rrjedhojë, edhe në përmirësimin e premisave të punësimit.

2. ARGUMENTIMI

2.1. Analiza e Kontekstit

Ekziston një korrelacion i vërtetuar dhe i fortë midis mbrojtjes së të drejtës themelore të pronës, përfshirë të drejtën për kompensimin e të drejtë në rastet e shpronësimit, si dhe cilësisë së shërbimeve kadastrale dhe regjistrimit të pronë. Indeksi ndërkombëtar mban parasysh perceptimin e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë dhe lehtësinë e regjistrimit të pronës. Në vitin 2020, Shqipëria renditej e 112-ta nga 129 vende duke shënuar rënie krahasuar me vitin 2019, çka tregon se zbatimi i reformës është nevojë urgjente.

Qëllimi madhor i reformës së tokës është që të drejtat e pronësisë të jenë të sigurta. Të drejtat e pronësisë mbrohen nga Karta e Të Drejtave Themelore e BE-së[1] dhe mbështeten nga Kuadri Programues për IPA III, nën Dritaren 1: Shteti i Së Drejtës, Të Drejtat Themelore dhe Demokracia, Prioriteti Tematik 5. Kuadri programues i IPA III riafirmon se respektimi i të drejtave themelore është një nga vlerat kryesore të BE-së të mishëruara në traktatet e BE-së si dhe element thelbësor në procesin e anëtarësimit. Synimi është që të drejtat themelore të mishërohen gjerësisht në legjislacionin e përfituesve, por më tepër duhet bërë për të garantuar zbatim të plotë në praktikë. Kështu, mbështetja IPA III do të prioritizojë zbatimin korrekt të të gjitha lirive dhe të drejtave, që përfshin garantimin e barazisë gjinore dhe parandalimin e diskriminimit në përputhje me Planin e Veprimit Gjinor III, si edhe harmonizimin me të drejtën e BE-së.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZhI) 2014-2020 e identifikon reformën e tokës si prioritet të lartë. Sigurimi i të drejtave të pronësisë dhe menaxhimi i integruar i tokës janë një nga tre prioritetet kryesore të shprehura në SKZhI 2014-2020 për të arritur Objektivin Strategjik të Qeverisjes së Mirë dhe Shtetit të Së Drejtës. Strategjia shpreh përkushtimin ndaj reformës dhe objektivave strategjikë për: i) adresimin e mospërputhjeve dhe boshllëqeve në kuadrin ligjor për të drejtat e pronësisë, për të mundësuar ecuri të shpejtë dhe efikase në regjistrimin e titujve, legalizimin, kthimin dhe kompensimin e pronës; dhe ii) përfundimin e regjistrimit fillestar sistematik në shkallë vendi dhe ngritjen e një regjistri të konsoliduar elektronik e publik për pasuritë e paluajtshme. Reforma e Menaxhimit të Integruar të Tokë është zbatuar që në vitin 2017. Reforma ka për qëllim të forcojë produktivitetin dhe qëndrueshmërinë e përdorimit të tokës, si dhe të përshpejtojë zhvillimin e Shqipërisë, duke sjellë përfitime të qenësishme ekonomike, sociale dhe mjedisore, si dhe duke i ofruar publikut shërbime më transparente për tokën.

Ligji për Kadastrën nr. 111/2018 që hyri në fuqi në vitin 2019, mishëron prioritetet e reformave dhe ngriti Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (AShK) për zbatimin e saj. Qëllimi kryesor i ligjit të miratuar është të përmirësojë kuadrin ligjor për regjistrimin e pasurive të paluajtshme. Ligji parashikon norma ligjore të reja se si administrohet regjistri publik i pasurive të paluajtshme, duke pasqyruar të drejtat dhe detyrimet që shoqërojnë pronën. Ligji parashikon edhe përmirësimin dhe përditësimin e të dhënave të regjistruara, me qëllim që të korrigjohen pasaktësitë materiale në tri dekadat e fundit, si edhe ngritjen e një regjistri të saktë dhe të besueshëm për pronat. Në fund, ligji synon që proceset e pronës të bëhen më efikase, përmes koordinimit nga vetëm një organ shtetëror.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës që funksionon nga prilli 2019, erdhi si shkrirje e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave dhe Ndërtesave Informale (ALUIZNI), Agjencisë për Regjistrimin e Pronave të Paluajtshme (ARPP) dhe Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike.

Ligji nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë" hyri në fuqi në maj 2020 dhe përcakton proceset që duhet të kryejë Agjencia Shtetërore e Kadastrës, që përfshijnë ndër të tjera: i) përfundimin e legalizimit; ii) përfundimin e shpërndarjes së titujve të pronësisë për tokën bujqësore dhe regjistrimit fillestar; dhe iii) përfundimin e inventarizimit të pronave shtetërore. Dy grupe pune janë ngritur për të realizuar inventarizimin dhe regjistrimin e tokës shtetërore.

Inventarizimi i tokës shtetërore duhej të përfundonte dhe të regjistrohej gjatë vitit 2019. Megjithatë, pronat ende të paregjistruara për shkak se mosmarrëveshjet janë dërguar në gjykatë dhe ende nuk ka vendim për to, problematikat e vazhdueshme në kthimin dhe kompensimin e pronës, si edhe legalizimi i diskutueshëm i ndërtimeve pa leje kanë bërë që databazat për pronat të jenë të paharmonizuara dhe të pasakta. Në këtë kontekst, ia vlen të theksohet se që nga 1 janari 2021, 563 çështje janë në pritje të gjykimit (104 çështje të komunikuara) nga GjEDNj, shumica e të cilave lidhen me problematikat e pronës dhe procesit të rregullt gjyqësor në çështje pronësore.

Me mbështetjen e IPA 2020, zbatimi i masave kryesore të planifikuara nën RMIT lidhur me cilësinë, besueshmërinë dhe efikasitetin e regjistrit të tokës/informacionit dhe shërbimeve kadastrale pritet të fillojë në vitin 2021. Kjo mbështetje përfshin dixhitalizim të të dhënave ligjore për të drejtat e pronësisë, zhvillimin institucional dhe ngritjen e Sistemit Informatik të Tokës për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Veprimi i financuar nga IPA 2021 do të konsolidojë arritjet e IPA 2020. Ky veprim do të vazhdojë projektimin dhe zhvillimin e Sistemit Qendror Informatik të Tokës, dixhilizimin e të dhënave dhe kontrollin e cilësisë. Në fazën e parë do të dixhitalizohen kartelat (regjistri i të drejtave të pronësisë). I gjithë informacioni kadastral bashkë me hartat dhe dokumentet shoqëruese do të dixhitalizohet, për të garantuar siguri dhe besueshmëri të të drejtave të pronësisë. Pas

[1] Shih nenin 17 dhe shpjegimet: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=OJ%3AC%3A2007%3A303%3ATOC

dixhitalizimit të të dhënave, cilësia do të përmirësohet në nivelin e standardeve të pranueshme. Veprimi nën IPA 2021 do të bazohet në të dhëna më cilësore dhe do të forcojë dhënien e shërbimeve kadastrale, duke përmirësuar funksionet e zyrës pritëse dhe mbështetëse të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Për më tepër, Veprimi do të përmirësojë ndërlidhjen e sistemit kadastral me regjistrat publikë që administrohen nga institucion të tjera shtetërore. Komponenti i tretë i Veprimit do të përgatitë Qeverinë e Shqipërisë për ngritjen e sistemit të monitorimit bujqësor bazuar në parcelë toke në përputhje me standardet e BE-së, si dhe do të përmirësojë transparencën në përdorimin e Tokës Bujqësore.

2.2. Analiza e problematikave në fushat që do të mbështeten

Fusha e Mbështetjes 1: Kuadri institucional për Të Drejtat e Pronësisë - rikonceptimi i shërbimeve kadastrale.
Vendi ende vuan nga problemet me të drejtat e pasigurta të pronësisë, bashkë me kuadrin kompleks ligjor dhe institucional. Edhe korrupsioni, krimi i organizuar dhe mungesa e mbrojtjes së të drejtave të pronarëve të ligjshëm, ndërthurur me mosmarrëveshjet private, kanë shkaktuar konflikte të rënda sociale në 27 vitet e fundit. Raporti i Komisionit Evropian 2021 për Shqipërinë[2] thekson nevojën për të konsoliduar të drejtat e pronësisë, veçanërisht në këto aspekte: përfundimi i regjistrimit fillestar, avancimi i regjistrimit të titujve të pronësisë, zbatimi i skemës së kompensimit dhe progresi i nevojshëm në dixhitalizimin dhe hartëzimin e pronave në mënyrë transparente dhe tërësore.

Kuadri institucional i Shqipërisë për pronën u është ngarkuar agjencive të ndryshme me funksione të ndryshme politike, administrative dhe teknike. Veprimet e këtyre organeve të ndryshme nuk kanë qenë gjithmonë të harmonizuara, kompetencat mund të kenë pasur mbivendosje dhe koordinimi mes tyre nuk ka qenë gjithmonë i kënaqshëm.

Kuadri ligjor mbron në përgjithësi të drejtën themelore të pronësisë, e cila parashikohet qartë në Kushtetutën e Shqipërisë, në përputhje me KEDNj-në dhe Protokollet e saj. Megjithatë, aktet nënligjore, rregullat procedurale dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore (shih për shembull vendimin historik në çështjen Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë) nuk tregojnë përmbushje të plotë të kësaj të drejte. Toka, pronësia e saj dhe të drejtat e tjera të lidhura me të, janë një nga çështjet më të komplikuara dhe më problematike në Shqipëri, që prekin shtetin e së drejtës dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Proceset e kaluara dhe aktuale lidhur me dhënien dhe rivendosjen e të drejtave të pronësisë, si legalizimi i ndërtimeve pa leje, kthimi i pronës dhe dëmshpërblimi i pronarëve që kanë vuajtur nga konfiskimi gjatë regjimit komunist dhe regjistrimi masiv i titujve kanë vendosur një barrë të madhe në buxhet.

Kjo fushë rregullohet nga një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore të miratuara në kohë të ndryshme nga forca të ndryshme politike. Kuadri ligjor pasqyron zhvillimet politike, ligjore, ekonomike dhe sociale në vend gjatë viteve. Pas rënies së regjimit komunist, ligjet e para të miratuara në vitet '90 synonin kryesisht privatizimin e tokës bujqësore të kooperativave dhe kthimin e pronave të konfiskuara, në mënyrë që të kishte rregullim të përshtatshëm për ekonominë e tregut. Për këtë qëllim, toka bujqësore u nda për frymë dhe mbetet tejet e copëzuar, ndërsa nuk u lejua kthimi dhe kompensimi i tokës bujqësore te pronarët fillestarë. Sidoqoftë, ligji për kthimin dhe kompensimin qëndroi në qendër të zhvillimeve ligjore dhe politike.

Zbatimi në praktikë i këtyre ligjeve shkaktoi konflikte midis shtetit, ish-pronarëve fillestarë (të shpronësuar nga regjimi komunist) dhe fermerëve apo banorëve të qytetit. Në vitet në vijim, ligjet dhe aktet nënligjore synonin rregullimin e problematikave të krijuara nga kuadri ligjor i miratuar në fillim të viteve '90. Si rezultat, copëzimi i legjislacionit, moria e akteve nënligjore, boshllëqet në sistemin e regjistrimit dhe moszbatimi i ligjit krijuan premisat për informalitet, zënie të paligjshme të tokës dhe pasiguri të të drejtave ligjore. Kjo situatë shpesh ua ka privuar të drejtat pronësore pronarëve legjitimë, me pretendime dhe të drejta të mbivendosura mbi tokën dhe të drejta të tjera reale.

Fusha e mbështetjes 2: Përmirësimi i cilësisë së të dhënave për pasuritë e paluajtshme
Pasaktësia e të dhënave për të drejtat e pronësisë dhe **administrimin e tokës** mbetet problem kyç. Reformat prioritare në bujqësi, turizëm, administrimin e tokës bujqësore dhe tregun e tokës kërkojnë investime të mëdha për të garantuar cilësinë, besueshmërinë dhe efikasitetin e regjistrit të tokës/informacionit dhe shërbimeve kadastrale, bashkë me ngritjen dhe funksionimin e duhur të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, ngritjen e një infrastrukture TIK solide dhe përmirësimin e finalizimin e të dhënave kadastrale dhe për të drejtat e pronësisë. Integrimi i mirëstrukturuar i të dhënave nga sistemet e tjera informatike (regjistra publikë) në një sistem dhe databazë të vetme qendrore për tokën është thelbësor. E rëndësishme është edhe ndërlidhja me Sistemin e Adresave dhe me Regjistrin e Gjendjes Civile, në mënyrë që të dhënat të jenë lehtësisht të aksesueshme në formate të përputhura përmes Regjistrit të Tokës.

[2] SWD(2021) 289 final

Dy institucionet përgjegjëse deri në vitin 2018, ZRPP dhe ALUIZNI, janë tashmë të dyja pjesë e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Sipas të dhënave të tyre, 11% e territorit të vendit nuk është e regjistruar dhe afërsisht 80% e pronave të regjistruara janë të pasakta. Kjo përbën një pengesë për çdo aktivitet planifikimi, zhvillimi apo investimi. Nga 3057 zona kadastrale me afërsisht 4 milionë prona, vetëm 140 zona kadastrale me rreth 700,000 prona kanë të dhëna dixhitale të përditësuara në ALBSREP (Sistemi Shqiptar për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme, i njohur edhe si sistemi IPS apo Multifunksional). Të dhënat kadastrale dhe të drejtat pronësore në vijim të regjistrimit fillestar në rreth 20 zona kadastrale si dhe nga regjistrimi fillestar i pyjeve dhe kullotave, i cili shtrihet në 18 bashki, janë pranuar dhe ngarkuar ALBSREP. Regjistrat e rinj dixhitalë me informacion ligjor - rreth 1.6 milionë kartela[3] - janë hapur në baza sporadike ndërsa transaksionet e reja kryhen në zyrat vendore, por pa hartat ose planimetritë kadastrale dixhitale përkatëse. ALBSREP, ku mbahen të dhënat e hartës kadastrale dhe të drejtave pronësore, nuk komunikon me modulin për menaxhimin e dokumenteve mbështetëse. Për rrjedhojë, nuk ka asnjë lidhje mes dokumenteve mbështetëse dhe parcelës së pronës.

Aktualisht përdoren softuerë të vjetër që nuk përputhen me modelin e të dhënave ALBSREP për hedhjen e të dhënave; kjo e ndërlikon vërtetimin dhe migrimin e të dhënave në ALBSREP në kuadër të programit 2-vjeçar të përmirësimi të cilësisë së të dhënave të ZRPP-së. Për të gjitha këto arsye, ndërhyrjet në kuadrin e IPA 2020 kanë synuar të përcaktojnë urgjentisht procedurat për përmirësimin e dixhitalizimit të të dhënave.

Sistemi Qendror Shqiptar i Informacionit për Tokën (ACLIS) do të mbështetë migrimin e të dhënave nga ALBSREP dhe mirëmbajtjen e të dhënave për hartat kadastrale dhe të drejtat pronësore të regjistruara në një sistem të vetëm të unifikuar, i cili mundëson shkëmbimin e të dhënave me regjistra të tjerë publikë. Më pas, do të modernizohet ASHK-ja dhe shërbimet që ofron, si dhe do të përditësohen dhe do të përmirësohen të dhënat për hartat kadastrale dhe të drejtat pronësore.

Fusha e mbështetjes 3: Masat përgatitore për monitorimin bujqësor bazuar në parcelë toke
Raporti i KE-së 2020 për Shqipërinë thekson nevojën për të zhvilluar sistemin e Integruar të Administrimit dhe Kontrollit për Monitorimin e Tokës Bujqësore dhe krijimin e Sistemit të Identifikimit të Parcelave të Tokës (LPIS). Kërkesat për Sistemin e Identifikimit të Parcelave të Tokës (sistemi i unifikuar i monitorimit të BE-së) janë përcaktuar në Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 640/2014 dhe 1307/2013. Sistemi kërkon që parcela të jetë e matshme, të ketë lokalizim unik dhe të qartë dhe të jetë e qëndrueshme në kohë.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka një njësi të ngarkuar dhe përgjegjëse për monitorimin e tokës. Kontrollorët në terren nuk janë të trajnuar lidhur me metodologjitë dhe zbatimin e kontrollit me bazë zone. Parimet e monitorimit të tokës bujqësore dhe saktësisë së të dhënave për tokën bujqësore nuk kuptohen qartë, teksa legjislacioni përkatës nuk ekziston.

Çfarëdo sistemi monitorimi i tokës varet shumë nga cilësia e informacionit për tokën bujqësore. Aktualisht, 80% e të dhënave të parcelave janë të pasakta për sa i përket madhësisë dhe kufijve ndarës. Nuk rekomandohet ngritja e një sistemi bazuar në informacion të pasaktë për shpërndarjen e subvencioneve. Prandaj, mund të kryhen vetëm veprimet përgatitore (si projektimi i sistemit dhe ndërtimi i kapaciteteve në institutet përkatëse) përpara se i gjithë informacioni për tokën të korrigjohet dhe të jetë gati për t'u përdorur nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

Çështje ndërsektoriale: mbrojtja e të drejtave të pronësisë për gratë si edhe e të drejtës themelore të pronësisë për romët dhe grupet e tjera vulnerabël. Kushtetuta aktuale (1998) dhe kushtetuta e mëparshme e regjimit komunist[4] (1946) kanë parashikuar barazinë gjinore në të gjitha aspektet e jetës, duke përfshirë të drejtën për pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme. Mbrojtje e mëtejshme parashikohet në Kodin Civil, në Kodin e Familjes dhe burime të tjera legjislacioni për të drejtat pronësore që burojnë nga trashëgimia dhe regjimi martesor. Përparim i mëtejshëm është bërë vitet e fundit duke detyruar noterët dhe zyrat e regjistrimit që të zbatojnë kërkesat për pëlqimin e përbashkët të bashkëshortëve në shit-blerje dhe regjistrim të përbashkët të pronësisë për pronat e krijuara gjatë martesës. Kështu, legjislacioni shqiptar ndjek një përqasje gjinore në dukje neutrale dhe jodiskriminuese ndaj barazisë gjinore. Megjithatë, të dhënat tregojnë qartë se burrat posedojnë dhe administrojnë pronë në një masë shumë më të madhe në krahasim me gratë. Prandaj, nevojiten masa për të garantuar barazinë gjinore në praktikë. Të drejtat e pronësisë së grave janë ndikuar

[3] Kartela shërben si raport përmbledhës i pronës dhe i marrëdhënies ndërmjet objekteve, subjekteve juridike (palëve) dhe të drejtave, kufizimeve dhe përgjegjësive të tyre, si edhe kufizime të tjera (si pjesëtime, uzufrukt) në momente të caktuara në kohë. Gjithashtu, kartela përmban informacionin dhe marrëdhëniet në kohë.
[4] Neni 4 i Kushtetutës së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë e vitit 1946.

shumë nga ligjet dhe traditat zakonore që datojnë nga kohërat mesjetare. Për arsye historike, popullsia shqiptare ka mbajtur për shekuj me radhë praktika zakonore të përcaktuara në disa *Kanune*. Sipas të drejtës zakonore, gratë nuk lejoheshin të zotëronin apo të trashëgonin pasuri të paluajtshme. Kjo traditë vazhdon veçanërisht në zonat rurale, ku gratë heqin dorë nga të drejtat e trashëgimisë ose, në rastet e divorcit, nga të drejtat e pronësisë së përbashkët nga frika e stigmatizimit. Prapë nevojiten ndërhyrje të mëtejshme, edhe pse situata ka ndryshuar gradualisht në dy dekadat e fundit, jo vetëm nga dinamikat e tregut të punës por edhe nga ndryshimet në legjislacion.

Shumë romë dhe grupe të tjera vulnerabël vazhdojnë të jetojnë në vendbanime informale ku të drejtat e pronësisë dhe problematikat e pronës mbeten të pazgjidhura. Kjo i bën ata veçanërisht vulnerabël ndaj dëbimeve me formë. Shqipëria ka aderuar në Deklaratën e Poznanit për Integrimin e Romëve[5], duke marrë përsipër zotimin e qartë që kurdo që është e mundur "*të legalizojë të gjitha vendbanimet informale ku jetojnë romët, ose të ofrojnë strehim permanent, të denjë, të përballueshëm dhe të pasegreguar për romët që aktualisht jetojnë në vendbanime informale që nuk mund të legalizohen për arsye të justifikuara*".

Institucionet kryesore të përfshira në këtë ndërhyrje janë:
Kryeministria / Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes: po koordinon Reformën e Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Tokës, me rol Sekretariati dhe drejtuesi të Grupit të Punës. Shërben si Sekretariat i Komitetit Ndërministror për Reformën e Menaxhimit të Integruar të Tokës.
Agjencia Shtetërore e Kadastrës (AShK) është nën varësinë e Kryeministrit dhe është përgjegjëse kryesisht për përfundimin e procesit të legalizimit, dixhitalizimin dhe korrigjimin e të dhënave kadastrale, përfundimin e inventarit dixhital për pronat shtetërore, si edhe lëshimin e titujve të pronësisë për tokën.
ASHK, përfshirë zyrën qendrore dhe të gjitha njësitë vendore, është përfituesi kryesor direkt i Veprimit. ASHK do të jetë përgjegjëse për zbatimin e Veprimit në koordinim me Kryeministrinë dhe me Komitetin Ndërministror për Reformën e Menaxhimit të Integruar të Tokës.
Ministria e Drejtësisë (MD) ka qenë përgjegjëse për koordinimin e procesit të reformës së të drejtave pronësore. Me Ligjin e ri për Kadastrën, shumica e roleve të MD-së u transferuan drejtpërdrejt nën autoritetin e Kryeministrisë. MD vazhdon të ketë rol këshillues për çështjet e pronës. Gjithashtu, një përfaqësues i MD-së është anëtar i Bordit Këshillimor të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të cilit ASHK i raporton.
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si dhe Agjencia e Pagesave janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve kombëtare dhe të donatorëve në bujqësi, duke garantuar verifikim dhe monitorim të aplikimeve si dhe kryerje të pagesave në përputhje me aktet normative të BE-së.

Palë të tjera interesi të përfshira në zbatimin e reformës janë:
Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)
Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) është përgjegjës për zbatimin e politikës kombëtare për informacionin gjeohapësinor dhe ruajtjen e standardeve dhe rregullave për krijimin e Informacionit Kombëtar të të Dhënave Hapësinore në përputhje me standardet përkatëse evropiane.
Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) – Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike dhe Drejtoria e Buxhetit janë përgjegjëse për të gjitha çështjet financiare që lidhen me regjistrimin e pronës.
Qeverisja Vendore: Bashkitë janë përgjegjëse për të dhënat dhe bashkëpunimin në lidhje me regjistrimin fillestar.
Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) siguron infrastrukturën dhe siguron disponueshmërinë dhe sigurinë e portalit të qeverisjes elektronike dhe ofron infrastrukturën TIK në mbarë vendin.
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTE) dhe **Agjencia Kombëtare e Turizmit** nën varësinë e saj janë përgjegjëse për zhvillimin e potencialit turistik nëpërmjet përdorimit të qëndrueshëm të tokës dhe burimeve që lidhen me turizmin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura. Agjencia propozon edhe shpronësimin e tokës private që mund të përdoret nga zhvilluesit e turizmit.
Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP) është përgjegjëse për shqyrtimin e pretendimeve të personave të shpronësuar, trajtimin e pronave për të cilat nuk ka një vendim dhe shqyrtimin e vlerësimit të kërkesave për dëmshpërblim.
Avokati i Popullit – mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individëve nga veprimet e paligjshme të organeve të administratës publike si dhe të tretëve që veprojnë në emër të tij. Kjo zyrë, e krijuar në vitin 1999, ka qenë zë aktiv për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë me fokus të veçantë te gratë dhe grupet vulnerabël të shoqërisë shqiptare.
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) – ka mandatin të punojë me politikat e integrimit të romëve dhe grupeve të tjera vulnerabël.

[5] Integrimi i Romëve 2020 | Deklarata e Partnerëve të Bankës Botërore për Integrimin e Romëve brenda Procesit të Zgjerimit të BE-së (rcc.int)

2.3. Relevanca dhe komplimentariteti me strategjitë e mbështetura nga palët e interesuara kryesore kombëtare

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2014-2020 mbështetet në gjashtë shtylla, përfshirë demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Sigurimi i të drejtave të pronësisë dhe menaxhimi i integruar i tokës përbëjnë një nga tre prioritetet kryesore të SKZHI-së 2015-2020 për arritjen e Objektivit Strategjik të Mirëqeverisjes dhe shtetit të së drejtës. Veprimi mbështet objektivat e mëposhtme të SKZHI-së: Modernizimi dhe përmirësimi i integritetit të të dhënave dhe informacionit, me anë të dixhitalizimit dhe ndërlidhjes 100% të sistemeve të informacionit për pasuritë e patundshme (përfshirë hartat dixhitale) në përputhje me standardet e INSPIRE (Infrastruktura për Informacionin Hapësinor në Komunitetin Evropian). standardet si dhe të ofrohen shërbime *online* për klientët, nëpërmjet:

- Zbatimit të një sistemi të automatizuar të pasurive të patundshme në të gjitha Zyrat Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës;
- Ofrimit të informacionit dhe shërbimeve *online* për institucionet publike; dhe
- Lidhjes së sistemit dixhital të ASHK-së me baza dhe sisteme të tjera shtetërore të dhënash.

Zbatimi i Sistemit të Menaxhimit të Integruar të Tokës po ecën përpara. Kjo nismë synon të përmirësojë sistemin e të drejtave të pronësisë, titujve, regjistrimit dhe kthimit të pronës (lëshimin e titujve dhe përfundimin e regjistrimit). Ligji për Kadastrën (viti 2019) pasoi miratimin e Reformës për Sistemin e Menaxhimit të Integruar të Tokës. Qëllimi i ligjit për kadastrën është:

- Përmirësimi i kuadrit ligjor për regjistrimin e pronave të paluajtshme, duke miratuar norma ligjore të reja se si administrohet regjistri publik i pronave të paluajtshme, duke reflektuar të drejtat dhe detyrimet që lidhen me pronën e paluajtshme, si edhe duke përmirësuar dhe përditësuar të dhënat e regjistruara; si dhe korrigjimi i pasaktësive materiale gjatë tri dekadave të fundit;
- Sigurimi i një regjistri të pronave të paluajtshme që është i saktë dhe i besueshëm, si dhe rritja e efikasitetit në proceset që lidhen me pronat, si rezultat i koordinimit të proceseve nga vetëm një organ shtetëror.

RMIT parashikon këto ndërhyrje kryesore: (i) krijimi i një kuadri koheziv të politikave të tokës për të udhëhequr vazhdimisht aktivitetet e tokës, përfshirë një politikë të përgjithshme kombëtare të tokës dhe krijimin e politikave nënsektoriale të tokës si pylltaria, turizmi, pronat e paluajtshme dhe bujqësia; (ii) finalizimi i reformës institucionale dhe ligjore për të reduktuar copëzimin dhe mbivendosjet institucionale ekzistuese, si dhe krijimin e institucioneve më efikase të tokës; (iii) përmirësimi i regjistrave kryesorë (përfshirë të dhënat dhe sistemet) që lidhen me RMIT; (iv) forcimi i shtyllave mbështetëse të RMIT, si planifikimi hapësinor i menaxhimit të tokës shtetërore, zhvillimi i tokës dhe përmirësimi i tregut të tokës; dhe v) mbështetja për strategjinë e zhvillimit të kapaciteteve në të gjithë sektorin e tokës. Hartimi i Politikës Kombëtare të Tokës parashikohet në vitin 2021, me mbështetjen e Programit IPA 2020 për të Drejtat e Pronësisë.

Ligji "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" miratuar në mars 2020, përcakton procedurat dhe organin shtetëror përgjegjës për legalizimin e titujve të pronësisë për tokën bujqësore, inventarizimin, transferimin, trajtimin dhe regjistrimin përfundimtar të titujve të pronësisë për pronat e paluajtshme shtetërore dhe private.

2.4. Relevanca dhe komplimentariteti me politikën e BE-së dhe asistencën e BE-së dhe donatorëve të tjerë

Ky Veprim është në përputhje me **Kuadrin Programues IPA III** nën Dritaren 1 – Prioriteti Tematik 5, sepse mbështet zbatimin e të drejtave themelore. Kuadri Programues IPA III nënvizon edhe se paqartësia e të drejtave të pronësisë përbën një dobësi të madhe strukturore në sistemin e qeverisjes ekonomike në Shqipëri. Politika e zgjerimit e BE-së kërkon që Qeveria e Shqipërisë të ndërmarrë masa/reformë konkrete për këtë çështje.

Strategjia e Ballkanit Perëndimor[6] rithekson përqasjen se anëtarësimi i Ballkanit Perëndimor në BE bëhet mbi bazë merite, sepse kjo është në interesin politik, të sigurisë dhe ekonomik të vetë BE-së, si dhe nënvizon rolin thelbësor që bashkëpunimi strategjik dhe operacional mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor ka për sigurinë dhe drejtësinë. Strategjia evidenton se ekonomitë e rajonit përballen me shumë dobësi strukturore, tregje joefikase dhe të ngurta, përfshirë të

[6] COM(2018) 65 final

drejta pronësore të paqarta dhe kuadër rregullator të ngathët, që rezultojnë në konkurrueshmëri të ulët dhe papunësi të lartë.

Vlerësimi i Komisionit Evropian për **Programin e Reformave Ekonomike (PRE) 2020-2022**[7] të prillit 2020 konstaton se "Diagnoza e pengesave strukturore fokusohet të aksesi në financime, pronësia e tokës bujqësore, rregullimi i biznesit, mbështetja për novacionin, dixhitalizimi i ekonomisë dhe lehtësimi i tregtisë, por nuk mbulon çështjet e diversifikimit të prodhimit dhe **të drejtat e pronësisë**... ku të drejtat e pronësisë përbëjnë pengesë për tërheqjen e investitorëve të huaj [...]. PRE identifikon sfidat dhe propozon një masë që redukton copëzimin e tokës bujqësore dhe e konsolidon, e cila vijon nga viti pararendës. Megjithatë, masa është e hartuar dobët dhe nuk propozon një rend logjik masash për të arritur rezultatet e parashikuara. Shqipëria nuk ka bërë përparim në konsolidimin dhe reduktimin e copëzimit të tokës bujqësore, për shkak se mungon një bazë ligjore, institucionale dhe administrative. Masat e reformës parashikojnë dixhitalizim të pjesshëm të regjistrit të tokës bujqësore. Nuk janë planifikuar aktivitete për të krijuar kushtet e nevojshme për konsolidimin e tokës, siç është qartësimi i të drejtave të pronësisë dhe zhvillimi i një regjistri toke tërësor, planifikimi i territorit apo mbrojtja e mjedisit [...]. Seksioni për risqet potenciale duhet të përfshijë edhe risqet nga mosmarrëveshjet gjyqësore për të drejtat e pronësisë".

PRE 2021-2023 përcakton këto prioritete për Sektorin e Drejtësisë: "Legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve dhe zonave informale" si dhe "Rregullimi i çështjes së pronave në zbatim të Ligjit 133/2015 'Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave' dhe akteve nënligjore të tij. Në Shtojcën "Kontribute të jashtme për PRE 2021-2023", Banka Botërore për Rindërtim dhe Zhvillim konstaton se 'forcimi i të drejtave të pronësisë duhet të jetë në krye të axhendës dhe të shoqërohet në PRE me masa reformash konkrete".

Konstatimi kryesor në **Raportin e Komisionit Evropian 2021 për Shqipërinë**[8] është se "ka pasur përparim në lidhje me regjistrimin, dixhitalizimin dhe kompensimin. Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Shqipëri në maj 2020, Agjencia Shtetërore e Kadastrës filloi procesin e regjistrimit fillestar në tetë zona kadastrale të Bashkisë Himarë. Procesi është lehtësuar me një fushatë informimi publik dhe me hapjen e tri zyrave vendore ku qytetarët, përveç informimit, mund të dorëzojnë dokumentacion. Regjistrimi fillestar po vazhdon edhe në pjesë të tjera të vendit. Nga gjithsej 3 057 zona kadastrale që përbëjnë rreth 4 milionë prona, regjistrimi fillestar ka përfunduar në 2 717 zona kadastrale që përbëjnë rreth 3 540 000 prona. Në vitin 2020 dhe gjatë gjysmës së parë të 2021, regjistrimi ka vazhduar me një mesatare prej rreth 2000 prona në muaj. Deri në prill 2021, janë dixhitalizuar pothuaj 1 783 000 dosje. Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP) vazhdoi vlerësimin e kërkesave dhe shpërndarjen e fondeve për kompensimin e pronave. Ajo regjistroi 122 aplikime të reja dhe ekzekutoi 106 vendime që rezultuan në shpërndarjen e rreth 6.9 milionë euro nga fondi financiar dhe një sipërfaqe prej rreth 100 hektarësh nga fondi i tokës (vlera rreth 1.6 milionë euro). Në fillim të vitit janë shpërndarë kësti i dytë, i tretë dhe i katërt për 148 aplikime të viteve 2016–2019".[9] Raporti i vitit 2021 për Shqipërinë rekomandoi që nevojitet përparim i vazhdueshëm, transparent dhe gjithëpërfshirës në regjistrimin fillestar të pronave dhe në zbatimin e ligjit për finalizimin e proceseve të pronësisë kalimtare.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2020-2022 identifikon masa afatmesme dhe afatgjata në mënyrë që Shqipëria të arrijë përafrimin e plotë të legjislacionit të brendshëm me *acquis* të BE-së. Sipas PKIE, përafrimi ligjor po përparon në të gjitha fushat e Kapitullit 24. Prioritetet në Kapitullin e Drejtësisë, Lirisë dhe Sigurisë përfshijnë forcimin e mëtejshëm të të drejtave të pronësisë, veçanërisht duke avancuar rishikimin e vendimeve për të drejtat e pronësisë dhe zbatimin e skemës së kompensimit, si dhe arritjen e progresit të nevojshëm në dixhitalizimin dhe hartëzimin e pronës.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) me KE-në kërkon që Shqipëria të forcojë institucionet në fushën e ligjzbatimit në kuadrin e parimeve të përgjithshme, si dhe detyron Shqipërinë të respektojë parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut. Në fjalët e hapjes të mbledhjes së dhjetë të Komitetit të Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri, përfaqësuesit e Bashkimit Evropian nënvizuan se "të drejtat e pronësisë kërkojnë edhe një përqasje tërësore dhe përpjekje e reformave të vazhdueshme" si dhe mirëpritën gatishmërinë e autoriteteve shqiptare për të bashkëpunuar me BE-në dhe aktorë të tjerë relevantë, përfshirë Komisionin e Venecias, në lidhje me reformën e të drejtave të pronësisë.

Çështjet e pronës dhe menaxhimit të tokës po mbështeten edhe nga një sërë donatorësh të tjerë.

Projektet e realizuara

[7] https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/Economic-Reform-Programme-2020-2022.pdf
[8] SWD(2021) 289 final
[9] SWD(2021) 289 final

Banka Botërore - Administrimi dhe Menaxhimi i Tokës (LAMP) - Komponenti A (2007-2013) synonte forcimin e sigurisë së pronës, përmirësimin e planifikimit urban, kontrollin dhe menaxhimin e zhvillimit të tokës nëpërmjet dixhitalizimit të të dhënave të administruara nga ZRPP-të. Buxheti total i projektit ishte 20.5 milionë dollarë. Arritja kryesore është sistemi dixhital i regjistrimit ALBSReP, i cili është instaluar edhe në tri ZRPP vendore[10]. Gjithashtu, ka përfunduar regjistrimi fillestar për rreth 370 mijë prona të paluajtshme në zonat kryesore urbane. Këto prona ishin të parat që u ngarkuan dhe u ruajtën në ALBSREP. Gjatë procesit të regjistrimit fillestar në kuadrin e LAMP-it, dixhitalizimi i të dhënave u krye në mënyrë korrekte, por nuk rezultoi në të dhëna të sakta sepse si informacioni teknik edhe ai ligjor nuk u trajtuan në mënyrë korrekte. Procesi i përmirësimit të të dhënave duhet të realizohet, sepse të dhënat aktuale që ruhen në ALBSReP nuk janë të sakta.

Bashkimi Evropian dhe OSBE-ja (me donacione të qeverive të Greqisë, Zvicrës dhe Republikës Çeke) u fokusuan te regjistrimi fillestar i pronave të paluajtshme dhe te sinjalistika rrugore në zonat bregdetare. Ky projekt i zbatuar nga OSBE-ja, realizoi investime totale prej 1 686 000 euro gjatë periudhës 2010-2012.

Banka Botërore - Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore (NRDP) Komponenti A – Menaxhimi dhe qeverisja e pyjeve dhe kullotave komunale (2005-2011) kishte si synim përmirësimin e menaxhimit të pyjeve dhe kullotave komunale. Projekti përgatiti 225 plane menaxhimi për të forcuar sigurinë e pronës përmes dixhitalizimit të të gjitha të dhënave të administruara si dhe regjistrimin e tyre në ZRPP. Buxheti total për këtë projekt ishte 19.4 milion USD. Komponenti B (1.6 milion USD) – Shërbimet mjedisore në pyje – inventari kombëtar i fondit të pyjeve dhe kullotave (2014-2015) synonte llogaritjen e sipërfaqeve të fondit të pyjeve dhe kullotave dhe regjistrimin në kadastër (ZRPP) sipas formatit dixhital (GIS).

GIZ - Fondi i Hapur Rajonal – Projekti për Të Drejtat Gjinore mbi Tokën (2015-2019) u zbatua në bashkëpunim me FAO-n (Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë). Si problematikë kryesore, projekti identifikoi titujt e pronësisë mbi tokën bujqësore për gratë. Në kohën e ndarjes së tokës bujqësore në vitin 1991, titulli i pronësisë (AMTP) i jepej kryefamiljarit mashkull të familjes bujqësore, paçka se toka ndahej për frymë sipas përbërjes familjare. Kjo praktikë shpesh i nxori gratë jashtë loje, madje duke shkaktuar pengesa të mëdha në tjetërsimin e tokës në mungesë të një marrëveshjeje ku jepnin pëlqimin për pjesën e tyre. GIZ, në bashkëpunim me ZRPP dhe Dhomën e Noterisë, hartoi udhëzime praktike për të dyja institucionet se si të regjistronin tokën në emrin e të gjithë pjesëtarëve të familjes, përfshirë gratë, bazuar në AMTP-të e lëshuara në vitet '90 dhe më pas. Projekti trajtoi edhe problematikat e trashëgimisë dhe mbrojtjen e të drejtave të grave në proceset e trashëgimlënies që kryhen te noterët dhe/ose gjykatat.

Ndërhyrjet aktuale dhe të planifikuara:

Instrumenti Horizontal i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës (Projekti D-Rex) – fokusohet aktualisht në ndjekjen e zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së lidhur me të drejtat e pronësisë në Shqipëri, si edhe në përmirësimin e kuadrit rregullator për të drejtat e pronësisë. Gjatë fazës së tretë, projekti do të mbështetë ekzekutimin efektiv të vendimeve të GjEDNj-së dhe përmirësimin e zbatimit të KEDNj-së në Shqipëri.

SIDA – Qeveria e Suedisë po jep 3.3 milion euro (2018-2023) për të gjetur një zgjidhje për Taksën Kombëtare mbi Pronën në Shqipëri, bazuar në modelin e realizuar me sukses në Kosovë*. Kjo zgjidhje do të krijojë një kadastër fiskale me taksa prone bazuar në vlerën e tregut. Qëllimi i projektit është të forcojë bashkitë në Shqipëri që të rrisin ndjeshëm të ardhurat duke zbatuar taksën e pronës për ndërtesat bazuar në vlerën e tregut.

Autoriteti Hartëzues Norvegjez ka mbështetur vazhdimisht ngritjen dhe mirëfunksionimin e ASIG-ut, gjeoportalit shqiptar.

Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim në kuadrin e projektit PROMAS (Programi për Modernizimin e Sektorit Bujqësor) po mbështet MBZHR dhe AZHBR përmes një huaje të butë me vlerë totale 10 milion euro.

FAO mbështet zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020. Projekti asiston Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) në objektivin e përgjithshëm: forcimi i kapaciteteve të zbatimit të politikave të MBZHR në dobi të sektorit, konkurrueshmërisë, zhvillimit të qëndrueshëm të zonave rurale përmes zhvillimit efikas të burimeve, si edhe cilësi më të mirë jetese për popullatën rurale.

[10] Zyrat e Agjencisë së Regjistrimit të Pronës.

* Ky emërtim nuk paragjykon qëndrimin e BE-së mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/99 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe me Opinionin e GjND-së për deklaratën e pavarësisë së Kosovës.

Gjatë periudhës 2019-2020, **BE** ka mbështetur ASHK-në me disa projekte përgatitore të vogla: "Mbështetje për Të Drejtat e Pronësisë në Shqipëri (një këshilltar teknik mbi të drejtat e pronësisë dhe çështjet kadastrale), një "Ekspert Finance për të asistuar në Kostimin e Udhërrëfyesit të Reformës së Tokës si dhe në kostimin e Programit IPA 2020 'BE-ja për Të Drejtat e Pronësisë', si dhe "Mbështetja për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës në Shqipëri" (4 ekspertë teknikë japin mbështetje afatshkurtër për menaxhimin institucional, infrastrukturën e sigurinë TIK dhe infrastrukturën institucionale).

Projekti rajonal "Integrimi i Romëve" i financuar nga **BE**-ja po punon aktualisht me qeverinë për të hartëzuar të gjitha vendbanimet informale ku jetojnë romët. Hartëzimi do të mbledhë të dhëna mbi situatën e strehimit të romëve, përfshirë të dhëna mbi infrastrukturën vendore dhe pronësinë, kur është e mundur. Të dhënat do të transferohen te Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS) rajonal për vendbanimet e romëve, që do të shërbejë për qëllime legalizimi si dhe më tej në investime për strehim. Pas përfundimit të projektit, softueri GIS do të menaxhohet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

2.5. Mësimet e nxjerra dhe lidhjet me asistencën financiare të mëparshme

Për përfundimin e regjistrimit fillestar në Shqipëri janë bërë disa përpjekje që nga viti 2003, të mbështetura nga donatorë dhe partnerë për zhvillim si USAID, BB dhe OSBE. Arsyet kryesore për mungesën e suksesit kanë qenë: i) mungesa e një drejtimi strategjik dhe dokumenti që përcakton një qasje gjithëpërfshirëse; ii) mungesa e një fokusi të fortë politik për të adresuar çështjen; iii) mungesa e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare; iv) koordinimi dhe bashkëpunimi i dobët ndërmjet palëve të përfshira dhe agjencive; v) progresi i kufizuar për shkak të projekteve pilot dhe ndërhyrjeve të pjesshme; vi) mondjekja e një përqasjeje pjesëmarrëse në zbatimin e projektit; dhe vii) mosinformim dhe mosnxitja e përfshirjes së grave dhe grupeve të marxhinalizuara përmes fushatave të duhura informuese.

Ndërhyrja e propozuar synon të shmangë këto dështime si më poshtë: Së pari, teknologjia është përmirësuar ndjeshëm në dekadën e fundit, ndërkohë që projektet e mëparshme nuk kanë përdorur teknologji moderne edhe kur ka qenë e disponueshme. Së dyti, institucionet përfituese kanë mësuar nga gabimet e rënda që janë bërë në dy dekadat e fundit. Të gjitha projektet e deritanishme kanë pasur fokus të shpërndarë, sepse kanë trajtuar çështje të caktuara, në territore të vogla dhe përmes veprimeve pilot. Përfundimisht, gjatë projekteve të mëparshme nuk ka pasur kontroll dhe mbikëqyrje sistematike dhe rigoroze, si dhe produktet dhe rezultatet nuk kanë pasur sigurim cilësie në vijimësi. Ndërhyrja aktuale do të jetë faza e dytë e Programit të BE-së për të Drejtat e Pronësisë, duke ndjekur një përqasje holistike për të trajtuar në tërësi problematikat e ndërlikuara të të drejtave të pronësisë, si dhe duke synuar të gjithë territorin e Shqipërisë, edhe pse në faza. Metodologjia e parashikuar mundëson korrigjimin e të dhënave për çështjet që do të trajtohen, në mënyrë shumë më të shpejtë dhe më të saktë. Ndërhyrja parashikon monitorimin dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme teknike të nivelit të lartë si një nga elementët thelbësorë të rekomanduar.

3. PËRSHKRIMI I VEPRIMIT

3.1. Rezultatet e planifikuara dhe logjika e ndërhyrjes (përshkrimi i lidhjeve shkakësore midis ndikimit, rezultatit dhe produktit, si edhe supozimet)

Ndikimi i Veprimit është të kontribuojë në forcimin dhe mbrojtjen e të drejtës për pronën fizike në Shqipëri si edhe në kapacitetet e Shqipërisë për të garantuar në praktikë të drejtën e pronës, si një nga të drejtat themelore.

Rezultati – tregu i tokës dinamik dhe instrumentet financiare të zhvilluara përmes ngritjes së një kuadri të qartë për të drejtat e pronësisë në Shqipëri – do të arrihet përmes tre produkteve:

- Produkti 1 – Të dhënat hapësinore dhe të drejtat ligjore të pronësisë si dhe informacioni i menaxhimit të tokës korrigjohen, përditësohen dhe bëhen publike.
- Produkti 2 – Rikonceptohen shërbimet publike të Kadastrës Shtetërore; dhe
- Produkti 3 – Ndërmerren masa përgatitore për ngritjen e sistemit të monitorimit bujqësor bazuar në parcelën e tokës, sipas standardeve të BE-së.

Produktet do të rrisin sigurinë e transaksioneve dhe besimin në saktësinë e të dhënave, gjë që do të kontribuojë në rritjen e numrit vjetor të transaksioneve. Procesi i përmirësuar i regjistrimit të pronës fizike do të reduktojë kohën e nevojshme dhe barrën administrative për çdo transaksion. Në mënyrë indirekte, aktivitetet përgatitore për ngritjen e Sistemit të

Identifikimit të Parcelave të Tokës (LPIS) do t'i hapin rrugën subvencioneve për parcela bujqësore në bazë të sipërfaqes, me potencialin për rritje të vlerës së tokës bujqësore.

Në nivel produkti, asistenca do të kontribuojë në këto arritje:

- Deri në vitin 2026, do të rritet përqindja e hartave kadastrale plotësisht të dixhitalizuara (nëpërmjet skanimit dhe gjeoreferencimit), nga 4% aktualisht në 100% të zonave kadastrale, si dhe do të rritet përqindja e parcelave me të dhëna të përditësuara dhe të përmirësuara mbi të drejtat e pronësisë mbi to, nga 20% aktualisht në 40$ (për Produktin 1.1).
- Deri në vitin 2026, procesi i regjistrimit të pronës do të jetë më efikas për shkak se do të kërkohen më pak dokumente, dixhitalizimit të procesit dhe trajnimit efektiv të zyrtarëve të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në kuadër të Veprimit. (për Produktin 1.2).

Në kuadrin e Veprimit, mbi 100 persona do të trajnohen mbi përcaktimin dhe monitorimin e parcelave kadastrale bazuar në pronësi (një apo disa fermerë) dhe në të mbjella (një apo disa kategori të mbjellash) (për Produktin 1.3).

3.2. Aktivitetet indikative

Ky Veprim do të mbështetë arritjen e Produktit 1, Produktit 2 dhe Produktit 3 me asistencë teknike dhe investime (furnizime) që do të përfshijnë si më poshtë:

- Kontrollin e cilësisë për dixhitalizimin e të dhënave të regjistrimit të pronës dhe përmirësimin e të dhënave – Faza 2 (vazhdimi i projektit IPA 2020 KC);
- Përmirësimin e të dhënave, përfshirë dixhitalizimin e Hartave Kadastrale për të gjithë territorin e Shqipërisë; skanimin e dokumenteve mbështetëse të regjistrimit të pronës si dhe procesin e përditësimit dhe përmirësimit sistematik të të dhënave sipas Zonave Kadastrale.
- Përmirësimin e sistemit qendror të menaxhimit të integruar të tokës (zhvilluar në kuadër të IPA 2020) për të garantuar transparencën e të drejtave të pronësisë si dhe aksesin për të gjithë aparatin shtetëror dhe publikun, zhvillimin e aplikacionit për përmirësimin e të dhënave bazuar në modelin e të dhënave ACLIS dhe instalimin e qendrës primare dhe rezervë (*back up)* të të dhënave për sistemin e ri.
- Mbështetjen e përmirësimit të proceseve të punës (BPI) të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, përfshirë strategjinë dhe planifikimin e biznesit, ngritjen e kapaciteteve institucionale për ASHK-në, ATP-në dhe çdo institut toke aktual apo të ardhshëm të krijuar në kuadrin e ATP-së. Ky aktivitet përfshin edhe mbështetje të vazhdueshme për Qendrën e Dixhitalizimit të ASHK-së në ngritjen e kapaciteteve teknike dhe infrastrukturore të nevojshme për vazhdimin e dixhitalizimit të të dhënave dhe përmirësimin e të dhënave kadastrale. Qendra e dixhitalizimit do të pajiset me pajisjet dhe aplikacionet e nevojshme si dhe me trajnime të vazhdueshme dhe ngritjen e kapaciteteve lidhur me përditësimin dhe përmirësimin e të dhënave.

Forcimi i kompetencave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për të përmirësuar të dhënat dhe aksesin në parcelat e tokës në përgatitje të përqasjes së ngjashme me Politikën e Përbashkët Bujqësore për masat e pagesave direkte, si edhe për të projektuar LPIS-in.

3.3. Risqet dhe supozimet

Risqet	**Niveli i Riskut (L/M/U)**	**Masat zbutëse**
Risku 1. Ndryshimet politike ndikojnë në përmbajtjen / axhendën e reformës	M	Komunikim dhe bashkëpunim i vazhdueshëm dhe i ngushtë me drejtuesit politikë dhe administrativë.
Risku 2. Vonesa për shkak të kapaciteteve aktuale për zbatimin e proceseve të reformës	M	Të forcohen vazhdimisht kapacitetet e të autoriteteve shqiptare përmes masave për ndërtim kapacitetesh që zbatohen në kuadrin e këtij Veprimi. Të monitorohen nga afër ecuria e reformës, që të jetë mundësia për të marrë masa korrigjuese menjëherë. Të rekomandohen masa korrigjuese, si p.sh. ndërtim kapacitetesh shtesë apo mbështetje financiare shtesë.

Risku 3. Bashkëpunimi i dobët ndërinstitucional, mungesa e koordinimit dhe monitorimit të duhur	M	Të përcaktohen role të qarta dhe të hartohen udhëzime për koordinim ndërinstitucional normal. Të ngrihet një proces rigoroz monitorimi dhe vlerësimi.
Risku 4. Ndryshime të paparashikuara në kuadrin institucional dhe ligjor, që mund të ndikojnë te zbatimi	L	Të vlerësohet ndikimi i masave të propozuara në kuadrin institucional dhe ligjor përpara zbatimit, si dhe të propozohen zgjidhjet e përshtatshme që të mos preket zbatimi i Veprimit. Monitorimi dhe vlerësimi periodik i procedurave dhe rezultateve të agjencive të ngritura rishtas.
Risk 5. Mungesa e dakordësisë për prioritetet dhe përqasjet e propozuara mes palëve të interesit	M	Të përdoren argumente të qarta në mbështetje të përqasjeve të propozuara, si edhe fleksibilitet në arritjen e konsensusit. Të ngrihet një grup këshillimor i posaçëm përgjatë zbatimit të Veprimit, që t'ua lehtësojë drejtuesve arritjen e konsensusit për prioritetet dhe përqasjet e propozuara.
Risku 6. Pengesa shoqërore dhe zakonore si dhe stigmatizimi ndikojnë te gratë dhe vajzat që të mos pretendojnë të drejtën e pronës dhe të tërhiqen.	M	Strategji komunikimi e detajuar, fushata ndërgjegjësimi publik. Identifikimi i pengesave praktike që duhen adresuar nga autoritetet vendore apo qendrore.
Supozimet (pasqyrohen në Matricën e Kuadrit Logjik më lart) – të grupuara sipas produkteve dhe rezultateve		
Për Rezultatin 1: - Përkushtimi i vazhdueshëm i Qeverisë së Shqipëri ndaj axhendës së reformës së të drejtave të pronësisë. Për Produktin 1 dhe 2: - Të gjitha njësitë shtetërore procesin e dixhitalizimit/skanimit dhe mbështetin hapat e integrimit. Miratohet imponimi ligjor për mirëmbajtje ekskluzivisht dixhitale. Metodologjitë dhe teknologjitë pranohen dhe përdoren nga të gjithë institutet pjesëmarrëse. Procesi i korrigjimit të të dhënave mbështetet nga niveli qendror dhe vendor. - Qeveria vë në zbatim ndryshimet e planifikuara institucionale. Institutet pjesëmarrëse angazhohen në proceset e menaxhimit të ndryshimeve. Institutet përkatëse janë gati për përpunimin/zbatimin e ndryshimeve dhe trajnimet. Për Produktin 3: - Personeli i MBZHR-së dhe Agjencisë së Pagesave angazhohen me zbatimin.		

3.4. Harmonizimi me sektorë të tjerë

Të drejtat e pronësisë kanë natyrë ndërsektoriale, sepse ndikojnë në shumë sektorë ekonomikë, socialë dhe të drejtësisë, përveçse përbëjnë një nga shtyllat kryesore të një ekonomie tregu demokratike. Masat e propozuara synojnë kryesisht të ndihmojnë Shqipërinë në përpjekjet për të ngritur ndjeshëm mbrojtjen e të drejtës së pronësisë, si një e drejtë themelore e njeriut, si dhe gëzimin paqësor të posedimit në përputhje me detyrimet sipas KEDNj dhe Protokolleve të saj. Gjatë tranzicionit demokratik, legjislacioni për të drejtat e pronësisë në Shqipëri ka vuajtur nga ligje me filozofi kontradiktore në përpjekjen për të garantuar të drejtat e pronësisë, të cilat kanë rezultuar në shkelje, siç konstatohet edhe në vendimet e shumta të GjEDNj-së.

Nga një këndvështrim më praktik dhe ekonomik, masat e propozuara kanë potencialin për të ulur varfërinë, sidomos te gratë dhe grupet e margjinalizuara. Parcelat dhe pronat e regjistruara dhe të sakta kanë efektive pozitive të mëdha, aq më tepër kur 80% e të dhënave kanë pasaktësi. Prandaj, ato ndikojnë gjerësisht në shoqërinë shqiptare. Krahas masave legjislative për ta bërë sistemin transparent, ky Veprim do të përforcojë rezultatet pozitive për një sistem të sigurt, të saktë dhe transparent.

Një sistem i saktë me tituj të sigurt e lehtëson konsolidimin e pronësisë së copëzuar të pasurive të paluajtshme, sepse ky copëzim pengon zhvillimin e pronave në shkallë të gjerë dhe investimet e huaja direkte (IHD) në këtë sektor në Shqipëri.

Shumë prej pronave të paregjistruara ndodhen në zona me potencial të lartë ekonomik për turizmin. Formalizimi nëpërmjet titujve të regjistruar rrit shanset për zhvillim dhe investim në këto zona.

Fermerët dhe pronarët e tokave që do të kenë tituj të sigurt dhe të regjistruar, munden që të tjetërsojnë pronat e tyre dhe kjo do të mbështetë një treg më dinamik dhe më të sigurt të tokës. Ata do të kenë mundësinë ta përdorin tokën si kolateral për financime që u mundësojnë investime në tokë. Gjithashtu titujt e sigurt e lehtësojnë ndërtimin e infrastrukturës bujqësore, si serrat, me të drejta të sigurta pronësie për një infrastrukturë të tillë. Masat e propozuara për ngritjen e kapaciteteve do të hedhin themele të forta për ngritjen e sistemit LPIS, i cili do të jetë një instrument për sistemin e ardhshëm të subvencionimit të fermerëve, që do të zhvillohet në fazën vijuese të mbështetjes.

Të dhënat e pasakta për parcelat e tokës dhe rreziku i njohur tashmë i pasigurisë së pronave janë ndër arsyet pse shumë banka në Shqipëri ngurrojnë të pranojnë titujt e tokës si kolateral dhe të përfshihen në zhvillimin e pasurive të paluajtshme. Për rrjedhojë, tregu i pasurive të paluajtshme mbetet i pazhvilluar dhe praktikat e paqëndrueshme të biznesit vazhdojnë.

Masat kanë potencialin të fuqizojnë gratë dhe vajzat rurale, përmes regjistrimit të pjesës së tokës që u takon për frymë. Ato mund të përfitojnë nga transaksionet me pronat ku janë pronare, të nisin aktivitet sipërmarrës, të marrin kredi dhe të rritin rolin e tyre vendimmarrës në familje. Regjistrimi dhe korrigjimi i parcelave të tokës është parakusht për regjistrimin e ndërtimeve mbi to, kështu që do të ndikonte direkt edhe në regjistrimin e banesave dhe shtëpive në emrin e të dy bashkëshortëve në zonat ku do të kryhet regjistrimi fillestar.

Brenda zonave të paregjistruara, 10-14% e territorit banohet nga pakica etnike, përfshirë romët, të cilët do të përfitojnë nga procesi i korrigjimit të të dhënave, regjistrimit fillestar, etj. Masa të veçanta do të miratohen për të mbështetur romët vulnerabël drejt legalizimit të plotë dhe të drejtave të pronësisë, sepse shpesh pronarët duhet të përballojnë kosto të konsiderueshme.

Nga këndvështrimi social dhe i drejtësisë, përqasja sa më pjesëmarrëse do të sigurojë përfshirjen aktive të komuniteteve në regjistrimin e parcelave dhe matjet në terren do të sensibilizojnë grupet vulnerabël dhe të marxhinalizuara për të drejtat e tyre të pronësisë. Në planin afatgjatë, masat e propozuara mund të ulin nivelin e konflikteve dhe numrin (aktualisht të lartë) e çështjeve gjyqësore për mosmarrëveshje pronësie.

Integrimi gjinor – Është e pamundur të thuhet me saktësi sa është numri i pronave që zotërohen prej grave në Shqipëri. Vetë sistemi është projektuar që të prodhojë të dhëna, por sasia e vogël e të dhënave në sistem nuk mundëson statistika të sakta. 75% e të dhënave të ZRPP-ve nuk përmbajnë informacion bazuar në gjini. Sipas të dhënave të mbledhura nga FAO në 5 qarqe, 405 e pronave janë të regjistruara në emër të grave si pronare apo bashkëpronare[11]. Më poshtë paraqiten shqetësimet kryesore gjinore lidhur me lëshimin e titujve të pronësisë.

Privatizimi dhe Menaxhimi i Tokës Bujqësore - Ligji 7501 "Për Tokën" i vitit 1991 përcaktoi ndarje të tokës bujqësore për frymë, por vetë titulli lëshohej në emër të kryefamiljarit mashkull të familjes bujqësore, çka shkaktoi pengesa për gratë "në gëzimin paqësor të tokës së tyre"[12]. E njëjta vlen edhe për vajzat. Përpara dhe gjatë fazës së zbatimit, për pronat ende të paregjistruara, vëmendje e veçantë dhe e detajuar i duhet kushtuar regjistrimit të këtyre titujve si prona të përbashkëta të bashkëshortëve, sipas rastit, si dhe nën emrin e vajzave dhe djemve të tyre në secilin rast. Mbështetja e ZRPP-së dhe njësive të qeverisjes vendore është thelbësore në hartimin e akteve nënligjore që u mundësojnë të dy bashkëshortëve të konsiderohen "kryefamiljarë". Shumica dërrmuese e kryefamiljarëve të regjistruar të familjeve bujqësore në Shqipëri janë burra dhe djem.

Kthimi dhe Kompensimi - Legjislacioni për kthimin dhe kompensimin është neutral në aspektin gjinor dhe jodiskriminues për të gjithë trashëgimtarët. Pengesat për gratë që të kërkojnë të drejtat e pronësisë nuk ekzistojnë në ligj, por në praktikat zakonore. Sipas traditës, kryefamiljar bëhet trashëgimtari mashkull. Në shumë raste, motrat deklarojnë me shkrim heqjen dorë nga e drejta e trashëgimisë, veçanërisht për pronat e konfiskuara. E njëjta gjë ka ndodhur shpesh edhe në raste të tjera, si kthimi i tokës së konfiskuar apo kompensimi në vlerë monetare. Edhe pse ky Veprim nuk e trajton këtë çështje qartazi, ekzistenca e titujve të saktë dhe të dixhitalizuar për gratë për gratë që vendosin të regjistrojnë pronën e tyre, garanton njohjen e të drejtës së tyre dhe sigurinë e titujve, gjë që është e domosdoshme për gëzimin e plotë të të drejtës mbi pronën, përfshirë investimet në pronë, përdorimin e saj si kolateral, etj.

[11] Raporti i BB dhe FAO për Të Dhënat e Ndara sipas Gjinisë në Ballkanin Perëndimor, 2013.
[12] Pasqyrim i nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për Të Drejtat e Njeriut.

Legalizimi i ndërtimeve pa leje - Një fushë që nuk ka dispozita ligjore është legalizimi i pronave nga të dy bashkëshortët kur objekti është ndërtuar gjatë martesës. Leja e legalizimit dhe certifikata e pronësisë nuk lëshohen si bashkëpronësi, duke diskriminuar kështu kryesisht të drejtat e bashkëshorteve (grave). Edhe pse është kusht ligjor[i] që aplikanti të depozitojë certifikatën familjare, ende nuk ka mekanizma të mjaftueshëm nga ALUIZNI te ZRPP që certifikatat e pronësisë për prona të legalizuara të lëshohen në bashkëpronësi të bashkëshortëve.

Gratë e komunitetit rom dhe egjiptian – Gratë rome dhe egjiptiane përballen me pengesa shumë më të mëdha në marrjen e të drejtave të pronësisë dhe aksesit në drejtësi. Vështirësitë për të pasur vendbanim, strehim apo infrastrukturë bazë rriten për shkak të formimit arsimor të ulët dhe mungesës së informacionit. Shpesh, mosregjistrimi i lindjes së tyre, të fëmijëve apo të martesës në Zyrën e Gjendjes Civile pengon rëndë të drejtën e tyre për pronë dhe akses në drejtësi, siç theksohet edhe nga Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racor në Vëzhgimet Përfundimtare 2019 për Shqipërinë.[13]

Mundësitë e barabarta - Parimi i mundësive të barabarta do të respektohet në të gjitha fazat e zbatimit të projektit. Kualifikimet dhe përvoja e duhur profesionale do të jenë faktorët kryesorë të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit. Të gjitha raportet periodike të progresit dhe raportet e ndërmjetme do të përfshijnë një shpjegim specifik mbi masat dhe politikat e marra në lidhje me pjesëmarrjen e grave dhe mundësitë e barabarta për gratë dhe burrat, si dhe do të matin arritjen e këtij objektivi.

Pakicat dhe grupet vulnerabël - Sipas censusit të vitit 2011, në Republikën e Shqipërisë janë gjithsej 52 700 individë nga të gjitha pakicat[14]. Me interes të veçantë për projektin është përqendrimi i personave që u përkasin të gjitha pakicave kombëtare, veçanërisht pakica greke që jeton në bregdet (kryesisht në Bashkinë e Himarës), zonë ku po kryhet regjistrimi fillestar. Që nga viti 1991, kjo pakicë e ka kundërshtuar metodologjinë e ndarjes së tokës për frymë sipas ligjit 7501, veçanërisht përgjatë zonës bregdetare. Që Veprimi të jetë i suksesshëm, strategjia dhe instrumentet e ndërhyrjes duhet të sigurojnë komunikim të ngushtë me njësitë e qeverisjes vendore, drejtuesit e komunitetit dhe kryepleqtë apo anëtarët, në masë sa më të madhe. Takimet dhe konsultimet duhet të jenë periodike, për të garantuar transparencë të plotë. Nevojitet një analizë e fazës së parë të regjistrimit që po vazhdon, me qëllim që mësimet e nxjerra të aplikohen në shkallë më të gjerë. Në përgjithësi, komuniteti rom dhe egjiptian nuk është diskriminuar në proceset e privatizimit të tokës bujqësore, kthimit dhe kompensimit, privatizimit të banesave në vitet '90, regjistrimit fillestar apo legalizimit. Megjithatë, shumë romë dhe egjiptianë vazhdojnë të jetojnë në vendbanime informale ku të drejtat e pronësisë dhe problematikat e pronës të pazgjidhura. Përmbushja e zotimit sipas Deklaratës së Poznanit për Integrimin e Romëve për të legalizuar vendbanimet informale ku jetojnë romët kurdo që është e mundur, apo që t'u sigurohet strehim i përshtatshëm romëve që jetojnë në vendbanime informale që nuk mund të legalizohen, do të vazhdojë të kërkohet dhe të monitorohet.

Angazhimi me shoqërinë civile (dhe palë interesi joshtetërore, sipas rastit) - Për të rritur transparencën dhe për të shmangur çdo perceptim korrupsioni, Veprimi parashikon angazhimin e organizatave të shoqërisë civile (OSHC), nisur nga interesi i lartë që shoqëron regjistrimin e titujve të pronësisë. Neutraliteti i OSHC-ve mund të rezultojë vlerë e shtuar gjatë fushatave të ndërgjegjësimit apo takimeve derë-më-derë, fokus grupeve, diskutimeve me udhëheqësit e komunitetit, mbledhjes së statistikave dhe mediumeve krijuese për të rritur pjesëmarrjen. Inkurajohet prania e anëtarëve të OSHC-ve gjatë punës në terren, sepse kështu rritet llogaridhënia dhe transparenca e personelit të projektit dhe qytetarëve. Bashkëpunimi me institucionin e Avokatit të Popullit është shumë i rëndësishëm në rastet e problematika me të drejtat e njeriut.

Mjedisi dhe ndryshimet klimatike - Ndryshimet klimatike, humbja e tokës dhe e biodiversitetit po prekin Shqipërinë duke krijuar vështirësi ekonomike dhe duke dëmtuar ekuilibrin ekologjik të vendit. Shqipëria do të jetë një nga vendet evropiane më të prekura nga efektet e ndryshimeve klimatike, me rritje të temperaturave, periudha thatësire, përmbytje, rritje të nivelit të detit, ngjarje ekstreme të motit, ulje të reshjeve dhe kompromitim të sektorit të bujqësisë. Kjo do të sjellë sfida të mëdha për aktivitetet ekonomike dhe mjetet e jetesës, si dhe do të rrisë presionin e popullatës drejt zonave dhe ekosistemeve të mbrojtura. Aktivitetet e këtij veprimi, të tilla si përmirësimi i informacionit dhe shërbimeve të menaxhimit të integruar të tokës, kryesisht duke përmirësuar shërbimet kadastrale dhe dixhitalizimin e të dhënave të tokës, rritjen e kapaciteteve për përdorimin e tokës dhe reformat, janë kyçe për zbutjen e ndryshimeve klimatike, mbrojtjen e tokës, menaxhimin dhe ruajtjen e zonat e mbrojtura, mbrojtjen civile, mbrojtjen dhe menaxhimin e ujit, si dhe mbledhjen e statistikave mjedisore dhe ekonomike. Politikat, planifikimi dhe reformat e ardhshme në fushat e

[13] Konventa Ndërkombëtare e OKB-së për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, Vëzhgimet Përmbyllëse të raporteve periodike 9 deri 12 të Shqipërisë, 2 janar 2019.
[14] Ligji 96/2017 parashikon se "pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë janë pakicat greke, maqedonase, arumune, rome, egjiptiane, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare".

sipërpërmendura do të mbështeten në dixhitalizimin e të drejtave të pronësisë. Dixhitalizimi është thelbësor për të ditur kufijtë e zonave dhe pyjeve të mbrojtura dhe ku planifikohen korridoret e ardhshme për jetën e egër, për planifikimin urban dhe planifikimin e një transporti publik të qëndrueshëm. Zhvillimi i energjisë së rinovueshme në Shqipëri shpesh pengohet nga paqartësia në të drejtat e pronësisë, pasi fermat diellore dhe ato me erë kërkojnë sipërfaqe të mëdha dhe të konsoliduara toke. Mbrojtja e ujit dhe planet e menaxhimit, planet e mbrojtjes civile lidhur me përmbytjet, do të bazohen në dixhitalizimin dhe në shërbimet e menaxhimit të integruar të tokës. Ndërtimi i kapaciteteve, zhvillimi i legjislacionit si dhe përgatitja dhe zbatimi i planeve, programeve dhe strategjive për shërbimet e menaxhimit të integruar të tokës do të mbajnë parasysh legjislacionin e zbatueshëm për mjedisin dhe do të avancojnë planifikimin për zbutjen e ndryshimeve klimatike, zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e natyrës.

3.5. Kushtet për zbatimin

Qeveria e Shqipërisë:

- Respekton zotimin për të përmbushur detyrimet në kuadrin e marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare, gjatë të gjithë zbatimit të projektit.
- Me fillimin e zbatimit të programit, përkushtohet që të ofrojë infrastrukturën, mjediset dhe personelin pjesëmarrës të nevojshëm për zbatimin e programit.
- Përgjatë zbatimit, garanton hartimin e ndryshimeve ligjore të nevojshme në legjislacionin përkatës (përfshirë aktet nënligjore, sipas rastit).
- Përditëson planin (e hartuar për të përmbushur kushtet e IPA 2020) e luftës kundër korrupsionit në fushën e të drejtave të pronësisë, gjatë dy viteve të para të zbatimit.
- Me fillimin e zbatimit të programit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës konfirmon ose riemëron Menaxherin e përhershëm të Programit (të emëruar në kuadrin e IPA 2020) me kompetenca vendimmarrëse.

Mosrespektimi i kushteve të renditura më lart mund të rezultojë në rikuperim të fondeve në kuadrin e këtij programi dhe/ose rialokimin e financimeve të ardhshme.

3.6. Kuadri Logjik

Rezultatet	Zinxhiri i rezultateve: rezultatet kryesore të pritshme (maks. 10)	Treguesit (të paktën një tregues për rezultat të pritshëm)	Viti bazë (2020)	Synimet (viti) 2026	Burimet e të dhënave (1 për tregues)	Supozimet
Ndikimi	Të kontribuojë në forcimin e mbrojtjes së të drejtës për pronën fizike në Shqipëri dhe në kapacitetet e Shqipërisë për të garantuar në praktikë të drejtën e pronës, si një nga të drejtat themelore	Indeksi Global i Konkurrueshmërisë	Vendi 112 nga 141 shtete 2019 (vlera 57.61)		https://www.weforum.org/reports/the-global-competitiveness-report-2020	*Nuk aplikohet*
		Indeksi i Të drejtave të Pronësisë, Rezultati i Përgjithshëm	Vendi 112 nga 129 shtete, në 2002 (vlera 4.29)	Përmirësim me të paktën 5 pozicione	https://www.internationalpropertyrightsindex.org/countries#compare-panel Indeksi i Renditjes Globale për Shqipërinë	
Rezultati 1	1. Treg toke dinamik dhe instrumente financiare të zhvilluara përmes ngritjes së një kuadri të qartë për të drejtat e pronësisë në Shqipëri.	Mbrojtja ligjore dhe politike, Indeksi i Të drejtave të Pronësisë	4,04 (2020)	Përmirësim i indeksit me të paktën 20%	https://www.internationalpropertyrightsindex.org/country/albania Mbrojtja ligjore dhe politike e Indeksit të Të Drejtave të Pronësisë	Përkushtimi i vazhdueshëm i Qeverisë së Shqipëri ndaj axhendës së reformës së të drejtave të pronësisë.
Produkti 1 lidhur me Rezultatin 1	1.1 Të dhënat hapësinore dhe të drejtat ligjore të pronësisë si dhe informacioni i menaxhimit të tokës korrigjohen, përditësohen dhe bëhen publike.	Numri i zonave kadastrale ku hartat kadastrale janë plotësuar të dixhitalizuara (të skanuara dhe të gjeoreferencuara).	4% ose 126 ZK (nga 3057 në 2020)	100%	Të dhënat bazë nga Njësia e Monitorimit të Projekteve (ASHK).	Të gjitha njësitë qeveritare përkrahin procesin e dixhitalizimit/ skanimit dhe mbështetin hapat e integrimit. Miratohet imponimi ligjor për mirëmbajtje
		Përqindja e parcelave me të	20%	40%	Të dhënat e Regjistrit të Pronës dhe raportet periodike. Raportet e Sigurimit të Cilësisë përgjatë Veprimit.	

		dhëna plotësisht të përditësuara dhe të përmirësuara për të drejtat e pronësisë.					ekskluzivisht dixhitale. Metodologjitë dhe teknologjitë pranohen dhe përdoren nga të gjithë institutet pjesëmarrëse. Procesi i korrigjimit të të dhënave mbështetet nga niveli qendror dhe vendor. Qeveria vë në zbatim ndryshimet e planifikuara institucionale. Institutet pjesëmarrëse angazhohen në proceset e menaxhimit të ndryshimeve. Institutet përkatëse janë gati për përpunimin/zbatimin e ndryshimeve dhe për trajnimet.
		Numri i njësive shtetërore që marrin të dhëna nga ACLIS (Sistemi Informatik Qendror i Menaxhimit të Informacionit të Tokës)	Të gjitha zyrat ASHK vetëm në 2020	20 njësi shtetërore jashtë ASHK	-Dokumentacion sistemi, manuale. -Raporte projekti.		
Produkti 2 lidhur me Rezultatin 1	1.2 Shërbimet publike të ASHK-së rikonceptohen dhe ofrohen.	Numri i dokumenteve që qytetari duhet të dorëzojë për të regjistruar në pronë të përfituar përmes një kontrate shitjeje.	7	4	-Lista e dokumenteve që kërkohen verifikohet sipas Të Bërit Biznes të Bankës Botërore (në Tiranë 5 hapa, në qytete të tjera 6 për shkak të aksesit të noterisë), aktet nënligjore të ZRPP-së, faqja e internetit e ZRPP-së: http://www.zrpp.gov.al/new/sherbimet/ -Raportet shtetërore vjetore.		
		% e posedimit dhe menaxhimit të pronave nga gratë	Të dhënat bazë maten në fillin të projektit	Rritje me 10%	Të dhënat nga Regjistri i Pronave (të dhëna nga sistemi qendror i regjistrimit të ASHK-së)		
		Numri i ditëve për regjistrimin e pronës.	19	12	Të dhënat bazë dhe raportet e progresit nga Njësia e Monitorimit të Projekteve (ASHK) Të dhënat e Regjistrit të Pronave dhe raportet periodike.		
		Numri i zyrtarëve të trajnuar / mentoruar në ASHK./ # i zyrtarëve femra të trajnuara	0	300 / 150	-Raporti i vlerësimit të kapaciteteve. -Raportet e Trajnimeve -Raporti i menaxhimit të ndryshimeve në organizatë.		
Produkti 3 lidhur me Rezultatin 1	1.3 Masat përgatitore ndërmerren për ngritjen e sistemit të monitorimit	Numri i zyrtarëve të trajnuar mbi standardet e BE-së për LPIS (përfshirë	0	100 / 50	Programi i trajnimit, materialet e trajnimit, lista e pjesëmarrësve, vlerësimi i trajnimit. Specifikimet për ngritjen e LPIS.		Personeli i MBZHR-së dhe Agjencisë së Pagesave angazhohen me zbatimin.

bujqësor bazuar në parcelë toke, sipas standardeve të BE-së	IACS, CAP, GIS). / # i zyrtareve femra						
	Hartimi i specifikime teknike për LPIS.	Jo					
		Po				Specifikimet teknike për LPIS. Raporti i progresit të Projektit.	

4. MODALITETET E ZBATIMIT

4.1 Marrëveshja e financimit

Për zbatimin e këtij Veprimi, parashikohet lidhja e një marrëveshjeje financimi me Republikën e Shqipërisë.

4.2 Zbatimi i komponentit të mbështetjes buxhetore

N/A

4.3 Modalitetet e zbatimit

Komisioni do të garantojë respektimin e rregullave dhe procedurave përkatëse të BE-së për dhënien e financimeve palëve të treta, përfshirë procedurat e rishikimit sipas rastit dhe përputhshmërinë e veprimit me masat shtrënguese të BE-së[15].

4.3.1 Menaxhim Direkt (Grantet)

N/A

4.3.2 Menaxhimi Direkt (Çmimet)

N/A

4.3.3 Menaxhimi Direkt (Prokurim)

Produktet 1, 2 dhe 3 do të arrihen përmes prokurimit të shërbimeve dhe furnizimeve.

Objekti	Lloji indikativ (punime, furnizime, shërbime)	Tremujori indikativ i shpalljes së procedurës
Kontrolli i Cilësisë për të dhënat e pasurive të paluajtshme.	Shërbime	T3 2022
Përmirësimi i të dhënave dhe informacionit për pasuritë e paluajtshme	Shërbime	T2 2022
Mbështetja për ngritjen e **Qendrës së Dixhitalizimit të ASHK-së dhe Qendrës së Të Dhënave ACLIS**	Shërbime dhe Furnizime	T3 2022
Mbështesja për përmirësimin e proceseve të punës të shërbimeve të ASHK-së	Shërbime	T4 2022
Forcimi i kapaciteteve të Ministrisë së Bujqësisë për monitorim dhe subvencionim bujqësor bazuar në parcelë.	Shërbime	T4 2023

[15] www.sanctionsmap.eu Vini re se harta e sanksioneve është një mjet TI për identifikimin e regjimeve sanksionuese. Sanksionet burojnë nga aktet ligjore të publikuara në Gazetën Zyrtare (GZ). Në rast mospërputhjeje mes akteve ligjore të publikuara dhe përditësimeve në faqen e internetit, mbizotërojnë versionet e publikuara në GZ.

4.3.4 Menaxhim indirekt me delegim te subjekti(et) (p.sh. organizatë e Shtetit Anëtar, vend i tretë donator, agjenci e specializuar e BE-së (tradicionale / rregullatore), organizatë ndërkombëtare

N/A

4.3.5 Menaxhim indirekt me një Përfitues IPA III

N/A

4.3.6 Kontributi për <emri i Instrumentit Miks Rajonal/Platformës>

N/A

4.3.7 EFSD+ operacionet që mbulohen me garanci buxhetore

N/A

4.3.8 Ndryshime nga menaxhimi direkt në modalitetin indirekt (dhe anasjelltas) për shkak të rrethanave përjashtimore (një alternativë, opsioni i dytë)

Në rrethana përjashtimore dhe me autorizim të Komisionit Evropian, lejohen ndryshimet nga menaxhimi indirekt në direkt (dhe anasjelltas), si dhe ndryshime të tjera në modalitetet e menaxhimit dhe prokurimit.

Nëse Veprimi zbatohet me menaxhim indirekt me një subjekt, ky i fundit përzgjidhet prej shërbimeve të Komisionit bazuar në kriteret e mëposhtme:

i. Mandati i subjektit të ngarkuar/deleguar që mbulon natyrën e veprimit;
ii. Përvoja e subjektit potencial, sidomos në kontekstin e Bashkimit Evropian dhe në Shqipëri;
iii. Kapacitetet operacionale/ekspertiza teknike, kapacitetet logjistike dhe menaxhuese, sidomos në sektorin në fjalë;
iv. Ndikimi, rezultatet, efekti levë i bashkëpunimit me subjekte të tjera/donatorët, si edhe efektiviteti i delegimit të detyrave qoftë edhe në Shqipëri;
v. Reduktimi i kostove të transaksioneve;
vi. Kapaciteti i subjektit për të dhënë bashkëfinancim të mundshëm;
vii. Përvoja në sektorin e të drejtave të pronësisë.

4.4. Shtrirja e pranueshmërisë gjeografike për prokurimet dhe grantet

Pranueshmëria gjeografike në kuptimin e vendit të vendosjes për pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit dhe të dhënies së granteve si dhe në kuptimin e origjinës së artikujve të blerë, sipas aktit bazë dhe dispozitave të dokumenteve kontraktuale, zbatohet sipas dispozitës së mëposhtme:

Zyrtari përgjegjës autorizues i Komisionit mund të zgjerojë pranueshmërinë gjeografike në rast urgjence apo mungese të shërbimeve në tregjet e vendeve apo territoreve përkatëse, apo në situata të tjera të justifikuara siç duhet, ku aplikimi i rregullave të pranueshmërisë do ta bënte realizimin e këtij Veprimi të pamundur ose tejet të vështirë.

4.5. Buxheti indikativ

	Kontributi i BE-së (në EUR)	Kontributi indikativ i palës së tretë (në EUR)
Produkti 1: Të dhënat hapësinore dhe të drejtat ligjore të pronësisë si dhe informacioni i menaxhimit të tokës korrigjohen, përditësohen dhe bëhen publike, që konsiston në	6 000 000	N.A.
Menaxhim direkt (Prokurim) – cf. seksioni 4.3.3	N.A.	
Produkti 2: Rikonceptohen shërbimet publike të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, që konsiston në	3 200 000	N.A.
Menaxhim direkt (Prokurim) – cf. seksioni 4.3.3	N.A.	
Produkti 3: Ndërmerren masa përgatitore për ngritjen e sistemit të monitorimit bujqësor bazuar në parcelë toke, sipas standardeve të BE-së, që konsiston në	800 000	N.A.
Menaxhim direkt (Prokurim) – cf. seksioni 4.3.3	N.A.	
Prokurimi – buxheti total nën seksionin 4.3.3	**10 000 000**	N.A
Vlerësimi (cf. seksioni 5.3)	mbulohet nga një tjetër vendim	N.A.
Auditi/Verifikimi i shpenzimeve (cf. Seksioni 6)	mbulohet nga një tjetër vendim	N.A.
Komunikimi dhe vizibiliteti (cf. Seksioni 7)	0	N.A.
Kontingjencat	0	N.A.
Totali	**10 000 000**	

4.6. Struktura organizative dhe përgjegjësitë

Në rastin e menaxhimit direkt, Autoriteti Kontraktues do të jetë **Delegacioni i BE-së në Shqipëri.** DBE do të jetë përgjegjëse për të gjitha marrëveshjet kontraktuale me kontraktorët e përzgjedhur.

Homologët kryesorë të Autoritetit(eve) Kontraktues gjatë zbatimit të Veprimit janë:

- **Për produktet 1.1 dhe 1.2,** përfituesi kryesor i Veprimit do të jetë Agjencia Shtetërore e Kadastrës, që do të veprojë në koordinim të ngushtë me Kryeministrinë dhe me Komitetin Ndërministror për Reformën e Menaxhimit të Integruar të Tokës dhe me palët e tjera të interesit.
- **Për produktin 1.3,** përfituesi kryesor i Veprimit do të jetë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Delegacioni i BE-së do të organizojë takime të përbashkëta të Komitetit Drejtues për zbatimin e mbështetjes të parashikuar për Të Drejtat e Punës, në kuadrin si të Veprimit të IPA 2020 dhe të këtij Veprimi.

Koordinimi sektorial sigurohet nga Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave për Menaxhimin e Tokës, i cili i korrespondon Komitetit Ndërministror për Reformën e Menaxhimit të Integruar të Tokës, në kuadrin e Urdhrit të Kryeministrit nr. 202, datë 21.11.2018 "Për ngritjen e Komitetit Ndërministror dhe

Grupit Ndërministror të Punës për Reformën e Menaxhimit të Integruar të Tokës dhe masat për zbatimin e saj". Struktura qeverisëse e reformës përbëhet nga: (i) Komiteti Ndërministror; (ii) Grupi i Punës; dhe (iii) Sekretariati Teknik. Ministria e Drejtësisë e kryeson Komitetin Ndërministror. Ministria e Drejtësisë ka edhe rolin për të bërë propozime legjislative, përfshirë për të drejtat e pronësisë. Gjithashtu, një përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë është anëtar i Bordit ku do të raportojë Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Ministria e Drejtësisë ka edhe rol të drejtpërdrejtë mbikëqyrës mbi Agjencinë e Trajtimit të Pronave (ATM) që kryen procesin e kthimit dhe kompensimit.

5. MONITORIMI DHE RAPORTIMI I PERFORMANCËS/REZULTATEVE

5.1. Monitorimi i brendshëm

Për zbatimin e reformave, Qeveria e Shqipërisë do të garantojë mekanizma adekuate monitorimi dhe vlerësimi në kuadrin e Komitetit Ndërministror për Menaxhimin e Integruar të Tokës. Komiteti do të mbajë kontakte periodike me organizatat apo individët që udhëheqin secilën ndërhyrje për të garantuar që aktivitetet janë në shinat e duhura dhe që pengesat po adresohen.

Për zbatimin e Veprimit do të ketë monitorim periodik bazuar në raportet e progresit të paraqitura nga Komiteti Drejtues, që vlerësojnë arritjen e treguesve dhe objektivave në zbatimin e secilës kontratë.

Një nga kontratat sipas IPA 2020, "BE-ja për të Drejtat e Pronës" do të përfshijë mbështetje teknike këshilluese mbi monitorimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha aspekteve teknike të zbatimit, mbi koordinimin teknik mes modaliteteve, si dhe shërben si ombrellë teknike për programin e të drejtave të pronësisë në kuadrin e IPA 2020 dhe IPA 2021. Përgjegjësitë specifike përfshijnë: monitorim dhe këshillim mbi të gjitha procedurat teknike dhe produktet e kontratës së shërbimit; ofrim i koordinimit teknik ndërmjet moduleve; përgatitje të specifikimeve të ndryshme teknike, sipas nevojës; ndërlidhje me partnerë për çështje teknike (me përfituesit dhe organizatat donatore); sigurim i cilësisë për të gjitha rezultatet e projektit.

5.2. Rolet dhe përgjegjësitë për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave

Raportimin mbi progresin e RMIT-së e bën Qeveria përmes strukturave të brendshme monitoruese ekzistuese. Gjatë 2021-2022, do të hartohet një strategji (me mbështetjen e asistencës teknike gjatë fazës së parë të këtij programi në kuadrin e IPA 2020) dhe do të integrohet në mekanizmat monitorues periodikë të politikave të qeverisë. Në kohën që ky program fillon, strategjia si dhe mekanizmat monitorues dhe raportues të saj do të jenë finalizuar.

Gjithashtu, të gjitha veprimet përfshijnë Asistencë Teknike që do të përmbajë modalitete raportimi.
Për secilin projekt, tregues të matshëm specifikë do të përcaktohen dhe do të monitorohen.
Rezultatet e treguesve dhe pagesat do të bëhen në kuadrin e secilit projekt dhe do të mbikëqyren nga *Task Manager* i BE-së dhe nga Komiteti Drejtues i Projektit.

5.3. Vlerësimi

Nisur nga rëndësia e Veprimit, konsulentë të pavarur të kontraktuar prej Komisionit do të kryejnë një vlerësim përfundimtar për këtë Veprim në tërësi apo komponentë të tij.

Vlerësimi përfundimtar kryhet për qëllimet e llogaridhënies dhe nxjerrjes së mësimeve në nivele të ndryshme (edhe për rishikimin e politikave).

Komisioni informon partnerin zbatues të paktën një muaj përpara datave të planifikuara për misionet e vlerësimit. Partneri zbatues bashkëpunon në mënyrë efikase dhe efektive me ekspertët vlerësues si dhe u

ofron atyre, ndër të tjera, të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, si edhe akses në ambientet dhe aktivitetet e projektit.

Raportet e vlerësimit u vihen në dispozicion vendit partner dhe palëve kryesore të interesit. Partneri zbatues dhe Komisioni analizojnë përfundimet dhe rekomandimet e vlerësimeve dhe, sipas rastit, vendosin bashkërisht mbi masat ndjekëse dhe rregullimet e nevojshme që mund të përfshijnë edhe riorientimin e projektit.

6. AUDITI

Pa cenuar detyrimet e zbatueshme në kuadrin e kontratave të nënshkruara për zbatimin e këtij Veprimi, Komisioni mundet që mbi bazën e një vlerësimi risku të kontraktojë kryerjen e auditeve të pavarura apo verifikimin e shpenzimeve për një ose disa kontrata apo marrëveshje.

7. KOMUNIKIMI DHE VIZIBILITETI

Vizibiliteti i financimeve të BE-së dhe komunikimi mbi objektivat dhe ndikimin e Veprimeve janë detyrim ligjor për të gjitha Veprimet e financuara nga BE-ja, siç përcaktohet në kërkesat në fuqi të komunikimit dhe vizibilitetit të BE-së.

Në veçanti, përfituesi i fondeve të BE-së pranon origjinën e fondeve të BE-së dhe garanton vizibilitetin e duhur të tyre përmes masave më poshtë:

- të gjitha dokumentet dhe materialet e komunikimit që lidhen me zbatimin e fondeve dhe faqja zyrtare e internetit dhe mediat sociale, nëse ka, duhet të përmbajnë në vend të dukshëm një pohim që nënvizon se fondet janë dhënë nga BE-ja;
- promovon masat dhe rezultatet e tyre, duke dhënë informacion të shënjestruar, proporcional, koherent dhe efektiv për audiencat e ndryshme, përfshirë median.

Masat e vizibilitetit dhe komunikimit zbatohen, sipas rastit, nga administratat kombëtare (p.sh., për reformat që mbështeten me buxhet të BE-së), subjektet e ngarkuara, kontraktorët dhe përfituesit e granteve. Detyrimet kontraktuale të përshtatshme përfshihen në marrëveshjet e financimit, në marrëveshjet e delegimit dhe në kontratat e prokurimit dhe ato grant.

Masat bazohen në një Plan specifik Komunikimi dhe Vizibiliteti, që hartohet dhe zbatohet në përputhje me kërkesat në fuqi të BE-së për komunikimin dhe vizibilitetin. Plani duhet të përmbajë ndër të tjera një narrativë komunikimi dhe mesazhe kryesore për Veprimin, të përshtatura sipas audiencave të synuara (palët e interesit, shoqëria civile, publiku i gjerë, etj.).

Masat e vizibilitetit dhe komunikimit specifike për këtë Veprim janë komplementare me aktivitetet e gjera të komunikimit që zbatohen direkt nga shërbimet e Komisionit Evropian dhe/ose Delegacioni i BE-së. Komisioni Evropian dhe Delegacioni i BE-së duhet të informohen plotësisht mbi planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve specifike të vizibilitetit dhe komunikimit, sidomos ato që kanë të bëjnë me narrativën e komunikimit dhe mesazhet kryesore.

Në kuadrin e programit të IPA 2020, "BE-ja për Të Drejtat e Pronë", një kontratë kuadër do të fillojë në shtator 2021 e cila do të mbështetë komunikimin dhe vizibilitetin e reformës në përgjithësi si dhe mbështetjen që i kushton BE-ja të drejtave të pronësisë në veçanti.

8. QËNDRUESHMËRIA

Qeveria e Shqipërisë e ka shprehur tashmë angazhimin politik për reformën e tokës, e cila identifikohet në Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë, si një prioritet kyç. Mekanizmi institucional i ngritur do të monitorojë zbatimin dhe do të organizojë takime periodike për mbledhjen e informacionit mbi: aktivitetet që do të kryejë secili institucion, ecurinë e tyre, rezultatet e arritura dhe kur është e nevojshme, identifikimin e problemeve praktike me synimin për të gjetur zgjidhje. Raportet vjetore të monitorimit do të përmbajnë rekomandime për masa që sigurojnë qëndrueshmërinë.

Çelësi për sigurimin e qëndrueshmërisë së Veprimit është ngritja e kapaciteteve të personelit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencinë e Pagesave të parashikuara përmes Veprimit, në mënyrë që proceset e nisura të finalizohen dhe të vazhdojnë në të ardhmen, konkretisht për sa i përket dixhitalizimit të të dhënave për pronën dhe ngritja e vënia në funksionim të plotë i LPIS (Sistemi i Identifikimit të Parcelave të Tokës). Gjithashtu, duhet të sigurohet mirëmbajtja e duhur dhe përmirësimi i mëtejshëm i të gjitha sistemeve TI sipas nevojave.

Mekanizmi i koordinimit ndërinstitucional i nivelit të lartë i ngritur për menaxhimin e integruar të tokës ka rol qendror për qëndrueshmërinë e Veprimit, sepse garanton përfshirjen e plotë të organeve të qeverisjes dhe publike duke siguruar kështu "pronësinë" e tyre në të gjitha nivelet.

SHTOJCA I.3
e Marrëveshjes së Financimit për planin vjetor të veprimit në favor të Shqipërisë për vitin 2021
Dokumenti i Veprimit për "BE-ja për Natyrën"

SINOPS

1.1. Tabela Përmbledhëse e Veprimit

Titulli	**BE-ja për Natyrën** Plani Vjetor i Veprimit në favor të Shqipërisë për vitin 2021			
Numri *CRIS*	IPA III/2021/ 043-666/3			
Akti bazë	Financuar në kuadrin e Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA III)			
Nisma *Team Europe*	Jo			
Zona që përfiton nga veprimi	Veprimi zbatohet në Shqipëri			
Dokumenti programues	Kuadri Programues IPA III			
FUSHAT PRIORITARE DHE INFORMACIONI SEKTORIAL				
Dritarja dhe prioriteti tematik	D 3 – Axhenda e Gjelbër dhe Ndërlidhja e Qëndrueshme PT 1 – Mjedisi dhe ndryshimet klimatike			
Objektivat e Zhvillimit të qëndrueshëm (OZhQ)	OZhQ kryesor (vetëm 1): 13 – Veprimi për Klimën: Marrja e masave urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe ndikimet e tyre. OZhQ të tjera të rëndësishme (deri në 9) dhe synimet, sipas rastit: 14 Jeta nën Ujë: Ruajtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i oqeaneve, deteve dhe burimeve detare për zhvillimin e qëndrueshëm. 15 Jeta në Tokë: Mbrojtja, restaurimi dhe promovimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, lufta kundër shkretimit, ndalimi dhe kthimi pas i degradimit të tokë dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit.			
Kodi(et) *DAC*	Kodi DAC kryesor: 41030 Biodiversiteti (90%) Nënkodi 1: 312 Pylltaria (10%)			
Kanali Kryesor i Zbatimit	13000 – Qeveri e vendit të tretë (bashkëpunim i deleguar)			
Treguesit **(nga formulari DAC)**	**Objektivi i përgjithshëm i politikës**	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	Zhvillimi i pjesëmarrjes/ qeverisja e mirë	☐	☒	☐
	Ndihmë për mjedisin	☐	☐	☒
	Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave	☐	☒	☐
	Zhvillimi i tregtisë	☒	☐	☐

	Shëndeti riprodhues, i mëmësisë, të sapolindurve dhe fëmijëve	☒	☐	☐
	Reduktimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore	☒	☐	☐
	Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara	☒	☐	☐
	Ushqyerja	☒	☐	☐
	Treguesit e Konventës RIO	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	Diversiteti biologjik	☐	☐	☒
	Lufta ndaj shkretimit	☒	☐	☐
	Zbutja e ndryshimeve klimatike	☐	☒	☐
	Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike	☐	☒	☐
Tregues të brendshëm	**Objektivat e politikës**	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	Dixhitalizimi	☒	☐	☐
	Migrimi	☒	☐	☐
	COVID-19	☒	☐	☐
INFORMACION PËR BUXHETIN				
Shumat përkatëse	Linja e buxhetit: 15.020201.02 Kostoja totale e vlerësuar: 6 000 000 Euro Kontributi total i buxhetit të BE-së: 6 000 000 Euro			
MENAXHIMI DHE ZBATIMI				
Lloji i financimit dhe metoda(t) e zbatimit	Me Projekt **Menaxhim Direkt** përmes prokurimit **Menaxhim Indirekt** me subjekt(e) që përzgjidhen sipas kritereve të përcaktuara në seksionin 4.3.4.			
Prioritetet përkatëse dhe programet nga Plani Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor [vetëm për Ballkanin Perëndimor]	Prioritetet: "Axhenda e Gjelbër"			
Afati për lidhjen e Marrëveshjes së Financimit	deri më 31 dhjetor N+1			
Afati për lidhjen e marrëveshjeve të	3 vite pas datës së lidhjes së Marrëveshjes së Financimit, me përjashtim të rasteve të renditura në nenin 114(2) të Rregullores Financiare			

kontributit /delegimit, prokurimeve dhe kontratave grant	
Periudha indikative e zbatimit operacional	72 muaj pas lidhjes së Marrëveshjes së Financimit
Afati për zbatimin e Marrëveshjes së Financimit	12 vite pas lidhjes së Marrëveshjes së Financimit

1.2. Përmbledhja e Veprimit

Mbrojtja e natyrës është identifikuar si një nga prioritetet kryesore mjedisore nga Qeveria Shqiptare për financim nga IPA III. Ky Veprim synon të kontribuojë në menaxhimin efektiv të zonave të mbrojtura si dhe në krijimin e zonave të reja të mbrojtura si pjesë e përgatitjeve për rrjetin Natura 2000. Objektivi i përgjithshëm i Veprimit është që të paktën 25% e territorit shqiptar (në tokë dhe në det) të jetë e mbrojtur dhe e ruajtur deri në vitin 2030 - nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të një sistemi efektiv të zonave të mbrojtura, ndërlidhjes së ekosistemeve dhe masave të tjera efektive të bazuara në zona. Fokusi u vihet zonave veçanërisht të rëndësishme për biodiversitetin.

Organigrama dhe kapacitetet e duhura institucionale të institucioneve përgjegjëse si Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe të Administratave Rajonale të saj (AKZM/ARZM) janë thelbësore për ruajtjen e habitateve dhe specieve të rëndësishme. Kapacitetet duhet të përfshijnë edhe burimet e përshtatshme për inspektimin dhe zbatueshmërinë. Veprimi do të mbështetë Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTE) në hartimin e legjislacionit të brendshëm në përputhje me *acquis* të BE-së për natyrën. Gjithashtu, do të përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse në nivel kombëtar për zbatimin e legjislacionit për natyrën dhe të Direktivave për Shpendët dhe Habitatet (BHD).

Ky Veprim do të forcojë kapacitetet e institucioneve përgjegjëse në menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe në ngritjen e një sistemi efektiv monitorimi të performancës. Veprimi do të kontribuojë direkt në përmirësimin e efektivitetit të menaxhimit të zonave të mbrojtura në Shqipëri si dhe në zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive për të luftuar krimin mjedisor dhe për të bashkëpunuar me gjyqësorin. Përveç kësaj, mbështetja do të shkojë për rishikimin e planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura dhe hartimin e planeve të reja, në përputhje me kërkesat e Natura 2000. Përfundimisht, do të mbështetet edhe zbatimi i masave ruajtëse dhe rikuperimi i habitateve/ekosistemeve të degraduara.

Veprimi do të kontribuojë në rritjen e njohurive mbi shpërndarjen e habitateve dhe specieve në Shqipëri, kështu që do të sigurojë vendimmarrje për ruajtjen bazuar në shkencë. Gjithashtu, hartimi i planeve të reja të menaxhimit për pyjet dhe prodhimet pyjore jodrusore do të përmirësojë menaxhimin e qëndrueshëm të këtyre burimeve natyrore të rëndësishme. Zbatimi i zgjidhjeve bazuar në natyrë, ndërgjegjësimit, harmonizimit të legjislacionit dhe granteve, do t'u japë mbështetje më të fortë zonave të mbrojtura në veçanti dhe përpjekjeve për ruajtjen e tyre në përgjithësi.

2. ARGUMENTIMI

2.1. Analiza e Kontekstit

Shqipëria konsiderohet vatër e nxehtë e biodiversitetit në Evropë. Megjithatë, biodiversiteti i jashtëzakonshëm dhe burimet e vyera natyrore po përballen me sfida. Si një ekonomi në tranzicion, Shqipëria po ndjek një trajektore të shpejtë zhvillimi. Ndërtimi i rrugëve, infrastrukturës, digave, hidrocentraleve, depozitave të naftës dhe infrastrukturës së turizmit masiv synojnë të jenë në dobi të ekonomisë, por përbëjnë një kërcënim të madh për mbrojtjen e mjedisit. Në kuadrin e qëllimit për t'u anëtarësuar në BE, Shqipëria duhet t'i harmonizojë përpjekjet e saj për ruajtjen e natyrës me kërkesat e BE-së, veçanërisht duke siguruar zbatimin e Direktivave për Shpendët dhe Habitatet. Komisioni Evropian[1] konstatoi në Raportin 2020 për Shqipërinë se ka avancuar ndjeshëm përafrimi me *acquis* të BE-së në fushën e mbrojtjes së natyrës, veçanërisht në Direktivat për Shpendët dhe Habitatet. Sipas të dhënave më të fundit, transpozimi i Direktivës së Habitateve është afërsisht 86% dhe transpozimi i Direktivës së Shpendëve është 65%. Megjithatë, zbatueshmëria e ligjit për mbrojtjen e mjedisit mbetet përgjithësisht e dobët.

Prioriteti kryesor është transpozimi i plotë i të gjitha direktivave/rregullore të BE-së në legjislacionin e brendshëm. Legjislacioni nevojitet për të garantuar vlerësimin e duhur të çdo plani/strategjie dhe projekti apo programi që kanë gjasa të kenë efekt të konsiderueshëm në zonat e ruajtura.

Nisur nga informacioni i mangët për popullatat e specieve që ekzistojnë në Shqipëri, përpjekje të mëtejshme duhen bërë për të pasur një inventar dhe monitorim të specieve të shpendëve. Një fushatë e gjerë për mbledhjen e të dhënave të tilla do të kontribuonte për të pasur njohuri më të sakta mbi shpërndarjen e habitateve dhe specieve në mbarë territorin.

Një kusht thelbësor për të çuar përpara zhvillimin e qëndrueshëm dhe për të arritur përdorim të balancuar dhe të drejtë të burimeve natyrore është që shoqëria të informohet, të ndërgjegjësohet dhe të përfshihet aktivisht në çështjet e mjedisit. Zbatimi i suksesshëm i Natura 2020 kërkon komunikim të gjerë dhe ndërgjegjësim të të gjithë palëve të përfshira. Në

[1] SWD(2020) 354 final

përputhje me Kuadrin Programues IPA III, ky Veprim trajton sfidën globale të përmirësimit të mjedisit dhe ruajtjen e tij për brezat e ardhshëm. Veprimi përfshin aktivitete që fokusohen në kthimin pas të degradimit mjedisor dhe në nxitjen e ruajtjes së ekosistemeve tokësore dhe ujore.

2.2. Analiza e problematikave sipas fushave që do të mbështeten

FUSHA E MBËSHTETJES #1: Zbatueshmëria dhe zbatimi i legjislacionit për mbrojtjen e natyrës në nivel vendor

Prioriteti kryesor i Shqipërisë në fushën e mbrojtjes së natyrës është transpozimi i plotë në legjislacionin e brendshëm i *acquis* të BE-së për natyrën. Projekti SANE 27[2] vlerësoi nivelin e transpozimit dhe zbatimit të kësaj *acquis,* duke konstatuar se shumica e direktivave dhe rregulloreve në nënkapitullin e natyrës janë në fazën fillestare të zbatimit. Nuk ka plane dhe/ose data të përcaktuara në nivel kombëtar për zbatimin e plotë të tyre. Në përgjithësi, ekzistojnë dispozitat ligjore dhe institucionet, por zbatueshmëria është ende e dobët dhe inspektimet nuk janë efektive. Legjislacioni duhet të zhvillohet për të garantuar vlerësimin e duhur të çdo plani dhe/ose projekti që mund të ketë efekte të ndjeshme në zonat e ruajtura. Gjithashtu, nevojiten masa kompensuese për të garantuar koherencën e përgjithshme me Natura 2000. Duhet hartuar legjislacionin edhe që asnjë masë të mos përkeqësojë zonat e ruajtura dhe që të inkurajohet menaxhimi i veçorive të peizazheve me rëndësi madhore për florën dhe faunën e egër (ato që janë thelbësore për shtegtimin, përhapjen dhe shkëmbimin gjenetik të specieve të egra).

Zbatimi pengohet nga mungesa e monitorimit të duhur, mekanizmave ligjzbatues dhe përgjegjësive të qarta për autoritetet dhe institucionet përgjegjëse. Kapacitetet institucionale duhet të forcohen, me qëllim që të ushtrohen përgjegjësitë e ngarkuara, sidomos lidhur me menaxhimin dhe monitorimin e zonave të mbrojtura.

Nisur nga informacioni i kufizuar për popullatën e specieve të pranishme në Shqipëri, përpjekje të mëtejshme duhet t'i kushtohen inventarizimit dhe monitorimit të specieve të shpendëve. Niveli i kufizuar i njohurive mbi shpërndarjen e habitateve dhe specieve pengon identifikimin dhe mbrojtjen e duhur të zonave përkatëse, si dhe përzgjedhjen dhe zbatimin e masave të duhura të ruajtjes. Është hartuar një listë paraprake[3] e Vendeve Potenciale me Rëndësi Komunitare dhe të Zonave të Mbrojtjes së Posaçme, e cila përfshin 44 zona. Megjithatë, jo për të gjitha vendet/zonat janë përcaktuar qartë kufijtë dhe prioritetet e menaxhimit. Përcaktimi i duhur i kufijve kërkon mbështetje të mëtejshme që ekspertët të hartëzojnë shpërndarjen e habitateve dhe shpendëve në secilën zonë të propozuar. Gjithashtu, duhet një fushatë e gjerë për mbledhjen e të dhënave për të përmirësuar njohuritë mbi shpërndarjen e habitateve dhe specieve në të gjithë vendin. Ky informacion do të kontribuojë në rishikimin e planeve ekzistuese të menaxhimit të zonave të mbrojtura dhe në hartimin e planeve të reja.

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM), edhe pse kërkohet me ligj, ka rezultuar mjet i pamjaftueshëm për të garantuar ruajtjen e duhur të specieve dhe habitateve të rëndësishme dhe të ndjeshme. Në shumicën e rasteve, informacioni dhe pohimet e raporteve VNM sfidohen dhe kundërshtohen gjerësisht nga ekspertët e pavarur dhe organizatat e shoqërisë civile. Shpesh, konsultimet publike vetëm sa bëhen formalisht. Pjesëmarrja dhe përfshirja e të gjitha palëve të interesuara është e dobët.

Edhe zbatimi i kërkesave të Direktivave për Shpendët dhe Habitatet ka nevojë për fonde. Ngritja e rrjetit Natura 2000 është proces i gjatë, kërkues dhe i kushtueshëm, sidomos në rastin kur ekspertiza vendase për specie dhe habitatet është e kufizuar. Deri tani, përpjekjet për ruajtjen e natyrës janë financuar kryesisht me kontributet e donatorëve. Përqindja e fondeve të buxhetit të shtetit duhet të rritet ndjeshëm për zbatimin e aktiviteteve monitoruese dhe masave të ruajtjes që kërkojnë direktivat dhe rregulloret. Duhet mbështetje financiare për ngritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e strukturës institucionale. Duhen eksploruar dhe zhvilluar instrumente financiare që mbulojnë zbatimin e kërkesave të direktivave të BE-së.

FUSHA E MBËSHTETJES #2: Rritja e angazhimit të publikut të gjerë për mbrojtjen e natyrës

Zbatimi i rregulloreve dhe direktivave sipas nënkapitullit për natyrën kërkon bashkëpunim të ngushtë me akademikët / universitetet dhe organizatat e shoqërisë civile. Për rrjedhojë, duhet të zhvillohen mekanizma për të garantuar përfshirjen dhe kontributin e tyre shkencor në procesin e zbatimit.

Kërkimi shkencor për mbrojtjen, menaxhimin dhe përdorimin e specieve dhe habitateve të egra natyrore në territorin shqiptar është ende në fazë fillestare. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTE) u jep financime të pakta institucioneve kërkimore për mbledhjen dhe sigurimin e të dhënave për jetën e egër. Pjesa më e madhe e fondeve vjen nga burime të jashtme, siç janë projektet e mbështetura nga BE-ja dhe Shtetet Anëtare të BE-së. Institucionet kërkimore shtetërore kanë kapacitete të kufizuara shkencore në disa fusha të specializuara (jovertebrorët).

[2] Mbështetja e Negociatave të Shqipërisë për Kapitullin 27 "Mjedisi", është program i financuar nga SIDA (shihni seksionin 2.5 për detajet).
[3] Projekti "NaturAL" (2015-2019) e ka përgatitur një listë paraprake me zonat që mund të përfshihen në rrjetin Natura 2000.

Kushti thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm dhe përdorimin e balancuar dhe të drejtë të burimeve natyrore është që shoqëria të jetë e informuar, e ndërgjegjshme dhe aktivisht e përkushtuar ndaj mjedisit. Zbatimi i suksesshëm i rrjetit Natura 2000 kërkon komunikim të gjerë dhe rritje të ndërgjegjësimit midis të gjithë palëve të përfshira. Ndërgjegjësimi dhe informimi i shtuar mbi rolin e zonave të mbrojtura shërbejnë jo vetëm për të mbështetur ruajtjen e biodiversitetit, por edhe si një mjet për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm dhe përdorimin e mençur të burimeve natyrore. Mbështetja nga palët e interesit dhe shoqëria civile në përgjithësi është thelbësore.

2.3. Relevanca dhe komplimentariteti me strategjitë e mbështetura nga palët e interesuara kryesore kombëtare

Gjatë dekadave të fundit, Shqipëria ka bërë përparim të konsiderueshëm në politikën e saj për mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë ruajtjen e natyrës. Strategjia Kombëtare e Biodiversitetit dhe Plani i Veprimit 2015-2022 janë aktualisht të vetmet dokumente politikash që synojnë drejtpërdrejt mbrojtjen e natyrës. Strategjia u përditësua në vitin 2020 pas rishikimit të saj afatmesëm dhe identifikon qartë fushat kryesore të punës, duke përfshirë ndër të tjera:

- Rritjen e sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura me 20% në tokë dhe 10% në ujërat detare dhe të brendshme.
- Plotësimin e kuadrit ligjor sipas *acquis* të BE-së për natyrën dhe mjedisin, në përputhje me Direktivat për Shpendët dhe Habitatet.
- Forcimin e ligjzbatimit duke përmirësuar legjislacionin dhe kapacitetet institucionale.

Aktivitetet e këtij Veprimi janë në linjë me rekomandimet e Raportit/Rishikimit Afatmesëm të Strategjisë Kombëtare të Biodiversitetit (2020) që identifikon këta objektiva për të ardhmen:

- Plotësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes së natyrës dhe harmonizimi i plotë me *acquis* të BE-së në këtë fushë.
- Zbatimi në praktikë i kuadrit ligjor të brendshëm në fushën e mbrojtjes së natyrës.
- Krijimi i Rrjetit Natura 2000 të Zonave e Interes për Komunitetin Evropian dhe garantimi i menaxhimit të qëndrueshëm të tyre.
- Rritja e sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura, sidomos zonat e mbrojtura detare dhe bregdetare, si kontribut për të arritur objektivin global për këto zona "Aichi objektivi 11" dhe rehabilitimin e zonave të mbrojtura.
- Përmirësimi dhe forcimi i mëtejshëm kapaciteteve të strukturave që merren me menaxhimin e zonave të mbrojtura.
- Zbatimi dhe përditësimi i planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura të cilat e kanë një plan, si edhe hartimi i planeve të menaxhimit të reja.
- Zbatimi i planeve të veprimit ekzistuese për speciet dhe habitatet si dhe hartimi i planeve të reja për speciet e rrezikuara.
- Forcimi i zbatimit të moratoriumit 5-vjeçar të gjuetisë dhe plotësimi i kuadrit ligjor në këtë fushë.

Integrimi në BE është një prioritet kryesor për Qeverinë Shqiptare dhe prej më shumë se një dekade Shqipëria ka punuar intensivisht për transpozimin e Direktivave të BE-së në legjislacionin e saj të brendshëm. Megjithëse transpozimi i direktivave përkatëse po përparon mirë (86% e Direktivës për Habitatet, 65% e Direktivës për Shpendët), zbatimi i të dyjave është ende në fazë fillestare.

Së pari, transpozimi i plotë duhet të përfundojë. Është miratuar lista e habitateve dhe specieve me Rëndësi Komunitare në Shqipëri, por ekspertët mendojnë se mund të përmirësohet. Gjithashtu, janë evidentuar disa korrigjime / shtesa në listën e specieve dhe habitateve me interes komunitar në Shqipëri. Lista paraprake e Zonave me Rëndësi Komunitare të hartuar nga projekti NaturAL përmban 44 zona që mbulojnë zonat e mbrojtura ekzistuese, si edhe zona që ende nuk janë të mbrojtura. Janë hartuar orientimet metodologjike se si të identifikohen zonat me interes komunitar bazuar në kërkim shkencor dhe përqasje pjesëmarrëse. Megjithatë, mungojnë hartat e detajuara për habitatet që mbulojnë të gjithë vendin. Njohuritë mbi shpërndarjen e specieve janë të kufizuara dhe/ose të copëzuara.

2.4. Relevanca dhe komplimentariteti me politikën e BE-së dhe asistencën e BE-së dhe donatorëve të tjerë

Ky Veprim është në përputhje me **Kuadrin Programues IPA III,** Prioriteti Tematik 1: Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike nën Dritaren 3 – Axhenda e Gjelbër dhe Ndërlidhja e Qëndrueshme. Objektivi i përgjithshëm është të promovojë axhendën e gjelbër duke përforcuar mbrojtjen mjedisore, duke kontribuuar në zbutjen dhe rritjen e rezistencës ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe të mbështetë mbrojtjen dhe kthimin e natyrës në gjendjen e mëparshme.

Reduktimi i gjurmës mjedisore dhe klimatike të sistemeve ushqimore do të forcojë kapacitetet e zinxhirëve të vlerës ushqimore për të përballuar sfidat në të ardhmen.

Ky Veprim është në përputhje me **Strategjinë e BE-së për Diversitetin për vitin 2030**[4]. Strategjia përmban zotime dhe veprime specifike që do të realizohen deri në vitin 2030, përfshirë krijimin e një rrjeti më të madh në mbarë BE-në të zonave të mbrojtura në tokë dhe në det, bazuar në zonat ekzistuese të Natura 2000, me mbrojtje rigoroze për zonat me vlerë shumë të lartë biodiversiteti dhe klimatike. Gjithashtu, një sërë zotimesh dhe veprimesh konkrete do të ndërmerren për të rikthyer ekosistemet e degraduara në të gjithë BE-në deri në vitin 2030 dhe për t'i menaxhuar ato në mënyrë të qëndrueshme, duke adresuar faktorët kryesorë të humbjes së biodiversitetit.

Ky program është në përputhje me **Axhendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor**[5]. Një nga pesë shtyllat e saj, thelbësore për Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane, është përfshira e masave për mbrojtjen e biodiversitetit në të gjitha aktivitetet ekonomike. Mbrojtja e biodiversitetit është shtylla e katërt e Axhendës së Gjelbër, me veprime të tilla si planet e mbrojtjes dhe restaurimit dhe zgjidhjet e bazuara në natyrë. Zbatimi i Direktivave për Shpendët dhe Habitatet, së bashku me zbatimin e Direktivave të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Vlerësimit Strategjik të Ndikimit në Mjedis, shihen si parakushte për zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës së qëndrueshme. Axhenda e Gjelbër thekson nën Shtyllën I gjetjen e zgjidhjeve të bazuara në natyrë me qëllim zbutjen dhe përshtatjen me ndryshimet klimatike.

Raporti i Komisionit Evropian 2020 për Shqipërinë e pranon që harmonizimi me *acquis* të BE-së në fushën e mbrojtjes së natyrës, veçanërisht të Direktivave për Shpendët dhe Habitatet, ka avancuar mirë, por ligjzbatimi mbetet përgjithësisht i dobët dhe kapacitetet institucionale janë ende të kufizuara, pavarësisht mjaft aktiviteteve për ndërtim kapacitetesh dhe asistencë teknike, përfshirë kapacitetet e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM). Legjislacioni për investimet strategjike ngre shqetësime për mbrojtjen e biodiversitetit, sepse mund të lejojë turizmin masiv dhe investimet industriale në zonat e mbrojtura, p.sh. aeroporti i propozuar në zonën Vjosë-Nartë. Kjo bie ndesh me ligjet e tjera të Shqipërisë dhe me konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e biodiversitetit të ratifikuara nga Shqipëria. Shqipëria duhet të respektojë detyrimet kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e natyrës dhe menaxhimin e ujit, të sigurojë pjesëmarrjen dhe konsultimin publik dhe të garantojë raporte VNM të cilësisë së lartë që përfshijnë edhe vlerësime të ndikimit në natyrë dhe në biodiversitet.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2021-2023 përcakton si prioritete kryesore për periudhën në vijim: identifikimin, studimin dhe plotësimin e formularëve standard të propozuar për secilën zonë potenciale Natura 2000 në Shqipëri. Paralelisht, Qeveria dhe autoritetet vendore duhet të forcojnë kapacitetet e të gjitha strukturave në fushën e mbrojtjes së natyrës në nivel qendror dhe vendor, me qëllim menaxhimin e integruar të zonave të mbrojtura. Nevojiten përpjekje për zbatimin e moratoriumit kundër gjuetisë dhe shfrytëzimit të pyjeve.

2.5. Mësimet e nxjerra dhe lidhjet me asistencën financiare të mëparshme

Duke marrë parasysh rëndësinë e Shqipërisë si vatër e nxehtë e biodiversitetit, BE dhe donatorë të tjerë kanë ofruar mbështetje të konsiderueshme për ndërtimin e kapaciteteve kombëtare për ruajtjen e natyrës në Shqipëri në vitet e fundit. Ky Veprim do të ndjekë rekomandimet dhe mësimet e nxjerra nga asistenca e mëparshme për të maksimizuar rezultatet e pritshme.

Programi i Partneritetit Mjedisor të BE-së për Aderimin (EPPA) 2019-2020 në Ballkanin Perëndimor dhe në Turqi është shtytja kryesore e reformave dhe zhvillimeve në qeverisjen mjedisore përmes përputhshmërisë me *acquis* mjedisor të BE-së. Programi konsolidon rezultatet e Rrjetit Rajonal Mjedisor të Aderimit (RENA) dhe programet e Rrjetit Rajonal të Mjedisit dhe Klimës të Aderimit (ECRAN) duke mbështetur bashkëpunimin rajonal dhe duke forcuar kapacitetet administrative të përfituesve. Bashkëpunimi rajonal shërben si kuadër për shkëmbimin e njohurive, ekspertizës dhe praktikave të mira, si edhe për trajtimin e problemeve të përbashkëta mjedisore në mënyrë më të qëndrueshme dhe efikase. Programi synon të forcojë zbatimin e *acquis* mjedisor të BE-së në Ballkanin Perëndimor dhe në Turqi në fusha që adresojnë problematikat mjedisore ndërkufitare. Qëllimi është që të asistohet Komisioni Evropian në mbështetjen e Sekretariatit të Programit të Partneritetit Mjedisor të BE-së për Aderimin (EPPA). Përfituesit kryesorë janë Ministritë e Mjedisit të Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Maqedonisë së Veriut, Kosovës*, Malit të Zi, Serbisë dhe Turqisë.

EPPA ka mbështetur ministritë e rajonit për zbatimin e strategjive të biodiversitetit. Studimi për vendosjen e infrastrukturës së gjelbër dhe statusin e ndërlidhjes ekologjike të Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi dhe

[4] COM(2020) 380 final
[5] SWD(2020) 223 final
* Ky emërtim nuk paragjykon qëndrimin e BE-së mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/99 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe me Opinionin e GjND-së për deklaratën e pavarësisë së Kosovës.

Serbisë ofron një bazë për propozime dhe rekomandime konkrete mbi mbrojtjen, zhvillimin dhe përmirësimin e ndërlidhjes ekologjike në të gjithë rajonin. Hartimi i propozimeve fillestare për krijimin e Zonave të reja të Mbrojtura Detare (ZMD) në Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë dhe Mal të Zi, do të kontribuojë në krijimin e një rrjeti ekologjik të ZMD-ve për të mbrojtur të paktën 10% të ujërave detare dhe bregdetare të Mesdheut. Këto studime përbëjnë bazën për aktivitetet e ardhshme të mbrojtjes së natyrës në Shqipëri.

Projekti **NaturAL** "Forcimi i kapaciteteve kombëtare në ruajtjen e natyrës – përgatitja për Rrjetin Natyra 2000" (IPA 2013) kishte si synim të ndalonte humbjen e biodiversitetit në Shqipëri duke përmirësuar Menaxhimin e Zonave të Mbrojtura. Projekti nisi dhe mbështeti hartimin e rrjetit Natyra 2000 duke përgatitur një listë paraprake të zonave Natura 2000 dhe investoi në 3 qendra vizitorësh, 8 godina të inspektorëve pyjorë, pajisje, instrumente, infrastrukturë, mjete transporti, njohuri, kapacitete dhe aftësi në 10 Zona të Mbrojtura, që mbulojnë 68% të territorit kombëtar të mbrojtur.

Ky Veprim do të konsolidojë përvojën e fituar me NaturAL. Veprimi do të përftojë njohuri mbi habitatet dhe speciet në disa zona të listës paraprake të zonave Natura 2000, do të plotësojë Formularët Standard të të Dhënave dhe do t'i hapë rrugë përcaktimit të zonave Natura 2000 në Shqipëri. Modeli i zhvilluar nga NaturAL për përcaktimin e një zone me status Natura 2000 ofron referencë tekniko-shkencore në ndihmë të dizenjuesve të ardhshëm të rrjetit Natura 2000.

Projekti i financuar nga BE-ja **"Ngritja e institucioneve për zbatimin e *acquis* për mjedisin dhe klimën (IBECA)"** forcoi kapacitetet e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në hartimin dhe zbatimin e një strategjie të shëndoshë sektoriale dhe në zbatimin dhe imponimin e legjislacionit për mjedisin dhe ndryshimet klimatike. Ky Veprim do të konsolidojë përvojën dhe kapacitetet e zhvilluara, si dhe do të mbështetë aktivitetet e përcaktuara në Planin e Zbatimit të Direktivave Specifike.

Qeveria e Suedisë financon programin **"Mbështetje e Negociatave të Shqipërisë në Kapitullin 27 – Mjedisi" (SANE27)** me qëllim forcimin e kapaciteteve dhe aftësive të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe institucioneve të tjera në përgatitjet e tyre për negociatat me BE-në për Kapitullin 27. Programi filloi në prill 2018 dhe u zbatua në partneritet mes MTE-së dhe Agjencisë Suedeze për Mbrojtjen Mjedisore. Programi përfshin përgatitjet për *screening* dhe planifikimin strategjik për negociatat nën Kapitullin 27. Gjithashtu, përgatiti Dokumentin e Vlerësimit të Nevojave për Kapitullin 27, ku evidentoi nevojat kryesore për të mbushur boshllëqet përkundër 73 direktivave dhe legjislacionit të BE-së. SANE27 mbështet edhe përfshirjen e OSHC-ve në përgatitjet për procesin e negociatave, si edhe forcimin e kapaciteteve të palëve të interesuara në këto përgatitje, procesin *screening* dhe kërkesat / kriteret për direktivat dhe rregulloret e BE-së. Ky Veprim do të adresojë një sërë boshllëqesh në zbatimin e Direktivave të BE-së për Shpendët dhe Habitatet, të cilat SANE27 i ka identifikuar në Dokumentin e Vlerësimit të Nevojave.

3. PËRSHKRIMI I VEPRIMIT

3.1. Rezultatet e planifikuara dhe logjika e ndërhyrjes

Veprimi do të përmirësojë menaxhimin e zonave të mbrojtura ekzistuese dhe ato që mund të marrin këtë status gjatë Veprimit. Ndikimi kryesor do të jetë mbrojtja dhe ruajtja përmes një sistemi të mirëlidhur dhe efektiv për zonat e mbrojtura dhe masave ruajtëse në zona të tjera në të paktën 25% të territorit shqiptar (në tokë dhe det) deri në vitin 2030, me fokus në zonat me rëndësi të veçantë për biodiversitetin. Veprimi do të mbështetë Shqipërinë të plotësojë kërkesat e *acquis* të BE-së në mbrojtjen e natyrës dhe të rritë kapacitetet për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Ndërhyrja konsiston në tetë produkte që do të kontribuojnë në arritjen e **rezultatit** "përmirësimi i efektivitetit të menaxhimit të zonave të mbrojtura". Ky Veprim do të forcojë kapacitetet e institucioneve përkatëse, do të rishikojë dhe do të hartojë plane menaxhimi të reja për zonat e mbrojtura si dhe për përdorimin e pyjeve dhe të produkteve pyjore jodrusore, do të mbështetë ngritjen e sistemeve të monitorimit të performancës, do të mbështetë zbatimin e masave ruajtëse, do të mbështetë OSHC-të në zbatimin e zgjidhjeve bazuar në natyrë dhe masave kundër krimit mjedisor, si dhe në sensibilizimin për Natura 2000 dhe ruajtjen e biodiversitetit.

AKZM dhe MTE të ngarkuara me këtë Veprim, kanë tashmë përvojë nga projekti i mëparshëm NaturAL. Legjislacioni në mbështetje të këtij Veprimi është i miratuar dhe ka pasur një vendim së fundmi për të ngritur një Fond të Posaçëm për Zonat e Mbrojtura (FPZM) dhe për të investuar aty të ardhurat që gjeneron AKZM. Termat e referencës dhe udhëzimet e aplikimit po përgatiten me ndihmën e ekspertëve të SANE27.

Produkti 1: Forcohen kapacitetet e institucioneve përgjegjëse (AKZM/ARZM) për të menaxhuar me efektivitet zonat e mbrojtura sipas *acquis* dhe praktikave më të mira të BE-së

Struktura dhe kapacitetet institucionale të institucioneve përgjegjëse (AKZM/ARZM), bashkë me inspektimin dhe ligjzbatimin, janë të rëndësishme për ruajtjen e habitateve dhe specieve. Përafrimi i plotë i legjislacionit me *acquis* të BE-së është baza për këtë Veprim. Prandaj, Veprimi do të mbështetë Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTE) në zhvillimin e mëtejshëm të legjislacionit të brendshëm në përputhje me *acquis* të BE-së për natyrën dhe në përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësive të autoriteteve qendrore përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit të natyrës dhe të Direktivave për Shpendët dhe Habitatet. Hapi i radhës është identifikimi i aftësive dhe kapaciteteve të kërkuara në nivele të ndryshme nëpërmjet një vlerësimi të nevojave teknike dhe trajnimi për zbatimin e Direktivave për Shpendët dhe Habitatet (përfshirë inspektimin dhe ligjzbatimin). Kjo do të pasohet me përgatitjen dhe zbatimin e një programi trajnimi gjithëpërfshirës të përshtatur (afatshkurtër dhe afatgjatë). Veprimi do të zhvillojë specifikime që të përcaktojnë të gjitha kushtet/kriteret për menaxhimin efektiv të zonave të mbrojtura. Për më tepër, Veprimi do të mbështesë zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive për të luftuar krimin mjedisor, si dhe bashkëpunimin me sistemin gjyqësor (prokurorë dhe gjyqtarë) përmes organizimit të aktiviteteve të përbashkëta. Gjithashtu, do të ofrohen pajisjet e nevojshme teknike dhe ato të terrenit.

Produkti 2: Plane menaxhimi të zonave të mbrojtura të rishikuara dhe të reja përmes vlerësimit të vlerave dhe kërcënimeve ndaj biodiversitetit duke ndjekur kërkesat e Natura 2000

Ngritja e rrjetit Natura 2000 në Shqipëri ka filluar. Ky proces nxori në pah boshllëqe të konsiderueshme të njohurive në lidhje me shpërndarjen e habitateve dhe specieve në vend. Ngritja e suksesshme e rrjetit Natura 2000 kërkon plane menaxhimi të përditësuara dhe të reja për zonat e mbrojtura, duke adresuar sfidat në ruajtjen dhe menaxhimin e natyrës, përfshirë ndryshimet klimatike. Veprimi do të lehtësojë përcaktimin e zonave të mbrojtura, duke përgatitur kategori të dhënash të plota që kërkohen nga Direktivat për Shpendët dhe Habitate për të paktën dhjetë zona me interes të posaçëm komunitar, të cilat do të propozohen si zona Natura 2000, si dhe të paktën dhjetë (10) zona të tjera, për të mbështetur përgatitjen e Planeve të Menaxhimit të reja sipas kërkesave të Direktivave për Shpendët dhe Habitatet, duke siguruar kështu për to mbrojtje dhe menaxhim të qëndrueshëm në të ardhmen. Gjithashtu, Veprimi do të forcojë kapacitetet e institucioneve përgjegjëse (MTE, AKZM), universiteteve dhe OSHC-ve vendore - që punojnë në botanikë, zoologji dhe ruajtjen e natyrës - lidhur me parimet e zbatimit dhe menaxhimit të rrjetit Natura 2000. Me sigurimin e angazhimit të plotë të autoriteteve kombëtare, veçanërisht të MTE-së dhe AKZM-së, për të bashkëpunuar në përzgjedhjen e të paktën 20 zonave, Veprimi do të mbështesë përgatitjen e planeve të menaxhimit dhe vlerësimin e vlerave dhe kërcënimeve ndaj biodiversitetit. Vlerësimi do të identifikojë masat prioritare të ruajtjes dhe restaurimit duke marrë parasysh ndërlidhjen e ekosistemit, të nevojshme për të parandaluar degradimin e mëtejshëm të biodiversitetit, habitateve dhe ekosistemeve. Kjo do të bëhet sipas kërkesave të Direktivave për Shpendët dhe Habitatet, për të siguruar mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tyre në të ardhmen. Përzgjedhja e planeve të menaxhimit për rishikim do të bazohet në vlerësimin e vlefshmërisë së çdo plani menaxhimi, rrezikimit të ekosistemeve, specieve dhe habitatit, si dhe intensitetit të aktiviteteve njerëzore në zonat e mbrojtura. MTE dhe AKZM duhet të garantojnë që zonat e përzgjedhura të kenë shumëllojshmëri ekosistemesh dhe habitatesh, duke përfshirë zonat detare dhe bregdetare. Gjithashtu do të përfshihen zona të reja që do të marrin statusin e zonave të mbrojtura. Përzgjedhja e zonave të mbrojtura dhe zhvillimi i zonave të reja do të shoqërohet me një propozim për një sërë masash ruajtjeje për të garantuar ruajtjen e specieve dhe habitateve, përfshirë masat zbutëse dhe përshtatëse ndaj ndryshimeve klimatike. Procesi i vlerësimit dhe rishikimit do të përfshijë një përqasje pjesëmarrëse. Veprimi do të përmirësojë edhe mbledhjen e të dhënave dhe evidencave në lidhje me rishikimin dhe zbatimin e veprimeve/masave të përcaktuara në planet e menaxhimit. Mbledhja e të dhënave do të bazohet në mjete analitike (si p.sh. Instrumenti i Avancuar i Gjurmimit të Efektivitetit të Menaxhimit [METT]) dhe kërkime shkencore në vend. Planet e Menaxhimit do të shfrytëzojnë të dhënat e mbledhura dhe Veprimi do të propozojë masa që të përmirësohet monitorimi dhe zbatimi i planeve të menaxhimit.

Produkti 3: Ngrihet sistemi i monitorimit të performancës

Veprimi do të mbështesë MTE-në dhe AKZM-në në zhvillimin e Sistemit të Monitorimit të Performancës me një Plan Monitorimi dhe Vlerësimi. Kuadri i monitorimit do të bazohet në protokollet dhe mjetet për ruajtjen e statusit të ruajtjes së specieve dhe habitateve. Plani i Monitorimit dhe Vlerësimit do të organizojë sistematikisht mbledhjen e të dhënave specifike për ekosistemet, habitatet dhe speciet. Të dhënat duhet të vlerësohen dhe ruhen në një sistem informacioni referimi gjeografik, i cili do të përbëjë një repozitor të organizuar të të dhënave për menaxhimin e informacionit numerik kyç që mundëson ngritjen e monitorimit dhe raportimit efektiv mbi zbatimin e Direktivave për Shpendët dhe Habitatet. Kapacitetet e AKZM-së për zbatimin e planeve të menaxhimit dhe vlerësimin e zbatimit të tyre do të forcohen. Kjo do të kontribuojë në mbikëqyrje dhe ligjzbatim më të mirë, duke rritur efikasitetin e tyre dhe duke përmirësuar raportimin mbi rezultatet e patrullimeve dhe aktakuzave. Për të përmirësuar ndjekjen penale të krimeve mjedisore, Veprimi do të mbështesë bashkëpunimin me agjencitë ligjzbatuese dhe institucionet e gjyqësorit (policia e shtetit, prokuroria, gjyqtarët). Veprimi do të përgatitë tregues dhe procedura monitorimi që mënyrë që AKZM-ja të raportojë rezultatet në lidhje me ligjzbatimin dhe luftën kundër krimit mjedisor. Kapacitetet e institucioneve përkatëse për ofrimin e provave për zgjidhjen më të lehtë dhe më të shpejtë të çështjeve gjyqësore që kanë të bëjnë me legjislacionin për mbrojtjen e natyrës do të forcohen. Sistemi i monitorimit të performancës do të mbështesë edhe partnerët e qeverisë në të gjitha

nivelet për të marrë pjesë dhe për të përfituar nga Veprimi. Do të sigurohen pajisjet e nevojshme për monitorimin, mbikëqyrjen dhe aktivitetet e ligjzbatimit. Kjo mundëson mbledhjen e provave të mjaftueshme për ndjekjen penale.

Produkti 4: Zbatohen masat ruajtëse dhe restauruese të parashikuara në planet e menaxhimit
Veprimi do të zbatojë masa ruajtëse dhe restauruese në ekosistemet e degraduara natyrore dhe gjysmënatyrore. Do të mbështetë arritjen e Objektivit Aichi për Diversitetin 14 dhe 15 për restaurimin dhe ruajtjen e ekosistemeve që ofrojnë shërbime thelbësore dhe për restaurimin e të paktën 15% të ekosistemeve të degraduara. Veprimi kontribuon edhe në arritjen e zotimeve në kuadër të konventave të tjera[6]. Planet e Menaxhimit të cilat janë ende të vlefshme dhe sipas standardeve, përmbajnë disa masa ruajtëse dhe aktivitete rehabilituese që nuk janë zbatuar për shkak të mungesës së financimit dhe mungesës së një fondi të dedikuar/autonomisë financiare të Zonave të Mbrojtura. Masat e nevojshme të ruajtjes dhe restaurimit (përfshirë zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe masat e përshtatjes) do të vlerësohen dhe do të hartohen sipas Produktit 2. Nën Produktin 4, do të forcohet statusi i ruajtjes së elementë të rëndësishëm të biodiversitetit (habitate dhe/ose specie). Veprimi do të përmirësojë menaxhimin e pyjeve dhe ripyllëzimit/pyllëzimit, për të përmirësuar kapacitetet përshtatëse (p.sh. pyllëzim në basenin e lumit për të pasur regjim hidrologjik më të qëndrueshëm dhe për të reduktuar përmbytjet). Punimet do të kontribuojnë në kthimin e biodiversitetit të humbur, rikuperimin e ndërlidhjes, përmirësimin e qëndrueshmërisë së ekosistemit, përmirësimin e ofrimit të shërbimeve të ekosistemit, zbutjen dhe përshtatjen ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike, luftimin e shkretimit dhe degradimit të tokës, si dhe përmirësimin e mirëqenies së njerëzve duke pakësuar rreziqet dhe problemet mjedisore. Veprimi do të mbështesë një sërë masash ruajtëse në zona të përzgjedhura, nëpërmjet punimeve në shkallë të vogël. Restaurimi i ekosistemeve do të bëhet në të gjitha llojet e habitateve, biomave dhe ekosistemeve, përfshirë pyjet, kullotat, tokat bujqësore, ligatinat dhe ekosistemet e tjera tokësore dhe të brendshme ujore, ekosistemet detare dhe bregdetare, për një sërë qëllimesh dhe me aktorë të ndryshëm. Aktivitetet e ruajtjes mund të shtrihen edhe përgjatë korridoreve të përshtatshme, për të mundësuar lidhjen mes zonave të mbrojtura. Kjo do të sigurojë qëndrueshmërinë e popullsisë dhe investime në infrastrukturën e gjelbër që ulin ndikimin njerëzor në biodiversitetin e zonave të mbrojtura ku ka vendbanime. Aktivitetet e restaurimit të ekosistemit do të planifikohen dhe do të zbatohen duke përdorur njohuritë shkencore dhe tradicionale më të mira, duke shfrytëzuar potencialin e përqasjes së zgjidhjeve bazuar në natyrë. Autoritetet kombëtare duhet të garantojnë gjithëpërfshirje duke përfshirë komunitetet vendore, akademikët, organizatat mjedisore të shoqërisë civile dhe palë të tjera të interesuara. Komunikimi, edukimi dhe ndërgjegjësimi i publikut do të shërbejnë për të rritur të kuptuarit e përfitimeve dhe kostove të aktiviteteve të restaurimit të ekosistemit.

Përqasja pjesëmarrëse do të rritë angazhimin e banorëve dhe mbështetjen për zonat e mbrojtura dhe përpjekjet për ruajtjen e biodiversitetit. Monitorimi duhet të fillojë në fazë të hershme, në mënyrë që kushtet e ekosistemit dhe efektet socio-ekonomike të maten përkundër një modeli referimi. Monitorimi efektiv përfshin planifikim të gjerë përpara se të fillohen aktivitetet e ruajtjes, përfshirë përcaktimin e viteve/vlerave bazë, treguesve biologjikë dhe objektivave të matshëm të restaurimit.

Produkti 5: Hartohen plane të reja të menaxhimit për përdorimin e pyjeve dhe produkteve pyjore jodrusore
Pyjet, ligatinat dhe kullotat zënë një sipërfaqe prej 340 438.00 ha ose 66% të rrjetit të zonave të mbrojtura. 21% e sipërfaqes me pyje dhe kullota gjendet brenda këtij rrjeti. Veprimi do të mbështetë përgatitjen e një procesi të ri për Planifikimin e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave, bazuar në informacionin e marrë nga inventari i pyjeve dhe kullotave. Planet shumëfunksionale të menaxhimit të pyjeve do të garantojë qëndrueshmërinë e pyjeve, duke marrë parasysh funksionet dhe shërbimet që ofrohen nga pyjet, zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe potencialin përshtatës, si de nevojat dhe kërkesat e të gjithë palëve të interesit. Pyjet e mirëmenaxhuara mund të shërbejnë si zona amortizimi përreth zonave të mbrojtura. Ato janë pjesë të korridoreve ekologjike dhe të ruajtjes midis zonave të mbrojtura dhe ndihmojnë në ruajtjen e biodiversitetit. Autoritetet kombëtare do të zgjedhin zonat për të cilat do të zhvillohen planet e menaxhimit të pyjeve (minimumi 10,000 ha në total) në bashkëpunim me autoritetet vendore, ku do të merret parasysh rëndësia e zonave për speciet dhe komunitetet vendore. Planet e reja të menaxhimit të pyjeve duhet të jenë shumëqëllimëshe, pra, të mbulojnë aspektet sociale, ekonomike, ndryshimet klimatike dhe ekologjike. Ato duhet të bazohen edhe në zonimin funksional optimal të njësisë së menaxhimit të pyjeve, duke ruajtur përfitimet socio-ekonomike pa rrezikuar biodiversitetin dhe funksionet ekologjike të ekosistemeve natyrore. Planet e menaxhimit do të sigurojnë një inventar të pyjeve dhe kullotave, si dhe integrimin dhe standardizimin e informacionit për pyjet dhe kullotat në zonat e mbrojtura brenda sistemit kombëtar të informacionit pyjor (AlFIS). AlFIS synon të krijojë një përqasje të standardizuar që mundëson rezultate të harmonizuara dhe të krahasueshme në nivel kombëtar. Kjo do të kërkojë bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë Kombëtare të Pyjeve (AKP) të sapongritur dhe bashkitë përkatëse.

Produkti 6: Shoqëria civile mbështetet në mbrojtjen mjedisore dhe restaurimin e zonave të mbrojtura

[6] përfshirë Konvetën Kudër të OKB-së për Ndryshimet Klimatike, Konventën e OKB-së për Luftën ndaj Shkretimit, Konventën e Ramsarit për Ligatinat, Konvetën për Ruajtjen e Specieve Shtegtare të Botës së Egër, Forumin e OKB-së për Pyjet, si dhe Axhendën 2030 oër Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe Kuadrin Sendai për Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2015-2020.

Ky produkt synon përfshirjen e OShC-ve në mbrojtjen mjedisore dhe restaurimin e zonave të mbrojtura. Ndër çështjet e rëndësishme do të jetë identifikimi dhe zbatimi i mekanizmit për ruajtjen e natyrës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura. Veprimi do të zhvillojë dhe mbështesë zbatimin e modelit të zgjidhjeve bazuar në natyrë dhe infrastrukturën e gjelbër brenda zonave të mbrojtura, si dhe ngritjen e kapaciteteve lidhur me përdorimin e qëndrueshëm dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Shoqëria civile ka qenë palë e rëndësishme në luftën kundër krimit mjedisor, i cili është rritur gjatë dy viteve të fundit në Shqipëri, veçanërisht në zona të mbrojtura. Ky Veprim do të mbështesë shoqërinë civile në identifikimin e masave të zbatueshme, në bashkëpunim me institucionet shtetërore përgjegjëse për ligjzbatimin. Veprimi do të mbështesë rolin e OSHC-ve në kuadrin e masave zbatuese kundër krimit mjedisor në zona të mbrojtura, do të forcojë bashkëpunimin e tyre me administratat dhe institucionet shtetërore përgjegjëse për zonat e mbrojtura, si dhe do të krijojë kapacitete për të luftuar më mirë krimin mjedisor jo vetëm brenda, por edhe jashtë zonave të mbrojtura. Shoqëria civile ka nevojë për mbështetje jo vetëm në luftën kundër krimit të organizuar, por edhe në korrigjimin e dëmeve që shkakton krimi mjedisor dhe ndërhyrja e njeriut në zonat e mbrojtura.

Produkti 7: Zbatohen zgjidhjeve bazuar në natyrë (me fokus mbrojtjen/ruajtjen e natyrës dhe luftën kundër krimit mjedisor)
Zgjidhjet bazuar në natyrë synojnë të mbështesin arritjen e qëllimeve zhvillimore dhe mirëqenies së shoqërisë, në mënyra që pasqyrojnë vlerat kulturore dhe shoqërore dhe rrisin qëndrueshmërinë e ekosistemeve, kapacitetin e tyre ripërtëritës dhe ofrimin e shërbimeve. Prandaj, Veprimi i propozuar do të zhvillojë dhe mbështesë zbatimin e modelit të zgjidhjeve bazuar në natyrë brenda zonave të mbrojtura, përmes identifikimit, përgatitjes dhe zbatimit të aktiviteteve të zgjidhjeve bazuar në natyrë, si dhe ngritjes së kapaciteteve për çështje që kanë të bëjnë me zgjidhjet bazuar në natyrë. Bashkëpunimi me OSHC-të dhe palët vendore është thelbësor për ta bërë zbatimin të qëndrueshëm në kohë dhe efikas në procesin e përshtatjes.

Me supozimin se do të ketë interesim të gjerë, pjesëmarrje, përfshirje dhe angazhim të palëve kryesore, organeve profesionale, sektorit privat, akademikëve, bashkive dhe organizatave të shoqërisë civile, zbatimi zgjidhjeve bazuar në natyrë do të adresojë disa sfida të mëdha shoqërore, si siguria ushqimore, ndryshimet klimatike, siguria e ujit, shëndeti njerëzor, rreziku nga fatkeqësitë, zhvillimi social dhe ekonomik, aktivitetet ekonomike të lidhura me turizmin, si një parakusht i rëndësishëm për menaxhimin efektiv të zonave të mbrojtura.

Krimi mjedisor duhet të jetë pjesë e punës së institucioneve shtetërore në identifikim dhe ligjzbatim. Veprimi do të rrisë sinergjitë dhe bashkëpunimet ndërmjet AKZM-së dhe institucioneve të tjera (si p.sh. inspektoratet dhe sistemi i drejtësisë) dhe do të kontribuojë në vendosjen e mekanizmave që do të reduktojnë incidencën e krimeve mjedisore. Ky Veprim do të lidhet me masat në Produktin 6, që ndërthur luftën kundër krimit mjedisor me punën e OSHC-ve.

Produkti 8: Rritet komunikimi, ndërgjegjësimi dhe angazhimi i komuniteteve dhe sektorit privat në ruajtjen e natyrës dhe Natura 2000
Ndërgjegjësimi për rëndësinë e Mbrojtjes së Natyrës dhe Biodiversitetit në Shqipëri është thelbësor për zbatimin e modelit të aktiviteteve turistike bazuar në natyrë brenda zonave të mbrojtura. Veprimi do të mbështesë autoritetet përgjegjëse me komunikim efektiv lidhur me vlerat e veçanta të zonave të mbrojtura për vizitorët. Veprimi do të rritë ndërgjegjësimin edhe për përfitimet që ka zbatimi i objektivave të BE-së për mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës dhe zonat NATURA 2000.

3.2. Aktivitetet indikative

Veprimi do të mbështetë arritjen e **Produktit 1, Produktit 2, Produktit 3, Produktit 5 dhe Produktit 7** me **asistencë teknike** që do të mbulojë:

- Forcimin e kapaciteteve administrative të institucioneve përgjegjëse (Ministria e Turizmit dhe Mjedisit [MTE], Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura [AKZM] / Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura [ARZM]) për menaxhimin efektiv të zonave të mbrojtura, përmes vlerësimit të nevojave të tyre për trajnim, hartimit të një Programi Trajnimi dhe dhënies së trajnimeve, hartimit të manualeve të procedurave, etj.;
- Identifikimin e nevojave teknike për furnizime/pajisje që nevojiten për menaxhimin dhe monitorimin e zonave të mbrojtura si dhe për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave;
- Hartimin e legjislacionit të nevojshëm që garanton transpozim të plotë me *acquis* të BE-së për natyrën;
- Adresimin e boshllëkut të njohurive lidhur me shpërndarjen e habitateve dhe specieve, duke përmirësuar vendimmarrjen për ruajtjen bazuar në shkencë;
- Mbështetjen për rishikimin dhe hartimin e planeve të reja të menaxhimit për zonat e mbrojtura, sipas kërkesave të Natura 2000, si dhe hartimin e planeve të reja të menaxhimit për pyjet dhe kullotat me qëllim që të arrihet shfrytëzim i qëndrueshëm i pyjeve dhe produkteve pyjore jodrusore dhe të përmirësohet menaxhimi i burimeve natyrore të rëndësishme në bashkëpunim të ngushtë me komunitetet vendore, duke pasur parasysh masat për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe përshtatjen ndaj tyre;

- Ngritjen e një sistemi monitorimi të performancës, mbështetjen e aktiviteteve monitoruese dhe mbledhjen e të dhënave specifike për habitatet dhe speciet, si dhe monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të planeve të menaxhimit;
- Identifikimin e masave të nevojshme ruajtëse e restauruese dhe të zonave të degraduara (ekosisteme dhe habitate) që kanë nevojë për rehabilitim, si dhe krijimin e modeleve për zbatimin e tyre, përfshirë masat për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe përshtatjen ndaj tyre.

Produkti 1 dhe **Produkti 3** kanë të bëjnë pjesërisht me forcimin e kapaciteteve administrative dhe lidhen me ofrimin e pajisjeve, mjeteve monitoruese dhe pajisjeve mbikëqyrëse që shërbejnë për menaxhimin dhe monitorimin e zonave të mbrojtura, mbledhjen dhe raportimin e të dhënave, përmirësimin e mbikëqyrjes dhe ligjzbatimit, si edhe ngritjen e Sistemit të Monitorimit të Performancës.
Aktivitetet që lidhen me **Produktin 4, Produktin 7** dhe **Produktin 8** janë:

- Investime (punime) lidhur me masat ruajtëse dhe restaurimin e habitateve/ekosistemeve të degraduara (Produkti 4);
- Asistencë Teknike për mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve;
- Zbatimi i fushatës së ndërgjegjësimit për ruajtjen e natyrës dhe Natura 2000 (Produkti 7).

Nën **Produktin 6** që mbështet shoqërinë civile në mbrojtjen mjedisore dhe restaurimin e zonave të mbrojtura, Veprimi parashikon një skemë grant që fokusohet te mbrojtja / ruajtja dhe restaurimi i natyrës nga njëra anë, si dhe te masat kundër krimit mjedisor nga ana tjetër, me qëllim që të mbështetë palët joqeveritare në përpjekjet për ruajtjen dhe rehabilitimin e zonave të mbrojtura në Shqipëri.

3.3. Risqet dhe supozimet

Risqet	Niveli i Riskut (L/M/U)	Masat zbutëse
Mungesa e bashkëpunimit dhe shkëmbimit ndërinstitucional të të dhënave.	L	Teknologjitë e informacionit që zbatohen apo përdoret gjatë projektit janë të përshtatshme për kontekstin vendor dhe nuk pengojnë transferimin apo komunikimin e informacionit. Gjatë projektit do të krijohet një platformë dixhitale për shkëmbimin e të dhënave dhe informacionit, si pjesë e sistemit të dedikuar të menaxhimit të informacionit (SIM).
Vonesa në transpozimin e Direktivave përkatëse të BE-së në legjislacionin e brendshëm	M	Angazhim me institucionet që në fillim, përfshirë hartimin dhe mbështetjen e planeve të transpozimit që janë realiste, me monitorim të vazhdueshëm të progresit.
Largime të shumta të personelit të agjencive zbatuese dhe mungesa e njohurive dhe përvojës në mbrojtjen e natyrës	L	Institucionet pjesëmarrëse në Veprim do të identifikojnë që në fillim personat që mund të zëvendësojnë personelin kyç në rast largimi, që të garantohet vijimësia institucionale e pjesëmarrjes në Veprim. Udhëzime teknike do të hartohen në anglisht dhe shqip për të orientuar personelin e ri që përfshihet në Veprim.
Mungesa e kapaciteteve dhe mekanizmave për planifikim të duhur dhe mobilizim fondesh për të përshkallëzuar masat ruajtëse në plan afatgjatë	L	Do të hartohet një strategji për përshkallëzimin, mbështetjen dhe zbatimin e masave ruajtëse. Institucioneve publike do t'u jepet asistencë në të gjitha nivelet për t'i mbështetur me planifikimin buxhetor afatmesëm. Qeveria e Shqipërisë miratoi në janar 2021 rregullat për administrimin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifat që paguhen në Zonat e Mbrojtura, si dhe ngritjen e një Fondi të Posaçëm për Zonat e Mbrojtura (FPZM). AKZM do të përdorë dhe do të ri-investojë këto të ardhura në zonat e mbrojtura.
Konflikt interesash me palë të tjera interesi (ruajtje apo shfrytëzim / zhvillim, ose bota e egër apo njerëzit) që përdorin të njëjtat burime natyrore të përbashkëta.	L	Këto situata sfiduese do të zbuten me takime /dialog shumëpalësh ku marrin pjesë të gjithë personat, me trajnime mbi ndërmjetësimin dhe negocimin, si dhe me gjetjen dhe mbështetjen e zgjidhjeve alternative.
Kapacitetet e kufizuara teknike kombëtare pengojnë ndërhyrjet e projektit.	L	Identifikimi dhe zhvillimi i kapaciteteve sipas nevojës. Veprimi do të nisë bashkëpunimin dhe do të nxitë shkëmbimet mes institucioneve kombëtare dhe instituteve kërkimore ndërkombëtare. Fondi i Posaçëm për zonat e

		mbrojtura do t'i mundësojë AKZM-së punësimin e personelit shtesë dhe kontraktimin e ekspertizës së nevojshme.
Përkushtimi/angazhimi i kufizuar i komuniteteve vendore.	M	Një plan angazhimi i palëve (të interesuara) do të hartohet për të garantuar përkushtimin dhe angazhimin në projekt. Veprimi do t'u drejtohet komuniteteve vendore gjatë zbatimit me masa të shënjestruara informimi.
Supozimet (pasqyrohen në Matricën e Kuadrit Logjik më lart) – të grupuara sipas produkteve dhe rezultateve		
Rezultati 1 • Qeveria e Shqipërisë e konsideron ruajtjen e natyrës si prioritet, në linjë me procesin e anëtarësimit në BE; • Institucionet kombëtare garantojnë vendimmarrje në kohë në hartimin e legjislacionit dhe politikës(ave) përkatëse. Gjithashtu, vendimet e projektit merren në kohë për të mundësuar zbatim normal. • Autoritetet do të garantojnë përfshirjen e komuniteteve vendore, akademikëve dhe OSHC-ve mjedisore gjatë të gjithë zbatimit të Veprimit. Produkti 1: • Qeveria përkushtohet plotësisht në zbatimin e rekomandimeve mbi përmirësimin e kapaciteteve institucionale dhe jep alokime buxhetore adekuate. Produkti 2 dhe Produkti 5: • Institucionet shtetërore qendrore dhe projektet në vazhdim janë të gatshëm të bashkëpunojnë dhe të vënë në dispozicion të gjithë informacionin teknik, administrativ dhe institucional lidhur me ruajtjen e natyrës. Produkti 3: • Partnerët kryesorë shtetërorë angazhojnë kohë dhe personel të mjaftueshëm në të gjitha nivelet, që të marrin pjesë dhe të përfitojnë nga projekti. Produkti 4, Produkti 6, Produkti 7 dhe Produkti 8: • Ekziston interesim i gjerë, pjesëmarrje, përfshirje dhe përkushtim nga palët kryesore të interesit, organet profesionale, akademikët, bashkitë dhe organizatat e shoqërisë civile. • Qeveria e Shqipërisë është e përkushtuar në luftën kundër krimit mjedisor brenda dhe jashtë zonave të mbrojtura. • AKZM/ARZM janë plotësisht të përkushtuara dhe marrin pjesë në zbatimin e fushatës së komunikimit dhe ndërgjegjësimit.		

3.4. Harmonizimi me sektorë të tjerë

Integrimi gjinor dhe mundësitë e barabarta: Ky Veprim do të përgatitë një vlerësim nevojash gjinore bazë si dhe do të propozojë metodologjinë dhe rekomandime konkrete për masat gjinore. Gjatë zbatimit të këtij Veprimi, analiza gjinore synon të garantojë integrimin e dimensionit gjinor në të gjitha aktivitetet, si p.sh. në plane, fushata promocioni, hartimin e politikave, vlerësimeve dhe monitorimeve. Integrimi gjinor në aktivitetet e projektit konsiderohet si mjet për përmbushjen e objektivave të Natura 2000. Perspektiva gjinore do të lehtësojë aksesin e barabartë në burime dhe në mundësi. Do të promovojë pjesëmarrjen e grave në proceset e planifikimit dhe në aktivitetet e ndërgjegjësimit. Përqasja gjinore do të nxitë edhe mundësitë e barabarta në aktivitetet ekonomike, përfshirë bujqësinë, turizmin, pylltarinë dhe projektet infrastrukturore. Gjatë zbatimit, pjesëmarrja e barabartë të burrave dhe grave në aktivitetet e projektit do të analizohet dhe mbështetet. Vendimet e palëve të interesuara do të merren me përfaqësim të balancuar gjinor.

Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike: Veprimi do të ketë ndikim mjedisor shumë pozitiv. Ai synon të rritë kapacitetet e palëve kombëtare në planifikimin dhe zbatimin e masave ruajtëse për restaurimin e habitateve të degraduara dhe biodiversitetit me vlera. Do të përmirësojë gjendjen mjedisore në planin afatshkurtër deri afatgjatë. Duke nxitur dhe mbështetur përpjekjet për ruajtjen e natyrës, projekti do të adresojë indirekt qëndrueshmërinë mjedisore dhe do të përmirësojë rezistencën e përgjithshme të Shqipërisë ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike. Meqë Veprimi do të angazhojë konsulencë ndërkombëtare, do të ketë edhe udhëtime ndërkombëtare, prandaj do të mbahen parasysh aktivitete si kompensimi i karbonit dhe ndërhyrje të tjera (që mbështesin mbjelljen e pemëve).

Përqasja bazuar në Të Drejta: Ndryshimet në mjedis dhe burimet natyrore kanë ndikim të madh te personat që jetojnë në varfëri, sepse kanë rezistencë të ulët ndaj ndryshimeve të tilla. Përqasja bazuar në Të Drejtat e Njeriut ofron bazën ligjore dhe parimet që udhëheqin aktivitetet/punën me personat që jetojnë në varfëri. Veprimi do të integrojë perspektivën e të drejtave në procesin e planifikimit, bazuar në legjislacionin ekzistues të BE-së dhe Shqipëri, ndërkohë që mban parasysh standardet progresive. Parashikohet pjesëmarrje dhe konsultim mosdikriminues me kohë dhe buxhet të përcaktuar. Theksi vihet te identifikimi dhe përfshirja e grupeve vulnerabël. Partneriteti gjithëpërfshirës me organizatat vendore mbështetet për të fuqizuar edhe grupet më vulnerabël dhe më të marxhinalizuara, me qëllim që të rritet zëri / pronësia e tyre demokratik mbi politikat dhe nismat që prekin jetën e tyre.

Angazhimi me Shoqërinë Civile: Pjesëmarrja e qenësishme e titullarëve të të drejtave është thelbësore për ruajtjen e qëndrueshme të biodiversitetit. Komunitetet vendore, OSHC-të dhe palët e tjera të interesit duhet të kuptojnë dhe të ushtrojnë të drejtat e tyre të tubimit, organizimit dhe shprehjes, si edhe të marrin pjesë në proceset vendimmarrëse – që nga ngritja e këshillave dhe organeve zyrtare në zonat e mbrojtura, deri te masat e udhëhequra nga komuniteti dhe të lidhura me një burim apo sektor specifik. Rezistenca komunitare do të përmirësohet përmes krijimit të platformave për pjesëmarrje në menaxhimin e zonave të mbrojtura, si një mekanizëm afatgjatë që garanton vendimmarrje pjesëmarrëse dhe *pronësi* të përbashkët. Kjo do të nxitet edhe me aktivitete edukative; me fuqizim të të rinjve që të angazhohen në sfidat e ruajtjes, ndërkohë që krijojnë për të ardhmen udhëheqës me ndjeshmëri mjedisore.

Zgjidhja e konflikteve: Interesat konkurruese ndërmjet grupeve të njerëzve varen nga konteksti dhe këndvështrimet e kundërt, që mund të rezultojnë në shpërthim të dhunës. Interesat e kundërta mes palëve të ndryshme të interesit mund të jenë: konfrontimet e komuniteteve vendore dhe grupeve ruajtëse kundër ndërtuesve/zhvilluesve të hidrocentraleve brenda zonave të mbrojtura po zonave të përcaktuara se kanë potencial Natura 2000; ose konfliktet mes botës së egër dhe njerëzve që ndajnë të njëjtat zona dhe konkurrojnë për të njëjtat burime natyrore për mbijetesë. Konfliktet e mundshme do të zbuten përmes dialogut shumëpalësh, trajnimeve mbi ndërmjetësimin dhe negocimin, i dhe mbështetjes së zgjidhjeve alternative. Veprimi ndjek një përqasje që parandalon konfliktet e mundshme para se të përshkallëzohen në tensione dhe dhunë.

3.5. Kushtet për zbatimin

Në janar 2021, Qeveria e Shqipërisë miratoi rregullat për administrimin e të ardhurave prej tarifave që paguhen në zonat e mbrojtura, si edhe ngritjen e një Fondi të Posaçëm për Zonat e Mbrojtura (FPZM). Fondi synon të mbledhë bashkë të ardhurat e AKZM-ë me kontributet e donatorëve dhe fondet e projekteve. Kjo i mundëson AKZM-së të shfrytëzojë të ardhurat që krijon vetë sipas nevojave dhe prioriteteve të saj, për të garantuar qëndrueshmëri të masave dhe ri-investimin e të ardhurave në ruajtjen dhe restaurimin e ekosistemeve të zonave të mbrojtura, përmes blerjes dhe mirëmbajtjes së pajisjeve, ndërgjegjësimit dhe ofrimit të punësimit sezonal në zonat e mbrojtura.

- Për funksionim sa më të mirë dhe transparent të FPZM-së, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura do të hartojë dhe miratojë – deri në fund të vitit të parë të zbatimit të Veprimit – procedura të qarta dhe dokumentacionin e nevojshëm për përdorimin e këtij Fondi në mënyrën e duhur dhe në përputhje me parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar dhe ligjet e Shqipërisë.

Qeveria e Shqipërisë realizoi një Studim Vlerësimi të Zonave të Mbrojtura në 2019-2020 dhe e paraqiti në seminarin përfundimtar të shkurtit 2020 si bazë për sistemin e ri të zonave të mbrojtura. Qeveria ka hartuar një projekt-VKM për secilën zonë të mbrojtur të propozuar me kufijtë e ri. Këto VKM po i nënshtrohen konsultimit me të gjitha palët e interesuara dhe ministritë e linjës para miratimit.

- Qeveria dhe AKZM do të reflektojnë të projekt VKM-të komentet që po marrin gjatë procesit të konsultimit. Gjatë zbatimit të Veprimit, Qeveria dhe AKZM do të përfshijnë më tej komunitetin shkencor, OSHC-të, BE-në, donatorët dhe palët e tjera të interesit, që të përmirësojnë dhe të rishikojnë çdo ndryshim në sistemin e zonave të mbrojtura në përputhe me legjislacion shqiptar, të drejtën ndërkombëtare dhe *acquis* të BE-së.

Mosrespektimi i kushteve të renditura më lart mund të rezultojë në rikuperim të fondeve në kuadrin e këtij programi dhe/ose rialokimin e financimeve të ardhshme.

3.6. Kuadri Logjik

Rezultatet	Zinxhiri i rezultateve: rezultatet kryesore të pritshme (maks. 10)	Treguesit (të paktën një tregues për rezultat të pritshëm)	Viti bazë (2021)	Synimet 2026	Burimet e të dhënave (1 për tregues)	Supozimet
Ndikimi	Të mbrohet dhe të ruhet - përmes një sistemi të ndërlidhur dhe efektiv të zonave të mbrojtura dhe masave të tjera ruajtëse sipas zonave - të paktën 25% e territorit të Shqipërisë (në tokë dhe det) deri në vitin 2030, me fokus zonat me rëndësi të veçantë për biodiversitetin.	% e territorit (në tokë) të Shqipërisë nën një sistem të ndërlidhur dhe efektiv të zonave të mbrojtura. % e territorit (në det) të Shqipërisë nën një sistem të ndërlidhur dhe efektiv të zonave të mbrojtura.	18% 1%	25% 4 %	Raporti për vlerësimin e zonave të mbrojtura të Shqipërisë / Të dhënat për zonat e mbrojtura në Shqipëri.	*Nuk aplikohet*
Rezultati 1	Efektivitet i përmirësuar i menaxhimit të zonave të mbrojtura.	% e totalit të zonave të mbrojtura nën rezultatin e efektivitetit të menaxhimit të mirë (sipas METT).	30%	55%	Rezultatet sipas Instrumentit të Gjurmimit të Efektivitetit të Menaxhimit (METT).	Qeveria e Shqipërisë e konsideron ruajtjen e natyrës si prioritet, në linjë me procesin e anëtarësimit në BE. Institucionet kombëtare garantojnë vendimmarrje në kohë në hartimin e legjislacionit dhe politikës(ave) përkatëse. Gjithashtu, vendimet e projektit merren në kohë për të mundësuar zbatim normal. Autoritetet do të garantojnë përfshirjen e komuniteteve vendore, akademikëve dhe OSHC-ve mjedisore gjatë të gjithë zbatimit të Veprimit.
Produkti 1 lidhur me Rezultatin 1	Forcohen kapacitetet e institucioneve përgjegjëse (AKZM/ARZM) për të menaxhuar me efektivitet zonat e mbrojtura sipas acquis dhe praktikave më të mira të BE-së	Numri i personelit të trajnuar (ndarë sipas moshës dhe gjinisë) që kanë përmirësuar aftësitë dhe kapacitetet profesionale.	40	80	Raportet e zbatimit të veprimit.	Qeveria përkushtohet plotësisht në zbatimin e rekomandimeve mbi përmirësimin e kapaciteteve institucionale dhe jep alokime buxhetore adekuate.
Produkti 2 lidhur me Rezultatin 1	Plane menaxhimi të zonave të mbrojtura të rishikuara dhe të reja përmes vlerësimit të vlerave dhe kërcënimeve ndaj biodiversitetit duke ndjekur kërkesat e Natura 2000.	Numri i zonave të mbrojtura me plane menaxhimi të rishikuara që parashikojnë masa për zbutje dhe/ose përshtatje ndaj NK. Numri i zonave të mbrojtura me plan menaxhimi të ri sipas modelit Natura 2000, që parashikojnë plane për zbutje dhe/ose përshtatje ndaj NK. Sipërfaqja (ha) e hartëzuar e habtiateve dhe specieve.	0 0 0	10 10 30 000	Raportet e Planeve të Menaxhimit me harta Habitatesh.	Institucionet shtetërore qendrore dhe projektet në vazhdim janë të gatshëm të bashkëpunojnë dhe të vënë në dispozicion të gjithë informacionin teknik, administrativ dhe institucional lidhur me ruajtjen e natyrës.
Produkti 3 lidhur me	Ngrihet sistemi i monitorimit të performancë.	Numri i raporteve vjetore të performancës nga AKZM/ARZM.	0	1 raport AKZM	Raportet vjetore AKZM / ARZM.	Partnerët kryesorë shtetërorë angazhojnë kohë dhe personel të mjaftueshëm në të gjitha

Rezultatet	Zinxhiri i rezultateve: rezultatet kryesore të pritshme (maks. 10)	Treguesit (të paktën një tregues për rezultat të pritshëm)	Viti bazë (2021)	Synimet 2026	Burimet e të dhënave (1 për tregues)	Supozimet
Rezultatin 1				12 raporte ARZM		nivelet, që të marrin pjesë dhe të përfitojnë nga projekti.
Produkti 4 lidhur me Rezultatin 1	Zbatohen masat ruajtëse dhe restauruese të parashikuara në planet e menaxhimit.	Sipërfaqja (ha) ku janë zbatuar masa ruajtëse (çfarëdo numri). Sipërfaqja (ha) e habitateve / ekosistemeve të degraduara kundrejt habitateve të restauruara.	0 0	10 000 ha. Minimum 3000 ha.	Raporti i zbatimit të Veprimit.	Ekziston interesim i gjerë, pjesëmarrje, përfshirje dhe përkushtim nga palët kryesore të interesit, organet profesionale, akademikët, bashkitë dhe organizatat e shoqërisë civile. Qeveria e Shqipërisë është e përkushtuar në luftën kundër krimit mjedisor brenda dhe jashtë zonave të mbrojtura. AKZM/ARZM janë plotësisht të përkushtuara dhe marrin pjesë në zbatimin e fushatës së komunikimit dhe ndërgjegjësimit.
Produkti 5 lidhur me Rezultatin 1	Hartohen plane të reja të menaxhimit për përdorimin e pyjeve dhe produkteve pyjore jodrusore	Sipërfaqja (ha) e zonave pyjore me plane menaxhimi të reja që parashikojnë masa për zbutje dhe/ose përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike.	0	10 000 ha.	Databaza ALFIS.	Institucionet shtetërore qendrore dhe projektet në vazhdim janë të gatshëm të bashkëpunojnë dhe të vënë në dispozicion të gjithë informacionin teknik, administrativ dhe institucional lidhur me ruajtjen e natyrës.
Produkti 6 lidhur me Rezultatin 1	Shoqëria civile mbështetet në mbrojtjen mjedisore dhe restaurimin e zonave të mbrojtura	Numri i aktiviteteve që zbatojnë modele zgjidhjeje për mbrojtjen mjedisore dhe restaurimin e zonave të mbrojtura.	0	6	Raporti i zbatimit të Veprimit	Ekziston interesim i gjerë, pjesëmarrje, përfshirje dhe përkushtim nga palët kryesore të interesit, organet profesionale, akademikët, bashkitë dhe organizatat e shoqërisë civile. Qeveria e Shqipërisë është e përkushtuar në luftën kundër krimit mjedisor brenda dhe jashtë zonave të mbrojtura. AKZM/ARZM janë plotësisht të përkushtuara dhe marrin pjesë në zbatimin e fushatës së komunikimit dhe ndërgjegjësimit.
Produkti 7 lidhur me Rezultatin 1	Zbatohen zgjidhjeve bazuar në natyrë (me fokus mbrojtjen/ruajtjen e natyrës dhe luftën kundër krimit mjedisor)	Numri i aktiviteteve që zbatojnë modele zgjidhjeje bazuar në natyrë	0	6	Raporti i zbatimit të projektit	
Produkti 8 lidhur me Rezultatin 1	Rritet komunikimi, ndërgjegjësimi dhe angazhimi i komuniteteve dhe sektorit privat në ruajtjen e natyrës dhe Natura 2000.	Fushatë efektive për të rritur ndërgjegjësimin dhe angazhimin e publikut në ruajtjen e natyrës. Përqindja e personave në komunitet të ndërgjegjshëm për Natura 2000 dhe ruajtjen e natyrës.	Asnjë fushatë ndërgjegjësimi. N.A	1 fushatë ndërgjegjësimi e zbatuar Rritja e % të personave të ndërgjegjësuar për Natura 2000 dhe natyrën.	Raporti bazë i Veprimit. Raporti Përfundimtar i Veprimit. Raportet e aktiviteteve. Anketat fillestare dhe përfundimtare mbi sensibilizimin për Natura 2020 e ruajtjen e natyrës.	

4. MODALITETET E ZBATIMIT

4.1. Marrëveshja e financimit

Për zbatimin e këtij Veprimi, parashikohet lidhja e një marrëveshjeje financimi me Republikën e Shqipërisë.

4.2. Zbatimi i komponentit të mbështetjes buxhetore

N.A.

4.3. Modalitetet e zbatimit

Komisioni do të garantojë respektimin e rregullave dhe procedurave përkatëse të BE-së për dhënien e financimeve palëve të treta, përfshirë procedurat e rishikimit sipas rastit dhe përputhshmërinë e veprimit me masat shtrënguese të BE-së[7].

4.3.1. Menaxhim Direkt (Grante)

N.A.

4.3.2. Menaxhim Direkt (Çmime)

N.A.

4.3.3. Menaxhim Direkt (Prokurim)

Produkti 8 do të realizohet me një kontratë shërbimi.

Objekti	Lloji indikativ (punime, furnizime, shërbime)	Tremujori indikativ i shpalljes së procedurës
Rritja e komunikimit, ndërgjegjësimit dhe angazhimit të komuniteteve dhe sektorit privat në ruajtjen e natyrës dhe Natura 2000	Shërbime	T2 2022

4.3.4. Menaxhim indirekt me delegim te subjekti(et) (p.sh. organizatë e Shtetit Anëtar, vend i tretë donator, agjenci e specializuar e BE-së (tradicionale / rregullatore), organizatë ndërkombëtare

Pjesë e këtij Veprimi mund të zbatohet me menaxhim indirekt nga një subjekt që do të përzgjidhet nga shërbimet e Komisionit bazuar në kriteret e mëposhtme:

i. Mandati i subjektit të ngarkuar/deleguar që mbulon natyrën e veprimit;
ii. Përvoja e subjektit potencial, sidomos në kontekstin e Bashkimit Evropian dhe në sektor, ku avantazh përbën përvojë në këtë sektor në Ballkanin Perëndimor ose në vende të dy zgjerimeve të fundit (Bullgari, Rumani, Kroaci);
iii. Kapacitetet operacionale/ekspertiza teknike, kapacitetet logjistike dhe menaxhuese, përfshirë në nivel vendor.
iv. Ndikimi, rezultatet, efekti levë i bashkëpunimit me subjekte të tjera/donatorët, si edhe efektiviteti i delegimit të detyrave, përfshirë edhe në Shqipëri;
v. Reduktimi i kostove të transaksioneve;
vi. Kapaciteti i subjektit për të dhënë bashkëfinancim të mundshëm.

Zbatimi nga ky subjekt përfshin Produktet nga 1 në 7.

4.3.5. Menaxhimi indirekt me një përfaqësues IPA III

N.A.

[7] ëëë.sanctionsmap.eu Vini re se harta e sanksioneve është një mjet TI për identifikimin e regjimeve sanksionuese. Sanksionet burojnë nga aktet ligjore të publikuara në Gazetën Zyrtare (GZ). Në rast mospërputhjeje mes akteve ligjore të publikuara dhe përditësimeve në faqen e internetit, mbizotërojnë versionet e publikuara në GZ.

4.3.6. Kontributi për <emri i Instrumentit Miks Rajonal/Platformës>

N.A.

4.3.7. EFSD+ operacionet që mbulohen me garanci buxhetore

N.A.

4.3.8. Ndryshime nga menaxhimi direkt në modalitetin indirekt (dhe anasjelltas) për shkak të rrethanave përjashtimore (një alternativë, opsioni i dytë).

Nëse negociatat me një subjekt sipas pikës 4.3.4 dështojnë, kjo pjesë e veprimit mund të zbatohet me menaxhim direkt në përputhje me modalitetet e zbatimit të përcaktuara në pikën 4.3.3.

4.4. Shtrirja e pranueshmërisë gjeografike për prokurimet dhe grantet

Pranueshmëria gjeografike në kuptimin e vendit të vendosjes për pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit dhe të dhënies së granteve si dhe në kuptimin e origjinës së artikujve të blerë, sipas aktit bazë dhe dispozitave të dokumenteve kontraktuale, zbatohet sipas dispozitës së mëposhtme:

Zyrtari përgjegjës autorizues i Komisionit mund të zgjerojë pranueshmërinë gjeografike në rast urgjence apo mungese të shërbimeve në tregjet e vendeve apo territoreve përkatëse, apo në situata të tjera të justifikuara siç duhet, ku aplikimi i rregullave të pranueshmërisë do ta bënte realizimin e këtij Veprimi të pamundur ose tejet të vështirë.

4.5. Buxheti indikativ

	Kontributi i BE-së (në EUR)	**Kontributi indikativ i palës së tretë (monedhë e identifikuar)**
Produkti 1 – Forcohen kapacitetet e institucioneve përgjegjëse (AKZM/ARZM) për të menaxhuar me efektivitet zonat e mbrojtura sipas *acquis* dhe praktikave më të mira të BE-së **Produkti 2 - Plane menaxhimi të zonave të mbrojtura të rishikuara dhe të reja përmes vlerësimit të vlerave dhe kërcënimeve ndaj biodiversitetit duke ndjekur kërkesat e Natura 2000** **Produkti 3 - Ngrihet sistemi i monitorimit të performancës** **Produkti 4 - Zbatohen masat ruajtëse dhe restauruese të parashikuara në planet e menaxhimit** **Produkti 5 - Hartohen plane të reja të menaxhimit për përdorimin e pyjeve dhe produkteve pyjore jodrusore** **Produkti 6 - Shoqëria civile mbështetet në mbrojtjen mjedisore dhe restaurimin e zonave të mbrojtura** **Produkti 7 - Zbatohen zgjidhjeve bazuar në natyrë (me fokus mbrojtjen/ruajtjen e natyrës dhe luftën kundër krimit mjedisor)** Që konsiston në:	**5 500 000**	N.A
Menaxhim Indirekt me subjekt(e) të deleguar – cf. seksioni 4.3.4	5 500 000	N.A
Produkti 8 - Rritet komunikimi, ndërgjegjësimi dhe angazhimi i komuniteteve dhe sektorit privat në ruajtjen e natyrës dhe Natura 2000 Që konsiston në:	**500 000**	N.A
Menaxhim Direkt (Prokurim) – cf. seksioni 4.3.3	N.A	
Prokurimi – buxheti total nën seksionin 4.3.3	**500 000**	N.A.
Vlerësimi, (cf. seksioni 5.3)	mbulohet nga një tjetër vendim	N.A.

Auditi/Verifikimi i shpenzimeve (cf. Seksioni 6)	mbulohet nga një tjetër vendim	N.A.
Komunikimi dhe vizibiliteti (cf. Seksioni 7)	0	N.A.
Kontingjencat	0	N.A.
Totali	**6 000 000**	

4.6. Struktura organizative dhe përgjegjësitë

Në rastin e menaxhimit direkt, **Autoriteti Kontraktues do të jetë Delegacioni i BE-së në Shqipëri.** DBE do të jetë përgjegjëse për të gjitha marrëveshjet kontraktuale me kontraktorët e përzgjedhur. Në rastin e menaxhimit indirekt me në subjekt të ngarkuar, përgjegjësitë e tij për këtë Veprim përcaktohen një Marrëveshje Kontributi.

Homologët kryesorë të Autoritetet(ve) Kontraktues(e) gjatë zbatimit të projekteve janë **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTE)** si përfaqësuese kryesore e Veprimit. Për shkak të përfshirjes së thellë të palëve të tjera kombëtare si Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe Inspektorati Shtetëror i Mbrojtjes së Territorit, si dhe i bashkive në zonat e mbrojtura, MT do të koordinohet ngushtë me ta gjatë zbatimit të aktiviteteve.

Disa institucione të administratës kombëtare të Shqipërisë, të cilat kanë përgjegjësi të ndryshme në mbrojtjen e natyrës, do të luajnë rol të rëndësishëm teknik në zbatimin e Veprimit, si për shembull:

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është përgjegjëse për përmirësimin e ruajtjes së natyrës duke zbatuar Direktivat për Shpendët dhe Habitatet.
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) ka përgjegjësinë e përgjithshme për menaxhimin e zonave të mbrojtura në Shqipëri.
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit është institucioni kryesor përgjegjës për monitorimin e biodiversitetit si dhe vlerësimin dhe licencimin e aktiviteteve në zona natyrore dhe/ose që prekin vlerat e biodiversitetit.
- Inspektorati Shtetëror i Mbrojtjes së Territorit është përgjegjës për mbikëqyrjen, inspektimin dhe ligjzbatimin e përgjithshëm për çështjet e ruajtjes së natyrës.

Koordinatori Kombëtar IPA (KKIPA) ka përgjegjësinë për koordinimin e përgjithshëm të programimit IPA dhe është homologu kryesor i Komisionit Evropian për të gjithë procesin e planifikimit strategjik, koordinimin e programimit, monitorimin e zbatimit, vlerësimin dhe raportimin e asistencës IPA III në nivel programi.

Për koordinimin e përgjithshëm të politikave dhe asistencës së huaj, Qeveria e Shqipërisë ka ngritur një strukturë ndërinstitucionale dhe operacionale për menaxhimin e zbatimit të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) përmes përqasjes sektoriale dhe ndërsektoriale; SPI shërben si sistemi kryesor që përcakton instrumentet dhe mekanizmat për planifikim të integruar të politikave publike. Urdhri nr. 157, datë 22.10.2018 i Kryeministrit rishikoi Grupet e Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP-et) si dhe strukturat e komiteteve drejtuese sektoriale për zbatimin e përqasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale që merren me menaxhimin dhe koordinimin e politikave në fusha prioritare dhe sektorë me rëndësi të veçantë, si dhe me programimin ndërsektorial përmes krijimit të një mekanizmi menaxhimi sektorial /ndërsektorial. Komitetet Drejtuese Sektoriale (KDS-të) për Mjedisin, Klimën dhe Menaxhimin e Mbetjeve sigurojnë bashkëpunim në nivel drejtimi, brenda sektorëve me rëndësi të veçantë për reformat, si dhe koordinim ndërinstitucional. Grupet Tematike (GT-të) për Konkurrueshmërinë dhe Novacionin sigurojnë bashkëpunim në nivel teknik, përfshirë edhe me partnerët për zhvillim, brenda sektorëve specifikë të fushave prioritare.

Një **Komiteti Drejtues Projekti (KDP)** do të ngrihet për të drejtuar zbatimin. KDP do të përbëhet nga përfaqësues të palëve të interesuara kryesore, si edhe nga Koordinatori Kombëtar IPA (KKIPA) dhe DBE. Komiteti Drejtues i Projektit do të ketë rolin e monitorimit të përmbushjes së objektivave në nivelin e Veprimit.

5. MONITORIMI DHE RAPORTIMI I PERFORMANCËS/REZULTATEVE

5.1. Monitorimi i brendshëm

Veprimi do të jetë objekt i monitorimit nga Delegacioni i BE-së në Shqipëri dhe nga Përfituesi në nivel kombëtar.

KKIPA ka përgjegjësinë e përgjithshme për zbatimin e asistencës IPA në vend dhe monitoron zbatimin e Veprimit dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuar. Autoriteti Kontraktues monitoron zbatimin e aktiviteteve për çdo kontratë. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTE), si pjesë e Strukturës Operuese, do të ndjekë arritjen e treguesve dhe produkteve të përcaktuara në Veprim. MTE do të informojë rregullisht KKIPA-n dhe palët e tjera të interesuara mbi

ecurinë e treguesve. Gjithashtu, MTE ndjek zbatimin e aktiviteteve përkatëse dhe sinjalizon për vonesa të mundshme dhe shkaqet e këtyre vonesave.

Komiteti Monitorues Sektorial (KMS) për Mjedisin dhe Ndryshimet Klimatike mbikëqyr zbatimin e përgjithshëm të aksionit(eve) të financuara nga IPA III, Dritarja 3. Koordinim specifik do të realizohet me bashkitë pjesëmarrëse dhe partnerët zbatues të tjerë, për të garantuar dialogun mbi politikat dhe menaxhimin e njohurive ndërmjet nivelit qendror dhe rajonal/vendor të qeverisjes. Edhe OSHC-të do të konsultohen gjatë zbatimit.

Në përputhje me rregullat dhe procedurat e Komisionit Evropian të përcaktuara në Marrëveshjen e Financimit, **Komiteti Monitorues IPA** do të organizohet me pjesëmarrjen e KKIPA-s, institucioneve përfituese, Agjencive Zbatuese / Autoritetit Kontraktues dhe Delegacionit të BE-së në Shqipëri, me qëllim rishikimin e ecurisë së veprimeve të financuara nga IPA.

5.2. Rolet dhe përgjegjësitë për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave

Modalitetet e monitorimit të performancës dhe rezultateve duhet të jenë në përputhje me sistemin e monitorimit të përshkruar në seksionin 5.1 më lart.

Sistemet e monitorimit sektorial janë aktualisht të kufizuara, prandaj ky Veprim do të kontribuojë në zhvillimin e kapaciteteve më të mira për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave në nivel strategjie sektoriale për çështjet e biodiversitetit.

KKIPA është përgjegjës në nivel kombëtar për monitorimin, rishikimin dhe vlerësimin e ecurisë/progresit të zbatimit të treguesve të përcaktuar në matricën e kuadrit logjik të Veprimit dhe për komunikimin e këtij informacioni pranë shërbimeve të Komisionit Evropian.

Institucioni përfitues i përfshirë direkt në zbatimin e Veprimit ka përgjegjësinë të mbledhë të dhëna për treguesit dhe t'i raportojë ato në kohë te KKIPA.

5.3. Vlerësimi

Nisur nga rëndësia dhe natyra e Veprimit, konsulentë të pavarur të kontraktuar prej Komisionit do të kryejnë një vlerësim përfundimtar për këtë Veprim në tërësi apo komponentë të tij.

Vlerësimi kryhet për qëllime të nxjerrjes së mësimeve si dhe për të vlerësuar ndikimin e aktiviteteve të propozuara në mbrojtjen e natyrës, duke shërbyer kështu si bazë për planifikimin e aktiviteteve të mëtejshme për mbrojtjen e natyrës në Shqipëri, që të mbështeten nga IPA III. Gjithashtu, vlerësimi do të ketë qëllime llogaridhënieje në nivele të ndryshme (përfshirë rishikimin e politikave), duke pasur parasysh sidomos zbatimin e planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura sipas Natura 2000.

Komisioni informon partnerin zbatues të paktën tre muaj përpara datave të planifikuara për misionet e vlerësimit. Partneri zbatues bashkëpunon në mënyrë efikase dhe efektive me ekspertët vlerësues si dhe u ofron atyre, ndër të tjera, të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, si edhe akses në ambientet dhe aktivitetet e projektit.

Raportet e vlerësimit u vihen në dispozicion vendit partner dhe palëve kryesore të interesit. Partneri zbatues dhe Komisioni analizojnë përfundimet dhe rekomandimet e vlerësimeve dhe, sipas rastit, vendosin bashkërisht mbi masat ndjekëse dhe rregullimet e nevojshme që mund të përfshijnë edhe riorientimin e projektit.

6. AUDITI

Pa cenuar detyrimet e zbatueshme në kuadrin e kontratave të nënshkruara për zbatimin e këtij Veprimi, Komisioni mundet që mbi bazën e një vlerësimi risku të kontraktojë kryerjen e auditeve të pavarura apo verifikimin e shpenzimeve për një ose disa kontrata apo marrëveshje.

7. KOMUNIKIMI DHE VIZIBILITETI

Vizibiliteti i financimeve të BE-së dhe komunikimi mbi objektivat dhe ndikimin e Veprimeve janë detyrim ligjor për të gjitha Veprimet e financuara nga BE-ja, siç përcaktohet ne kërkesat në fuqi të komunikimit dhe vizibilitetit të BE-së.

Në veçanti, përfituesit e fondeve të BE-së pranojnë origjinën e fondeve të BE-së dhe garantojnë vizibilitetin e duhur të tyre përmes masave më poshtë:

- të gjitha dokumentet dhe materialet e komunikimit që lidhen me zbatimin e fondeve dhe faqja zyrtare e internetit si dhe mediat sociale, nëse ka, duhet të përmbajnë në vend të dukshëm një pohim që nënvizon se fondet janë dhënë nga BE-ja;
- promovon masat dhe rezultatet e tyre, duke dhënë informacion të shënjestruar, proporcional, koherent dhe efektiv për audiencat e ndryshme, përfshirë median.

Masat e vizibilitetit dhe komunikimit zbatohen, sipas rastit, nga administratat kombëtare, subjektet e ngarkuara, kontraktorët dhe përfituesit e granteve. Detyrimet kontraktuale të përshtatshme përfshihen në marrëveshjet e financimit, në marrëveshjet e delegimit dhe në kontratat e prokurimit dhe ato grant.

Masat bazohen në një Plan specifik Komunikimi dhe Vizibiliteti, që hartohet dhe zbatohet në përputhje me kërkesat në fuqi të BE-së për komunikimin dhe vizibilitetin. Plani duhet të përmbajë ndër të tjera një narrativë komunikimi dhe mesazhe kryesore për Veprimin, të përshtatura sipas audiencave të synuara (palët e interesit, shoqëria civile, publiku i gjerë, etj.).

Masat e vizibilitetit dhe komunikimit specifike për këtë Veprim janë komplementare me aktivitetet e gjera të komunikimit që zbatohen direkt nga shërbimet e Komisionit Evropian dhe/ose Delegacioni i BE-së. Komisioni Evropian dhe Delegacioni i BE-së duhet të informohen plotësisht mbi planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve specifike të vizibilitetit dhe komunikimit, sidomos ato që kanë të bëjnë me narrativën e komunikimit dhe mesazhet kryesore.

8. QËNDRUESHMËRIA

Parakushti më i rëndësishëm për qëndrueshmërinë e Veprimit është bashkëpunimi i mirë dhe marrëdhëniet e forta të punës ndërmjet ekipit dhe përfituesve direktë gjatë zbatimit të Veprimit, çka do të garantojë forcim gradual të kapaciteteve të personelit që menaxhon zonat e mbrojtura, si edhe një plan të shëndoshë mirëmbajtje për infrastrukturën, pajisjet dhe instrumentet që sigurohen nga Projekti.

Transferimi i njohurive dhe aftësitë zhvilluese do të garantohen duke përdorur një sërë teknikash trajnimi si uorkshop, trajnim në punë, vizita studimore, evente demonstruese, etj., si dhe dhënien e materialeve trajnuese të detajuara dhe paketa pune të dokumentuara. Projekti do të vendosë bashkëpunim të ngushtë me përfituesit kryesorë (MTE, AKZM, AKU, AKM) për të minimizuar largimin e personelit dhe për të rritur motivimin e tyre.

Qëndrueshmëria dhe replikimi i proceseve për rishikimin dhe/ose hartimin e planeve të reja të menaxhimit për zonat e mbrojtura kërkon pjesëmarrjen aktive të personelit nga institucionet përfituese. Mjetet dhe procedurat që përdoren në këto procese do të detajohen dhe dokumentohen që përfituesit t'i përdorin në të ardhmen.

Përgatitja dhe zbatimi i sistemit të monitorimit të performancës kontribuon në qëndrueshmërinë e përgjithshme të përpjekjeve për ruajtjen e natyrës. Sistemi konsolidon përfshirjen e institucioneve përkatëse shqiptare të cilat do të marrin pjesë aktivisht në zhvillimin e sistemit dhe zbatimin e gjerë të tij gjatë Veprimit.

Gjithashtu, përfituesit do të përftojnë përvojë të dobishme nga zbatimi i masave ruajtëse dhe rehabilituese të habitateve / ekosistemeve të degraduara, si edhe aplikimi i zgjidhjeve bazuar në natyrë, sepse do të tregojnë nivelin e përpjekjeve që nevojiten për të zbatuar masa të tilla në të ardhmen. Pjesëmarrja e plotë në hartimin e dokumentacionit të tenderit si dhe gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të këtyre punimeve do të forcojë kapacitetet e nevojshme të institucioneve dhe do të garantojë qëndrueshmërinë e punimeve të kryera.

Institucionet përfituese do të garantojnë planifikimin buxhetor afatmesëm dhe një zë buxhetor për Fondin e Posaçëm me qëllim zbatimin e duhur të Direktivave përkatëse, mirëmbajtjen e pajisjeve dhe punimeve mjedisore, zbatimin e planeve të menaxhimit, si edhe ngarkimin e personelit me kohë të pjesshme apo të plotë me mirëmbajtjen e investimeve dhe pajisjeve të blera gjatë programit.

Forcimi i pjesëmarrjes efektive dhe komunikimit me palët e interesuara (shoqërinë civile, komunitetet vendore dhe bashkitë) do të rritë qëndrueshmërinë e masave të zbatuara dhe do të shërbejë si mbështetje afatgjatë për përpjekjet e ruajtjes së natyrës në Shqipëri.

SHTOJCA I.4
e Marrëveshjes së Financimit për planin vjetor të veprimit në favor të
Shqipërisë për vitin 2021
Dokumenti i Veprimit për "BE-ja për Ekonominë Qarkulluese dhe Rritjen e Gjelbër"

SINOPS

1.1. Tabela Përmbledhëse e Veprimit

Titulli	**BE-ja për Ekonominë Qarkulluese dhe Rritjen e Gjelbër** Plani Vjetor i Veprimit në favor të Shqipërisë për vitin 2021			
Numri *CRIS*	IPA III/2021/ 043-666/4			
Akti bazë	Financuar në kuadrin e Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA III)			
Nisma *Team Europe*	Jo			
Zona që përfiton nga veprimi	Veprimi zbatohet në Shqipëri			
Dokumenti programues	Kuadri Programues IPA III			
FUSHAT PRIORITARE DHE INFORMACIONI SEKTORIAL				
Dritarja dhe prioriteti tematik	D 3 – Axhenda e Gjelbër dhe Ndërlidhja e Qëndrueshme PT 1 – Mjedisi dhe ndryshimet klimatike			
Objektivat e Zhvillimit të qëndrueshëm (OZhQ)	OZhQ kryesor: 11 – Qytete gjithëpërfshirëse, të sigurta, rezistente dhe të qëndrueshme. OZhQ të tjera të rëndësishme (deri në 9) dhe synimet, sipas rastit: 12: Konsum dhe prodhim i qëndrueshëm. 13: Veprimi për Klimën: Masa urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe ndikimet e tyre. 14: Ruajtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i oqeaneve, deteve dhe burimeve detare			
Kodi(et) *DAC*[1]	Kodi kryesor 14050: Menaxhimi/Eliminimi i mbetjeve 62% Nënkodi 1: 41010 Politika mjedisore dhe menaxhimi administrativ 38%			
Kanali Kryesor i Zbatimit	13000 – Qeveri e vendit të tretë (bashkëpunim i deleguar)			
Treguesit **(nga formulari DAC)**	**Objektivi i përgjithshëm i politikës**	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	Zhvillimi i pjesëmarrjes/ qeverisja e mirë	☐	☒	☐
	Ndihmë për mjedisin	☐	☐	☒
	Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave	☐	☒	☐
	Zhvillimi i tregtisë	☐	☒	☐
	Shëndeti riprodhues, i mëmësisë, të sapolindurve dhe fëmijëve	☒	☐	☐
	Reduktimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore	☒	☐	☐

[1] Sektorët DAC (kodet dhe përshkrimet) tregohen në kolonën e parë dhe të katërt në tabelën "kodet e qëllimeve" në dokumentin në vijim: http://www.oecd.org/dac/financing-sustainable-development/development-financestandards/dacandcrscodelists.htm

	Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara	☒	☐	☐
	Ushqyerja	☒	☐	☐
	Treguesit e Konventës RIO	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	Diversiteti biologjik	☐	☒	☐
	Lufta ndaj shkretimit	☒	☐	☐
	Zbutja e ndryshimeve klimatike	☐	☒	☐
	Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike	☒	☐	☐
Tregues të brendshëm	**Objektivat e politikës**	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	Dixhitalizimi	☐	☒	☐
	Migrimi	☒	☐	☐
	COVID-19	☒	☐	☐
INFORMACION PËR BUXHETIN				
Shumat përkatëse	Linja e buxhetit: 15.020201.02 Kostoja totale e vlerësuar: 30 900 000 Euro Kontributi total i buxhetit të BE-së: 30 900 000 Euro			
MENAXHIMI DHE ZBATIMI				
Lloji i financimit dhe metoda(t) e zbatimit	Me Projekt **Menaxhim Direkt** përmes prokurimit **Menaxhim Indirekt** me subjekt(e) që përzgjidhen sipas kritereve të përcaktuara në seksionin 4.3.4.			
Prioritetet përkatëse dhe programet nga Plani Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor	Prioritetet: Axhenda e Gjelbër Programet: VII Mbetjet dhe Ujërat e Përdorur			
Afati për lidhjen e Marrëveshjes së Financimit	deri më 31 dhjetor N+1			
Afati për lidhjen e marrëveshjeve të kontributit /delegimit, prokurimeve dhe kontratave grant	3 vite pas datës së lidhjes së Marrëveshjes së Financimit, me përjashtim të rasteve të renditura në nenin 114(2) të Rregullores Financiare			
Periudha indikative e zbatimit operacional	72 muaj pas lidhjes së Marrëveshjes së Financimit			

Afati për zbatimin e Marrëveshjes së Financimit	12 vite pas lidhjes së Marrëveshjes së Financimit

1.2. Përmbledhja e Veprimit

Shqipëria ka përkushtim konstant dhe të fuqishëm publik dhe politik ndaj integrimit evropian. Shqipëria ka filluar hapat e parë drejt Ekonomisë Qarkulluese dhe Rritjes së Gjelbër me masa që do të kontribuojnë për një Evropë më të pastër dhe më konkurruese, në bashkëpunim me palët ekonomike, konsumatorët, qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile. Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve bashkë me Planin e Veprimit dhe Masterplanin (Studimi Sektorial për Nevojën për Investime) përbëjnë një hap thelbësor për përputhjen e plotë me *acquis* të BE-së për menaxhimin e mbetjeve dhe për negociatat e *Kapitullit 27: Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike*. Këto dokumente përcaktojnë objektiva ambiciozë për Ekonominë Qarkulluese dhe realizimin e objekteve infrastrukturore për të përmbushur kërkesat e BE-së në mbarë vendin.

Veprimi do të kontribuojë në përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit, në zhvillimin e ekonomisë qarkulluese që është gjithëpërfshirëse dhe me perspektivë gjinore, si dhe në rritjen e gjelbër të qëndrueshme në Shqipëri. Aktivitetet përfshijnë, ndër të tjera, përafrimin e legjislacionit, prezantimin e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit (PZP), mbështetjen e infrastrukturës rajonale për mbetjet, si dhe angazhimin e komuniteteve dhe sektorit privat në ekonominë qarkulluese dhe rritjen e gjelbër. Veprimi do të mbështesë transpozimin dhe zbatimin e direktivave kryesore për mbetjet, duke përgatitur dokumentet kryesore planifikimi për pajtueshmërinë ligjore, parandalimin e mbetjeve, ekonominë qarkulluese dhe mbetjet e rrezikshme. Gjithashtu, do të mbështesë forcimin e kapaciteteve të autoriteteve të menaxhimit të mbetjeve në nivel qendror dhe vendor dhe do t'u sigurojë atyre mjete për zbatimin, monitorimin dhe ekzekutimin ligjor të politikave të menaxhimit të mbetjeve, duke përfshirë ngritjen e një sistemi të integruar për mbledhjen e të dhënave për mbetjet. Kështu, Veprimi do të mbështesë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për të përmbushur kërkesat e raportimit dhe Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM) në zbatimin e përgjegjësive të saj[2].

Ky Veprim do të mundësojë ngritjen dhe zbatimin e kuadrit rregullator për PZP-në, si dhe të instrumenteve mbështetëse për zbatimin e ekonomisë qarkulluese, sistemin PZP, ndarjen e mbetjeve dhe riciklimin. Palët e treta si sektori privat, organizatat e përgjegjësisë së prodhuesit (OPP), organizatat mjedisore të shoqërisë civile, bizneset sociale dhe qeverisja vendore do të mbështeten në zbatimin e masave që lehtësojnë dhe nxisin rritjen e gjelbër dhe ekonominë qarkulluese gjithëpërfshirëse dhe me perspektivë gjinore.

Veprimi plotëson zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe ofron shembuj për bashkitë. Veprimi do të zbatojë modele për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta bashkiake dhe mbylljen e landfilleve / vendgrumbullimeve të parregullta, , duke përfshirë riciklimin dhe ripërdorimin në zonat e mbetjeve Kukës dhe Gjirokastër-Vlora jug. Këto modele do të bazohen në studimin e fizibilitetit për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta të hartuar për të dyja zonat e mbetjeve. Aktivitetet synojnë prezantimin dhe zbatimin e ekspertizës dhe praktikave më të mira të shërbimeve të ngjashme në vende të BE-së, duke arritur objektivat e përcaktuara në planin kombëtar të menaxhimit të mbetjeve.

Sjellja shoqërore dhe komunitare ndikohet ndjeshëm nga rritja e ekonomisë dhe e konsumit nga një pjesë e madhe e popullsisë. Veprimin do ta shoqërojë një fushatë e përshtatur gjithëpërfshirëse që rrit ndërgjegjësimin dhe nxit pjesëmarrjen e konsumatorëve në masat për parandalimin e mbetjeve, ekonominë qarkulluese dhe rritjen e gjelbër.

2. ARGUMENTIMI

2.1. Analiza e Kontekstit

Në periudhën 2012-2018, numri i vendeve të punës të lidhura me ekonominë qarkulluese në BE u rrit me 5%, duke arritur në rreth 4 milionë. Qarkullimi pritet të ketë efekt neto pozitiv në krijimin e vendeve të punës, me kusht që punëtorët të përftojnë aftësitë që kërkon tranzicioni i gjelbër. Për shkak të normave kulturore dhe dallimeve profesionale

[2]AKUM ka përgjegjësinë e zbatimit të të gjitha kompetencave që Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka në lidhje me infrastrukturën e menaxhimit të mbetjeve dhe planifikimin e territorit.

dhe fizike, modelet e konsumit të burrave dhe grave ndryshojnë. Njëkohësisht, prodhimi i paqëndrueshëm, gjenerimi i mbetjeve dhe ndotja shpesh kanë ndikime të dëmshme veçanërisht te gratë, sidomos ato nga shtresat shoqërore të pafavorizuara, përmes kanaleve të ndryshme: nga sforcimi i të mirave natyrore prej të cilave varet ekzistenca e grave, deri te kushtet e këqija të punës për fuqinë punëtore "të feminizuar" dhe rritja e punës së papaguar lidhur me menaxhimin e mbetjeve. Shpesh gratë kanë përgjegjësinë për menaxhimin e mbetjeve, prandaj më shumë mbetje do të thotë më shumë punë për to.

Si një vend kandidat në BE, Shqipëria po ndërmerr masa për Ekonominë Qarkulluese dhe Rritjen e Gjelbër, të cilat kontribuojnë për të pasur një Evropë më të pastër dhe më konkurruese në bashkëpunim me palët ekonomike, konsumatorët, qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile. Strategjitë kombëtare përcaktojnë disa politika dhe nisma për energjinë e rinovueshme, efiçencën e energjisë dhe turizmin. Këto strategji duhet të menaxhohen nën një kuadër të përbashkët që integron parimet e ekonomisë së gjelbër dhe qarkulluese, i cili përcakton stimuj (edhe masa dekurajuese) për të vënë në zbatim axhendën e gjelbër.

Zbatimi i legjislacionit për menaxhimin e mbetjeve është në fazë të hershme, për shkak të kompleksitetit të kësaj fushe, burimeve të konsiderueshme financiare që kërkon infrastruktura e mbetjeve, legjislacioni pjesërisht i harmonizuar me *acquis,* kapacitetet e pamjaftueshme në nivel qendror dhe vendor, si dhe mungesa e dokumenteve planifikuese për flukset e veçanta të mbetjeve dhe menaxhimin rajonal të mbetjeve. Pavarësisht ekzistencës së dispozitave ligjo, sasia dhe origjina e mbetjeve të rrezikshme është e panjohur, kryesisht për shkak të mosmbledhjes së të dhënave, çka rezulton edhe nga mosndarja e mbetjeve të rrezikshme që grumbullohen. Mungesa e të dhënave dhe e gjithëpërfshirjes pengon menaxhimin e shëndoshë të mbetjeve të rrezikshme.

Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve Bashkiake në Shqipëri organizohet në 10 zona (rajone) mbetjesh, bazuar në ekonominë e shkallës dhe ndërlidhen. Bashkitë kanë përgjegjësinë të organizojnë menaxhimin e integruar të mbetjeve, që nga grumbullimi deri te trajtimi përfundimtar, si edhe të raportojnë të dhënat te organet përgjegjëse të Qeverisë: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTE) dhe AKM. Katër objekte rajonale të menaxhimit të mbetjeve janë operacionale: landfilli i Maliqit dhe stacionet e transferimit (Zona e Mbetjeve Korçë), landfilli i Bajkajt dhe stacioni i transferimit Himarë (zona e mbetjeve Vlora jug - Gjirokastër), landfilli i Bushatit (zona e mbetjeve Shkodër - Lezhë), landfilli i Sharrës (zona e mbetjeve Tiranë - Durrës), si dhe inceneratori i Elbasanit (zona e mbetjeve Elbasan). Objektet komplekse të trajtimit të mbetjeve janë në qendër të zhvillimit infrastrukturor.

Qindra landfille dhe vendgrumbullime të vjetra/të parregullta duhet të mbyllen dhe duhet të fillojë grumbullimi i ndarë i fluksit të mbetjeve, bashkë me rritjen e riciklimit dhe ripërdorimit, si edhe kompostimin e biombetjeve. Vetëm 65% e mbetjeve grumbullohen dhe nuk bëhet fare riciklim i mbetjeve të demolimeve (inerte nga ndërtimet). Instrumentet ekonomike për të promovuar grumbullimin e ndarë, riciklimin dhe parandalimin e gjenerimit të mbetjeve mbeten të kufizuara. Inceneratori funksional në Elbasan dhe ndërtimi i dy inceneratorëve në Tiranë dhe Fier paraqesin shqetësime për sa i përket përputhshmërisë me Direktivat e Mbetjeve të BE-ë, parimin e hierarkisë së mbetjeve të destinuara për incenerim si alternativa më pak e preferuar e menaxhimit të mbetjeve, si dhe me objektivat e riciklimit të BE-së.

2.2. Fushat problematike që do të mbështeten

Veprimi do të fokusohet në disa fusha të ndërlidhura për zhvillimin e konceptit të ekonomisë qarkulluese dhe rritjes së gjelbër (EQ&RRGJ).

FUSHA E MBËSHTETJES #1: Transpozim dhe zbatim i kufizuar i acquis të BE-së për mbetjet
Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2020 - 2035 përbëjnë një hap drejt **përputhshmërisë së plotë me *acquis* të BE-së për menaxhimin e mbetjeve** dhe negociatat për *Kapitullin 27 - Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike*. Ai përcakton masat për avancimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe fokusohet në adresimin e mangësive aktuale të sistemit, transpozimin dhe zbatimin e legjislacionit dhe përgatitjen për kërkesat e politikave të ardhshme, si dhe ndryshimet ligjore në kuadrin e Direktivës Evropiane. Megjithatë, raporti i Komisionit Evropian 2020 për Shqipërinë[3] konstaton *progres të kufizuar në përafrimin e politikave dhe legjislacionit me acquis, në fusha të tilla si mbetjet...,* teksa ende duhen bërë përpjekje të konsiderueshme *...për zbatimin dhe ekzekutimin e ligjit, veçanërisht në menaxhimin e mbetjeve.* Legjislacioni për menaxhimin e integruar të mbetjeve ka transpozuar 53.7% të *acquis* të BE-së. Shumica e direktivave janë në fazat fillestare të zbatimit. Prandaj, transpozimi ka nevojë për një shtysë shtesë, në mënyrë që zbatimit të avancojë. Kuadri aktual legjislativ dhe rregullator nuk parashikon një ndarje të qartë të kompetencave ndërmjet autoriteteve përgjegjëse të sektorit. Përgjegjësitë ndahen ndërmjet MTE-

[3] SWD(2020) 354 final

së që është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe legjislacionit, si dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) përgjegjëse për infrastrukturën.

Plani i Veprimit i BE-së për Ekonominë Qarkulluese[4] (prodhimi, konsumi, lëndët e para, novacioni, investimet dhe monitorimi) ende nuk është integruar në dokumentet e politikave të Shqipërisë. Mbetet të hartohet një **Udhërrëfyes për Ekonominë Qarkulluese** që përmban masat për arritjen e objektivave të ekonomisë qarkulluese. Në zbatim të planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e mbetjeve, janë hartuar plane menaxhimi të mbetjeve bashkiake dhe rajonale (të kufizuara). Kërkesa e direktivës kuadër për një **Program Parandalimi të Mbetjeve** mbetet e patrajtuar askund. Analiza gjinore në këtë sektor do të kontribuojë në procesin e përgatitjes së legjislacionit me ndjeshmëri gjinore. Aktivitetet konceptohen që të kenë përgjegjshmëri gjinore, t'u përgjigjen nevojave të ndryshme të grave dhe burrave, djemve dhe vajzave lidhur me të gjitha dallimet mes tyre.

Shqipëria bashkëpunon në menaxhimin e mbetjeve detare në rajonin e Adriatikut, në kontekstin e Planit të Veprimit të Mesdheut. Gjatë negociatave me BE-në, Shqipërisë do t'i duhet të përcaktojë mjetet dhe afatet për zbatimin e direktivave kryesore të BE-së për mbetjet. Hartimi i Planeve të Zbatimit të Direktivave Specifike (PZDS) është baza për të pasur përqasje strategjike në kuadrin e negociatave me BE-në, si dhe për zbatimin dhe monitorimin e progresit në përmbushjen e kërkesave të BE-së në nënkapitullin e mbetjeve.

FUSHA E MBËSHTETJES #2: Kapacitetet dhe instrumentet e kufizuara të palëve të interesuara për EQ dhe riciklimin

Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve dhe Plani i Veprimit i Shqipërisë përmbajnë **objektiva ambiciozë për Ekonominë Qarkulluese.** Ajo adreson menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe prek aspekte të ekonomisë qarkulluese si p.sh. përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit, prokurimi i gjelbër dhe parandalimi i mbetjeve. Shqipëria aspiron të zbatojë Paktin e Gjelbër Evropian[5] dhe Axhendën 2030 të BE-së, duke bërë një transformim drejt ekonomisë qarkulluese dhe rritjes së qëndrueshme. Ky transformim kërkon novacion dhe produkte e incentiva për bizneset dhe konsumatorët. Megjithatë, politikat mjedisore janë të nënfinancuara dhe të paafta të garantojnë burime të mjaftueshme për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe zbatimin e legjislacionit. Kjo minon përpjekjet e MTE-së për të integruar politikat mjedisore në politikat e tjera të Shqipërisë.

Raporti i Komisionit Evropian 2020 për Shqipërinë nënvizon se *grumbullimi i ndarë i flukseve të mbetjeve dhe instrumentet ekonomike për të promovuar riciklimin dhe ripërdorimin si dhe për të parandaluar gjenerimin e mbetjeve mbeten të kufizuara.* Raporti i OECD-së "Perspektiva e Konkurrueshmërisë për Evropën Juglindore" i vitit 2018 konstaton se nismat për ekonominë qarkulluese sapo kanë filluar: Shqipëria shënon 0.5 pikë nga 5 pikë të plota për kuadrin e ekonomisë qarkulluese, 2.5 pikë për menaxhimin e mbetjeve urbane (bashkiake), si edhe rezultat mesatar 1.66 nga 5 për produktivitetin e burimeve. Sa u përket politikave për rritjen e gjelbër, Shqipëria shënon rezultatin 1.33 nga 5 pikë, ndërsa për cilësinë mjedisore të jetës kap rezultatin 2 nga 5 pikë. Evidentimi/shënjestrimi i roleve gjinore dhe preferencave gjinore të sjelljes në konsum dhe në gjenerim dhe parandalim mbetjesh mund të jetë një shtyllë themelore për kalimin drejt ekonomisë qarkulluese, jo vetëm duke reduktuar mbetjet, por edhe duke adresuar disa pabarazi gjinore përmes njohjes së vlerave që disa vende pune kanë në mbështetje të ekonomisë qarkulluese.[6]

Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit i ndryshuar (10431/2011) përcakton parimet bazë që mbështesin ekonominë qarkulluese dhe rritjen e gjelbër. Ligji parashikon instrumentet për ekoetiketimin, ekomenaxhimin dhe auditimin, marrëveshjet vullnetare, edukimin dhe trajnimin. Procedurat operacionale dhe administrative që mbështetin zbatimin e tyre ende mungojnë. Ligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve (nr. 10463/2011) dhe Ligji për lejet mjedisore (nr. 10448/2011) përcaktojnë në përgjithësi mjedisin mundësues për skemat dhe instrumentet e ekonomisë qarkulluese. Megjithatë, këto skema apo instrumente ende nuk janë zhvilluar, ndërkohë që disa akte nënligjore dhe kuadri ligjor mungojnë. Janë zbatuar disa nisma zyrtare për parandalimin e mbetjeve, si p.sh. një tarifë e vogël prej 0.02 Euro për qeset plastike. MTE synon të ndjekë shembullin e BE-së mbi ndalimin e qese plastike njëpërdorimëshe.

Shkalla mesatare kombëtare e grumbullimit të mbetjeve për mbetjet bashkiake vlerësohet 70% (2019) dhe shkalla aktuale e rikuperimit dhe riciklimit të përgjithshëm vlerësohet rreth 17% (2019)[7]. Disa kompani riciklimi kanë investuar në infrastrukturën e riciklimit, por pak prej tyre janë moderne në ndarjen dhe mbledhjen e lëndëve të pastra të ricikluëshme. Ekziston një potencial i madh për riciklim të mëtejshëm, veçanërisht të mbetjeve të ngurta urbane. Industria vendase e riciklimit shfrytëzon pak kapacitetet e veta, për shkak se mungon materiali i ricikluëshëm që vjen kryesisht nga mosndarja e mbetjeve në burim.

[4] COM(2020) 98 final
[5] COM(2019) 640 final
[6] OECD: Notë për Gjininë dhe Menaxhimin e Mbetjeve.
[7] Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Menaxhimin e Mbetjeve 2018-2033.

Kalimi drejt ekonomisë qarkulluese ka nevojë të adresojë edhe kapacitetet e Shqipërisë për **novacion,** i cili mbetet i ulët dhe gjeneron fare pak efekte pozitive për ekonominë ku ka angazhim shumë të ulët të sektorit privat në programe kërkimi shkencor, zhvillimi dhe novacioni. Veprimi duhet të fokusohet te kuadri rregullator, mundësitë ekonomike dhe ndërgjegjësimin e konsumatorit për EQ&RrGj, me qëllim që të prodhojë raste suksesi dhe të nxitë përfshirjen e publikut. Nevojiten sisteme, procedura dhe instrumente ekonomik të parashikuara me ligj për **grumbullimin e ndarë** (të diferencuar) të mbetjeve specifike (ambalazhet dhe mbetjet e paketimit, mbetjet e pajisjeje elektrike dhe elektronike, si edhe flukse të tjera mbetjesh). Sistemet e grumbullimit të ndarë të mbetjeve dhe afatet për të përmbushur objektivat e përcaktuar në VKM-të nuk janë realizuar sepse mungon legjislacioni PZP që përcakton përgjegjësinë e prodhuesit sipas parimit "ndotësi paguan".

FUSHA E MBËSHTETJES #3: Rrjet i paplotë i objekteve infrastrukturore për menaxhimin e mbetjeve

Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve parashikon ngritjen e një Rrjeti të Integruar të Objekteve të Menaxhimit të Mbetjeve – i cili ende nuk është ngritur - për trajtimin e mbetjeve në përputhje me standardet e BE-së. Studimi Sektorial i Nevojës për Investime (Masterplani) për mbetjet urbane dhe mbetjet inerte nga ndërtimet (demolimet) ka përcaktuar zonat (rajonet) e mbetjeve bazuar në sasitë e mbetjeve që ofrojnë ekonomi shkalle dhe ndërlidhje për objektet e trajtimit. Rrjeti i integruar i objekteve deri më sot përfshin pesë[8] nga dhjetë zona të mbetjeve me objekte të ndërtuara për trajtimin në nivel rajonal[9], dy objekte ende në ndërtim[10] dhe tre objekte[11] në fazë planifikimi. Megjithatë, rrjeti i stacioneve të transferimit është i nënzhvilluar, duke vënë kështu në rrezik shfrytëzimin në shkallë të gjerë të objektive të [trajtimit të] mbetjeve. Vetëm një zonë mbetesh ka një objekt rajonal që është i mirëlidhur me zonën e mbetjeve përmes stacioneve të transferimit dhe sistem transporti të distancave të gjata.

Zbatimi është fokusuar te trajtimi i mbetjeve. Dikur mbetjet hidheshin në vendgrumbullime apo vende të paligjshme, ndërsa tashmë janë ndërtuar disa landfille sanitare në përputhje me rregullat mjedisore, duke i sjellë kështu objektet e mbetjeve më afër standardeve të BE-së. Megjithatë 199 landfillet / vendgrumbullimet e parregullta[12] duhet të mbyllen dhe të zëvendësohen me objekte që respektojnë rregullat mjedisore. Përfundimi i rrjetit të integruar të impianteve të trajtimit të mbetjeve duhet të mbetet prioritet me qëllim që bashkive t'u ofrohet trajtim dhe eliminim i sigurt.

Financimi i investimeve për objektet rajonale të trajtimit është siguruar nga buxheti i shtetit për tre inceneratorët dhe nga mbështetja financiare ndërkombëtare për objektet e tjera rajonale. Investimet janë të nevojshme për të plotësuar rrjetin e objekteve të trajtimit dhe sistemet e transportit në distanca të gjata, duke u dhënë të gjitha bashkive në ZM akses në këto objekte. Bashkitë pjesëmarrëse duhet të planifikojnë burime për të përballuar kostot operative të objekteve të trajtimit, përveç aktiviteteve të grumbullimit dhe largimit të mbetjeve. Masterplani vlerëson se këto kosto nuk janë ekonomikisht të përballueshme për popullsinë. Shumica e bashkive duhet të hartojnë dhe të miratojnë një politikë afatgjatë fiskale që garanton mbulim të plotë të kostove të menaxhimit të mbetjeve nga tarifat e mbetjeve, në përputhje me parimin "ndotësi paguan". Masterplani ka llogaritur nevojat për investime në objektet rajonale, për investimet e nevojshme për përmirësimin e aktiviteteve të mbetjeve në nivel vendor dhe për mbylljen e vendgrumbullimeve aktuale dhe kujdesin e mëpasshëm. Raporti i Komisionit Evropian 2021 për Shqipërinë[13] thekson se "ndërtimi i një inceneratori të ri përveç dy ekzistuesve në Elbasan dhe Fier paraqet shqetësime në rritje për sa i përket përputhshmërisë me *acquis* të BE-së për mbetjet, përfshirë parimin e hierarkisë së mbetjeve dhe objektivat e riciklimit". Për të përmbushur objektivat e BE-së për rikuperimin material, nevojitet mbështetje e shumanshme për instalimin hap pas hapi dhe vënien në funksion të teknologjive të avancuara.

FUSHA E MBËSHTETJES #4: Mungesa e skemave të vetëfinancimit për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në Shqipëri

Analiza e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA)[14] tregon se boshllëku mes tavaneve të buxhetit për menaxhimin e mbetjeve dhe nevojave reale shkon në rreth 163 milion Euro që duhen për infrastrukturën e menaxhimit rajonal të mbetjeve të ngurta gjatë viteve 2021-2023. Për këtë periudhë, buxheti i shtetit alokoi 65.5 milion Euro për menaxhimin e mbetjeve urbane, nga të cilat 23% mbulojnë kostot e tre inceneratorëve dhe 76% përmirësime në objektet rajonale aktuale, rehabilitimin e vendgrumbullimeve dhe investime për ndërtimin e objekteve rajonale. Qeveria e paraqiti projektbuxhetin 2022 dhe PBA 2022-2024[15] në Parlament më 25 tetor 2021. Kryeministri u bëri thirrje publikisht

[8] ZM Elbasan, ZM Korçë, ZM Shkodër-Lezhë, ZM Tiranë-Durrës, ZM Vlora jug-Gjirokastër.
[9] Këtu përfshihet landfilli i ndërtuar për ZM Tiranë-Durrës, ku po vahdon ndërtimi i incineratorit.
[10] ZM Fier dhe ZM Vlora jug.
[11] ZM Berat, ZM Kukës dhe ZM Dibër.
[12] Disa prej këtyre landfileve/vendgrumbullimeve të parregullta janë në proces rehabilimi.
[13] SWD(2021) 289 final
[14] http://www.financa.gov.al/programi-buxhetor-afatmesem-2021-2023-faza-iii
[15] https://www.parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/55649

kryetarëve të bashkive që ta bëjnë menaxhimin e mbetjeve prioritet në nivel bashkie. Megjithatë, lista e investimeve në PBA 2022-2024 nuk parashikon programe të reja shpenzimesh për menaxhimin e mbetjeve, por vetëm vijimësi të programeve / projekteve në zbatim e sipër. Për 2022-2024, buxheti total i propozuar për menaxhimin e mbetjeve urbane është 90.1 milion Euro, ku përfshihen koncesionet / PPP-të[16], nga të cilat 69.5 milion Euro financohen përmes të ardhurave të veta dhe 20.6 milion Euro përmes granteve.[17] Këto kosto kanë të bëjnë kryesisht me trajtimin e mbetjeve. Aspektet e tjera të menaxhimit të mbetjeve, si p.sh. riciklimi dhe ripërdorimi, janë të nënfinancuara, ndërkohë që mungojnë politikat që mbështesin investimet private në sektor. Nevoja për investime në objektet rajonale të të gjitha ZM-ve deri në vitin 2027 vlerësohet të jetë rreth 228 milion Euro. Përveç kësaj, vlerësohet se duhen edhe investime 118 milion Euro për menaxhimin e mbetjeve në nivel vendor. Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve konstaton nivele të ulëta dhe mosefiçencë në arkëtimin e tarifave në shumë bashki; vetëm 60% (2019) e tarifave mblidhen. Nuk ka asnjë politikë fiskale për rikuperimin e kostos për 40% të mbulimit të shërbimit me të ardhurat nga tarifat. Për më tepër, kostot e shërbimit nëpër bashki në mjaft raste nuk përfshijnë kostot e trajtimit të mbetjeve. Mungesa e të dhënave të besueshme si për sasinë e mbetjeve ashtu edhe për përllogaritjen profesionale të kostove përgjatë të gjithë ciklit të mbetjeve, i pengon bashkitë të përgatisin politika të sakta fiskale për të adresuar këtë çështje. Nga ana tjetër, rritja progresive a tarifave të shërbimit drejt rikuperimit të kostos kërkon mbështetje dhe angazhim të fortë politik. Disa bashki me normën më të lartë të arkëtimit të tarifave po përdorin sistemin e konsoliduar të arkëtimit që përdorin ndërmarrjet e ujësjellësit. Alternativat e tjera të arkëtimit ofrojnë një bazë të kufizuar tatimpaguesish, sidomos në zonat rurale. Nevojitet një analizë e implikimeve sociale, sidomos për rolin e grave në drejtimin e transformimeve të nevojshme në ekonominë qarkulluese, aftësitë që nevojitën dhe ndikimin te mundësinë për punë te gratë. Forcimi i kapaciteteve dhe legjislacionin duhet të zhvillojnë një skemë funksionale vetëfinancimi për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, si edhe duhen incentiva që sektori privat të nxitet të financojë për ripërdorimin dhe riprodhimin e materialeve dhe për t'u angazhuar që në ciklin e prodhimi.

FUSHA E MBËSHTETJES #5: Pjesëmarrja e kufizuar e shoqërisë civile në ekonominë qarkulluese

Sjellja shoqërore dhe komunitare ndikohet ndjeshëm nga rritja e ekonomisë dhe e konsumit nga një pjesë e madhe e popullsisë. Prandaj, ekziston nevoja urgjente për ndërgjegjësim të fortë lidhur me grumbullimin e ndarë të mbetjeve, riciklimin dhe kursimin e burimeve, të ndërthurur me mundësi dhe teknologji të reja që mund të përdoren për biznes fitimprurës duke përdorur materialet dytësore (riciklimet, biombetjet, etj.). Organizatat e shoqërisë civile po nxisin dhe zbatojnë nisma të ekonomisë qarkulluese, me biznese të reja por novatore që krijojnë produkte nga materialet e ricikluara. Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014-2020[18] përmban masa për këshillim dhe orientim të NMV-ve në përmirësimin e efikasitetit të burimeve dhe thekson nevojën për të rritur gamën e produkteve ekologjike. Gjithashtu, strategjia përcakton masa për zhvillimin e industrisë së riciklimit. Por, pavarësisht politikave të gjelbra për NVM-të, zbatimi i tyre mbetet i kufizuar. Pengesë janë buxheti i ulët për masat e gjelbra të NVM-ve, bashkë me vonesat në mobilizimin e fondeve për zbatimin, ashtu si monitorimi i dobët i treguesve të performancës për politikat e gjelbra. Angazhimi i grave në ekonominë qarkulluese - përmes ndërgjegjësimit mbi konsumin e qëndrueshëm dhe nxitjen e pjesëmarrjes së tyre në lidership dhe role drejtuese - është i domosdoshëm për të krijuar sisteme të mira qarkullimi. Mund të projektohet një lëvizje drejt ekonomisë qarkulluese për të nxitur barazinë gjinore. Meqë gratë shpesh punojnë në punë me pagë të ulët, sigurime të ulëta dhe mobilitet social të kufizuar, rritja e punëve të gjelbra në kuadrin e lëvizjes për ekonominë qarkulluese ofron mundësi për fuqizimin e grave.[19] Në tërësi, duhet më shumë fokus te zbatimi dhe stimuj për ndërtimin e partneriteteve, krijimin e historive të suksesit të NVM-ve me produktet e gjelbra si dhe kapërcimin e barrierave financiare ndaj përpjekjeve të gjelbra të NVM-ve.

2.3. Relevanca dhe komplimentariteti me strategjitë e mbështetura nga palët kryesore kombëtare

Shqipëria ka shënuar përparim në politikën e menaxhimit të mbetjeve, përfshirë ekonominë qarkulluese dhe rritjen e gjelbër, duke hartuar strategjitë përkatëse që identifikojnë qartë fushat kryesore të punës. Veprimi i mbështet këto strategji kombëtare.

Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta 2019-2032 përcakton një plan investimi për infrastrukturën vendore dhe rajonale në fushën e mbetjeve. Objektivat e Planit janë: i) të përcaktojë metodologjinë dhe teknologjinë e duhur për investimet e ardhshme në sektorin MMN; ii) të përcaktojë kostot dhe tarifat e duhura; iii) të ofrojë një sistem objektiv, transparent dhe të verifikueshëm për përcaktimin e prioriteteve për investimet në infrastrukturën MIMN; iv) të ofrojë një plan investimi për infrastrukturën vendore dhe rajonale të MIMN të ndarë sipas fazave në afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, në lidhje me grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, reduktimin dhe

[16] Kryesisht ndërtimi i landfillimit, incineratori dhe rehabilitimi i landfilleve ekzistuese të Tiranës.
[17] Llogaritjet bazohen në të dhënat e tabelave 1, 1.1 dhe 1.2 të projektbuxhetit dhe "Relacionit për projektligjin për buxhetin e vitit 2022".
[18] Projekt-Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 po i nënshtrohet konsultimeve me grupet dhe palët e interesuara.
[19] ILO, 2015

riciklimin e tyre, si dhe impiantet për trajtimin dhe/apo depozitimin e mbetjeve; v) të propozojë ndryshimet e nevojshme ligjore dhe institucionale; të propozojë masa të tjera shoqëruese. Plani Sektorial udhëhiqet nga objektivat e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta, kryesisht në sigurimin e shërbimeve të qëndrueshme për MMN në të gjithë vendin, pakësimin dhe riciklimin e fraksioneve të mbetjeve, zvogëlimin e numrit të vend-depozitimeve të pakontrolluara dhe josanitare, si dhe mbrojtjen e mjedisit.

Veprimi plotëson objektivat e **Strategjisë Ndërsektoriale Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020** dhe Planit të Veprimit që janë shtyrë deri në 2022. Ai përfshin *nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm vendor,* ndër të tjera, përmes miratimit të *standardeve të reja për menaxhimin dhe administrimin e integruar të mbetjeve urbane përmes mekanizmave ekonomikë që nxisin ndarjen dhe grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim, si edhe promovimin e riciklimit të mbetjeve, si një përpjekje për të pakësuar landfillet dhe për të mundësuar djegien e tyre për qëllime të prodhimit të energjisë elektrike.* **Plani i Veprimit i përditësuar** përvijon masa që përmirësojnë si themelet financiare ashtu edhe performancën e pushtetit vendor. Plani parashikon ndërtimin e kapaciteteve dhe krijimin e kushteve/mjedisit mundësues për pushtetin vendor që të realizojë funksionet e veta. Gjithashtu, Veprimi mbështet përpjekjet e nivelit vendor në këto fusha të Planit të Veprimit: Objektivi Strategjik C: Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor; C.1 Zbatimi efikas i funksioneve të veta bazuar në një kuadër ligjor të qartë dhe të harmonizuar; C 1.4 Rritja e cilësisë dhe eficiencës së shërbimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Veprimi është i harmonizuar me GAP III[20] të BE-së dhe me Strategjinë për Barazi Gjinore 2021-2023, konkretisht me objektivin e saj për nxitjen dhe mbështetjen e grave dhe të sipërmarrjes të të rinjve në zonat rurale dhe urbane, përfshirë dhe idetë novatore që synojnë drejt ekonomisë mjedisore dhe dixhitalizimit.

2.4. Relevanca dhe komplimentariteti me politikën e BE-së dhe asistencën e BE-së dhe donatorëve të tjerë

Veprimi u referohet objektivave strategjikë të Kuadrit Programues IPA III sipas Prioritetit Tematik 1 - Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike nën Dritaren 3 – Axhenda e Gjelbër dhe Ndërlidhja e Qëndrueshme Kuadri Programues IPA III përcakton përmirësimin e efiçencës së energjisë, rritjen e burimeve të energjisë së rinovueshme për të asistuar përfituesit në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe adresimin e çështjeve të tjera mjedisore si p.sh. shfrytëzimi efikas i burimeve, ndërprerja e ndotjes dhe përmirësimi i prodhimit të qëndrueshëm të lëndëve të para. Ekonomia qarkulluese pritet jo vetëm të kontribuojë në mbrojtjen e mjedisit, por edhe të mbështesë rritjen ekonomike, hapjen e vendeve të punës dhe shëndetin e qytetarëve, duke pasur kështu rëndësi makroekonomike.

Ky Veprim është në përputhje me objektivat e **Paktit të Gjelbër Evropian**[21] për kalimin drejt ekonomisë qarkulluese, si një mundësi për të zgjeruar aktivitetin ekonomik të qëndrueshëm dhe intensiv në hapjen e vendeve të punës. Ky Veprim do të përshpejtojë kalimin e industrisë drejt një modeli të qëndrueshëm të rritjes gjithëpërfshirëse. Planet e veprimit për ekonominë qarkulluese do të përfshijnë masa që nxisin bizneset të ofrojnë dhe t'i lejojnë konsumatorët që të zgjedhin produkte të ripërdorshme, të durueshme dhe të riparueshme.

Sipas **Strategjisë për Ballkanin Perëndimor,**[22] vendet IPA do të nxisin sipërmarrjen dhe novacionin, duke konsoliduar skemën që mbështet transferimin e teknologjisë dhe bizneset e reja (*startup)* në të gjithë rajonin, si dhe duhet të mbështetin përpjekjet që synojnë ekonominë qarkulluese, përpjekje këto që do të vihen në dispozicion nga Komisioni.

Plani Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor[23] i paraprin mbështetjes për sistemet rajonale të menaxhimit të integruar të mbetjeve që shkojnë dorë për dore me mbylljen e landfilleve të parregullta.

Ekonomia qarkulluese është një nga shtyllat e **Axhendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor**[24], që adreson prodhim të mbetjeve të riciklueshme dhe të qëndrueshme, si edhe shfrytëzim efikas të burimeve. Axhenda e Gjelbër përmban 7 Programe (*Flagship*) për Menaxhimin e Mbetjeve dhe Ujit. Axhenda e Gjelbër e pranon se menaxhimi i qëndrueshëm dhe i besueshëm i eliminimit të mbetjeve është thelbësor për mbrojtjen e mjedisit dhe për shëndetin e qytetarëve. Ato mund të kenë ndikim pozitiv te turizmi, shëndeti dhe mirëqenia.

Gjithashtu, Veprimi ecën në hapat e **Planit të Veprimit të Ekonomisë Qarkulluese për një Evropë më të pastër dhe më konkurruese**[25]**,** e cila thekson se *për vendet me perspektivë anëtarësimi në BE, fqinjët tanë më të afërt në Evropën jugore dhe lindore, ekonomitë në rritje dhe partnerët kyçë në mbarë botën, modelet e reja të qëndrueshme hapin mundësi*

[20] JOIN(2020) 17 final
[21] COM(2019) 640 final
[22] COM(2018) 65 final
[23] COM(2020) 641 final
[24] SWD(2020) 223 final
[25] COM(2020) 98 final

biznesi dhe punësimi, ndërkohë që forcohen lidhjet me aktorët ekonomikë evropiane. Për të mbështetur këtë zhvendosje globale drejt ekonomisë qarkulluese, Komisioni do të: ... vazhdojë të promovojë ekonominë qarkulluese në procesin e anëtarësimit me Ballkanin Perëndimor si dhe në kontekstin e dialogut të politikave në nivel dypalësh, shumëpalësh dhe rajonal, forumeve dhe marrëveshjeve mjedisore, si edhe në programet e asistencës së para-anëtarësimit, fqinjësisë, zhvillimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, përfshirë këtu Platformën Ndërkombëtare për Financa të Qëndrueshme".

Përfundimet e Këshillit të BE-së për **Procesin e Zgjerimit dhe Stabilizim-Asociimit** 2020[26] theksuan nevojën që "*të realizohet dhe të përfundohet procesi i ekzaminimit analitik të acquis të BE-së me vendin aspirant*".

Raporti i Komisionit Evropian 2021 për Shqipërinë[27] nënvizon se "*Shqipëria duhet të nxitë ekonominë qarkulluese dhe të incentivojë parandalimin, pakësimin dhe riciklimin e mbetjeve për të reduktuar landfillet. Zbatimi i legjislacionit për flukset e mbetjeve duhet të përshpejtohet. Roli ligjzbatues dhe kontrollues i institucioneve duhet të qartësohet dhe të forcohet, duke siguruar personel dhe buxhet të përshtatshëm. Rekomandimet e masterplanit të mbetjeve janë ndonjëherë në kundërshtim me legjislacionin e brendshëm dhe acquis të BE-së për mbetjet. Kjo duhet të rishikohet".*

Axhenda 2030 e BE-së e përcakton kalimin drejt ekonomisë qarkulluese si një mundësi të rëndësishme për të krijuar avantazhe konkurruese mbi baza të qëndrueshme. Ky kalim në Ekonominë Qarkulluese do të kërkojë dizenjo të reja materialesh dhe produktesh që ofrojnë mundësi në rritje për ripërdorim, riparim dhe riciklim të tyre.

Veprimi ka lidhje të forta me **Programin e Reformave Ekonomike 2020-2022,** konkretisht me masën 06 që thekson se *"...standardet e shërbimit në sektorin e turizmit dhe zhvillimi i turizmit nënkuptojnë një fluks më të madh turistësh... Për të zbutur ndikimet negative në mjedis, synohen një sërë masash si:... politikat zbatuese për minimizimin e ndotjes nga mbetjet urbane duke i ndarë ato në burim për riciklim, kompostim dhe depozitim; mbledhjen dhe largimin e mbetjeve urbane në landfille të përshtatshme, etj.".*

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2021-2023 e pranon që kuadri ligjor për menaxhimin e integruar të mbetjeve është i harmonizuar 54% me *acquis* të BE-së. Duhet të fillojë zbatimi i planit të ri të veprimit për menaxhimin e mbetjeve, përgatitur për të gjitha direktivat dhe rregulloret e BE-së, përfshirë transpozimin dhe zbatimin. Prioritetet janë rehabilitimi / mbyllja vendgrumbullimeve të parregullta në vend, përshpejtimi i ndarjes së flukseve të mbetjeve në burim, si edhe instrumentet ekonomike që nxisin riciklimin, ripërdorimin dhe që parandalojnë krijimin e mbetjeve.

2.5. Mësimet e nxjerra dhe lidhjet me asistencën financiare të mëparshme

Gjatë dekadës së fundit janë realizuar disa aktivitete me financime dhe asistencë teknike të donatorëve ndërkombëtare, përfshirë BE-në. Konstatimet dhe mësimet e nxjerra prej këtyre aktiviteteve mund të përmblidhen si vijon:

- Mungesa e kapacitete të personelit teknik është një pengesë madhore në nivel qendror dhe vendor. Qëndrueshmëria e nismave të forcimit të kapaciteteve ka qenë e ulët, për shkak të zëvendësimit të personelit pas ndryshimeve politike apo që largohen nga shërbimi publik.
- Programi i financuar nga SIDA "Mbështetje për negociatat e Shqipërisë në Kapitullin 27 - Mjedisi" (SANE27) analizoi se legjislacioni i brendshëm për menaxhimin e integruar të mbetjeve ka transpozuar 53.7% të *acquis* të BE0së (shtator 2019), me 60% të direktivave në fazat fillestare të zbatimit. Nismat e ardhshme duhet të fokusohen në zbatim. Kjo duhet parë bashkë me përgatitjet dhe zbatimin e PZDS-ve për të mbështetur negociatat e BE-së dhe planet e menaxhimit të mbetjeve për zonat (rajonet), si edhe me ngritjen e infrastrukturës së nevojshme të mbetjeve. Nevojitet edhe mbështetja e INSTAT-it në zhvillimin e sistemit statistikor për mjedisin.
- Bashkitë janë përgjegjëse për menaxhimin e objekteve bashkiake të trajtimit të mbetjeve, d.m.th., për landfillet dhe vendgrumbullimet. Për shkak mjetet financiare dhe teknike i kanë të kufizuara, nismat e ardhshme duhet të rrisin fondet për qeverisjen vendore dhe të lehtësojnë menaxhimin e landfilleve ekzistuese, përfshirë përmes partneriteteve publik-privat.
- Zonat rurale dhe malore janë pak ose aspak të mbuluara me shërbime të grumbullimit të mbetjeve, për shkak të distancave të gjata dhe sasive të vogla të mbetjeve. Deri në 60% e mbetjeve në këto zona është organike. Nismat e ardhshme duhet të përfshijnë planifikimin e menaxhimit të mbetjeve të biodegradueshme si dhe biokompostimin apo trajtime të tjera të ngjashme.
- Një projekt për menaxhimin e mbetjeve financuar nga GiZ konstatoi se masat duhet të përfshijnë të gjithë zinxhirin, nga prodhimi deri te përpunimi dhe eliminimi i mbetjeve, me fokus të veçantë te mbetjet organike të cilat përbëjnë më shumë se 50% të mbetjeve bashkiake. Ka potencial për të pakësuar ambalazhet, për të futur paketimin e kompostueshëm dhe bashkëpunimin rajonal.

[26] 7002/20 (https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-7002-2020-INIT/en/pdf)
[27] SWD(2021) 289 final

Programi i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta në qarkun e Korçës financuar nga KfW merret me mbetjet rajonale dhe urbane të 6 bashkive. Programi ka ndërtuar një landfill sanitar modern bashkë me stacionet shoqëruese të transferimit, në përputhje me kërkesat e BE-së. Programi ka mbështetur grumbullimin parësor, kompostimin dhe riciklimin, si dhe ka mbështetur shoqatën e Menaxhimit Rajonal të Mbetjeve Korçë.

3. PËRSHKRIMI I VEPRIMIT

3.1. Rezultatet e planifikuara dhe logjika e ndërhyrjes

Veprimi synon të kontribuojë në përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimin e ekonomisë qarkulluese dhe rritjes së qëndrueshme të gjelbër në Shqipëri. Veprimi do të arrijë gjashtë produkte që do të rezultojnë në arritjen e katër rezultateve. Aktivitetet synojnë të gjenerojnë ndikim pozitiv mjedisor në një sërë aspektesh, si:

- Reduktim të mbetjeve në vendgrumbullime. Devijimi i flukseve të mbetjeve nga vendgrumbullimet drejt riciklimit do të reduktojë ndotjen dhe kontaminimin e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësore. Sasi të vogla mbetjesh (kryesisht mbetje organike) në vendgrumbullime, do të rezultojnë në më pak gaze serrë të çliruar në atmosferë.
- Reduktim të mbetjeve në landfillet sanitare të sapokrijuara do të rezultojnë në më pak gaze serrë të çliruar.
- Reduktim të ndotjes së bregdetit të Shqipërisë dhe të fqinjëve me mbetje detare.
- Rritja e riciklimit të mbetjeve do të reduktojë nxjerrjen e lëndëve të para natyrale dhe rrjedhimisht do të reduktojë presionin mbi mjedisin dhe burimet natyrore të kufizuara.
- Ekodizenjot e produkteve të reja mund të rezultojnë në më pak shkarkime/çlirime në natyrë nga proceset prodhuese dhe përdorim të sasive më të vogla të lëndëve të para natyrale.

Rezultati 1 -Legjislacion mjedisor më i përafruar me *acquis* të BE-së dhe i zbatuar siç duhet, duke mundësuar vënien në zbatim të ekonomisë qarkulluese.

Produkti 1: Kuadri ligjor për menaxhimin e mbetjeve dhe EQ&RrGj përmirësohet në përputhje me *acquis* të BE-së dhe dokumentet e politikave

Asistencë teknike do të ofrohet për transpozimin e direktivave të BE-së për mbetjet, për hartimin e instrumenteve ligjore dhe për nxitjen e zbatimi. Do të përcaktohen përgjegjësitë mes autoriteteve kombëtare dhe vendore për të shmangur mbivendosjet dhe për të garantuar kompetenca të qartë. Dokumentet planifikuese si Planet e Zbatimit të Direktivave të Veçanta (PZDS) për zbatimin e kërkesave të BE-së për mbetjet do të përmirësojnë planifikimin, zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e mbetjeve, si edhe mbarëvajtjen e negociatave me BE-në Autoritetet do të mbështeten që të integrojnë kërkesat e Direktivës Kuadër për Mbetjet në Programin e Parandalimit të Mbetjeve, në partneritet me autoritetet vendore, operatorët ekonomikë dhe shoqërinë civile. Do të realizohet vlerësimi i gjenerimit të mbetjeve të rrezikshme, si dhe do të përgatitet një Studim Fizibiliteti për Menaxhimin e Mbetjeve të Rrezikshme si dhe një Plan Menaxhimi për Mbetjet e Rrezikshme. Ky studim fizibiliteti do të identifikojë fondet që duhen dhe trajtimin sipas llojit të mbetjes së rrezikshme. Kapacitetet do të forcohen në hartimin e politikave, legjislacionit dhe një Udhërrëfyesi për Ekonominë Qarkulluese në përgjigje të Planit të Veprimit të BE-së për Ekonominë Qarkulluese, i cili do të përmbajë masa të integruara me politikat dhe programet sektoriale. Udhërrëfyesi duhet të përmbajë masa me perspektivë gjinore që mbulojnë politikat për Prodhimin, Konsumin, Prokurimin e Gjelbër, instrumentet ekonomike për menaxhimin e mbetjeve, lëndët e para dytësore, masa sektoriale (plastika, mbetjet ushqimore, lëndët e para kritike, ndërtimi dhe demolimi, biomasa dhe materialet me bazë bio), Rritjen e Gjelbër, Novacionin dhe Investimet. Veprimi do të mbështesë hartimin/përshtatjen e masave legjislative për mbledhjen, monitorimin dhe raportimin e të dhënave, duke reflektuar analizën gjinore sektoriale që përmban Udhërrëfyesi për Ekonominë Qarkulluese si edhe arritjen e objektivave strategjikë dhe të politikave.

Produkti 2: Forcohen kapacitetet institucionale në të gjitha nivelet për menaxhimin e mbetjeve dhe mbledhjen e monitorimin e të dhënave për EQ&RrGj dhe zbatimin

Ky aktivitet do të mbështesë forcimin e kapaciteteve të autoriteteve përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve në nivel qendror dhe vendor, si dhe do t'i pajisë me mjete dhe procese për zbatimin, monitorimin dhe ekzekutimin e legjislacionit për menaxhimin e mbetjeve, të politikave EQ&RrGj dhe në veçanti të Planit të Parandalimit të Mbetjeve dhe Udhërrëfyesit për Ekonominë Qarkulluese dhe Rritjen e Gjelbër. Në nivel qendror, një sërë palësh të interesuara do të kenë nevojë për mbështetje, sidomos MTE me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM), si dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me Agjencinë Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM) dhe INSTAT. Po kështu, do të realizohet një vlerësim nevojash për trajnim dhe zhvillim kapacitetesh. Specifikimet teknike do të përgatiten për pajisjet e teknologjisë së informacionit që duhen për mbledhjen

e të dhënave dhe raportimit për mbetjet, përmes një platforme dixhitale që shërben si sistem i integruar për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave për mbetjet. Sistemi do të gjenerojë të dhënat statistikore që Shqipëria duhet të raportojë pranë Agjencisë Evropiane të Mjedisit; do të projektohet që të mundësojë hedhjen e të dhënave nga disa përdorues si dhe funksione raportimi për bashkitë, këshillat rajonale, prodhuesit e mbetjeve, prodhuesit nën sistemin PZP, ministritë përgjegjëse për infrastrukturën, etj. Platforma dixhitale duhet të adresojë mungesën e të dhënave për mbetjet dhe flukset e tyre, si edhe të përmbushë objektivat për riciklimin dhe ekonominë qarkulluese. Në nivel vendor, fokusi do të jetë te matja e mbetjeve bashkiake që gjenerohet dhe grumbullohen Aktiviteti do të përzgjedhë bashki pilot, si dhe do të standardizojë procesin e gjenerimit të statistikave të nevojshme si dhe përdorimin e tyre për të populluar platformën dixhitale. AKM, AKUM dhe bashkitë e përzgjedhura do të përfitojnë asistencë në vendin e punës, që të zhvillojnë kapacitetet për gjenerimin e të dhënave për mbetjet, menaxhimin e mbetjeve, ekzekutimin e ligjit, monitorimin, raportimin, si edhe vënien e këtyre statistikave në dispozicion të publikut dhe palëve të tjera të interesuara.

Rezultati 2 -Ngrihet sistemi i Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit (PZP) për flukse të veçanta mbetjesh.

Produkti 1: Përgatitet dhe zbatohet kuadri ligjor për zbatimin e skemave PZP për të paktën tri flukse të veçanta mbetjesh

Hartimi dhe zbatimi i kuadrit ligjor për skemat PZP do të mundësojë zbatimin e detyrimit të prodhuesve që gjenerojnë mbetje pas konsumit, që të kenë detyrimin shtesë të kujdesit për fazën pas konsumit të produkteve të tyre. Do të krijohet kuadri rregullator dhe mjedisi financiar që shtyjnë drejt modeleve të qëndrueshme të prodhimit dhe konsumit për të paktën tri flukse të veçanta mbetjesh. Gjithashtu, do të garantohet pjesëmarrja e grave dhe vajzave në procesin e krijimit të kuadrit rregullator, në konsultimet publike dhe në vendimmarrje. Instrumente financiare do të zhvillohen për të mbështetur zbatimin e sistemit PZP dhe ndarjen e riciklimin e flukseve të veçanta të mbetjeve. Këtu do të përfshihen së paku tri flukse mbetjesh: ambalazhimi, mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike (MPEE) dhe bateritë e akumulatorët. Prodhuesve do t'u vihen detyrime të qarta, por pa rrezikuar tregun. Të ardhurat e gjeneruara nga instrumentet financuare duhet të përdoren për të mbështetur ekonominë qarkulluese. Zbatimi do të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat dhe prodhuesit, për të identifikuar pengesat për zbatimin. Mbështetje teknike do të ofrohet në përgatitjen e akteve të nevojshme ligjore, procedurave, modeleve dhe udhëzimeve për plotësimin e kuadrit ligjor PZP që do të mbështesë krijimin e Organizatës së Përgjegjësisë së Prodhuesit (OPP). Gjithashtu, duhet të hartohet legjislacioni për bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të ndryshme (inspektorati i mbikëqyrjes së tregut, autoriteti i të ardhurave publike, inspektorati i mjedisit) dhe raportimi i aktiviteteve të tyre. OPP-të do të ndihmohen në ofrimin e mbështetjes teknike, orientimeve, mbështetjes ligjore dhe organizative, mbledhjes së të dhënave dhe mbështetjes raportuese për të përmbushur detyrimet e tyre ligjore në lidhje me PZP-në. Palët e tjera të interesuara, si tregtarët, do të mbështeten në detyrimet dhe rolin e tyre brenda sistemit PZP dhe në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për objektivat dhe pjesëmarrjen në PZP.

Rezultati 3 – Përmirësohet efikasiteti i burimeve, ekodizenjot dhe ekologjia e prodhimit në biznese dhe zinxhirë furnizimi gjithnjë e më "rigjenerues".

Produkti 1: Mbështetje për bizneset, OJF-të dhe kapacitetet kërkimore në vend, që të zhvillojnë produkte, shërbime dhe modele biznesi qarkullues janë novatore, të gjelbra dhe me perspektivë gjinore.

Palët e treta, si sektori privat, organizatat e përgjegjësisë së prodhuesit, organizatat e shoqërisë civile mjedisore, bizneset sociale, universitetet dhe qeverisja vendore do të mbështeten në veprimet për të lehtësuar dhe për të promovuar ekonominë qarkulluese dhe rritjen e gjelbër. Universitetet, studiuesit, OSHC-të dhe industria do të bashkohen përmes ofruesve të mbështetjes së inovacionit. Synimi është të mbështeten bizneset e reja dhe ekodizenjimi përmes një skeme me nën-grante e cila do të shkëputë rritjen ekonomike nga nxjerrja intensive e materialit natyror dhe nga presioni mjedisor, si dhe do të stimulojë zhvillimin e vendeve të punës të gjelbra. Mbështetja mund të variojë nga asistenca dhe ngritja e kapaciteteve, deri te grantet për veprime që mund të përfshijnë investime në infrastrukturë dhe novacion. Zbatimi i legjislacionit të ri do të mbështetet. Mbështetja mbulon edhe përmirësimin e kuadrit të politikave për klimën e sipërmarrjes dhe investimeve, me qëllim që të mbështeten bizneset "qarkulluese" dhe zhvillimi i zinxhirëve të furnizimit/sektorit privat, si dhe zbatimi i skemave PZP, objekteve të veçanta të grumbullimit të mbetjeve dhe kantiere riciklimi për flukse të veçanta mbetjesh. MTE do të ketë një rol kyç në ofrimin e mbështetjes për përfituesit e mundshëm të granteve dhe në promovimin e modeleve të biznesit qarkullues. Programi do të vlerësojë alternativat për ta bërë këtë skemë financimi të qëndrueshme dhe të ngulitur në sistemin kombëtar, si dhe do të propozojë ndryshime politikash

Më poshtë jepet lista e llojeve të aktiviteteve që mund të mbështeten, por ajo nuk është shteruese:

- Zhvillimi i qendrave të ripërdorimit, riparimit dhe riciklimit të ngjashëm me ato në BE;
- Platformat e ekonovacionit/ekodizajnit, bizneset e reja të gjelbra në hapat e parë që promovojnë novacione ekologjike dhe sociale si dhe iniciativa të ngjashme me Inkubatorin e Gjelbër;

- Modele të reja biznesi, veçanërisht ato që ofrojnë masa konkrete për të nxitur ripërdorimin dhe stimulimin e simbiozës industriale (duke kthyer nënproduktin e një industrie në lëndë të parë për një industrie tjetër), skemat PZP;
- Zhvillimi i produkteve të biodegradueshme, të cilat do të zëvendësojnë plastikën aktuale njëpërdorimëshe;
- Ekologjia e produkteve dhe sistemeve të prodhimit, përfshirë mbështetjen për skemat e rikuperimit dhe riciklimit;
- Zgjidhje novatore që ulin konsumin dhe shkarkimet e lëndëve djegëse, mundësojnë riciklimin e mbetjeve bio dhe mbetjeve ushqimore, përmirësojnë paketimin me ambalazhe të biodegradueshme ose më të riciklueshme, adresojnë ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve të ngurta të demolimit dhe ndërtimit, novacionin në termoizolim dhe kursimin e energjisë, etj.

Produkti 2: Rritet komunikimi, ndërgjegjësimi dhe angazhimi i komuniteteve dhe sektorit privat në ekonominë e gjelbër dhe menaxhimin rajonal të mbetjeve
Veprimi e pranon rëndësinë e rritjes së ndërgjegjësimit dhe nxitjen e pjesëmarrjes së konsumatorit në parandalimin e mbetjeve, ekonominë qarkulluese dhe rritjen e gjelbër. Një fushatë gjithëpërfshirëse dhe me perspektivë gjinore do të zhvillohet për të nxitur konsumatorët të bëjnë blerje më të mirinformuara dhe të përdorin produkte të ripërdorshme, të qëndrueshme dhe të riparueshme, duke luajtur kështu një rol më aktiv në tranzicionin ekologjik. Për të informuar këtë fushatë dhe takimet konsultative, do të bëhet një anketë mbi njohuritë, perceptimin dhe aspiratat e popullatës në lidhje me EQ&RrGj. Do të studiohet roli i grave, burrave dhe fëmijëve në lidhje me mbetjet shtëpiake, gatishmëria dhe vullneti për të marrë pjesë në aktivitetet e riciklimit dhe për të mbuluar kostot për menaxhimin e integruar të mbetjeve, si dhe aspekte të tjera të EQ&RrGj. Fushatat do të zhvillohen si në nivel kombëtar edhe vendor, të përshtatura sipas kontekstit vendor dhe grupeve të synuara. Fushatat për publikun e gjerë do të përfshijnë p.sh. stenda dhe transmetimet televizive. Do të shfrytëzohen kanalet e mediave sociale që përfshihen drejtpërdrejtë në aktivitetet e gjelbra, ato që kanë audiencën ose mbulimin më të madh në nivelin vendor të synuar. Do të shihet mundësia e ndërgjegjësimit për legjislacionin dhe sanksionet për krimit mjedisor. Fuqizimi i shoqërisë civile në EQ&RrGj mund të përfshijë futjen e temave në kurrikulat shkollore dhe në modulet e departamenteve teknike të politeknikës dhe fakulteteve universitare të lidhura me bujqësinë / mjedisin.

Rezultati 4 - Rriten kapacitetet infrastrukturore që mbështesin EQ&RrGj, efikasitetin e burimeve, riciklimin dhe ripërdorimin në nivel zone (rajonal).

Produkti 1: Sistemet e menaxhimit (rajonal) të mbetjeve dhe objektet infrastrukturore mbështeten që të funksionojnë në përputhje të plotë me ekonominë qarkulluese
Ky aktivitet do të mbështesë zbatimin e modeleve për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta bashkiake në zonat e mbetjeve Kukës dhe Gjirokastër-Vlorë jug, pas studimit të fizibilitetit për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta që përfshin 15 bashki në Shqipëri. Aktiviteti do të demonstrojë një shembull për bashkitë e tjera në drejtim të EQ&RrGj. Do të prezantohen ekspertiza dhe praktikat më të ira që ndjekin vendet e BE-së. Infrastruktura e dizajnit dhe zbatimi do të mbështeten për të ecur drejt riciklimit dhe ripërdorimit më të lartë, duke krijuar vende pune të gjelbra teksa ulet presioni mbi mjedisin dhe klimën. Do të mbështetet realizimi i dizenjove, dokumenteve të tenderit, prokurimit për objektet rajonale të trajtimit të mbetjeve dhe stacionet e transferimit. Edhe krijimi i kompanive ndërbashkiake për menaxhimin e mbetjeve do të mbështetet. Mbështetje do të jepet edhe për integrimin e ekonomisë qarkulluese në skemat e prokurimit publik dhe në financimet për investime në realizimin e objektive të trajtimit dhe stacioneve të transferimit për aktivitetet rajonale të sistemeve të integruara të menaxhimit të mbetjeve të ngurta në zonën e mbetjeve Kukës dhe Gjirokastër-Vlorë jug. Qëllimi është që të zhvendoset fokusi nga këndvështrimi i menaxhimit të mbetjeve te këndvështrimi i industrisë / biznesit, që këto të fundit t'i shohin mbetjet si material për t'u ri-injektuar në prodhim (bizneset prodhuese, industria e riciklimit, turizmi, bujqësia, hoteleria dhe palët përkatëse të interesit). Meqë shumica e mbetjeve në këto zona janë organike, prioritet do të jetë kompostimi për bujqësinë. Veprimi do të mbështesë edhe mbylljen dhe rehabilitimin e landfilleve/vendgrumbullimeve të parregullta. Në këto dy zona mbetjesh do të zhvillohen fushata publike dhe ndërgjegjësimi. Ekonomitë qarkulluese mund të krijojnë mundësi ekonomike për gratë në riciklimin dhe menaxhimin e mbetjeve, ndërkohë që ndihmojnë në trajtimin e rreziqeve që vijnë nga mbledhja dhe riciklimi manual i mbetjeve. Shfrytëzimi i këtyre mundësive kërkon që të konsiderohet perspektiva gjinore në hartimin e strategjive dhe masave kombëtare dhe vendore për ekonominë qarkulluese, si dhe të nismave në nivel biznesi. Do të promovohet bashkëpunimi ndërmjet OSHC-ve, bizneseve sociale, OPP-ve, ndërmarrjeve private dhe universiteteve me kompanitë e menaxhimit rajonal të mbetjeve bashkiake dhe qeverisjen vendore.

3.2. Aktivitetet indikative
Veprimi do të mbështesë arritjen e **Produkteve 1** dhe **2 (lidhur me Rezultatin 1)** dhe **Produktit 1 (lidhur me Rezultatin 2)** me aktivitete të **asistencës teknike** që do të mbulojë si vijon:

- Mbështetje për hartimin e Ligjit për Menaxhimin e Mbetjeve në përputhje me direktivat e BE-së, konkretisht me Direktivën Kuadër të Mbetjeve (DKM), Direktivën e Landfilleve (DL), si dhe Rregulloren për Transportin e Mbetjeve me Anije dhe Riciklimin e Mbetjeve në Anije.
- Hartimi ose përditësimi i Planeve të Zbatimit të Direktivave Specifike (PZDS) për DKM-në dhe LD-në, si edhe direktivat për flukset e veçanta të mbetjeve lidhur me Paketimin, MPEE dhe Bateritë e Akumulatorët.
- Hartimi i një programi për parandalimin e mbetjeve, të përafruar me standardet e DKM-së, i një Udhërrëfyesi për ekonominë qarkulluese dhe rritjen e gjelbër, si dhe i një plani për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme (MPMRr) me një studim fizibiliteti dhe analizë sektoriale gjinore.
- Ngritje kapacitetesh të autoriteteve të menaxhimit të mbetjeve mbi zbatimin e legjislacionit për ekonominë qarkulluese dhe rritjen e gjelbër (EQ&RrGj) dhe menaxhimin e mbetjeve, mbi mbledhjen dhe grumbullimin e të dhënave të ndjeshme gjinore, si edhe ekzekutimin e legjislacionit.
- Përgatitja e karakteristikave dhe specifikimeve teknike për pajisjet TI dhe të tjera, softueri dhe hardueri për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave mbi mbetjet në përputhje me kërkesat e *acquis* të BE-së për mbetjet. D të krijohet një platformë dixhitale si në sistem i integruar për mbledhjen e të dhënave për mbetjet si dhe për përmbushjen e detyrimeve raportuese të AKM-së.
- Hartimi i ligjeve dhe akteve nënligjore për flukset e veçanta të mbetjeve, që do të jenë në përputhje të plotë me direktivat e BE-së, të paktën për paketimin, MPEE, bateritë dhe akumulatorët) dhe përdorimi i përqasjes me ndjeshmëri gjinore e cila bazohet në analizën gjinore.
- Futja e instrumenteve ekonomikë për të mbështetur reduktimin, ndarjen dhe riciklimin e mbetjeve, si edhe mbështetja e zbatimit të skemës PZP në kuadrin e organizatave të përgjegjësisë së prodhuesit (OPP) dhe palëve të tjera në lidhje me detyrimet PZP për të paktën tri flukse mbetjesh.
- Transpozimi i direktivave kryesore të BE-ë për mbetjet si dhe hartimi i instrumenteve ligjore për zbatimin e tyre.

Rezultati 1 dhe Rezultati 2 përfshijnë furnizimin e pajisjeve TI dhe dixhitale të nevojshme për mbledhjen e të dhënave për mbetjet, si edhe zhvillimin e një platforme dixhitale për hedhjen, qarkullimin dhe raportimin e të dhënave mbi mbetjet (softueri dhe hardueri)

Mbështetja për bizneset, OJF-të dhe kapacitetet kërkimore në Shqipëri për të zhvilluar produkte e shërbime novatore dhe të gjelbra si dhe modele biznesi qarkulluese siç parashikohet në **Produktin 1 (lidhur me Rezultatin 3)** parashikon ngritjen e një **skeme grant** për të mbështetur zbatimin e aktiviteteve pilot, kryesisht nga palët joshtetërore në Shqipëri, në ekonominë qarkulluese dhe rritjen e gjelbër, efikasitetin e burimeve, ripërdorimin / riciklimin, ekodizajnin, etj. Këto aktivitete do të mbështesin palë të treta si: sektori privat, organizatat e përgjegjësisë së prodhuesit, organizatat mjedisore të shoqërisë civile, bizneset sociale, universitetet dhe autoritetet vendore në zbatimin e masave që lehtësojnë dhe promovojnë ekonominë qarkulluese dhe rritjen e gjelbër.

Rritja e komunikimit, ndërgjegjësimit dhe angazhimit të komuniteteve dhe sektorit privat në ekonominë qarkulluese dhe rritjen e gjelbër, të cilat do të arrihen në kuadrin e **Produktit 2 (lidhur me Rezultatin 3),** do të zbatohet përmes organizimit të fushatave informuese mbi ekonominë qarkulluese dhe rritjen e gjelbër në Shqipëri, si dhe përmes mbështetjes për zbatimin e infrastrukturës së re, duke kontribuar kështu në arritjen e objektivave kryesorë të ekonomisë qarkulluese dhe kontributin e saj në menaxhimin e mbetjeve dhe në shoqëri në tërësi.

Aktivitetet lidhur me rritjen e kapaciteteve infrastrukturore që mbështesin EQ&RrGj, efikasitetin e burimeve, riciklimin dhe ripërdorimin **(Produkti 1 lidhur me Rezultatin 4)** mund të përfshijnë asistencë teknike që mbështet bashkitë dhe ndërmarrjet e ujësjellësit të tyre në menaxhimin e infrastrukturës së re, investimet në punime dhe furnizime, mbikëqyrje, etj. Veprimi do të krijojë shembullin për bashkitë e tjera se si të ecin drejt EQ&RrGj.

3.3. Risqet dhe supozimet

Risqet	Niveli i Riskut (L/M/U)	Masat zbutëse
Lidhje e dobët mes objektivave të politikave dhe alokimeve financiare për zbatimin e planit kombëtar për MMN, përfshirë alokimet buxhetore për Bashkitë që të përmbushin funksionet e tyre ligjore në fushën e menaxhimit të mbetjeve.	L	Veprimi, përmes asistencës teknike, instrumenteve financuese PZP dhe granteve, do të zbutë disa risqe që paraqesin mandatet e nënfinancuara. Ky risk do të zbutet edhe me harmonizimin mes politikave, planifikimit dhe buxhetimit vjetor / shumëvjeçar.
Koordinimi i dobët sektorial mund të pengojë progresin, sepse zbatimi i disa aktiviteteve bazohet në koordinimin ndërinstitucional mes	L	Mbështetja për MTE-në (si kryesuese e KDS-së për Mjedisin, Klimën dhe Menaxhimin e Mbetjeve) në kuadrin e këtij Veprimi do të forcojë fokusin te

Risqet	Niveli i Riskut (L/M/U)	Masat zbutëse
MIE (përgjegjëse për infrastrukturën) dhe MTE (përgjegjëse për planifikimin) dhe bashkive (pronare të objekteve).		ekonomia qarkulluese, menaxhimi i integruar i mbetjeve, rritja e gjelbër, politikat, planifikimi dhe buxhetimi në mbarë sektorin. Grupi i koordinimit të projektit do të garantojë dialogun mbi politikat dhe menaxhimin e njohurive ndërmjet nivelit qendror dhe atij rajonal/vendor.
Angazhimi dhe përfshirja i kufizuar i komuniteteve vendore.	M	Do të hartohet një plan angazhimi të palëve të interesuara për të garantuar angazhimin dhe përfshirjen. Përmes komunikimit të shënjestruar, Veprimi do të angazhojë aktivisht komunitetet vendore gjatë zbatimit.
Mungesa e përkushtimit, mbështetjes politike dhe 'pronësisë' së veprimeve që çojnë përpara axhendën e ekonomisë qarkulluese.	M	Dialog i vazhdueshëm politik dhe mbi politikat në kontekstin e mbështetjes së BE-së për zbatimin e planit kombëtar për MMN, në kuadrin e negociatave për anëtarësim. Veprimi është përgatitur në konsultim shumë të ngushtë dhe të hollësishëm me përfaqësuesit e bashkive, shoqërisë civile dhe partnerëve për zhvillim, me qëllim që prioritetet të identifikohen bashkërisht dhe rezultatet realiste të përcaktohen me konsensus.
Përfshirje dhe kapacitete novacioni të kufizuara të NVM-ve që të angazhohen në vënien në funksion të skemave PZP dhe modifikimin e ciklit prodhues drejt produkteve të gjelbra. **Bashkëpunim i kufizuar** mes qendrave kërkimore e universiteteve dhe industrisë, si dhe niveli i ulët i investimeve në novacion.	M	Veprimi do të sjellë bashkë bizneset me universitetet, studiuesit dhe OSHC-të, që t'i mbështesë përmes skemës grant me mekanizma mbështetës drejt novacionit. Do të ketë aktivitete ndërgjegjësimi për të kuptuar më mirë përfitimet që sjell zbatimi i ekonomisë qarkulluese dhe prodhimi i gjelbër.
Kapacitetet përthithëse të kufizuara, mungesa e burimeve njerëzore për të realizuar proceset teknike dhe organizative, si dhe lëvizjet / largimet e shpeshta të personelit mund të pengojnë ndikimin e masave të forcimit të kapaciteteve.	M	Që në fillim do të rekomandohet caktimi i përfaqësuesve alternativë për të garantuar vijimësinë. Udhëzime teknike do të hartohen në anglisht dhe shqip për të orientuar personelin e ri që përfshihet.
Kapacitetet e kufizuara në bashkitë e vogla dhe të mesme apo OSHC-të në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve.	M	Mbështetja përmes forcimit (aktual dhe shtesë që do të propozohet) të kapaciteteve do të zbusë këtë risk. Asistenca teknike do të ofrojë mbështetje për forcimin e kapaciteteve dhe masat e tjera të partnerëve për zhvillim do të zbusin më tej këtë risk.
Kontratat e koncesionit për inceneratorët përcaktojnë një sasi minimale të garantuar të mbetjeve për trajtim, gjë që e bën **të vështirë dhe të kushtueshëm përafrimin me *acquis* të BE-së për menaxhimin e mbetjeve, sidomos me objektivat e riciklimit të materialit,** si edhe promovimin e krijimit të vendeve të punës të gjelbra dhe rritjen ekonomike të gjelbër.	M	Dialog i vazhdueshëm politik / mbi politikat në kuadrin e negociatave për anëtarësim të BE-së.
Supozimet		
Rezultati 1 • Qeveria e Shqipërisë ruan përkushtimin ndaj transpozimit dhe zbatimit të *acquis* të BE-së për mbetjet dhe aktivitetet e ekonomisë qarkulluese. Produkti 1: • MTE përkushtohet në rishikimin dhe përgatitjen e legjislacionit të ri për menaxhimin e mbetjeve në përputhje me *acquis* për mbetjet. • Institucionet në të gjitha nivelet janë të gatshme të bashkëpunojnë në hartimin e masave për zbatimin e legjislacionit për EQ dhe menaxhimin e mbetjeve.		

Risqet	Niveli i Riskut (L/M/U)	Masat zbutëse
Produkti 2: • Administrata qendrore dhe vendore është e përkushtuar që të marrë pjesë në trajnime dhe forcim kapacitetesh. • AKM dhe agjenci të tjera i kushtojnë kohë dhe personel të mjaftueshëm menaxhimit të fluksit të ri të të dhënave. • Institucionet e të gjitha niveleve janë të gatshme të bashkëpunojnë në zbatimin e sistemeve të monitorimit dhe zbatimit. • Qeveria e Shqipërisë është e përkushtuar që të mbështetë zbatimin e Udhërrëfyesit me masa mbështetëse për EQ&RRGJ, sapo të hartohet. • Qeveria është plotësisht e përkushtuar që të zbatojë rekomandimet për përmirësimin e kapaciteteve institucionale dhe të japë alokime buxhetore adekuate. • Bashkitë bashkëpunojnë me autoritetet kombëtare dhe janë të përkushtuara në mbledhjen dhe ofrimin e të dhënave mbi krijimin e mbetjeve. **Rezultati 2:** Industria dhe qeverisja vendore janë mbështetës dhe të gatshëm që të kontribuojnë në ekonominë qarkulluese dhe PZP. Produkti 1: • Operatorët ekonomikë janë të ndërgjegjshëm dhe të përkushtuar që të marrin përsipër përgjegjësitë si prodhues të mbetjeve që iu përkasin flukseve të veçanta. • Autoritetet kryesore kombëtare dhe vendore i kushtojnë kohën dhe perosnelin e mjaftueshëm, në të gjitha nivelet, pjesëmarrjes në ngritjen e PZP-së. • MTE dhe AKM i kushtojnë kohën dhe personelin e mjaftueshëm monitorimit të fluksit të ri të të dhënave nga OPP. **Rezultati 3:** • Qeveria mbështet dhe zbaton masat për incentivimin e ekonomisë qarkulluese dhe produkteve e shërbimeve të gjelbra. • Sektori privat është gati të zbatojë EQ. • Statistikat e vendeve të punës për Industrinë e Riciklimit dhe Të Gjelbër janë të disponueshme, të besueshme dhe me ndjeshmëri gjinore. Produkti 1: • Qeveria mbështet dhe zbatim masat për incentivimin e ekonomisë qarkulluese dhe produkteve e shërbimeve të gjelbra. • Bizneset, OJF-të dhe kapacitetet kërkimore, OPP-të janë të gatshme të angazhohen në zbatimin e aktiviteteve që mbështesin EQ&RrGj. • MTE është plotësisht e përkushtuar që të mbështesë zbatimin e EQ&RrGj dhe t'u japë mbështetje administrative adekuate përfituesve të skemës grant. Produkti 2: • Gratë dhe burrat, djemtë dhe vajzat pa dallim kanë akses ose ekspozohen ndaj mesazheve dhe objektivave të fushatës. • MTE dhe autoritetet e tjera në nivel kombëtar dhe vendor janë plotësisht të përkushtuar që të marrin pjesë aktivisht dhe të ofrojnë të dhëna që mbështesin zbatimin e fushatës së ndërgjegjësimit. • Bashkitë në rajone (zona) janë të përkushtuara dhe mbështesin aktivisht zbatimin e fushatës. **Rezultati 4:** Sipërmarrësit privatë Sipërmarrësit privatë tregojnë interes në shfrytëzimin e materialeve dytësore për të krijuar ide biznesi fitimprurëse. Produkti 1: • Ekziston bashkëfinancimi kombëtar për investimet dhe mirëmbajtjen në menaxhimin e mbetjeve, që kërkohet në zonat e mbetjeve zonat e mbetjeve Kukës dhe Gjirokastër-Vlora jug, për të plotësuar fondet e BE-së. • Qeveria është plotësisht e përkushtuar që të zbatojë studimet e fizibilitetit dhe hartimin e projekteve për ngritjen e infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve në nivel rajonal. • Bashkitë në rajone (zona) janë të përkushtuara që të bashkëpunojnë dhe të marrin pjesë me sukses në menaxhimin e mbetjeve në nivel rajonal.		

3.4. Harmonizimi me sektorë të tjerë

Integrimi gjinor dhe mundësitë e barabarta. Ky Veprim do të mbështesë përgatitjen dhe zbatimin e reformës sektoriale. Integrimi sistematik i optikës gjinore në arkitekturën e ekonomisë qarkulluese – duke kuptuar sjelljet e konsumatorit, reflektimin e mësimeve të nxjerra nga praktikat e qëndrueshme tradicionale ku gratë janë shpesh ato që posedojnë njohuritë, si edhe shfrytëzimi i zinxhirëve të vlerës vendore për qëndrueshmëri – do të garantojnë kalim në EQ për të gjithë, si dhe do të shërbejnë si bazë për ta bërë paradigmën ekonomike operacionale dhe të qëndrueshme. Shënjestrimi i roleve gjinore dhe preferencave të sjelljes në konsum dhe krijim e parandalim mbetjesh, mund të jenë thelbësore për të adresuar disa pabarazi gjinore duke njohur vlerën e vendeve të punës që mbështesin ekonomitë qarkulluese siç referohen në OZhQ 12 dhe OZhQ 15. Veprimi do të përfshijë një analizë gjinore sektoriale që do të shërbejë si bazë për të integruar perspektivën gjinore në masat e planifikuara si p.sh. legjislacioni, aktivitetet, instrumentet ekonomike, fushatat promovuese, politikat, vlerësimet dhe ndarja e të dhënave sipas gjinisë, kur është e mundur. Menaxhimi i duhur i mbetjeve, sidomos parandalimi dhe ndarja e tyre për riciklim, kërkon përfshirjen e të gjithë qytetarëve. Nuk është e qartë se si burrat dhe gratë preken në mënyrë të pabarabartë në këtë sektori, por sipas studimeve parapake, gratë, burrat dhe fëmijët demonstrojnë qëndrime, kuptueshmëri dhe sjellje të ndryshme ndaj menaxhimit dhe riciklimit të mbetjeve. Analiza gjinore do të shtjellojë më tej disa prej këtyre pikëpyetjeve në kontekstin shqiptar, për të garantuar që sistemet e menaxhimit të mbetjeve dhe fushatat informuese të përgatiten siç duhet, si dhe që informacioni të arrijë te burrat, gratë dhe fëmijët në mënyrë efikase.

Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike. Aktivitetet kanë të bëjnë kryesisht me këto direktiva: i) Mbetjet (ndryshuar nga Direktiva 2008/98/KE; ii) Landfillet e mbetjeve (ndryshuar nga Direktiva 1999/31/KE); iii) Paketimi dhe mbetjet e ambalazhit (ndryshuar nga Direktiva 94/62/KE); iv) Automjetet në fundin e ciklit të jetës (ndryshuar nga Direktiva 2000/53/KE); v) Bateritë dhe akumulatorët dhe mbetjet e tyre (ndryshuar nga Direktiva 2006/66/KE); vi) Mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike, MPEE (ndryshuar nga Direktiva 2012/19/BE); vii) Mbetjet e rrezikshme (Direktiva 91/689/KEE; viii) Eliminimi i vajrave të përdorur (Direktiva 75/439/KEE).

Gazet serrë çlirohen nga shumë operacione të menaxhimit të mbetjeve, sidomos nga vendgrumbullimet e mbetjeve, landfillet dhe incenerimi. Aktivitetet do të ndihmojnë për të zhvendosur mbetjet sa më lart në hierarkinë e menaxhimit të tyre, ku çlirimi i gazeve serrë është në përgjithësi më i ulët. Aktivitetet që do të ndikojnë indirekt në *acquis* mjedisore të BE-së kanë të bëjnë me forcimin e kapaciteteve, hartimin e legjislacionit, instrumentet financiare dhe përgatitjen e planeve, programeve dhe strategjive. Ndikimi mjedisor përfundimtar do të varet nga alternativat që gjenden ndaj vendgrumbullimeve dhe landfilleve. Do të promovohet fokusi te parandalimi i hershëm i mbetjeve, në trajtën e modeleve "qarkulluese" të biznesit, përfshirë shërbimet e riparimit, ripërdorimin, rifabrikimin dhe riciklimin. Vlerësimet e Ciklit të Jetës (VCJ) duhet të bëhen për të përcaktuar alternativën për trajtimin dhe rikuperimin e mbetjeve, e cila ka ndikimin më pak negative ose më pozitiv në mjedis. Planet zhvillimore për menaxhimin e integruar të mbetjeve, ekonominë qarkulluese dhe rritjen e gjelbër do të kërkojnë përgatitjen e Vlerësimeve Strategjike Mjedisore (VSM). Duhen bërë edhe Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis (VNM) përpara ndërtimit të impianteve më të mëdha, në përputhje me legjislacionin e brendshëm në fuqi.

Angazhimi me Shoqërinë Civile. Proceset e konsultimit dhe komunikimit me shoqërinë civile dhe publikun janë thelbësore për ngritjen dhe forcimin e ekonomisë qarkulluese dhe rritjes së gjelbër. Përfaqësuesit e shoqërisë civile që përfshijnë organizatat për të drejtat e grave, romëve dhe fëmijëve, janë interlokutorë kyçë në nxitjen dhe mobilizimin e komunitetit dhe institucioneve vendore drejt masave të ekonomisë qarkulluese rritjes së gjelbër. Kështu, ato janë konsultuar gjatë përgatitjes së këtij Veprimi. Parashikohen aktivitete për angazhimin e autoriteteve dhe komuniteteve vendore dhe ndërgjegjësimin; këto aktivitete shënjestrojnë ose kanë lidhe me organizatat e shoqërisë civile.

Pakicat dhe grupet vulnerabël. Mbledhja e materialeve të ricklueshme bëhet në një masë të madhe nga grupet vulnerabël dhe pakicat. Vlerësohet rreth 12 000 individë, kryesisht nga komuniteti rom, e nxjerrin jetesën nga shitja e materialeve të ricklueshme të cilat i mbledhin nga kontejnerët publikë, bizneset dhe burime të tjera potenciale. Institucionalizimi dhe zgjerimi i aktiviteteve të riciklimit paraqet rrezikun që këto grupe të humbasin burimin e vetëm të të ardhurave. Prandaj, situata e tyre duhet analizuar dhe ata duhet të përfshihen në përpjekjet për t'iu siguruar një vend pune dhe të ardhura të denja – në kuadrin e zhvillimit të mëtejshëm të sektorit. Përveç kësaj, edhe fëmijët angazhohen në mbledhjen dhe riciklimin e mbetjeve, duke shkaktuar probleme shëndetësore, braktisje të shkollës etj. Veprimi do ta trajtojë këtë problem dhe do të sigurojë ndërlidhjet me institucionet përgjegjëse me qëllim që puna e fëmijëve të parandalohet dhe rregullat e sigurisë të zbatohen për të gjitha ata që janë të përfshirë në këtë aktivitet. Për më tepër, masat janë ideuar për të nxitur aksesin e pakicave dhe grupeve vulnerabël në shërbimet e mbrojtjes sociale, arsimim dhe mundësi punësimi, për të siguruar përfshirjen e tyre në ekonominë kryesore dhe për të mbështetur zbatimin e politikave të përfshirjes sociale të qeverisë. Në këtë kontekst, grupet kryesore të synuara do të jenë romët dhe egjiptianët, familjet

vulnerabël dhe të rinjtë. Do të prezantohen përqasje dhe shërbime të shënjestruara për personat e këtyre grupeve, duke krijuar kështu mundësi të barabarta për ta që të kenë akses në shërbime. Për monitorimin e Veprimit, treguesit do të ndahen sipas përkatësisë etnike dhe vulnerabilitetit, kurdo që është e mundur. Ndikimi i këtij Veprimi për promovimin e mundësive të barabarta do të matet si pjesë e vlerësimit, sipas rastit.

3.5. Kushtet për zbatimin

Para fillimit të aktiviteteve të Produktit 1 lidhur me Rezultatin 4 duhet të përmbushen disa parakushte, prandaj nënshkrimi i Marrëveshjes së Kontributit me organizatat ndërkombëtare të përzgjedhura dhe fillimi i zbatimit të masave për Rezultatin 4 kushtëzohen nga përfundimi i aktiviteteve të mëposhtme:

- Studimet e Fizibilitetit për ngritjen e sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta në zonat e mbetjeve Kukës dhe Gjirokastër duhet të miratohen nga Qeveria e Shqipërisë dhe bashkitë përkatëse.
- Bashkitë përkatëse duhet të miratojnë Planin Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve në përputhje me Masterplanin e 2020-ës. Qeveria e Shqipërisë do të mbështetë bashkitë përkatëse që ende nuk i kanë miratuar ato plane.
- Qeveria e Shqipërisë, bashkë me MIE dhe MTE duhet:
    - të përfundojë aktivitetet për miratimin e Studimeve të Fizibilitetit nga Këshillit Kombëtar i Territorit (KKT) gjatë vitit 2021, në përputhje me legjislacionin e brendshëm;
    - të përfundojë dhe të miratojë Vlerësimin Mjedisor Strategjik;
    - të lëshojë lejet e ndërtimit dhe lejet e tjera për fillimin e punimeve të përcaktuara në kuadrin e Rezultatit 4.

Autoritetet shqiptare duhet të mbështesin bashkitë e përfshira në këtë program, që të garantojnë grumbullim dhe ndarje në burim të mbetjeve, në funksion të zbatimit të Produktit 1 lidhur me Rezultatin 4. Grumbullimi dhe ndarja efektive në burim në 15 bashki sipas Produktit 1 lidhur me Rezultatin 4 të këtij programi, duhet të përfundojë të paktën në zonat urbane jo më vonë se dy vjet nga fillimi i programit.

Ministritë dhe agjencitë përgjegjëse për sektorin e mbetjeve duhet të kenë personel dhe buxhet adekuat jo më vonë se një vit nga fillimi i programit, sipas vlerësimeve dhe konstatimeve të projektit SANE27.

Në MTE do të ngrihet një Njësi e Zbatimit të Projekteve, e përbërë nga përfaqësues të MIE dhe MTE si dhe të paktën një përfaqësues nga secila prej bashkive të Kukësit dhe Gjirokastrës në rolin e tyre si bashki udhëheqëse në zonat e mbetjeve, si dhe/ose përfaqësues nga bashkitë e tjera brenda këtyre zonave të mbetjeve.

Mosrespektimi i kushteve të renditura më lart mund të rezultojë në rikuperim të fondeve në kuadrin e këtij programi dhe/ose rialokimin e financimeve të ardhshme.

3.6. Kuadri Logjik

Rezultatet	Zinxhiri i rezultateve: rezultatet kryesore të pritshme (maks. 10)	Treguesit (të paktën një tregues për rezultat të pritshëm)	Viti bazë (2020 ose sipas rastit)[28]	Synimet (2025)	Burimet e të dhënave (1 për tregues)	Supozimet
Ndikimi	Të kontribuojë në përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimin e ekonomisë qarkulluese dhe rritjes së gjelbër në Shqipëri.	-Rezultati i cilësisë mjedisore të jetës -Rezultati i produktivitetit të burimeve: kuadri i MMN bashkiake -Rezultati i produktivitetit të burimeve: kuadri i ekonomisë qarkulluese -Krijimi i mbetjeve për PBB.	- Niveli 2 nga 5 (2017) - Niveli 2.5 - Niveli 0.5 - 0.88 t/Mln ALL (2016)	- Niveli 4 nga 5 - Niveli 4 - Niveli 3 - 0.70 t/Mln ALL	- OECD 6-mujor: Konkurrueshmëria në Evropën juglindore: Perspektiva e Politikave - Raporti i AKM për gjendjen e mjedisit. - Raporti i AKM për gjendjen e mjedisit. - INSTAT.	*Nuk aplikohet*
Rezultati 1	Legjislacion mjedisor më i përafruar me acquis të BE-së dhe i zbatuar siç duhet, duke mundësuar vënien në zbatim të ekonomisë qarkulluese.	Niveli i transpozimit të direktivave të BE-së në fushën e mbetjeve (%)	Direktivat e BE-së për Mbetjet 53.5% - nivel mesatar transpozimi (2019).	Direktivat e BE-së për Mbetjet 85% - nivel i avancuar transpozimi.	Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë.	Qeveria e Shqipërisë ruan përkushtimin ndaj transpozimit dhe zbatimit të acquis të BE-së për mbetjet dhe aktivitetet e ekonomisë qarkulluese.
Rezultati 2	Ngrihet sistemi i Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit (PZP) për flukse të veçanta mbetjesh.	- Skemat PZP funksionojnë siç duhet brenda mjedisit mundësues. - Organizatat e përgjegjësisë së prodhuesit marrin pjesë në zbatimin e ekonomisë qarkulluese.	- Nuk ka sistem PZP - - Asnjë OPP nuk është e ngritur në Shqipëri.	-Sistemi PZP funksional për të paktën 3 flukse të veçanta mbetjesh. -Ngrihen të paktën 3 OPP për tri flukse të veçanta mbetjesh.	- Raporti i MTE për lejet e lëshuara për flukset e mbetjeve PZP. -Raportet vjetore të OPP me të dhëna për mbledhjen dhe riciklimin për të paktën 3 flukse të veçanta mbetjesh	Industria dhe qeverisja vendore janë mbështetës dhe të gatshëm që të kontribuojnë në ekonominë qarkulluese dhe PZP.
Rezultati 3	Përmirësohet efikasiteti i burimeve, ekodizenjot dhe ekologjia e prodhimit në biznese dhe zinxhirë furnizimi gjithnjë e më "rigjenerues".	Numri i vendeve të punës të krijuara në sferën EQ&RrGj (OZhQ 8 dhe 12).	1249 (2019) në industrinë e riciklimit dhe të gjelbër[29], ku rreth 70% e tyre janë gra	- 62500 në industrinë e riciklimit dhe të gjelbër, të ndarë sipas vendeve të punës të gjelbra dhe gjinisë.	- INSTAT	Qeveria mbështet dhe zbaton masat për incentivimin e ekonomisë qarkulluese dhe produktet e shërbimet e gjelbra. Sektori privat është gati të zbatojë EQ. Statistikat e vendeve të punës për Industrinë e Riciklimit dhe Të

[28] Viti bazë përcaktohet kur ekzistojnë të dhëna për treguesit përkatës. Kur të dhënat nuk specifikohen, viti bazë është 2020.
[29] Dokumenti i Politikave Strategjike për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.

Rezultatet	Zinxhiri i rezultateve: rezultatet kryesore të pritshme (maks. 10)	Treguesit (të paktën një tregues për rezultat të pritshëm)	Viti bazë (2020 ose sipas rastit)[28]	Synimet (2025)	Burimet e të dhënave (1 për tregues)	Supozimet
						Gjelbër janë të disponueshme, të besueshme dhe me ndjeshmëri gjinore.
Rezultati 4	Rriten kapacitetet infrastrukturore që mbështesin EQ&RrGj, efikasitetin e burimeve, riciklimin dhe ripërdorimin në nivel zone (rajonal).	- Volumi (absolut dhe %) i materialeve dytësore që kanalizohen në riciklim dhe ripërdorim. - Përqindja e popullsisë me akses në mbetje në zinxhirët e furnizimit qarkullues dhe të devijuara nga landfillet / vendgrumbullimet (kontribuon në OZhQ 9 dhe 11) - Përqindja e popullsisë me akses në diferencim / ndarje të mbetjeve në urim në ZM Kukës dhe Gjirokastër. - Numri i personave të ndarë sipas gjinisë që shërbehen me infrastrukturë MIM sipas standardeve të BE-së në nivel rajonal në Kukës dhe Gjirokastër.	- 18,7% e mbetjeve (2019) - 8% e popullsisë (2018) - 0% në Kukës dhe Gjirokastër - 0 banorë në Kukës dhe Gjirokastër	- 25% e mbetjeve - 30% e popullsisë e ndarë sipas gjinisë - 30% në Kukës dhe Gjirokastër. - 85,209 banorë në Kukës dhe 87,940 banorë në Gjirokastër.	- Ministria e Infrastrukturë dhe Energjisë - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit - INSTAT	Sipërmarrësit privatë tregojnë interes në shfrytëzimin e materialeve dytësore për të krijuar ide biznesi fitimprurëse.
Produkti 1 lidhur me Rezultatin 1	Kuadri ligjor për menaxhimin e mbetjeve dhe EQ&RrGj përmirësohet në përputhje me *acquis* të BE-së dhe dokumentet e politikave.	- Ligji i ri për Menaxhimin e Mbetjeve - Bashkë me aktet nënligjore janë plotësisht në përputhje me direktivat e BE-së [30]	- Legjislacioni i brendshëm për menaxhimin e mbetjeve nuk është i përafruar me *acquis* të BE-së për mbetjet.	- DKM, DL, Rregullorja për Transportin e Mbetjeve me Anije dhe Riciklimin e Mbetjeve në Anije plotësisht të transpozuara në Ligjin për Menaxhimin e Mbetjeve dhe	- Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë - ToC - VKM të publikuara në faqet e internetit përkatëse.	MTE përkushtohet në rishikimin dhe përgatitjen e legjislacionit të ri për menaxhimin e mbetjeve në përputhje me acquis për mbetjet. Institucionet në të gjitha nivelet janë të gatshme të bashkëpunojnë në hartimin e masave për zbatimin e legjislacionit për EQ dhe menaxhimin e mbetjeve.

[30] Direktivat e BE-së: Direktiva Kuadër të Mbetjeve (DKM), Direktiva e Landfilleve (DL), si dhe Rregullorja për Transportin e Mbetjeve me Anije dhe Riciklimin e Mbetjeve në Anije.

Rezultatet	Zinxhiri i rezultateve: rezultatet kryesore të pritshme (maks. 10)	Treguesit (të paktën një tregues për rezultat të pritshëm)	Viti bazë (2020 ose sipas rastit)[28]	Synimet (2025)	Burimet e të dhënave (1 për tregues)	Supozimet
		- Plane Zbatimi për Direktivat Specifike (PZDS) për DKM, LD dhe direktivat për flukset e veçanta të mbetjeve: Paketimet, MPEE dhe bateritë e akumulatorët. - Udhërrëfyes për ekonominë qarkulluese dhe rritjen e gjelbër - Plani i menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme (PMMRr) me studim fizibiliteti që integron rekomandimet që burojnë nga analiza gjinore sektoriale.	- Asnjë PZDS - Asnjë Udhërrëfyes me masa që mbështet zbatimin e EQ&RrGj. - Asnjë studim fizibiliteti PMMRr i përgatitur.	aktet nënligjore të miratuara nga Qeveria. - PZDS-të miratohen nga Qeveria. - Udhërrëfyesi miratohet nga Qeveria. - Studimi i fizibilitetit PMMRr përgatitet dhe miratohet.		
Produkti 2 lidhur me Rezultatin 1	Forcohen kapacitetet institucionale në të gjitha nivelet për menaxhimin e mbetjeve dhe mbledhjen e monitorimin e të dhënave për EQ&RrGj dhe zbatimin	- Numri i trajnimeve të forcimit të kapaciteteve me perspektivë gjinore dhe gjithëpërfshirëse që bëhen me autoritetet e menaxhimit të mbetjeve mbi zbatimin e EQ&RrGj dhe legjislacionit për menaxhimin e mbetjeve, mbledhjen e të dhënave, monitorimin dhe ekzekutimin e ligjit. - Platformë dixhitale për hedhjen, qarkullimin dhe raportimin e të dhënave për mbetjet. - Numri i bashkive me sistem për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave për mbetjet, të ndara sipas gjinisë, në	- Kapacitete dhe aftësi të ulëta të administratës për menaxhimin e mbetjeve dhe EQ&RrGj. - Nuk ka sistem të integruar për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave për mbetjet - Asnjë (0) bashki me sistem për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave për	- 20 trajnime të dhëna dhe 15 persona të trajnuar. - Softueri zhvillohet dhe bëhet funksional, si dhe pajisjet furnizohen. - Nëntë (9) bashki me sistem mbledhjeje dhe raportimi të dhënash, sipas	- Raportet e projektit (për treguesin 1) - Databaza e AKM-së (për treguesin 2). - Raportet e AKUM-it (për treguesin 2) - Raportet dhe të dhënat e bashkive të përzgjedhura (treguesi 3)	Administrata qendrore dhe vendore është e përkushtuar që të marrë pjesë në trajnime dhe forcim kapacitetesh. AKM dhe agjenci të tjera i kushtojnë kohë dhe personel të mjaftueshëm menaxhimit të fluksit të ri të të dhënave. Institucionet e të gjitha niveleve janë të gatshme të bashkëpunojnë në zbatimin e sistemeve të monitorimit dhe zbatimit. Qeveria e Shqipërisë është e përkushtuar që të mbështetë zbatimin e Udhërrëfyesit me masa mbështetëse për EQ&RRGJ, sapo të hartohet. Qeveria është plotësisht e përkushtuar që të zbatojë rekomandimet për përmirësimin e kapaciteteve institucionale dhe të japë alokime buxhetore adekuate.

Rezultatet	Zinxhiri i rezultateve: rezultatet kryesore të pritshme (maks. 10)	Treguesit (të paktën një tregues për rezultat të pritshëm)	Viti bazë (2020 ose sipas rastit)[28]	Synimet (2025)	Burimet e të dhënave (1 për tregues)	Supozimet
		përputhje me legjislacionin e brendshëm.	mbetjet, të ndara sipas gjinisë.	standardeve, përfshirë të dhëna të ndara sipas gjinisë.		Bashkitë bashkëpunojnë me autoritetet kombëtare dhe janë të përkushtuara në mbledhjen dhe ofrimin e të dhënave mbi krijimin e mbetjeve.
Produkti 1 lidhur me Rezultatin 2	Përgatitet dhe zbatohet kuadri ligjor për zbatimin e skemave PZP për të paktën tri flukse të veçanta mbetjesh.	- Përqindja e legjislacionit që transpozon flukset e veçanta të mbetjeve, në përputhje të plotë me direktivat e BE-së (të paktën Paketimi, MPEE dhe Bateritë e Akumulatorët) - Skema PZP bëhet funksionale për të paktën tri flukse të veçanta mbetjesh.	- Legjislacioni ekzistues për flukset e veçanta të mbetjeve nuk është në përputhje me direktivat përkatëse të BE-së: - Paketimi dhe mbetjet e ambalazhit -81% nivel transpozimi - MPEE – 38 % nivel transpozimi - Bateritë e Akumulatorët – 82% nivel transpozimi - Asnjë skemë PZP ekzistuese.	- Miratohen ligjet për flukset e veçanta të mbetjeve dhe aktet nënligjore të tyre në përputhje të plotë me *acquis* të BE-së - 100% nivel transpozimi - 100% nivel transpozimi - 100% nivel transpozimi - Skemat PZP janë funksionale për të paktën tri flukse mbetjesh.	Për të gjithë treguesit: - Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë - ToC - Fletorja Zyrtare - Vendimet dhe udhëzimet e KM-së dhe ministrisë përkatëse publikohen në faqen e internetit përkatëse. - Databaza e AKM-së.	Operatorët ekonomikë janë të ndërgjegjshëm dhe të përkushtuar që të marrin përsipër përgjegjësitë si prodhues të mbetjeve që iu përkasin flukseve të veçanta. Autoritetet kryesore kombëtare dhe vendore i kushtojnë kohën dhe personelin e mjaftueshëm, në të gjitha nivelet, pjesëmarrjes në ngritjen e PZP-së. MTE dhe AKM i kushtojnë kohën dhe personelin e mjaftueshëm monitorimit të fluksit të ri të të dhënave nga OPP.
Produkti 1 lidhur me Rezultatin 3	Mbështetje për bizneset, OJF-të dhe kapacitetet kërkimore në vend, që të zhvillojnë produkte, shërbime dhe modele biznesi qarkullues janë novatore, të gjelbra dhe me perspektivë gjinore.	-Numri i aktiviteteve pilot të realizuara që mbështesin perspektivën gjinore dhe gjithëpërfshirjen në ekonominë qarkulluese dhe rritjen e gjelbër, efikasitetin e burimeve, ripërdorimin / riciklimin, ekodizajnin. -Numri i subjekteve, d.m.th. operatorët	- Pak ose aspak aktivitete lidhur me EQ&RrGj. - 0	- Zbatohen të paktën 20 aktivitete lidhur me EQ&RrGj - 20 subjekte përfitojnë nga skema grant.	- Raportet e projektit - Raportet e OSHC-ve, industrisë së riciklimit, universiteteve, OPP	Qeveria mbështet dhe zbatim masat për incentivimin e ekonomisë qarkulluese dhe produkteve e shërbimeve të gjelbra. Bizneset, OJF-të dhe kapacitetet kërkimore, OPP-të janë të gatshme të angazhohen në zbatimin e aktiviteteve që mbështesin EQ&RrGj.

Rezultatet	Zinxhiri i rezultateve: rezultatet kryesore të pritshme (maks. 10)	Treguesit (të paktën një tregues për rezultat të pritshëm)	Viti bazë (2020 ose sipas rastit)[28]	Synimet (2025)	Burimet e të dhënave (1 për tregues)	Supozimet
		ekonomikë, OJF-të, institucionet kërkimore që përfitojnë nga skema grant, i ndarë sipas llojit të subjektit - Numri i projekteve të propozuara (privat/ publik-privat) që mbështesin "qarkullimin" me perspektivë gjinore	- 0	- 10 projekte të propozuara që mbështesin qarkullimin me perspektivë gjinore	- MTE.	MTE është plotësisht e përkushtuar që të mbështesë zbatimin e EQ&RrGj dhe t'u japë mbështetje administrative adekuate përfituesve të skemës grant.
Produkti 2 lidhur me Rezultatin 3	Rritet komunikimi, ndërgjegjësimi dhe angazhimi i komuniteteve dhe sektorit privat në ekonominë e gjelbër dhe menaxhimin rajonal të mbetjeve	- Numri i fushatave efektive të realizuara për ndërgjegjësimin dhe nxitjen e pjesëmarrjes së konsumatorëve në parandalim të mbetjeve, EQ dhe RrGj - Numri i personave të ndarë sipas gjinisë që kontaktohen nga fushatat për EQ dhe RrGj. - Numri i të anketuarve, të ndarë sipas gjinisë, të ndërgjegjësuar dhe gati që të marrin pjesë në EQ&RrGj. - Fushatë ndërgjegjësimi publik për zbatimin dhe përfitimet e sistemit rajonal të menaxhimit të mbetjeve.	- Nr. i fushatave të ndërgjegjësimit. - Nr. (0) i personave të kontaktuar. - Përcaktohet nga anketa bazë në fillim të fushatës. - Nr. i fushatave të ndërgjegjësimit për menaxhimin rajonal të mbetjeve.	- Në fushatë ndërgjegjësimi e realizuar. - 200 000 persona të kontaktuar - 30% rritje të të anketuarve të ndërgjegjësuar dhe gati të marrin pjesë në EQ&RrGj. - Një fushatë ndërgjegjësimi e realizuar për menaxhimin rajonal të mbetjeve.	Për të gjithë treguesit: - Projekti Bazë i Projektit - Raporti Përfundimtar i Projektit	Gratë dhe burrat, djemtë dhe vajzat pa dallim kanë akses ose ekspozohen ndaj mesazheve dhe objektivave të fushatës. MTE dhe autoritetet e tjera në nivel kombëtar dhe vendor janë plotësisht të përkushtuar që të marrin pjesë aktivisht dhe të ofrojnë të dhëna që mbështesin zbatimin e fushatës së ndërgjegjësimit. Bashkitë në rajone (zona) janë të përkushtuara dhe mbështesin aktivisht zbatimin e fushatës.
Produkti 1 lidhur me Rezultatin 4	Sistemet e menaxhimit (rajonal) të mbetjeve dhe objektet infrastrukturore mbështeten që të funksionojnë në përputhje të	- Numri i objekteve (infrastrukturës) për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta (MIMN) të ngritura në 2 zonat pilot	- Nr. (0) i objekteve rajonale MIMN në zonat pilot.	2 objekte rajonale MIMN në zonat pilot. - Minimumi 6 landfille /	Për të gjithë treguesit -Raportet e projektit -INSTAT -Projektet e MTE/NEA	Ekziston bashkëfinancimi kombëtar për investimet dhe mirëmbajtjen në menaxhimin e mbetjeve, që kërkohet në zonat e mbetjeve zonat e mbetjeve Kukës

Rezultatet	Zinxhiri i rezultateve: rezultatet kryesore të pritshme (maks. 10)	Treguesit (të paktën një tregues për rezultat të pritshëm)	Viti bazë (2020 ose sipas rastit)[28]	Synimet (2025)	Burimet e të dhënave (1 për tregues)	Supozimet
	plotë me ekonominë qarkulluese.	-Numri i landfilleve / vendgrumbullimeve të parregullta që mbyllen ose rehabilitohen.	- Nr. (0) i landfilleve / vendgrumbullime ve të parregullta që janë mbyllur ose rehabilituar.	vendgrumbullim e të parregullta mbyllen ose rehabilitohen.		dhe Gjirokastër-Vlora jug, për të plotësuar fondet e BE-së. Qeveria është plotësisht e përkushtuar që të zbatojë studimet e fizibilitetit dhe hartimin e projekteve për ngritjen e infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve në nivel rajonal. Bashkitë në rajone (zona) janë të përkushtuara që të bashkëpunojnë dhe të marrin pjesë me sukses në menaxhimin e mbetjeve në nivel rajonal.

4. MODALITETET E ZBATIMIT

4.1. Marrëveshja e financimit

Për zbatimin e këtij Veprimi, parashikohet lidhja e një marrëveshjeje financimi me Republikën e Shqipërisë.

.

4.2. Zbatimi i komponentit të mbështetjes buxhetore

N.A..

4.3. Modalitetet e zbatimit

Komisioni do të garantojë respektimin e rregullave dhe procedurave përkatëse të BE-së për dhënien e financimeve palëve të treta, përfshirë procedurat e rishikimit sipas rastit dhe përputhshmërinë e veprimit me masat shtrënguese të BE-së[31].

4.3.1. Menaxhim Direkt (Grante)

N.A.

4.3.2. Menaxhim Direkt (Çmime)

N.A.

4.3.3. Menaxhim direkt (Prokurim)

Produkti 2 lidhur me Rezultatin 3 do të zbatohet me një kontratë shërbimi.

Objekti	Lloji indikativ (punime, furnizime, shërbime)	Tremujori indikativ i shpalljes së procedurës
Rritja e komunikimit, ndërgjegjësimit dhe angazhimit të komuniteteve dhe sektorit privat në ekonominë qarkulluese dhe rritjen e gjelbër si dhe menaxhimin rajonal të mbetjeve.	Shërbime	T2 2022

4.3.4. Menaxhim indirekt me delegim te subjekti(et) (p.sh. organizatë e Shtetit Anëtar, vend i tretë donator, agjenci e specializuar e BE-së (tradicionale / rregullatore), organizatë ndërkombëtare

Pjesë e këtij Veprimi mund të zbatohet me menaxhim indirekt nga një subjekt që do të përzgjidhet nga shërbimet e Komisionit bazuar në kriteret e mëposhtme:

i. Mandati i subjektit të ngarkuar/deleguar që mbulon natyrën e veprimit;
ii. Përvoja e subjektit potencial, sidomos në kontekstin e Bashkimit Evropian dhe në Shqipëri;
iii. Kapacitetet operacionale/ekspertiza teknike, kapacitetet logjistike dhe menaxhuese, përfshirë në nivel vendor.
iv. Ndikimi, rezultatet, efekti levë i bashkëpunimit me subjekte të tjera/donatorët, si edhe efektiviteti i delegimit të detyrave, përfshirë edhe në Shqipëri;
v. Reduktimi i kostove të transaksioneve;
vi. Kapaciteti i subjektit për të dhënë bashkëfinancim të mundshëm.
vii. Përvoja në sektorin e mjedisit, mbetjeve dhe në menaxhimin e *skemave grant*.

Zbatimi nga ky subjekt përfshin Rezultatin 1 (Produktet 1 dhe 2), Rezultatin 2, si dhe Produktin 1 të Rezultatit 3.

Një tjetër pjesë e këtij Veprimi mund të zbatohet me Menaxhim Indirekt me një subjekt që do të përzgjidhet nga shërbimet e Komisionit bazuar në kriteret e mëposhtme:

i. Mandati i subjektit të ngarkuar/deleguar që mbulon natyrën e veprimit;
ii. Përvoja e subjektit potencial, sidomos në kontekstin e Bashkimit Evropian dhe në Shqipëri;
iii. Kapacitetet operacionale/ekspertiza teknike, kapacitetet logjistike dhe menaxhuese, përfshirë në nivel vendor.

[31] www.sanctionsmap.eu Vini re se harta e sanksioneve është një mjet TI për identifikimin e regjimeve sanksionuese. Sanksionet burojnë nga aktet ligjore të publikuara në Gazetën Zyrtare (GZ). Në rast mospërputhjeje mes akteve ligjore të publikuara dhe përditësimeve në faqen e internetit, mbizotërojnë versionet e publikuara në GZ.

iv. Ndikimi, rezultatet, efekti levë i bashkëpunimit me subjekte të tjera/donatorët, si edhe efektiviteti i delegimit të detyrave, përfshirë edhe në Shqipëri;
v. Reduktimi i kostove të transaksioneve;
vi. Kapaciteti i subjektit për të dhënë bashkëfinancim të mundshëm.
vii. Përvoja më investimet në sektorin e mjedisit dhe mbetjeve të ngurta.

Zbatimi nga ky subjekt përfshin Rezultatin 4.

4.3.5. Menaxhimi indirekt me një përfitues IPA III

N.A.

4.3.6. Kontributi për <emri i Instrumentit Miks Rajonal/Platformës>

N.A.

4.3.7. EFSD+ operacionet që mbulohen me garanci buxhetore

N.A.

4.3.8. Ndryshime nga menaxhimi direkt në modalitetin indirekt (dhe anasjelltas) për shkak të rrethanave përjashtimore (një alternativë, opsioni i dytë)

Nëse negociatat me një subjekt sipas pikës 4.3.4 dështojnë, kjo pjesë e veprimit mund të zbatohet me menaxhim direkt në përputhje me modalitetet e zbatimit të përcaktuara në pikën 4.3.3.

4.4. Shtrirja e pranueshmërisë gjeografike për prokurimet dhe grantet

Pranueshmëria gjeografike në kuptimin e vendit të vendosjes për pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit dhe të dhënies së granteve si dhe në kuptimin e origjinës së artikujve të blerë, sipas aktit bazë dhe dispozitave të dokumenteve kontraktuale, zbatohet sipas dispozitës së mëposhtme:

Zyrtari përgjegjës autorizues i Komisionit mund të zgjerojë pranueshmërinë gjeografike në rast urgjence apo mungese të shërbimeve në tregjet e vendeve apo territoreve përkatëse, apo në situata të tjera të justifikuara siç duhet, ku aplikimi i rregullave të pranueshmërisë do ta bënte realizimin e këtij Veprimi të pamundur ose tejet të vështirë.

4.5. Buxheti indikativ

	Kontributi i BE-së (në EUR)	**Kontributi indikativ i palës së tretë (monedhë e identifikuar)**
Produkti 2 (lidhur me Rezultatin 3): Produkti 2: Rritet komunikimi, ndërgjegjësimi dhe angazhimi i komuniteteve dhe sektorit privat në ekonominë e gjelbër dhe menaxhimin rajonal të mbetjeve që konsiston në:	1 000 000	N.A.
Menaxhim direkt (Prokurim) cf. seksioni 4.3.3	N.A	
Produkti 1 (lidhur me Rezultatin 1): Përmirësohet kuadri ligjor për menaxhimin e mbetjeve dhe EQ&RrGj në përputhje me acquis të BE-së dhe dokumentet e politikave. **Produkti 2 (lidhur me Rezultatin 1): Produkti 2: Forcohen kapacitetet institucionale në të gjitha nivelet për menaxhimin e mbetjeve dhe mbledhjen e monitorimin e të dhënave për EQ&RrGj dhe zbatimin.** **Produkti 1 (lidhur me Rezultatin 2): Përgatitet dhe zbatohet kuadri ligjor për zbatimin e skemave PZP për të paktën tri flukse të veçanta mbetjesh.**	4 000 000	N.A
Produkti 1 (lidhur me Rezultatin 3): Mbështetje për bizneset, OJF-të dhe kapacitetet kërkimore në vend, që të zhvillojnë produkte, shërbime dhe modele biznesi qarkullues janë novatore, të gjelbra dhe me perspektivë gjinore	6 600 000	N.A

që konsiston në:		
Menaxhim Indirekt me subjekt(e) të deleguar – cf. seksioni 4.3.4	**10 600 000**	N.A
Produkti 1 (lidhur me Rezultatin 4): Sistemet e menaxhimit (rajonal) të mbetjeve dhe objektet infrastrukturore mbështeten që të funksionojnë në përputhje të plotë me ekonominë qarkulluese që konsiston në:	19 000 000	N.A
Menaxhim Indirekt me subjekt(e) të deleguar – cf. seksioni 4.3.4	**19 000 000**	N.A
Prokurimi – buxheti total nën seksionin 4.3.3	**1 000 000**	
Vlerësimi, (cf. seksioni 5.3)	mbulohet nga një tjetër vendim	N.A.
Auditi/Verifikimi i shpenzimeve (cf. Seksioni 6)	mbulohet nga një tjetër vendim	N.A.
Komunikimi dhe vizibiliteti (cf. Seksioni 7)	0	N.A.
Kontingjencat	**300 000**	N.A.
Totali	**30 900 000**	

4.6. Struktura organizative dhe përgjegjësitë

Veprimi do të mbështetet në një sërë partnerësh si autoritetet kombëtare, organizatat ndërkombëtare, agjencitë dhe organizatat e shteteve anëtare, organizatat e shoqërisë civile, institucionet financiare ndërkombëtare dhe zhvillimore, në objektiva ku ato kanë qartazi vlerë të shtuar, duke u mbështetur në përvojën e arritur dhe mësimet e nxjerra.

Veprimi do të ketë një komponent në nivel kombëtar, me fokus në hartimin dhe harmonizimin e politikave dhe modeleve kombëtare të ofrimit të shërbimeve dhe produkteve për ekonominë qarkulluese, si dhe një komponent të nivelit rajonal dhe vendor me fokus në zhvillimin e praktikave të shëndosha në ofrimin e shërbimeve të integruara. Synohet që përfituesit e masave të përfaqësohen në strukturat drejtuese të Veprimit.

Në rastin e menaxhimit direkt, Autoriteti Kontraktues do të jetë **Delegacioni i BE-së në Shqipëri.** DBE do të jetë përgjegjëse për të gjitha modalitetet kontraktuale me kontraktorët e përzgjedhur.

Autoriteti homolog i Autoritetit Kontraktues gjatë zbatimit të Veprimit do të jetë **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTE),** si përfituesi kryesor i Veprimit. MTE do të koordinojë zbatimin me të gjitha palët e interesit kombëtare, si subjektet private dhe organizatat komunitare, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si edhe qeverisjet vendore në bashkitë pjesëmarrëse.

Koordinatori Kombëtar IPA (KKIPA) ka përgjegjësinë për koordinimin e përgjithshëm të programimit IPA dhe është homologu kryesor i Komisionit Evropian për të gjithë procesin e planifikimit strategjik, koordinimin e programimit, monitorimin e zbatimit, vlerësimin dhe raportimin e asistencës IPA.

Për koordinimin e përgjithshëm të politikave dhe asistencës së huaj, Qeveria e Shqipërisë ka ngritur një strukturë ndërinstitucionale dhe operacionale për menaxhimin e zbatimit të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) përmes përqasjes sektoriale dhe ndërsektoriale; SPI shërben si sistemi kryesor që përcakton instrumentet dhe mekanizmat për planifikim të integruar të politikave publike. Urdhri nr. 157, datë 22.10.2018 i Kryeministrit rishikoi Grupet e Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP-et) si dhe strukturat e komiteteve drejtuese sektoriale për zbatimin e përqasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale që merren me menaxhimin dhe koordinimin e politikave në fusha prioritare dhe sektorë me rëndësi të veçantë, si dhe me programimin ndërsektorial përmes krijimit të një mekanizmi menaxhimi sektorial /ndërsektorial. Komitetet Drejtuese Sektoriale (KDS-të) për Mjedisin, Klimën dhe Menaxhimin e Mbetjeve sigurojnë bashkëpunim në nivel drejtimi, brenda sektorëve me rëndësi të veçantë për reformat, si dhe koordinim ndërinstitucional. Grupi Tematik (GT) për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta siguron bashkëpunim në nivel teknik, përfshirë edhe me partnerët për zhvillim, brenda sektorëve specifikë të fushave prioritare.

KDS për Mjedisin, Klimën dhe Menaxhimin e Mbetjeve mblidhet nën drejtimin e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe shërben si një nga Komitet Monitoruese Sektoriale IPA. Ky Komitet do të mbikëqyrë zbatimin e përgjithshëm të Veprimit. Koordinimi specifik do të realizohet me bashkitë pjesëmarrëse dhe partnerët zbatues të tjerë, për të garantuar dialogun mbi politikat dhe menaxhimin e njohurive midis nivelit qendror dhe rajonal/vendor të qeverisjes. Edhe OSHC-të do të konsultohen gjatë zbatimit të këtij Veprimi.

Përveç mekanizmit të monitorimit të ngritur në nivel institucionesh/autoritetesh kombëtare dhe linjave të raportimit ndërmjet tyre, **një Komitet Drejtues Projekti (KDP)** do të ngrihet që të drejtojë zbatimin e projektit, me qëllim që të garantohet monitorimi i duhur për secilin projekt. KDP do të përbëhet nga përfaqësues të palëve kryesore të interesit si dhe KKIPA dhe Delegacioni i BE-së. KDP do të monitorojë nga afër përmbushjen e objektivave dhe rezultateve të projektit. KIPPA do të ketë rolin e monitorimit të përmbushjes së objektivave në nivel Veprimi.

5. MONITORIMI DHE RAPORTIMI I PERFORMANCËS/REZULTATEVE

5.1. Monitorimi i brendshëm

Veprimi do të jetë objekt i monitorimit nga Delegacioni i BE-së në Shqipëri dhe nga Përfituesi në nivel kombëtar.

KKIPA ka përgjegjësinë e përgjithshme për zbatimin e asistencës IPA në vend dhe monitoron zbatimin e Veprimit dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuar. Autoriteti Kontraktues monitoron zbatimin e aktiviteteve për çdo kontratë. MTE, si pjesë e Strukturës Operuese, do të ndjekë arritjen e treguesve dhe produkteve të përcaktuara në Veprim. MTE do të informojë rregullisht KKIPA-n dhe palët e tjera të interesuara mbi ecurinë e treguesve. Gjithashtu, MTE ndjek zbatimin e aktiviteteve përkatëse dhe sinjalizon për vonesa të mundshme dhe shkaqet e këtyre vonesave.

Institucionet përkatëse do të përdorin Monitorimin e Orientuar drejt Rezultateve gjatë raportimit të performancës dhe rezultateve të Veprimit. Monitorimi duhet t'i referohet katër kritereve (relevance, efikasiteti, efektiviteti dhe qëndrueshmëria). Ky ushtrim mundet të ofrojë informacion bazë që mund të shfrytëzohet për të orientuar monitorimet, vlerësimet dhe auditet e ardhshme, si edhe vendimet e nivelit drejtues për Veprimin. Ende nuk është zhvilluar një kuadër monitorimi të performacës për sektorin. Mbështetje e mëtejshme do të nevojitet për të forcuar kapacitetet analitike të ministrive, që të zhvillojnë dhe të aplikojnë mjetet e monitorimit të politikave – në përputhje me Udhëzimet e OECD-DAC – si dhe të harmonizojnë strukturat dhe proceset për marrjen dhe bërjen e komenteve për raportet monitoruese.

Komiteti Monitorues Sektorial (KMS) për Mjedisin dhe Ndryshimet Klimatike mbikëqyr zbatimin e përgjithshëm të aksionit(eve) të financuara nga IPA III, Dritarja 3. Koordinim specifik do të realizohet me bashkitë pjesëmarrëse dhe partnerët zbatues të tjerë, për të garantuar dialogun mbi politikat dhe menaxhimin e njohurive ndërmjet nivelit qendror dhe rajonal/vendor të qeverisjes. Edhe OSHC-të do të konsultohen gjatë zbatimit të këtij Veprimi.

Në përputhje me rregullat dhe procedurat e Komisionit Evropian të përcaktuara në Marrëveshjen e Financimit, **Komiteti Monitorues IPA** do të organizohet me pjesëmarrjen e KKIPA-s, institucioneve përfituese, Agjencisë Zbatuese dhe Delegacionit të BE-së në Shqipëri, me qëllim rishikimin e ecurisë së veprimeve të financuara nga IPA.

5.2. Rolet dhe përgjegjësitë për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave

Modalitetet e monitorimit të performancës dhe rezultateve duhet të jenë në përputhje me sistemin e monitorimit të përshkruar në seksionin 5.1 më lart.

KKIPA është përgjegjës në nivel kombëtar për monitorimin, rishikimin dhe vlerësimin e ecurisë/progresit të zbatimit të treguesve të përcaktuar në matricën e kuadrit logjik të Veprimit dhe për komunikimin e këtij informacioni pranë shërbimeve të Komisionit Evropian.

Institucioni përfitues i përfshirë direkt në zbatimin e Veprimit do të ketë përgjegjësinë për të mbledhur të dhënat lidhur me treguesit dhe raportimin në kohë te KKIPA. Meqë sistemet monitoruese sektoriale janë aktualisht të kufizuara, ky Veprim do të kontribuojë në zhvillimin e kapaciteteve më të mira për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave në nivel strategjie sektoriale.

Koordinimi i donatorëve në sektorin e mbetjeve në Shqipëri udhëhiqet nga Gjermania dhe MTE. Raportimi për këtë program do të bëhet i ditur në këtë forum.

5.3. Vlerësimi

Nisur nga rëndësia dhe natyra e Veprimit, konsulentë të pavarur të kontraktuar prej Komisionit do të kryejnë vlerësim afatmesëm dhe vlerësim *ex-post* për këtë Veprim në tërësi apo komponentë të tij

Vlerësimi afatmesëm do të kryhet për qëllime të nxjerrjes së mësimeve si dhe për të vlerësuar ndikimin e aktiviteteve të propozuara në ekonominë qarkulluese dhe rritjen e gjelbër, duke shërbyer kështu si bazë për planifikimin e aktiviteteve të mëtejshme në këtë fushë në Shqipëri, në fazën tjetër që do të mbështetet nga IPA III.

Vlerësimi *ex-post* do të kryhet për qëllime të llogaridhënies dhe nxjerrjes së mësimeve në nivel të ndryshme (përfshirë edhe rishikimin e politikave), duke pasur parasysh veçanërisht zbatimin e mundësive ekonomike për palët joshtetërore në EQ&RrGj, kuadrin rregullator për EQ&RrGj dhe ndikimin e aktiviteteve infrastrukturore në lidhje me menaxhimin e mbetjeve.

Komisioni informon partnerin zbatues të paktën tre muaj përpara datave të planifikuara për misionet e vlerësimit. Partneri zbatues bashkëpunon në mënyrë efikase dhe efektive me ekspertët vlerësues si dhe u ofron atyre, ndër të tjera, të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, si edhe akses në ambientet dhe aktivitetet e projektit.

Raportet e vlerësimit u vihen në dispozicion vendit partner dhe palëve kryesore të interesit. Partneri zbatues dhe Komisioni analizojnë përfundimet dhe rekomandimet e vlerësimeve dhe, sipas rastit, vendosin bashkërisht mbi masat ndjekëse dhe rregullimet e nevojshme që mund të përfshijnë edhe riorientimin e projektit.

6. AUDITI

Pa cenuar detyrimet e zbatueshme në kuadrin e kontratave të nënshkruara për zbatimin e këtij Veprimi, Komisioni mundet që mbi bazën e një vlerësimi risku të kontraktojë kryerjen e auditeve të pavarura apo verifikimin e shpenzimeve për një ose disa kontrata apo marrëveshje.

7. KOMUNIKIMI DHE VIZIBILITETI

Vizibiliteti i financimeve të BE-së dhe komunikimi mbi objektivat dhe ndikimin e Veprimeve janë detyrim ligjor për të gjitha Veprimet e financuara nga BE-ja, siç përcaktohet ne kërkesat në fuqi të komunikimit dhe vizibilitetit të BE-së.

Në veçanti, përfituesit e fondeve të BE-së pranojnë origjinën e fondeve të BE-së dhe garantojnë vizibilitetin e duhur të tyre përmes masave më poshtë:

- të gjitha dokumentet dhe materialet e komunikimit që lidhen me zbatimin e fondeve dhe faqja zyrtare e internetit si dhe mediat sociale, nëse ka, duhet të përmbajnë në vend të dukshëm një pohim që nënvizon se fondet janë dhënë nga BE-ja;
- promovon masat dhe rezultatet e tyre, duke dhënë informacion të shënjestruar, proporcional, koherent dhe efektiv për audiencat e ndryshme, përfshirë median.

Masat e vizibilitetit dhe komunikimit zbatohen, sipas rastit, nga administratat kombëtare (p.sh., në lidhe me reformat që lidhen me mbështetjen buxhetore të BE-së), subjektet e ngarkuara, kontraktorët dhe përfituesit e granteve. Të gjitha masat do të koordinohen dhe do të planifikohen në marrëveshje me Delegacionin e BE-së. Detyrimet kontraktuale të përshtatshme përfshihen në marrëveshjet e financimit, në marrëveshjet e delegimit dhe në kontratat e prokurimit dhe ato grant.

Masat bazohen në një Plan specifik Komunikimi dhe Vizibiliteti, që hartohet dhe zbatohet në përputhje me kërkesat në fuqi të BE-së për komunikimin dhe vizibilitetin. Plani duhet të përmbajë ndër të tjera një narrativë komunikimi dhe mesazhe kryesore për Veprimin, të përshtatura sipas audiencave të synuara (palët e interesit, shoqëria civile, publiku i gjerë, etj.).

Masat e vizibilitetit dhe komunikimit specifike për këtë Veprim janë komplementare me aktivitetet e gjera të komunikimit që zbatohen direkt nga shërbimet e Komisionit Evropian dhe/ose Delegacioni i BE-së.

Komunikimit dhe vizibilitetit do t'i kushtohet rëndësi e lartë gjatë zbatimit të Veprimit për shkak e ka natyrë specifike. Prandaj, për vizibilitetin synohet një aktivitet më vete që duhet të mbështetë përgatitjen e një Plani Komunikimi dhe Vizibiliteti të dedikuar për të gjitha aktivitetet e projekteve të përcaktuara brenda Veprimit. Gjithashtu, koordinimi i strategjive të komunikimit duhet të forcohet me qëllim të shpërndahet i njëjti nivel informacioni në faqet e internetit të partnerëve zbatues, ndërkohë që përmirësohen edhe mesazhet kryesore. Të gjitha masat e nevojshme do të merren për të publikuar faktin se Veprimi realizohet me mbështetjen dhe fondet e BE-së dhe, përveç kësaj, që Veprimi mbështet fuqimisht prioritetet e BE-së si p.sh. Pakti i Gjelbër Evropian.

Planet e komunikimit dhe vizibilitetit hartohen dhe planifikohen strategjikisht në fillim të zbatimit, me objektiva të qarta komunikimi, mesazhe të përcaktuara dhe sipas grupeve të synuara të identifikuara. Monitorimi i aktiviteteve të komunikimit do të garantojë që objektivat e përcaktuar që në fillim të ndiqen ose të rishikohen, sipas nevojës, përgjatë

zbatimit të masave. Masat e vizibilitetit dhe komunikimit duhet të tregojnë se si ndërhyrja kontribuon në objektivat e dakordësuar të programit dhe në procesin e anëtarësimit Masat do të synojnë forcimin e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë, si dhe do të mbështesin ndërhyrjet e financuara dhe objektivat e vendosur. Komunikimi konsiderohet pjesë e pandashme e dialogut me palët kryesore të interesit dhe përfituesit, si dhe do të luajë rol të rëndësishëm në shpjegimin dhe raportimin e strategjisë kombëtare dhe rezultateve të masave (jo vetëm teknikalitetet). Masat synojnë t'ua bëjnë të qartë audiencave të synuara vlerën e shtuar dhe ndikimin e ndërhyrjeve të BE-së, si dhe do të promovojnë transparencën dhe llogaridhënien e përdorimit të fondeve.

7.1. QËNDRUESHMËRIA

Një parakusht i rëndësishëm për qëndrueshmërinë e produkteve të Veprimit është bashkëpunimi i mirë ndërmjet Ekipeve të Projektit dhe përfituesve direktë gjatë zbatimit të Veprimit. Nisur nga natyra e masave që kërkojnë përfshirjen e palëve të ndryshme të interesit në lidhje me ekonominë qarkulluese dhe rritjen e gjelbër si nga sektori shtetëror edhe ai joshtetëror, pritet që të nxitet "pronësia" mbi rezultatet që do të arrihen. Pronësia e rritur do të kontribuojë në arritjen e rezultateve të qëndrueshme, të cilat do të ruhen në planin afatgjatë.

Qëndrueshmëria e rezultateve është integruar në të gjithë zbatimin e Veprimit, me përqasjen që qëndrueshmëria të arrihet si në nivel institucional ashtu edhe financiar.

Me fokusin në **qëndrueshmërinë institucionale,** Veprimi do të angazhohet si me bashkitë dhe nivelin qendror, përmes pjesëmarrjes së niveleve politike dhe teknike të institucioneve partnere qendrore dhe bashkive pilote. Gjithashtu, Veprimi i propozuar do të kontribuojë në konsolidimin e përpjekjeve sistematike dhe të qëndrueshme për të rritur aftësive e shoqërive tregtare vendase, për të përforcuar metodat dhe teknologjitë, si dhe për të mbështetur ekonominë e zgjuar bazuar në politika dhe strategji kombëtare për kërkimin shkencor dhe novacionin. Ky Veprim do të mbështesë edhe zhvillimin socio-ekonomik, duke grumbulluar fonde për kalimin drejt një sektori privat dhe shoqëria civile më të qëndrueshme në lidhje me konceptin e rritjes së gjelbër.

Me fokusin në **qëndrueshmërinë financiare**, Veprimi do të angazhohet që tarifat dhe politikat e mbetjeve të përputhen me zbatimin e ekonomisë qarkulluese sipas parimit "ndotësi paguan". Bazuar në të dhëna statistikore është vlerësuar sa mund të përballojnë familjet në qarkun Kukës dhe Gjirokastër pagesën e tarifës për shërbimet e avancuara MMN; ndërsa në bashkëpunim me INSTAT-in dhe institucione të tjera kombëtare dhe vendore, Veprimi do të hedhë bazat për monitorimin e vazhdueshëm të të dhënave për mbetjet si dhe mbulimin e kostove të sistemit.

Studimet e fizibilitetit mbajnë parasysh se sa popullsia vendore është e gatshme dhe e përballon pagimin e tarifave, duke propozuar një model progresiv me shkallë, në përputhje me objektivat dhe afatet e politikave kombëtare për menaxhimin e mbetjeve.

Njëkohësisht, Veprimi do të forcojë edhe kapacitetet e institucioneve kombëtare që të shërbejnë si lokomotiva të rikuperimit të gjelbër në Shqipëri dhe të vazhdojnë me aktivitete të ngjashme/.

SHTOJCA I.5
e Marrëveshjes së Financimit për planin vjetor të veprimit në favor të Shqipërisë për vitin 2021
Dokumenti i Veprimit për "BE-ja për Novacionin - Faza II"

1. SINOPS

1.1. Tabela Përmbledhëse e Veprimit

Titulli	**BE-ja për Novacionin – Faza II** Plani Vjetor i Veprimit në favor të Shqipërisë për vitin 2021			
Numri *CRIS*	IPA III/2021/ 043-666/5			
Akti bazë	Financuar në kuadrin e Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA III)			
Nisma *Team Europe*	Jo			
Zona që përfiton nga veprimi	Veprimi zbatohet në Shqipëri			
Dokumenti programues	Kuadri Programues IPA III			
FUSHAT PRIORITARE DHE INFORMACIONI SEKTORIAL				
Dritarja dhe prioriteti tematik	D4: Konkurrueshmëria dhe Rritja Gjithëpërfshirëse PT2: Zhvillimi i sektorit privat, tregtia, kërkimi shkencor dhe novacioni			
Objektivat e Zhvillimit të qëndrueshëm (OZhQ)	OZhQ kryesor: 9: Industria, Novacioni dhe Infrastruktura. OZhQ të tjera të rëndësishme (deri në 9) dhe synimet, sipas rastit: 5: Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave. 11: Të bëhen qytetet më përfshirëse, të sigurta, rezistente dhe të qëndrueshme. 12: Të sigurohen modele konsumi dhe prodhimi të qëndrueshme. 13: Veprimi për Klimën: Të merren masa urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe ndikimet e tyre.			
Kodi(et) *DAC*	Kodi *DAC* kryesor (40%): 25030 Shërbimet e zhvillimit të biznesit Nënkodet: (40%) 32130 Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (20%) 43082 – Institucionet kërkimore/shkencore			
Kanali Kryesor i Zbatimit	13000 – Qeveri e vendit të tretë (bashkëpunim i deleguar)			
Treguesit **(nga formulari DAC)**	**Objektivi i përgjithshëm i politikës**	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	Zhvillimi i pjesëmarrjes/ qeverisja e mirë	☐	☒	☐
	Ndihmë për mjedisin	☐	☒	☐
	Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave	☐	☒	☐
	Zhvillimi i tregtisë	☒	☐	☐
	Shëndeti riprodhues, i mëmësisë, të sapolindurve dhe fëmijëve	☒	☐	☐

	Reduktimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore	☒	☐	☐
	Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara	☒	☐	☐
	Ushqyerja	☒	☐	☐
	Treguesit e Konventës RIO	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	Diversiteti biologjik	☒	☐	☐
	Lufta ndaj shkretimit	☒	☐	☐
	Zbutja e ndryshimeve klimatike	☒	☐	☐
	Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike	☒	☐	☐
Tregues të brendshëm[1]	**Objektivat e politikës**	**I pasynuar**	**Objektiv i rëndësishëm**	**Objektiv kryesor**
	Dixhitalizimi	☐	☒	☐
	Migrimi	☒	☐	☐
	COVID-19	☐	☒	☐
INFORMACION PËR BUXHETIN				
Shumat përkatëse	Linja e buxhetit: 15.020201.02 Kostoja totale e vlerësuar: 10 000 000 Euro Kontributi total i buxhetit të BE-së 10 000 000 Euro			
MENAXHIMI DHE ZBATIMI				
Lloji i financimit dhe metoda(t) e zbatimit	Me Projekt **Menaxhim Indirekt** me Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH, (GIZ) si organizatë kryesore dhe Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit për Zhvillim (SIDA) si organizatë partnere			
Prioritetet përkatëse dhe programet nga Plani Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor	Prioritetet: Axhenda e Novacionit, Mbështetja e Sektorit Privat, Zhvillimi i Kapitalit Njerëzor.			
Afati për lidhjen e Marrëveshjes së Financimit	deri më 31 dhjetor N+1			
Afati për lidhjen e marrëveshjeve të kontributit /delegimit,	3 vite pas datës së lidhjes së Marrëveshjes së Financimit, me përjashtim të rasteve të renditura në nenin 114(2) të Rregullores Financiare			

[1] Këto tregues kanë një tjetër objekt/argumentim nga kodet DAC. Ato hartohen në nivelin e alokimit buxhetor dhe theksi vihet te veprimi në kuptimin e objektivave kryesorë të përzgjedhur. Përcaktimi i objektivave, rezultateve, aktiviteteve në përshkrimin e Veprimit duhet të jenë në përputhje me këtë seksion.

prokurimeve dhe kontratave grant	
Periudha indikative e zbatimit operacional	72 muaj pas lidhjes së Marrëveshjes së Financimit
Afati për zbatimin e Marrëveshjes së Financimit	12 vite pas lidhjes së Marrëveshjes së Financimit

1.2. Përmbledhja e Veprimit

Veprimi mbështet Shqipërinë të përshpejtojë transformimi drejt një ekonomike m novatore dhe bazuar në njohuri, e cila përqafon mundësinë që ofron tranzicioni i gjelbër dhe dixhital, duke shpalosur kapitalin njerëzor dhe potencialin sipërmarrës dhe rrjedhimisht duke rritur konkurrueshmërinë e vet.

Ekosistemi i bizneseve të reja dhe novacionit në Shqipëri është në fazë fillestare dhe renditet ndër ekosistemet e sipërmarrjes më të ulëta në Evropë. Rritja e PBB-së para COVID-it nuk rezultoi në rritje të konkurrueshmërisë. Aftësitë sipërmarrëse në Shqipëri mbetet problematike dhe përkeqësohen më tej nga bjerrja e trurit. Disa faktorë dhe pengesave kanë frenuar krijimin e bizneseve të reja dhe rritjen e atyre ekzistuese. Veprimi do të ofrojë një përgjigje bazuar në politika për të ndërtuar një ekosistem të shëndoshë për bizneset e reja dhe novacionin në ekonominë shqiptare. BE-ja do t'i shtojë vlerë Veprimit duke transferuar njohuritë dhe përvojën lidhur me zbatimin e modelit Spiralja e Katërfishtë.

Veprimi pritet të hedhë themelet për të ndryshuar sistemin në mjedisin e biznesit, ekosistemin e novacionit dhe klimën e investimeve. Do të konsolidojë specializimin inteligjent me qëllim që të forcojë kërkimin shkencor, zhvillimin teknologjik dhe novacionin, si edhe të mbështesë përparimin drejt një shoqërie bazuar në dije në përputhe me Paktin e Gjelbër Evropian[2] në katër fusha: 1) Zhvillimi i kapaciteteve në funksion të ekosistemit të bizneseve të reja dhe novacionit; 2) Përmirësimi i aksesit në financim për bizneset e reja dhe Organizatat e Mbështetjes së Novacionit përmes granteve; 3) Promovimi dhe zbatimi i përqasjes Spiralja e Katërfishtë; dhe 4) Promovimi i Shqipërisë si ekosistem për bizneset e reja dhe novacionin si dhe si destinacion për novatorët dhe sipërmarrës vendas dhe ndërkombëtarë. Veprimi është ideuar që të maksimizojë qëndrueshmërinë dhe të forcojë "pronësinë" e palëve në ekosistemin e novacionit. Veprimi bazohet dhe konsolidon ekosistemin e novacionit në Shqipëri dhe rezultatet pozitive të arritura gjatë fazës së parë të programit "BE-ja për Novacionin (IPA 2017").

2. ARGUMENTIMI

2.1. Analiza e Kontekstit

Kuadri i politikave të novacionit në Shqipëri përbëhet kryesisht nga **Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Novacionin** (2017-2022) dhe **Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve (SZHVI)** 2021-2027 bashkë me Planin e Veprimit[3] që do të hartohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Si një strategji ombrellë e zhvillimit ekonomik, SZHBI synon të përshpejtojë transformimin e ekonomisë shqiptare drejt një ekonomie më të orientuara drejt novacionit dhe të bazuar një njohuri, e cila krijon vende pune të reja dhe më cilësore. SZHBI përcakton këto objektiva në fushat/politikat e ndërhyrjes: 1) Tërheqje të investimeve dhe ndërkombëtarizim; 2) Zhvillim të NVM-ve, sipërmarrje dhe novacion; dhe 3) Zhvillim të kapitalit njerëzor. Masat në fushën e NVM-ve, sipërmarrjes dhe novacionit synojnë të krijojnë një mjedis favorizues për sipërmarrjen, të rrisin efektivitetin e mbështetjes dhe fuqizimit të NVM-ve, si dhe të nxisin integrimin ndërkombëtar të ekosistemit shqiptar të bizneseve të reja.

[2] COM(2019) 640 final.
[3] Pritet që Strategjia për Zhvillimin Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 dhe Plani i Veprimit të miratohen në 2021.

Axhenda Dixhitale për Shqipërinë[4] dhe Plani i Veprimit 2020-2022[5] miratuar së fundmi përcaktojnë vizionin "për të zhvilluar një shoqëri bazuar në njohuri dhe informacion, përmes konsolidimit të infrastrukturës dixhitale në Shqipëri, përmirësimit të cilësisë së shërbimeve *online* dhe rritjes së qeverisjes dhe transparencës". Strategjia synon të mbështesë proceset ekonomike përmes përmirësimit të kapaciteteve prodhuese bazuar në TIK, ekonominë e dijes dhe ngritjen e bizneseve të reja.

Formulimi i politikave të **Specializimit Inteligjent (S3)** filloi në Shqipëri në vitin 2017 për të integruar të gjitha palët e spirales trefishe dhe për të krijuar një politikë kombëtare për novacionin. Për procesin e hartëzimit **S3,** është analizuar stanjacioni në fushat e kërkimit shkencor, strukturës industriale, kapitalit njerëzor, fondeve publike dhe private, si edhe kushtet e tjera që përcaktojnë ekosistemin kombëtar të novacionit. Konstatimet fillestare tregojnë se sektori i shërbimet TIK, sektori i bioteknologjisë mjekësore, shërbimet e shkencës profesionale dhe të teknologjisë si dhe sektori i bankave dhe financës duhet të forcohen. Shqipëria duhet të rrisë investimet në kërkim shkencor, në përputhe me zotimet e saj dhe prioritet e zonës kërkimore evropiane si dhe të vazhdojë zhvillimin e Strategjisë së Specializimit Inteligjent.

Projektligji për Shkencën dhe Kërkimin në Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë parashikon që shkenca dhe kërkimi shkencor u shërbejnë politikave publike dhe bashkëpunimit ndërmjet industrisë dhe shoqërisë, mbështesin zhvillimin ekonomik të vendit dhe afirmojnë identitetin kombëtar.

Projektligji për *startup*-et inovative ka përfunduar procesin e konsultimit publik dhe pritet të miratohet në vitin 2021. **"Programi për *startup*-et dhe novacionin"** i Kryeministrisë përcakton vizionin tërësor dhe drejtimin politik të strategjive dhe politikave shtetërore në këtë fushë. Programi do të zbatohet përmes në plani veprimi në proces përgatitjeje që do të miratohet nga fundi i vitit 2021.

Sipas **vlerësimit të BE-së për Programin e Reformave Ekonomike (PRE) të Shqipërisë 2020-2022**[6], Shqipëria duhet të përmirësojë ofrimin e shërbimeve të mbështetjes teknike për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, përfshirë përmes zhvillimit të një rrjeti mbështetës që i ndihmon të zgjerohen, të kenë akses më të mirë në financime/fonde, të kenë novacion, të dixhitalizohen dhe të eksportojnë. PRE përmban edhe masën 8: zhvillimi i kuadrit ligjor në mbështetje të *startup*-eve inovative.

Në **Raportin 2021 për Shqipërinë**[7], Komisioni Evropian nënvizon se nevojiten përpjekje të mëtejshme për të përshpejtuar zbatimin e planit të veprimit "spiralja e trefishtë" dhe i rekomandon Shqipërisë që të përparojë me miratimin e ligjit për novacionin dhe ngritjen e agjencisë shqiptare për *startup*-et. Në tërësi, raporti konstaton se Shqipëria ka njëfarë niveli përgatitjeje në fushën e kërkimit shkencor dhe novacionit.

2.2. Analiza e problematikave sipas fushave që do të mbështeten

Panorama e përgjithshme

Ekosistemi i bizneseve të reja dhe novacionit në Shqipëri është në fazë fillestare dhe renditet ndër sistemet e sipërmarrjes më të ulëta në Evropë. Në Indeksin Global të Sipërmarrjes për vitin 2019, Shqipëria renditej në vendin 83 nga 137 ekonomi të analizuara.[8] Dinamikat e biznesit janë nën mesataren e rajonit dhe BE-së, jo vetëm për *startup*-et por edhe ndërmarrjet mikro dhe të vogla. Shqipëria humbi 2 vende në Indeksin Global të Konkurrueshmërisë për vitin 2019, krahasuar me një vit më parë (vendi 81 nga 141 shtete). Kjo tregon se rritja e vazhdueshme e PBB-së para periudhës së COVID-it nuk rezultoi në rritje të konkurrueshmërisë. Siç e theksoi edhe OECD në maj 2019[9], aftësitë sipërmarrëse në Shqipëri mbeten problematike dhe përkeqësohen më tej nga bjerrja e trurit. Krijimi i *startup*-eve të reja dhe forcimi i atyre ekzistuese është frenuar deri tani nga disa faktorë dhe pengesa. Ky Veprim i bazuar në politika i përgjigjet nevojës së ekonomisë shqiptare për të ndërtuar një ekosistem të shëndoshë për *startup*-et dhe novacionin. BE do t'i shtojë vlerë Veprimit duke transferuar njohuritë dhe përvojën lidhur me zbatimin e modelit "Spiralja e Katërfishtë".

Fusha e mbështetjes #1: Zhvillimi i kapaciteteve dhe bashkëpunimi mes palëve të interesuara në ekosistemin e *startup*-eve dhe novacionit

Analiza e problematikës. Palët e interesuara të Spirales së Katërfishtë (akademikët, industria, qeveria dhe shoqëria) që formojnë ekosistemin e *startup*-eve dhe novacionit përmes ndërveprimit dhe bashkëpunimit, përballjen me sfida

[4] https://akshi.gov.al/ep-content/uploads/2018/03/Digital_Agenda_Strategy_2015_-_2020.pdf
[5] Miratuar me VKM nr. 1081 datë 24.12.2020: https://qbz.gov.al/eli/fz/2020/233/0c4afe98-ea52-4e67-8f2c-10ef89e88e7b; Strategjia Ndërsektoriale "Axhenda Dixhitale për Shqipërinë" 2021-2024 do të finalizohet në T3 2021.
[6] https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-7468-2020-INIT/en/pdf
[7] SWD(2021) 289 final.
[8] https://thegedi.org/global-entrepreneurship-and-development-index/
[9] Indeksi i Politikave për NVM-të: Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2019: Vlerësimi i Zbatimit të Aktit të Biznesit të Vogël për Evropën | en | OECD

për sa u përket përmasave, kapaciteteve, buxhetit dhe lidhje ndërkombëtare. Ato janë të shkëputura dhe punojnë kryesisht të veçuara, duke penguar kështu novacionin. Krahasuar me ekonomitë e 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor (BP6) apo BE-në, numri i *startup*-eve në Shqipëri është i ulët. Në përgjithësi, mbështetja që marrin nga organizatat e mbështetjes së novacionit (OMN) nuk synon fazën e rritjes (ndërkombëtare). Gjithashtu, *startup*-et kanë nevojë për mbështetje të specializuar nga OMN-të në trajtën e trajnimit, *coaching* dhe programeve të përshpejtimit, në mënyrë që të ndërtojnë kapacitetet e novacionit. Ka pasur vetëm përpjekje sporadike për të ofruar mbështetje të vazhdueshme inkubacioni për sipërmarrës aspirantë në qytetet jashtë Tiranës dhe Korçës. Shumë sipërmarrës vendorë, *startup*-edhe OMN nuk e dinë peizazhin e financimit brenda dhe jashtë Shqipërisë, as si t'u drejtohen investitorëve të mundshëm. *Crowdfunding,* engjëjt e biznesit dhe investimet në kapital[10] nuk janë të njohura në Shqipëri. Investitorët vendas kanë pak përvojë me investimet në rritjen e *startup*-eve, prandaj e kanë të vështirë të kuptojnë sfidat dhe mundësitë. Mungesa e lidhjeve të OMN-ve shqiptare me ekosistemet e BP6 dhe evropiane, kufizon mundësitë e tyre për të gjetur ekspertizë ndërkombëtare, partnerë potencialë, investitorë dhe mentorë. Vetëm pak subjekte ndërkombëtare kanë eksploruar mundësitë për të zgjeruar ofertën e tyre për ekosistemin shqiptar. Lidhja ndërmjet universiteteve, ekosistemit të *startup*-eve dhe novacionit, industrisë dhe sektorit privat është jashtëzakonisht e dobët. Pjesëtarët e diasporës mund të japin mbështetje të vyer për ekosistemin e *startup*-eve dhe novacionit përmes mentorimit, *coaching* dhe investimeve (sipas studimeve, 1.4 milion shqiptarë jetojnë jashtë Shqipërisë[11]).

Palët e interesuara të këtij Veprimi janë subjektet e ndryshme të ekosistemit të *startup*-eve dhe novacionit: subjektet e biznesit si p.sh. *startup*-et, NVM-të dhe korporatat, institucionet që mbështesin palët e ekosistemit në kuptimin e gjerë, si p.sh. inkubatorët dhe përshpejtuesit, si dhe organizatat e mbështetjes së biznesit përfshirë organizatat klaster. Universitetet dhe institutet kërkimore si edhe parqet e shkencës dhe teknologjisë mbështesin ekosistemin duke ofruar talent, kërkim shkencor dhe novacion. Organizatat financiare përfshijnë firmat me kapital të përbashkët, engjëjt e biznesit dhe lloje të tjera investitorësh që ofrojnë akses në financim, ndërsa autoritetet publike dhe qeveritare në nivel vendor dhe qendror kanë rol kyç për të garantuar një kuadër të shëndoshë për ekosistemin. Media lehtëson shkëmbimin e informacionit dhe komunikimin me jashtë. Për qëllimet e këtij Veprimi, ekosistemi i *startup*-eve dhe novacionit përkufizohet si tërësia e institucioneve, sipërmarrjeve dhe personave që bashkëpunojnë dhe ndërveprojnë si sistem për të promovuar dhe për të krijuar sipërmarrje të orientuar drejt kërkesës, novacion dhe kërkim shkencor, të cilat në mënyrë të ndërsjellë forcojnë ndikimin e tyre përmes bashkëpunimit dhe shkëmbimit të burimeve, ideve dhe talentit. Sipas modelit të spirales së katërfishtë, ekosistemi duhet të shtrihet te shoqëria civile si dhe akademikët, qeveria dhe industria. Duke punuar bashkë, modeli "spiralja e katërfishtë arrin të krijojë vlerë të re të përbashkët nga e cila përfitojnë të gjithë pjesëmarrësit. Ky model priret drejt ndryshimeve strukturore, ku përdoruesit bashkëkrijojnë zgjidhje për të plotësuar nevojat e tyre.

Fusha e mbështetjes #2: Akses në financime për *startup*-et dhe Organizatat e Mbështetjes së Novacionit (OMN-të)

Analiza e problematikës. Edhe pse nuk ka evidenca zyrtare se sa është kërkesa e bizneseve *startup* për financime, peizazhi aktual financiar dhe bankar në Shqipëri është i nënzhvilluar për të mbështetur idetë apo *startup*-et në fazë të hershme. Për ndërmarrjet private tradicionale, edhe pse sektori bankar ka qenë i qëndrueshëm, me likuiditet dhe i mirëkapitalizuar, kreditimi për sektorin privat është më i ulët sesa në ekonomitë e ngjashme apo të avancuara, teksa Shqipëria ka raportin më të ulët hua-depozitë ndër ekonomitë në rritje, me 47%. Kreditimi është veçanërisht i shtrënguar për NVM-të, të cilat përballen me kritere të forta kreditimi nga bankat, si p.sh. kolateral i lartë që tejkalon me 177% vlerën e kredisë. Mbi 90% e kredive kërkojnë kolateral, prandaj kjo është pengesa e madhe për NVM-të që të kenë akses në financime. Ndërkohë që për bizneset embrionale, nuk ekzistojnë forma alternative financimi përveç atyre tradicionale. Kreditimi kërkon prova të aftësisë paguese financiare, kolateral dhe historik biznesi, të cilat shumica e *startup*-eve nuk munden t'i vënë në dispozicion. Rrjedhimisht, ato përjashtohen automatikisht nga skemat tradicionale të kreditimit: aksesi në financime është ende problem madhor për *startup*-et dhe OMN-të në përgjithësi, dhe peizazhi i financimit në Shqipëri ka nevojë për diversifikim. Kjo ndodh kryesisht për shkak se: 1) *startup*-et dhe nismat e vetëpunësimit nuk janë në gjendje të përfshihen në skemat tradicionale të kreditimit; dhe 2) mungesa e financimeve fleksibël janë sektorit bankar për projekte i pilotim i shpejtë *startup* apo programe përshpejtimi të OMN-ve. Grantet janë një instrument i përshtatshëm për të mbështetur fillimin e biznesit dhe zhvillimin e ideve, por programet shtetërore ofrojnë grante në vlera shumë të vogla; rrjedhimisht, ato kanë ndikim të kufizuar[12]. Pjesëmarrja e novatorëve shqiptarë në programet e BE-së duhet të nxitet përmes mbështetjes së dedikuar për të rritur përqindjen e pjesëmarrjes së tyre.

[10] Bazuar në nenin 2(25) të Rregullores Financiare të BE-së, "investim në kapital" do të thotë ofrimi i kapitalit një shoqërie tregtare për ta investuar drejtpërdrejtë ose tërthorazi, në këmbim të pronësisë së pjesshme të asaj shoqëria tregtare dhe ku investuesi i kapitalit mundet të marrë disa kompetenca drejtimi dhe të përfitojë pjesë të fitimit të shoqërisë tregtare.
[11] IOM OKB Migrimi, 2018.
[12] Raporti i Komisionit për Shqipërinë, 2020, faqe 95.

Palët kryesore të interesit. *Startup*-et dhe OMN-të shqiptare janë përfituesit e drejtpërdrejtë të këtij Veprimi. Informacioni i saktë për numrin e *startup*-eve mungon, sepse nuk ka një regjistër qendror apo databazë. *Startup*-et në kuadrin e këtij Veprimi do të përcaktohen mbi bazën e moshës së sipërmarrjes (më e re se 5-10 vjet, në varësi të sektorit), numrit të punonjësve dhe xhiros. Kritere shtesë do të përdoren për përzgjedhjen e përfituesve të granteve, si p.sh. aftësia për t'u rritur dhe niveli i novacionit (në modelin e shërbimeve, produktit apo biznesit). Ky Veprim synon të mbështesë *startup*-et në të gjithë sektorët. Nëngrup i synuar janë edhe përshkallëzuesit (d.m.th. *startup*-e me produkt pune dhe klientelë fillestare që duan të zgjerohen në tregun vendas apo ndërkombëtar), *startup*-et me shërbime/produkte dixhitale ose që merren me dixhitalizimin në të gjithë sektorët, si dhe *startup*-et produktet/shërbimet e të cilave mbështesin Agjendën e Gjelbër të BE-së për Ballkanin Perëndimor[13] dhe ekonominë qarkulluese në të gjithë sektorët e ekonomisë. Këto *startup*-e kanë aftësi të madhe që të rriten dhe të përshkallëzohen ndërkombëtarisht në periudhë afatshkurtër dhe afatmesme, prandaj prodhojnë ndikim pozitiv në aspektin e punësimit dhe modeleve të suksesshme.
OMN-të konsistojnë në një sërë palësh interesi që ofrojnë një gamë relativisht të gjerë shërbimesh. Për qëllimet e këtij Veprimi, fokusi do të jetë te inkubatorët dhe përshpejtuesit, hapësirat e përbashkëta të punës dhe programet universitare të inkubacionit dhe sipërmarrjes. Inkubatorët dhe përshpejtuesit ofrojnë trajnim, *coaching*, përputhje dhe mbështetje për vendosjen e kontakteve (rrjetëzim) për *startup*-et dhe sipërmarrësit aspirantë. Numri i përgjithshëm i MNO-ve në Shqipëri është ende i pakët[14] (2 programe para-inkubacioni; 4 programe inkubacioni dhe përshpejtimi, 3 hapësira të përbashkëta pune) dhe pengesat kryesore janë mungesa e modeleve të qëndrueshme të biznesit dhe varësia ndaj fondeve të donatorëve. Rrjedhimisht, u mungojnë flukset e diversifikuara të të ardhurave, çka rezulton në planifikim afatshkurtër të aktiviteteve.

Fusha e mbështetjes #3: Zbatimi i modelit "Spiralja e Katërfishtë" për të mbështetur tranzicionin e gjelbër dhe dixhital të Shqipërisë.
Analiza e problematikës. Rrjetëzimi dhe bashkëpunimi i talenteve të reja dhe xhepave të ekselencës ndër palët e Spirales së Katërfishtë për të mbështetur zhvillimin e mëtejshëm të specializimit inteligjent në Shqipëri janë të dobët. Bashkëpunimi ndërmjet industrisë dhe universiteteve është i pakët, për shkak të mosbesimit. Bashkëpunimi ekzistues fokusohet kryesisht në sistemimin e studentëve. Edhe pse promovimi i sipërmarrjes po merr hov në Tiranë dhe Durrës, ky koncept mbetet i huaj për universitetet shqiptare për shkak të mungesës së fondeve dhe dijeve se si realizohet mësimdhënia për sipërmarrjen.
Qeveria dalëngadalë po e njeh rëndësinë e ekosistemit të *startup*-eve dhe novacionit. Për momentin, objekti i politikave për novacionin, kërkimin shkencor, shkencën dhe nxitjen ekonomike është i shpërndarë ndërmjet disa ministrive, departamenteve dhe agjencive. Megjithatë, në kuadrin e hartimit të politikave, reformave dhe dokumenteve strategjike (p.sh. Programi i Reformave Ekonomike 2021-2023 dhe SZHBI 2021-2027 që do të miratohet), novacionit dhe sipërmarrjes i është kushtuar më shumë vëmendje dhe peshë.[15]

Ekonomia shqiptare është në fazë shumë të hershme të **tranzicionit të gjelbër dhe dixhital.** Sipërmarrjet janë ende të ngulitura në konceptin e ekonomisë lineare. Aspektet e avancuara të ekonomisë qarkulluese dhe rritjes ë gjelbër siç është parandalimi i mbetjeve, riciklimi, efikasiteti i burimeve, ekodizajni dhe ekonovacioni, po evoluojnë shumë ngadalë. Shumica e NVM-ve shqiptare nuk kanë kapacitete dixhitale për të ofruar produktet dhe shërbimet, apo si instrument për alokim më të zhdërvjellët të burimeve dhe shkëmbim të njohurive brenda ndërmarrjes. Pandemia COVID-19 solli nevojën për ndryshime radikale në funksionimin e shoqërive tregtare, duke ofruar mundësi për të rritur ofrimin e shërbimeve në distancë të largët dhe duke imponuar novacion dixhital që mund të nxitë dimensionet sociale dhe mjedisore të konkurrueshmërisë.

Palët kryesore të interesit në nivel qendror janë Kryeministria, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit (MARS) si dhe Ministri i Shtetit për Diasporën dhe Agjencia Kombëtare e Diasporës. Personeli në këto institucione është i kufizuar dhe përgjegjësia për nxitjen e novacionit dhe *startup*-eve iu është lënë fare pak individëve. Institucioni i varësisë i MFE-së, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) si dhe agjencia e varësisë e MARS-it, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Novacionit (AKKSHI), nuk kanë as autonominë për të përcaktuar strategjitë e veta dhe as buxhetin apo personelin për t'i zbatuar ato. Në nivelin e qeverisjes vendore, bashkitë e Tiranës dhe Korçës dallojnë me vizionin dhe ambicien e tyre për të zhvilluar një ekosistem dinamik për *startup*-et dhe novacionin. Edhe qytetet /

[13] SWD(2020) 223 final
[14] Një nga të paktët inkubatorë rajonalë me infrastrukturë të dedikuar është Inkubatori i Biznesit në Korçë, i ngritur me mbështetjen e bashkisë. Sidoqoftë, mungesa e kapaciteteve e ka penguar të shpalosë potencialin e plotë. Ekzistojnë edhe organizata si Përshpejtësi Shqiptar i Novacionit në Durrës, por duket se ofron shërbime vetëm mbi baza *ad hoc*.
[15] Projekt-SZHBI me synimin zhvillimor që të promovojë (ndër të tjera) një Shqipëri konkurruese, duke përshpejtuar transformimin drejt një ekonomie më të nxitur drejt novacionit dhe më të bazuar në njohuri. Temat si novacioni dhe sipërmarrja koncisderohet si një nga katër fushat e ndërhyrjes.

bashkitë e tjera janë palë të interesuara për këtë Veprim, sepse është e rëndësishme që sipërmarrja dhe novacioni të përhapet përtej këtyre dy qendrave urbane[16].

Sektori privat në Shqipëri karakterizohet nga ndërmarrje mikro dhe të vogla, me një pakicë ndërmarrjes të mesme. Bazuar në të dhënat e INSTAT-it për vitin 2019, kategoria "Ndërmarrje Të vogla dhe Të mesme" (me 10-29 punonjës) përbëhej nga 8 196 ndërmarrje, ndërsa kategoria "Ndërmarrje mikro" (me 1-9 punonjës) përbëhej nga 107 883 ndërmarrje[17] në vitin 2019[18]. Përfaqësuesit sektorialë të rëndësishëm për Veprimin janë Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë në Shqipëri, Unionin i Prodhuesve Shqiptar dhe Sipërmarrësit e Rinj Shqiptarë. NVM-të shqiptare vuajnë nga sofistikimi relativisht i ulët i biznesit dhe sensibilizimi i pakët lidhur me dobitë e parimeve të ekonomisë së gjelbër dhe qarkulluese, si edhe intensiteti i ulët i novacionit dhe teknologjisë, ndërsa ndërmarrjet e mëdha kanë pozita më të mira për sa i përket novacionit dhe teknologjisë.
Me synimin për të ndezur interesimin në sipërmarrje dhe për të ushqyer kulturën e novacionit, Veprimi fokusohet veçanërisht te **rinia shqiptare.** Të rinjtë përbënin 24% të të gjithë popullsisë në vitin 2018. Sipas Indeksit të Pjesëmarrjes së Rinisë (2018)[19], 53.9% e të rinjve ishin të regjistruar në arsimin tretësor në vitin 2017, ndërsa 26% e të rinjve janë diplomuar nga arsimi tretësor. Pra, ekziston një masë e konsiderueshme talenti të cilin ekosistemi i *startup*-eve mund ta shfrytëzojë. Të rinjtë shqiptarë konsiderohen si themeli i **shoqërisë civile,** që po ashtu synohet nga ky Veprim, me fokus te organizatat jofitimprurëse dhe media.

Fusha e mbështetjes #4: Promovimi i Shqipërisë si ekosistem për *startup*-et dhe novacionin dhe si destinacion për novatorët dhe sipërmarrësit ndërkombëtarë dhe të huaj
Analiza e Problematikës. Deri tani, ekosistemi shqiptar është promovuar përmes mediave vendase, si dhe përmes strategjisë së BE-së për Novacionin, Komunikimin dhe Vizibilitetin në kuadrin e IPA II. Në Shqipëri, ekosistemi i novacionit dhe komuniteti i *startup*-eve kanë pak akses te mediat, aktorët dhe palët e interesit të huaja. Partnerët mediatikë vendas kanë mungesë ndërgjegjësimi dhe njohurish lidhur me *startup*-et dhe novacionin. Kjo situatë rëndohet më tej nga nënpërfaqësimi në media; shumë pak kanale mediatike raportojnë histori suksesi të novacionit, prandaj edhe mungojnë modelet që të merren si shembull. Ende nuk ka një konsensus mes palëve të interesit se çfarë përbën ekosistem shqiptar. Prandaj, Shqipëria nuk promovohet dhe potenciali për të tërhequr nomadët dixhitalë, *startup*-et dhe talentin nga jashtë shtetit që të punojnë në ekosistemin e Shqipërisë nuk shfrytëzohet.
Veprimi synon mediat kombëtare për fushata trajnimi dhe ndërgjegjësimi, si **palë interesi kryesore.**

2.3. Relevanca dhe komplimentariteti me strategjitë e mbështetura nga palët e interesuara kryesore kombëtare

Sipas analizës së problematikës, sfidat për zhvillimin e sipërmarrjes dhe përhapjen e novacionit në Shqipëri janë mjedisi mundësues i dobët dhe disbalancat e forta rajonale. Modeli "Spiralja e Katërfishtë" do të mbështetë zhvillimin e specializimit inteligjent në vend. Duke mbështetur përmirësimin e mjedisit të biznesit, ekosistemin e novacionit dhe klimën e investimeve, ky Veprim është relevant dhe komplementar me strategjitë e mbështetura prej palëve kombëtare në fushën e zhvillimit të biznesit dhe investimeve, si edhe të shkencës, kërkimit shkencor dhe novacionit. Sfidat e përshkruara trajtohen në SZHBI (2021-2027) dhe Planin e saj të Veprimit si edhe në Programin e Kryeministrisë për Sipërmarrjen dhe Novacionin. Ato lidhen me një sërë strategjish kombëtare dhe sektoriale të përshkruara në analizën e kontekstit. Veprimi është në përputhje me Programin e Reformave Ekonomike (PRE) të Shqipërisë 2021-2023). Zbatimi i modelit "Spiralja e Katërfishtë" si mjet për të mbështetur tranzicionin e gjelbër dhe dixhital reflekton edhe disa elementë të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2021-2025.

2.4. Relevanca dhe komplimentariteti me politikën e BE-së dhe asistencën e BE-së dhe donatorëve të tjerë

Ky Veprim bazohet në politikat përkatëse të BE-së, me qëllimin e përgjithshëm që të forcojë ekosistemin e *startup*-eve dhe novacionit në Shqipëri në kontekstin e tranzicionit të gjelbër dhe dixhital.

Siç përcaktohet në Dritaren 4 të **Kuadrit Programues IPA III** dhe në koherencë me prioritetet e Komisionit Evropian, tranzicioni i gjelbër, transformimi dixhital dhe ekonomia që funksionon për njerëzit janë thelbësore për t'i dhënë hov dhe për të modernizuar ekonomitë e përfituesve IPA III. Kërkimi shkencor, novacioni, arsimi dhe kultura janë shtysa themelore në këtë proces – dhe duhet të mbështeten në politika bazuar në evidenca. Mbështetja e mëtejshme nevojitet për të përballuar disa prej sfidave kryesore të sektorit privat, përfshirë nxitjen e një mjedisi

[16] Bazuar në vlerësimin e BE-së, për projektet e novacionit mund të prëfshihen edhe qytetet e Elbasanit, Durrësit, Vlorës dhe Shkodrës (http://euforinnovation.al/neë-publication-on-the-entrepreneurial-and-innovation-ecosystem-in-albania/).
[17] Në këtë kategori nuk përfshihen sipërmarrjet bujqësore me vetëm një punonjës.
[18] EBRD/IDRA 2020: Mbështetje prë Dixhitalizimin e NVM-ve në Shqipëri për të zbuluar ndikimin negativ ekonomik të COVID-19.
[19] https://ybhëbt.eu/ëp-content/uploads/2019/11/Youth-Participation-Index-2018-1.pdf

mundësues për krijimin e bizneseve dhe për tërheqjen e investimeve të brendshme dhe të huaja, promovimin e NVM-ve dhe sipërmarrjes dhe inkurajimin e novacionit. Në veçanti, për NMVM, sfidat kryesore janë mungesa e aksesit në financime dhe përfshirja financiare (sidomos për gratë dhe të rinjtë), si dhe mungesa e teknologjive dixhitale. Aksesi në shërbimet financiare dhe financimet për to duhet të mbështetet.

Komisioni Evropian bashkë me institucione partnere[20] shpalli **Nismën për Novacionin Dixhital dhe Përshkallëzimin për Evropën lindore dhe juglindore (DISC)**[21] në vitin 2019, me fokus te *startup*-et novatore dhe NVM-të që merren me zgjidhjet teknologjike për sfida madhore shkencore dhe inxhinierike (teknologjia e thellë).

Axhenda e Ballkanit Perëndimor për Novacionin, Kërkimin Shkencor, Arsimin, Kulturën, Rininë dhe Sportin[22] (2020) përcakton objektiva afatgjatë për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe vendeve BP6 në fushat e lartpërmendura. Axhenda kontribuon në një sërë prioritetesh, përfshirë afrimin e kërkimit shkencor dhe ekosistemeve të novacionit më afër standardeve të BE-së për të forcuar kapacitetet novatore të rajonit, duke mbështetur transformimin dixhital dhe avancimin drejt ekonomisë qarkulluese. Forma më e ngushtë e bashkëpunimit në shkencë dhe teknologji është asociimi i plotë në **Horizon Europe (HE),** Programin Kuadër të BE-së për Kërkimin Shkencor dhe Novacionin. Ky program ofron financime për projektet e përbashkëta të novacionit, duke mundësuar aksesin e ndërsjellë në ekselencë, novacionin dhe burime kërkimore. Ky Veprim synon të shfrytëzojë mundësitë që HE ofron për vendet e asociuara nën shtyllën: Instituti Evropian i Novacionit dhe Teknologjisë (EIT); Këshilli Evropian i Novacionit EIC; Ekosistemet Evropiane të Novacionit (EIE).

Në linjë me **Paktin e Gjelbër Evropian** dhe ambicien e Evropës për t'u bërë i pari kontinent neutral ndaj klimës, **Axhenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor**[23] (2020) ka pesë shtylla: (1) veprimi për klimën, përfshirë dekabornizimin, energjinë dhe mobilitetin; (2) ekonomia qarkulluese, që adreson veçanërisht mbetjet, riciklimin, prodhimin e qëndrueshëm dhe shfrytëzimin efikas të burimeve; (3) biodiversiteti, që synon mbrojtjen dhe restaurimin e pasurisë natyrore të rajonit; (4) lufta ndaj ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës; dhe (5) sistemet e qëndrueshme ushqimore dhe zonat rurale. Dixhitalizimi i ekonomive të BP6 do të forcohet si një katalizator kyç për këto pesë shtylla.

Për të nxitur rimëkëmbjen ekonomike të rajonit BP6 pas krizës së COVID-19, Komisioni Evropian miratoi një tetor 2020 **Planin Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perëndimor**[24] duke vënë në dispozicion një paketë investimesh prej 9 miliard Euro për rajonin. Plani fokusohet ndër të tjera në financimin e programeve të investimeve në fushën e transportit, energjetikës, tranzicionit dixhital dhe mbështetjen e sektorit privat në novacion dhe rritjen e gjelbër. Fusha prioritare e mbështetjes së BE-së në kuadrin e këtij Veprimi është nxitja dhe zgjerimi i ekosistemit të *startup*-eve dhe novacionit në Shqipëri, në linjë me tranzicionin dixhital dhe të gjelbër.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2021-2023 identifikon nevojën për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve të mbështetjes teknike për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, që i ndihmojnë në përshkallëzim, investime, novacion, dixhitalizim dhe eksporte. Plani nënvizon edhe nevojën për të përshpejtuar zbatimin e modelit "Spiralja e Trefishtë", duke u fokusuar në bashkëpunimin ndërmjet akademikëve, biznesit dhe qeverisë. Sipas këtij Plani, prioritet afatmesme kryesore janë rritja e mbështetjes për kërkimin shkencor dhe miratimi i Strategjisë për Specializimin Inteligjent.

2.5. Mësimet e nxjerra dhe lidhjet me asistencën financiare të mëparshme

Veprimi është vazhdim i drejtpërdrejtë i fazës së parë të projektit të BE-së për Novacion i financuar në kuadër të IPA 2017. Nga aktivitetet e kryera, janë nxjerrë mësimet në vijim.

Ekspozimi dhe bashkëpunimi me arenën evropiane të *startup*-eve është thelbësor për zhvillimin e palëve të ekosistemit shqiptar. Gjithashtu, përvojat dhe metodikat ndërkombëtare duhet të përshtaten me kontekstin vendas. Përvoja e vyer në përshtatjen e partneriteteve dhe metodikave ndërkombëtare me kontekstin vendas, e fituar gjatë fazës 1 si në asistencë teknike ashtu me grante, duhet të merret parasysh duke synuar arritjen e qëndrueshmërisë më të madhe.

[20] Partnerë të tjerë të Nismës për Novacionin Dixhital dhe Përshkallëzimin janë Banka Evropiane e Investimeve, Fondi Evropian i Investimeve, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Banka Botërore dhe Korporata Ndërkombëtare e Financës.
[21] https://ec.europa.eu/digital-single-market/en/neës/launch-digital-innovation-and-scale-initiative-central-eastern-and-south-eastern-europe
[22] https://ëbc-rti.info/object/neës/21037/attach/1_ËB-Agenda_061020.pdf; https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/147b015e-09dd-11eb-bc07-01aa75ed71a1/
[23] https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52020SC0223&from=EN
[24] https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/communication_on_ëb_economic_and_investment_plan_october_2020_en.pdf

Gjatë fazës së parë të programit "BE-ja për Novacionin" në kuadër të IPA 2017, 500 aplikime për grant nga bizneset *startup* dhe OMN-të u vlerësuan nën tri Thirrje për Projekt-propozime[25]. 23 *startup*-e u shpallën fituese. Numri i lartë i aplikimeve, shumë prej tyre me cilësi të ulët, tregon nevojën për të forcuar shërbimet këshillimore profesionale dhe të fokusuara.
Programet e granteve me fokus të qartë tematik ose grup të synuar kanë më shumë ndikim, sepse mund t'iu ofrojnë *startup*-eve mbështetje më specifike, konkrete dhe të orientuar drejt kërkesës. Për të siguruar sinergji të forta ndërmjet zhvillimit të kapaciteteve dhe mbështetjes financiare të Veprimit, rëndësi parësore ka përcaktimi i unifikuar dhe i qartë i grupeve të synuara dhe i përfituesve potencialë të skemës së grantit. Kushtet kryesore për dhënien e grantit do të konsultohen me palët e interesuara përpara se të shpallet secila skemë granti, në mënyrë që të rritet fokusi dhe cilësia e aplikimeve. Aplikantët e refuzuar do të marrin sqarime individuale në mënyrë që të kuptojnë arsyet e refuzimit dhe të përmirësojnë performancën e tyre sipas rastit (rasti ideal është që ky përmirësim të vijë me mbështetjen e Veprimit në zhvillimin e kapaciteteve të tyre).

Komplimentariteti, sinergjia dhe koordinimi i donatorëve
Grumbullimi i ekspertizës, burimeve dhe buxheteve nga projektet dhe ndërhyrjet në fushën e promovimit të sipërmarrjes, synon të krijojë një masë kritike dhe efekte sinergjie.

Programi ProSEED që po zbatohet nga GiZ në Shqipëri dhe që financohet nga Ministria Federale Gjermane për Zhvillim Ekonomik dhe Bashkëpunim, synon të përmirësojë situatën e punësimit në tregun e punës për fuqinë punëtore dhe të vetëpunësuarit, sidomos të rinjtë që zotërojnë aftësi. Nën komponentin për zhvillimin e sektorit privat, ProSEED mbështet në rrjet që ofron shërbime zhvillimi biznesi për MNVM-të që në fazën e hershme të krijimit.

Programi Zviceran për Sipërmarrjen (EP 2015-2023) është një program global që zbatohet nga *Swisscontact* me fondet e Sekretariatit Zviceran të Shtetit për Çështjet Ekonomike. Programi synon të forcojë ekosistemet sipërmarrëse fillestare, duke ofruar mbështetje për ndërtuesit-inkubatorët e ekosistemeve vendore, përshpejtuesit, hapësirat e përbashkëta të punës, rrjetet e engjëjve ose kapitalin e përbashkët dhe sipërmarrësit. Në Shqipëri, programi mbështet shtatë organizata të ekosistemeve.

EU4Tech (2020-2021) është një program rajonal për Ballkanin Perëndimor, i cili ofron mbështetje për projektet premtuese të bazuara në teknologji në fazën e "Testimit të Konceptit" (PoC). Projektet nga organizatat kërkimore publike, *startup*-et ose NVM-të mbështeten nga një ekip ekspertësh me qëllim që të certifikojnë dhe mbrojnë teknologjinë e zhvilluar rishtazi, të zhvillojnë një model të fortë biznesi dhe ta çojnë projektin më afër tregut.

Programi "Star Venture" i BERZh-it zbatohet në Ballkanin Perëndimor përfshirë Shqipërinë dhe synon *startup*-et premtuese, përshpejtuesit dhe konsulentët që të shpalosin të gjithë potencialin e tyre.

Mekanizmi për Zhvillimin e Sipërmarrjeve dhe Novacionit në Ballkanin Perëndimor (ËB EDIF) i financuar nga BE-ja, synon të përmirësojë aksesin në financime për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) në Ballkanin Perëndimor. Ky mekanizëm është ideuar që të ofrojë instrumente financiare plotësuese në ndihmë të të gjithë gamës së NVM-ve në Ballkanin Perëndimor që kanë nevojë për financime. Programi filloi të jepte financime në Shqipëri përmes Instrumentit të Garancisë të zbatuar përmes bankave tregtare.

BE-ja për Ekonominë Qarkulluese dhe Rritjen e Gjelbër - Ky Veprim i planifikuar në kuadrin e IPA 2021 do të kontribuojë në përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit si dhe në zhvillimin e ekonomisë qarkulluese dhe rritjes së gjelbër të qëndrueshme në Shqipëri.

3. PËRSHKRIMI I VEPRIMIT

3.1. Rezultatet e planifikuara dhe logjika e ndërhyrjes

Veprimi synon të rritë konkurrueshmërinë dhe rimëkëmbjen socio-ekonomike pas COVID-it, përmes përmirësimeve në mjedisin e biznesit, ekosistemin e novacionit dhe klimën e investimeve. **Rezultati i këtij Veprimi (Rritje e pjekurisë dhe ekspozimit të ekosistemit shqiptar të *startup*-eve dhe novacionit si dhe e palëve të interesit)** do të arrihet përmes katër Produkteve.

Produkti 1: Zhvillohen kapacitetet në funksion të ekosistemit të *startup*-eve dhe novacionit.
Ky produkt fokusohet në nxitjen e subjekteve të reja publike dhe private që të hyjnë në ekosistemin shqiptar të *startup*-

[25] Thirrja e katërt është shpallur në vitin 2021.

eve dhe novacionit dhe të plotësojnë/zgjerojnë shërbimet ekzistuese. Gjithashtu, subjektet ekzistuese do të forcohen që të ofrojnë dhe të furnizojnë shërbime cilësore dhe të qëndrueshme që u shërbejnë më mirë nevojave në zgjerim të *startup*-eve dhe sipërmarrësve. Rritja e numrit të subjekteve (p.sh. mbështetje për përfshirje më të fortë të korporatave dhe pjesëtarëve të komunitetit të diasporës, me qëllimin që të shndërrohet bjerrja aktuale e trurit në kthim të trurit) dhe e shërbimeve, do të ndihmojë në forcimin e ekosistemin dhe shtrirje më të madhe të tij. Mentorimi i subjekteve do të forcojë cilësinë e shërbimeve. Nevoja për ndërgjegjësim në lidhje me ekonominë dixhitale, të gjelbër dhe qarkulluese është e integruar në këtë produkt. Qëllimi është që të nxiten dhe të mbështeten palët e ekosistemit që të rimodelojnë operacionet e tyre siç duhet.

Produkti 2: Përmirësohet aksesi në financime
Deri në vitin 2019, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) drejtonte katër skema mbështetëse për NVM-të, kryesisht për konkurrueshmërinë, ekonominë krijuese, mbështetjen për NVM-të *startup* dhe novacionin. Megjithatë, për shkak të pandemisë në vitin 2020, fondet e alokuara nga buxheti i shtetit për këto skema u rialokuan në masa mbështetëse për NVM-të që të kapërcejnë efektet e pandemisë. Më 25 maj 2021, Shqipëria shpalli platformën online për aksesin në financime (https://aida-smefinance.gov.al/) nën menaxhimin e AIDA-s, me qëllim që të mbështeten NVM-të që dëshirojnë të zgjerohen dhe të investojnë duke shfrytëzuar mundësitë financiare që ofron tregu, me grante, hua apo nisma të tjera financimi. Kjo platformë online ofron shërbim "me një ndalesë" ku jepet menjëherë informacion për aksesin në financime për NVM-të, nga ana e subjekteve të ndryshme private apo publike, organizata apo shoqëri tregtare, qofshin vendase apo ndërkombëtare. Ekzistojnë disa skema të garancisë kreditore për NVM-të, siç është Fondi i Garancisë për Kredit Rurale (RCGF) që mbështetet nga Banka Gjermane për Zhvillim, i cili ofron hua për agrobujqësinë dhe NVM-të; Programi i Mbështetjes s Agrobiznesit dhe Turizmit, që mbështet bizneset për të marrë kredi nga bankat dhe institucionet financiare jobankare. Mbështetja kryesore *startup*-et drejt novacionit vjen nga Fondi i Sfidës në kuadrin e programit "BE-ja për Novacionin". Kërkesa e lartë për fonde në kuadrin e Programit të Novacionit IPA 2017, tregon pengesat e larta që bizneset *startup* hasin për të marrë financime përmes sistemit të kreditimit. Kjo situatë lë tre mundësi: engjëjt e biznesit, investitorët e kapitalit dhe grantet. E fundit mbështetet nën Produktin 2, bazuar në përvojën e fituar me Fondin e Sfidës gjatë fazës së parë. Meqë shumica e OMN-të ndodhen në Tiranë, skema e grantit synon të nxitë zhvillimin e shërbimeve mbështetëse të OMN-ve edhe jashtë kryeqytetit. Skema e grantit bazohet në supozimin se ka kërkesë prej *startup*-eve dhe OMN-ve për fonde granti, në linjë me politikat e BE-së dhe ato kombëtare. Qëllimi është që shërbimet *startup* të jenë më të balancuara në territorin e vendit. Skema e grantit "BE-ja për Novacionin" do të financojë 50 biznese *startup* në fazën e hershme ose të rritjes, si edhe 15 OMN që janë subjekte ekzistuese apo të reja. Zbatimi do të përfshijë partnerë sektorialë në përputhje me Kodin Evropian të Sjelljes për Partneritetin. Skema e grantit do të menaxhohet direkt nga zbatuesit, me përfshirjen e fortë të sektorit publik dhe privat, me qëllimin që në njëfarë pike të dorëzohet Skema ose të ngrihet një Fond Novacioni gjatë kohëzgjatjes së projektit, sapo të piqen kushtet. Në përgjithësi, skema e grantit nuk është i vetmi instrument financues që ofron faza e re. Veprimi do të eksplorojë edhe mundësitë për të krijuar një Fond Kapitali, një rrjet të Engjëjve të Biznesit dhe instrumentin e grumbullimit të fondeve. Ky produkt do të rezultojë në krijimin e bizneseve të reja dhe/ose rritjen e *startup*-eve, si dhe në shërbime të reja/të përmirësuara të OMN-ve për të mbështetur më tej sipërmarrjen dhe zhvillimin e biznesit falë mundësive të përmirësuara për financime në kuadrin e Veprimit, me burime të identifikuara qartë për rritjen e gjelbër dhe transformimin dixhital.

Produkti 3: Promovohet dhe zbatohet modeli "Spiralja e Katërfishtë"
Objektivi i kësaj ndërhyrjeje është prishja e izolimit tradicional midis sipërmarrjeve, universiteteve dhe qeverisë, si dhe prezantimi i shoqërisë civile si shtresa e katërt e sistemit të novacionit. Modeli bazohet në shoqërinë e dijes, duke sjellë bashkë këndvështrime dhe praktika shumëdisiplinore në një mjedis që promovon punën në grup, bashkëpunimin dhe shkëmbimin e ideve. Duke punuar së bashku, palët që formojnë "Spiralen e Katërfishtë" mund të krijojnë vlera ë përbashkëta nga të cilat përfitojnë të gjithë pjesëmarrësit, duke forcuar kështu ekosistemin e novacionit. Ideja është që të ngushtohet hendeku u bashkëpunimit midis palëve të novacionit, duke nxitur marrëdhëniet sistemike midis universiteteve, industrisë, qeverisë dhe shoqërisë civile, si një çelës drejt novacionit dhe specializimit inteligjent. Modeli e kupton se paradigma e novacionit nuk është një model linear dhe se cilësia e institucioneve dhe burimet e jashtme të dijeve kanë rëndësi parësore për ritmin e inovacionit. Mbështetja për specializimin inteligjent bazohet në kushtet dhe nevojat vendore, duke synuar kalimin në një ekonomi dixhitale, të gjelbër dhe të qëndrueshme. Do të synohet bashkëpunim i fortë dhe sinergji me Veprimin "Ekonomia Rrethore" të IPA 2021. Ky produkt do të rezultojë në pjekuri më të madhe të ekosistemit të *startup*-eve dhe novacionit, si dhe në forcimin e modelit "Spiralja e Katërfishtë".

Produkti 4: Promovimi i Shqipërisë si ekosistem për *startup*-et dhe novacionin dhe si destinacion për novatorët dhe sipërmarrësit ndërkombëtarë dhe të huaj (Fusha e mbështetjes #4)
Arsyetimi është që të informohen partnerët kombëtarë mediatikë në lidhje me ekosistemin e novacionit dhe potencialin dhe mundësitë që u paraqiten *startup*-eve shqiptare gjatë kalimit në ekonominë dixhitale dhe të gjelbër, si edhe që të rritet ndërgjegjësimi i medias dhe i komunitetit novator ndërkombëtar.

3.2. Aktivitetet indikative

Veprimi do të mbështesë arritjen e **Produktit 1** përmes **asistencës teknike** dhe **dialogut mbi politikat**. Do të realizohen masat të zhvillimit të kapaciteteve si aktivitetet këshilluese dhe mentoruese për të përmirësuar shërbimet ekzistuese të biznesit dhe futjen e shërbimeve të reja në treg, trajnime dhe organizime aktivitetesh. Zhvillimi i kapaciteteve do të shënjestrojë *startup*-et, OMN-të, universitetet, palët e interesuara publike, korporatat dhe komunitetin e gjerë të biznesit, përfshirë pjesëtarët e diasporës (metoda përputhshmërie midis diasporës shqiptare dhe *startup*-eve, me qëllim që të nxitet bashkëpunimi dhe investimet në biznes), si dhe palë financiare jokredituese (engjëjt e biznesit, platformat e grumbullimit të fondeve [*crowdfunding*]).

Produkti 2 do të arrihet përmes **skemës së grantit**. Skema e grantit "BE-ja për Novacionin" do të zbatohet mbi baza konkurruese, duke kombinuar ngritjen e kapaciteteve me mbështetjen financiare. Aktivitetet kryesore do të jenë hartimi i detajuar i skemës, promovimi i skemës dhe udhëzimet për aplikantët, përzgjedhja e projekteve, kontraktimi, udhëzuesi përfituesit, menaxhimi i kontratave, verifikimet e menaxhimit (kontrollet administrative dhe ato në terren), pagesat, raportimi, si dhe masat e vizibilitetit. Për ngritjen institucionale të fondit, disa skenarë janë të ndryshëm: skema e grantit mund të menaxhohet nga i deleguari Menaxher Fondi në bashkëpunim me një institucion vendor, duke forcuar kështu ekspertizën e menaxhimit të granteve brenda ekosistemit vendor; dhe/ose mund të ngrihet një bord ose organ këshillimor i përbërë nga palët publike përkatëse, i cili ofron udhëzime dhe monitorim për të rritur kapacitetet qeverisëse të sektorit publik. Për të zgjedhur alternativën më të mirë nisur nga konteksti vendas, kryesore do të jenë avantazhet krahasuese të subjekteve të identifikuara, ekspertiza e fortë në sektor dhe përvoja në ngritjen dhe menaxhimin e këtyre lloj skemave (bazuar në përvojën e suksesshme me Fondin e Sfidës gjatë fazës së parë), por duke marrë parasysh modelet më të avancuara të fondeve të novacionit në Serbi dhe Maqedoni të Veriut.

Produkti 3 do të arrihet përmes: **asistencës teknike, dialogut mbi politikat** dhe **përforcimit të sistemeve** të Shqipërisë. Ky produkt do të arrihet përmes shërbimeve këshillimore të aktorëve të "Spirales së Katërfishtë" dhe aktivitete lehtësuese (p.sh. maratona informatike, konkurse) të organizuara prej tyre për të mbështetur novacionin si dhe kalimin drejt ekonomisë së qëndrueshme, të gjelbër dhe dixhitale në Shqipëri. Ndihma që do t'u jepet grupeve kërkimore/studiuesve nga universitetet shqiptare konsiston në mbështetje për përputhshmëri (kontakte për bashkëpunim), uorkshope dhe trajnime. Universitetet do të mbështeten që të përfshijnë në kurrikula kurse të reja ose të përmirësuara mbi sipërmarrjen. Për të shfrytëzuar novacionin dhe për të trajtuar sfidat e gjelbra në nivel vendor, komunitetet dhe autoritetet vendore do të mbështetën që të identifikojnë së bashku sfidat e gjelbra dhe të ndërtojnë zgjidhje që i adresojnë drejtpërdrejtë. Do të nxitet edhe rritja e ndërgjegjësimit mbi dobitë që sjell kalimi nga praktikat tradicionale në praktikat e gjelbra. Për të përmirësuar jetën e përditshme të qytetarëve, do të vihen në zbatim nisma që përmirësojnë dhënien e shërbimeve publike përmes aplikimit të teknologjive të reja me fokus të veçantë te alternativat e gjelbra si dhe që fusin konceptin e ekonomisë qarkulluese dhe rigjeneruese, duke i ndërthurur incentivat në mbështetje të modeleve të qëndrueshme të punës/biznesit. Aktivitete intensive ndërgjegjësimi do të organizohen në nivel komuniteti, sidomos jashtë kryeqytetit, ku modeli i komunitetit të gjelbër është i mundur të arrihet. Të tjera nisma të planifikuara në kuadrin e këtij Veprimi janë edhe seminaret edukuese, mundësitë eksperimentuese për t'u bërë ekologjikë, si edhe partneritetet me qeverisjen vendore dhe industrinë që të ulin nivelin/gjurmën e ndotjes.

Produkti 4 do të arrihet përmes **asistencës teknike**. Ky produkt do të arrihet përmes marrëdhënieve publike, bashkëpunimit me shtypin dhe aktiviteteve të dedikuara të ndërgjegjësimit dhe informimit për operatorët mediatikë, si edhe organizimeve për ekosistemin (p.sh. uorkshope, takime, aktivitete për krijime të përbashkëta).

3.3. Risqet dhe supozimet

Risqet	**Niveli i riskut (L/M/U)**	**Masat zbutëse**
Mungesa në burime njerëzore, luhatja e kapaciteteve dhe largimet e larta të personelit në institucionet partnere (publike dhe private) pengojnë përthithjen normale të ndërhyrjeve nën këtë Veprim.	M	Planifikimi i hollësishëm i Veprimit u mundëson të gjithë Palëve që të marrin pjesë në aktivitete. Për të sapoardhurit në sistem, Veprimi ka parashikuar aktivizim fleksibël të masave për ndërtim kapacitetesh bazë.
Progresi i ulët i autoriteteve kombëtare në hartimin e Strategjisë për Specializimin Inteligjent.	M	Masat mbështetëse identifikohen, miratohen dhe zbatohen. Përgjegjësitë më të qarta dhe arkitektura e duhur institucionale do të përshpejtojnë procesin S3.
Pandemia COVID-19 vazhdon të ndikojë te sipërmarrësit dhe OMN-të private (p.sh. vendet e përbashkëta të punës) duke ua vështirësuar	M	Zbatimi i ndërhyrjeve që mbështesin përshtatjen e modeleve të biznesit përmes strategjive të rezistencës.

planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve të biznesit.		
Interesim i ulët i sipërmarrësve potencialë për mundësitë që ofron tranzicioni i gjelbër dhe dixhital.	U	Fushata promovuese dhe informuese që synojnë sipërmarrësit potencialë.
Mbështetja për *startup*-et dhe novacionin përqendrohet në kryeqytet dhe ka efekt të ulët domino në mbarë vendin.	M	Aktivitete me OMN-të që funksionojnë jashtë kryeqytetit dhe masa pilot / aktivitete për novacionin komunitar në qytete të tjera jashtë kryeqytetit.
Konkurrueshmëria ndërkombëtare sipërmarrësve shqiptarë është shpesh e kufizuar, teksa tregjet vendase ofrojnë pak mundësi për rritje.	M	Ofrimi i programeve të përshtatura që synojnë specifikisht të përmirësojnë aksesin në tregjet ndërkombëtare dhe të evidentojnë avantazhet krahasuese të *startup*-eve shqiptare.
Supozimet (do të reflektohen në Matricën e Kuadrit Logjik më lart) të grupuara sipas produkteve dhe rezultateve		
Rezultati: Të gjitha palët e interesuara bashkëpunojnë aktivisht në fushën e novacionit dhe sipërmarrjes dhe në zbatimin e politikave.		
Produkti 1 • Organizatat e Mbështetjes së Novacionit janë të gatshme të zgjerojnë shërbimet e tyre për *startup*-et, që të nxisin zhvillimin e novacionit dhe biznesit në fushën e ekonomisë dixhitale, të gjelbër dhe të qëndrueshme. • *Startup*-et shqiptare kanë aftësinë të zhvillojnë produkte dhe shërbime me potencial suksesi në tregun vendas, por edhe në atë rajonal/ndërkombëtar, si dhe arrijnë të shfrytëzojnë mundësitë që ofron tranzicioni dixhital dhe i gjelbër. • Ekziston kërkesa nga *startup*-et për shërbimet që ofrojnë Organizatat e Mbështetjes së Novacionit, si edhe për Trajnimin e Gatishmërisë për Investime që organizon Veprimi. • Biznesmenët shqiptarë tregojnë interes që të bëhen Engjëj Biznesi dhe janë të gatshëm të bashkëpunojnë brenda një rrjeti të sapokrijuar të Engjëjve të Biznesit. • Komuniteti i diasporës është i motivuar që të nxitë dhe të bashkëpunojë me *startup*-et shqiptare. • Të paktën një nga platformat e reja apo ekzistuese të *crowdfunding* në Shqipëri është e gatshme të integrojë një opsion pilot *crowdfunding* që mbështetet nga ky Veprim.		
Produkti 2 • Ekziston kërkesa për fonde granti nga *startup*-et dhe OMN-të që është në linjë me politikat e BE-së dhe ato kombëtare, si dhe me synimin për të ofruar shërbime më të balancuar për *startup*-et në tërë territorin. • Ekzistojnë vullneti politik, kapacitetet institucionale dhe kuadri rregullator, si edhe burimet përkatëse		
Produkti 3 • Palët e "Spirales së Katërfishtë" dhe institucionet bashkëpunojnë në fushën e novacionit dhe sipërmarrjes. • Qeveria është e përkushtuar që të çojë përpara politikat për *startup*-et dhe NVM-të si dhe strategjinë e specializimit inteligjent. • Tregu ofron mundësi të pashfrytëzuara në fushat e ekonomisë së gjelbër si efiçenca e energjisë dhe praktikat e ekonomisë së gjelbër. • Vendoset bashkëpunimi me palët e Veprimit "Ekonomia Qarkulluese" të financuar nga IPA III si dhe arrihet sinergjia mes të dy Veprimeve.		
Produkti 4 • Media shfaq interes që të kuptojë më shumë mbi ekosistemin e novacionit në Shqipëri dhe të raportojë mbi këto mundësi dhe historitë e suksesit. • Komuniteti ndërkombëtar i novacionit është i hapur të përqafojë mundësitë për punë në Shqipëri.		

3.4. Harmonizimi me sektorë të tjerë

Veprimi do të kontribuojë në barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, duke përfshirë perspektivën në të gjitha aktivitetet. Në veçanti, barrierat kulturore në shoqërinë shqiptare që priren të bllokojnë mundësitë e sipërmarrjes dhe novacionit për gratë, trajtohen bazuar në analizën gjinore të kryer gjatë fazës së parë të projektit "BE-ja për Novacionin". Vëmendje duhet t'i kushtohet në nivel komuniteti fuqizimit ekonomik të grave në epokën dixhitale. Veprimi do të përditësojë analizën gjinore ekzistuese, me qëllimin që të integrojë perspektivën gjinore në të gjitha programet, skemat e financimit, fushatat promovuese, raportet e politikave dhe vlerësimet, si edhe të arrijë ndarjen e të dhënave sipas gjinisë. Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike do të trajtohen drejtpërdrejt nga aktivitetet e projektit përmes mbështetjes për *startup*-et që punojnë në ekonominë qarkulluese, si dhe nxitjen e modelit "Spiralja e Katërfishtë" për tranzicionin e gjelbër. Për më tepër, kalimi në modelin "Spiralja e Katërfishtë" e sheh shoqërinë civile si një lojtar qendror në

ekosistemin e novacionit, përmes angazhimit sistematik nga i cili përfiton i gjithë komunitetin. Mundësitë për të adresuar sfidat me të cilat përballen grupet vulnerabël në Shqipëri (p.sh. pakicat rome dhe egjiptiane dhe personat me aftësi të kufizuara) dhe për t'i përfshirë në mënyrë aktive në aktivitetet e krijimeve të përbashkëta do të mbahen parasysh veçanërisht në aktivitetet nën Produktin 3 (sfidat e trajtuara përmes bashkëpunimit të palëve të "Spirales së Katërfishtë").

3.5. Kushtet për zbatimin

Sipas rekomandimeve të Raportit të fundit të Monitorimit të Orientuar drejt Rezultateve (ROM) dhe mësimeve të nxjerra nga skema e financimit në kuadrin e programin "BE-ja për Novacionin – Faza I",

- Ligji për *Startup*-et do të miratohet para fillimit të programit. Miratimi më pas i akteve nënligjore është kusht për disbursimin e buxhetit të parashikuar për Skemën e Grantit: a) "Organizimi dhe funksionimi i brendshëm i Agjencisë" (neni 11, pika 7), si dhe b) "Rregullat për përzgjedhjen, shpërblimin, organizimin e brendshëm dhe zbatimin e detyrave të Bordit të Vlerësimit për *Startup-et* Novatore (neni 13, pika 4)
- duhet të garantohen përgjegjësi të qarta për çështjen e novacionit në institucionet qendrore si edhe buxheti operacional.

Mosrespektimi i kushteve të renditura më lart mund të rezultojë në rikuperim të fondeve në kuadrin e këtij programi dhe/ose rialokimin e financimeve të ardhshme.

3.6. Kuadri Logjik

Rezultatet	Zinxhiri i rezultateve: Rezultatet kryesore të pritshme	Treguesit	Viti bazë	Synimet (viti)	Burimet e të dhënave (1 për tregues)	Supozimet
Ndikimi	Të rritet konkurrueshmëria dhe rimëkëmbja socio-ekonomike pas COVID-it, përmes përmirësimeve në mjedisin e biznesit, ekosistemin e novacionit dhe klimën e investimeve.	Rezultati në "Të bërit Biznes"	67,7 në 2020	Afërsisht 10% rritje, 74,47 në 2027	Banka Botërore	*Nuk aplikohet*
Rezultati 1	Rritje e pjekurisë dhe ekspozimit të ekosistemit shqiptar të *startup*-eve dhe novacionit si dhe e palëve të interesit.	Numri i subjekteve publike dhe private brenda sistemit shqiptar të *startup*-ve dhe novacionit që kanë përmirësuar kapacitetet që të mbështesin sistemin e *startup*-it dhe novacionit në kuadrin e modelit "Spiralja e Katërfishtë".	0	Min. 30	Raportet e Veprimit, që shpjegojnë për secilin subjekt të llogaritur për këtë tregues se si masat e forcimit të kapaciteteve kanë rezultuar në kapacitete të përmirësuara	Të gjitha palët e interesuara bashkëpunojnë aktivisht në fushën e novacionit dhe sipërmarrjes dhe në zbatimin e politikave.
		Numri i OMN-ve të angazhuara në aktivitete bashkëpunimi me OMN ndërkombëtare (përfshirë BP6)	0	Min. 9	Të dhënat dhe Raportet Vjetore të OMN-ve.	
		Numri i *startup*-eve / sipërmarrësve (aspirues) që raportojnë se kanë ngelur të kënaqur me shërbimet e ofruara prej OMN-ve shqiptare (p.sh. inkubatorët përshpejtuesit, universitetet).	0	Min. 200 (ndarë sipas atyre që drejtohen nga gratë)	Anketë bashkë me OMN-të që ofrojnë shërbime për *startup*-et dhe sipërmarrësit	
		Numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet klasterave kërkimore universitare të mbështetura dhe operatorëve industrialë vendas ose ndërkombëtarë të lehtësuara nga Veprimi.	0	Min. 4	Raportet e Veprimit	
		Shërbimet dhe/ose zgjidhjet e reja dixhitale/të gjelbra të vëna në zbatim në bashkitë pilot/të përzgjedhura.	0	Min. 2	Raportet e Veprimit.	
Produkti 1	Zhvillohen kapacitetet e palëve të interesuara në funksion të ekosistemit të *startup*-eve dhe novacionit.	Numri i bizneseve (*startup*-et dhe/ose sipërmarrësit) që kanë përfituar nga aktivitetet mbështetëse (p.sh. programet e inkubacionit dhe përshpejtimit, trajnimet dhe seminaret që fokusohen në novacion) të organizuara dhe/ose të ndihmuara nga	200 në 2021	Min. 500 (Veprimi (ndarë sipas gjinisë, përdoruesve që përfitojnë nga shërbimet për herë të parë,	Dokumentacioni dhe raportet (p.sh. listat e pjesëmarrësve) të ndërhyrjeve të zbatuara dhe të mbështetura. Të dhënat bazë merren nga	Organizatat e Mbështetjes së Novacionit janë të gatshme të zgjerojnë shërbimet e tyre për *startup*-et, që të nxisin zhvillimin e novacionit dhe biznesit në fushën e

Rezultatet	Zinxhiri i rezultateve: Rezultatet kryesore të pritshme	Treguesit	Viti bazë	Synimet (viti)	Burimet e të dhënave (1 për tregues)	Supozimet
		Veprimi (ndarë sipas gjinisë, përdoruesve që përfitojnë nga shërbimet për herë të parë, bizneseve "gjelbra/qarkulluese").		biznesëve "gjelbra/qarkulluese").	Faza I e Programit "BE-ja për Novacionin".	ekonomisë dixhitale, të gjelbër dhe të qëndrueshme. *Startup*-et shqiptare kanë aftësinë të zhvillojnë produkte dhe shërbime me potencial suksesi në tregun vendas, por edhe në rajonal/ndërkombëtar, si dhe arrijnë të shfrytëzojnë mundësitë që ofron tranzicioni dixhital dhe i gjelbër.
		Numri i *startup*-eve që përfunduan Programin e Gatishmërisë për Investime të organizuar nga Veprimi dhe që janë gati për investime (d.m.th. kanë dokumentet dhe procedurat e kërkuara, përfshirë procesin e kujdesit të duhur) për të aplikuar për financim dhe/ose për të kërkuar investime.	0	Min. 30 (ndarë sipas atyre që drejtohen na gratë)	Raportet dhe dokumentacioni i aktiviteteve të realizuara nga Programi i Gatishmërisë për Investime	Ekziston kërkesa nga *startup*-et për shërbimet që ofrojnë Organizatat e Mbështetjes së Novacionit, si edhe për Trajnimin e Gatishmërisë për Investime që organizon Veprimi. Biznesmenët shqiptarë tregojnë interes që të bëhen Engjëj Biznesi dhe janë të gatshëm të bashkëpunojnë brenda një rrjeti të sapokrijuar të Engjëjve të Biznesit. Komuniteti i diasporës është i motivuar që të nxitë dhe të bashkëpunojë me *startup*-et shqiptare. Të paktën një nga platformat e reja apo ekzistuese të *crowdfunding* në Shqipëri është e gatshme të integrojë
		Numri i programeve mbështetëse të zhvillimit të kapaciteteve të ofruara për *startup*-et në fazën e rritjes, duke u fokusuar kryesisht në novacion (p.sh. programet e specializuara të përshpejtimit, programi i gatishmërisë për investime) dhe numri i programeve mbështetëse të zhvillimit të kapaciteteve për *startup*-et në fazat e hershme që fokusohen kryesisht në novacion (p.sh. programet e inkubacionit të universiteteve) të mbështetura nga Veprimi.	6 (programe për *startup*-et në fazat e hershme aktualisht në vazhdim në Shqipëri) për vitin 2021 3 (programe për fazat e rritjes *startup*-et aktualisht në vazhdim në Shqipëri) për 2021	Min. 8 Min. 10	Dokumentacioni i programeve mbështetëse (p.sh. planet e trajnimit), Raportet e trajnimeve dhe metodologjitë e aplikuara, ftesat, materialet e Marrëdhënieve me Publikun) dhe zbatimi i tyre (p.sh. ftesat, gjimia)	
		Numri i aktiviteteve të organizuara nga një rrjet i sapokrijuar shqiptar i Engjëjve të Biznesit (p.sh. takime e përputhshmërisë me *startup*-et, seminare për engjëj të mundshëm investitorë) të mbështetur nga Veprimi.	0	Min. 6	Të dhënat/dokumentet që vërtetojnë ekzistencën e Rrjetit të Engjëjve të Biznesit dhe dokumentacioni i aktiviteteve të organizuara	

Rezultatet	Zinxhiri i rezultateve: Rezultatet kryesore të pritshme	Treguesit	Viti bazë	Synimet (viti)	Burimet e të dhënave (1 për tregues)	Supozimet
		Mentorimi i diasporës për *startup*-et shqiptarë, që është mbështetur.	12 në2021	25 (ndarë sipas atyre të drejtuara nga gratë)	Raportet e Veprimit dhe dokumentacioni i bashkëpunimeve të mentorimit të diasporës (Të dhënat bazë nga Faza I e programit "BE-ja për Novacionin)	një opsion pilot crowdfunding që mbështetet nga ky Veprim.
		Një opsion pilot grumbullimi fondesh (crowdfunding) i mbështetur nga Veprimi që është integruar në një platformë të re apo ekzistuese shqiptare (p.sh. Platforma Online e Ekosistemit).	0	1	Dokumentacioni i opsionit *crowdfunding;* dokumentacioni i platformës.	
Produkti 2	Përmirësohen dhe diversifikohen mundësitë e financimit për *startup*-et dhe OMN-të shqiptare.	Numri i OMN-ve që morën financime nga Skema e Grantit.	0	Min. 15	Raportet e monitorimit dhe raportet financiare të Skemës së Grantit.	Ekziston kërkesa për fonde granti nga *startup*-et dhe OMN-të që është në linjë me politikat e BE-së dhe ato kombëtare, si dhe me synimin për të ofruar shërbime më të balancuar për *startup*-et në tërë territorin. Ekzistojnë vullneti politik, kapacitetet institucionale dhe kuadri rregullator, si edhe burimet përkatëse
		Numri i *startup*-eve që morën financime nga Skema Grant, ndarë sipas gjinisë, nënsektorëve "të gjelbër / dixhitalë; grupeve vulnerabël.	0	Min. 50 (ndarë sipas atyre të drejtuara nga gratë, nënsektorëve "të gjelbër / dixhitalë; grupeve vulnerabël.)	Raportet e monitorimit dhe raportet financiare të Skemës së Grantit.	
		Numri i instrumenteve të ngjashme me Fondin e Novacionit / Skemën e Grantit të ngritura, ose metodologjia e tyre i është dorëzuar një institucioni vendor të përshtatshëm.	0	1	Raportet e Veprimit dhe manualet operacionale të Fondit të Novacionit ose Skemës së Grantit; aktet legjislative / rregullatore përkatëse	
Produkti 3	Modeli "Spiralja e Katërfishtë" promovohet dhe zbatohet	Raporte këshilluese politikash të hartuar dhe që iu janë drejtuar politikëbërësve dhe agjencive publike përkatëse shqiptare.	3	Min. 6	Raportet e Veprimit (të dhënat bazë nga Faza I e Programit "BE-ja për Novacionin")	Palët e "Spirales së Katërfishtë" dhe institucionet bashkëpunojnë në fushën e novacionit dhe sipërmarrjes. Qeveria është e përkushtuar që të çojë përpara politikat për *startup*-et dhe NVM-të si dhe strategjinë e specializimit inteligjent.
		Numri i pjesëmarrësve që ndoqën uorkshopet dhe trajnimet nga politikëbërësit dhe agjencitë publike përkatëse shqiptare.	30 në 2021	Min. 70 (ndarë sipas gjinisë)	Raportet e trajnimeve. Të dhënat bazë nga Faza I e Programit "BE-ja për Novacionin".	
		Numri i aktiviteteve (p.sh. maratonat informatike, konkurset) të organizuara	0	Min. 10	Dokumentacioni dhe raportet e aktiviteteve.	

Rezultatet	Zinxhiri i rezultateve: Rezultatet kryesore të pritshme	Treguesit	Viti bazë	Synimet (viti)	Burimet e të dhënave (1 për tregues)	Supozimet
		nga palët e "Spirales së Katërfishtë" në mbështetje të novacionit, përfshirë për tranzicionin e qëndrueshëm, të gjelbër dhe dixhital në Shqipëri.				Tregu ofron mundësi të pashfrytëzuara në fushat e ekonomisë së gjelbër si efiçenca e energjisë dhe praktikat e ekonomisë së gjelbër. Vendoset bashkëpunimi me palët e Veprimit "Ekonomia Qarkulluese" të financuar nga IPA III si dhe arrihet sinergjia mes të dy Veprimeve.
		Numri i grupeve/klasterave kërkimore nga universitetet shqiptare që përfitojnë mbështetje (për përputhje, uorkshope dhe trajnime).	0	Min. 12	Dokumentacioni i ndërhyrjeve të mbështetjes (p.sh. materialet e trajnimeve, lista e pjesëmarrësve e ndarë sipas gjinisë) dhe dëshmi e bashkëpunimit të vendosur (p.sh. marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruara, projekte të vëna në zbatim, etj.)	
		Numri i universiteteve shqiptare që kanë futur në kurrikulat e tyre kurse të reja dhe/ose të përmirësuara mbi sipërmarrjen[26].	0	Min. 10	Dokumentacioni i materialeve të kursit dhe shpallja e kursit nga universitetet.	
		Numri i OMN-ve shqiptare të mbështetura për bashkëpunim afatgjatë me OMN- të huaja / shoqata OMN të BE-së.	4 në 2021	Min. 9	Marrëveshje bashkëpunimi / anëtarësime në shoqata (të dhënat bazë nga Faza I e Programit "BE-ja për Novacionin").	
		Numri i OMN-ve/*startup*-ve shqiptare të asistuara që të aplikojnë për mbështetje nga programet e BE-së për novacionin (p.sh. Horizon Europe, shtyllat si Skema Rajonale e Novacionit (EIT) si dhe EIC dhe EIe sapo Shqipëria të asociohet zyrtarisht) dhe në nisma të tjera të BE-së, përfshirë në instrumentet rajonale të	0	Min. 20 (ndarë sipas atyre të drejtuara nga gratë)	Raportet e Veprimit me informacion specifik mbi asistencën e dhënë	

[26] Sipas Ligjit aktual nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Shqipëri, neni 35 "Hapja, mbyllja dhe riorganizimi i programeve të studimit në IAL", pika 9 shprehimisht përcakton se " Institucioni i arsimit të lartë për programe studimi të akredituara mund të bëjë ndryshime profilizuese deri në masën 20 për qind dhe t'i reflektojë ato në diplomën e lëshuar prej tij. Institucioni i arsimit të lartë për programe studimi të akredituara mund të bëjë ndryshime profilizuese deri në masën 20 për qind dhe t'i reflektojë ato në diplomën e lëshuar prej tij. Miratimi i ndryshimeve bëhet nga Senati Akademik dhe për to njoftohet ministria përgjegjëse për arsimin e lartë jo më vonë se gjashtë muaj para fillimit të vitit akademik". Kështu, ministria thjest vihet në dijeni dhe nuk ka të drejtë të japë miratim për ndryshime të kurrikulës me 20%. Senati akademik [rektori i universitetit, personeli mësimdhënës me kohë të plotë që doktoraturë dhe diploma më të larta] është autoriteti miratuar. Linku i ligjit: Ligji-80-2015-Për-Arsimin-e-Lartë-dhe-kërkimin-shkencor-në-Shqipëri.pdf (openuniversity.al)

Rezultatet	Zinxhiri i rezultateve: Rezultatet kryesore të pritshme	Treguesit	Viti bazë	Synimet (viti)	Burimet e të dhënave (1 për tregues)	Supozimet
		ndara sipas nënsektorëve "të gjelbër / dixhitalë". Numri i OMN-ve/*startup*/eve shqiptare të asistuara me aplikime të suksesshme në programet e BE-së për novacionin dhe në nismat e tjera të BE-së, përfshirë në instrumentet rajonale.	0	Min. 2	Raportet e Veprimit	
		Numri i zgjidhjeve të gjelbra dhe/ose dixhitale (p.sh. për riciklimin, transportin, energjinë, klimën) për sfidat e bashkive / qyteteve shqiptare të zhvilluara dhe të pilotuara me përfshirjen e të paktën 3 palëve të "Spirales së Katërfishtë" përmes Veprimit, ndarë sipas nënsektorëve "të gjelbër / dixhitalë".	0	Min. 12	Dokumenti i procesit për secilën sfidë të zgjidhur dhe dokumentacioni i procesit të zbatimit (p.sh. maratonat informatike).	
Produkti 4	Ekosistemi shqiptar i *startup*-eve dhe novacionit promovohet me novatorë dhe sipërmarrës nga vendi dhe ndërkombëtarë.	Numri minimal i artikujve /postimeve për ekosistemin shqiptar (*startup*-et, sipërmarrësit, institucionet) të publikuara në mediat kombëtare dhe ndërkombëtare (artikuj lajmesh, *podcast*-e, media online).	60 në 2021	Min. 250	Artikujt mediatikë dhe dokumentacioni i artikujve dhe postimeve të publikuara (të dhënat bazë nga Faza I e programit "BE-ja për Novacionin").	Media shfaq interes që të kuptojë më shumë mbi ekosistemin e novacionit në Shqipëri dhe të raportojë mbi këto mundësi dhe historitë e suksesit.
		Numri i aktiviteteve të ekosistemit (p.sh. uorkshope, takime, aktivitete për krijime të përbashkëta) të mbajtura, nga të cilat 30% përfshijnë aktorë industrialë, organizuar me mbështetjen e projektit.	100 në 2021	Min. 250 Nga të cilat min. 30% kanë operatorë industrialë.	Dokumentacioni dhe raportet e aktiviteteve (p.sh. programi, materialet promovuese, postimet në median sociale). (Të dhënat bazë nga Faza I e programit "BE-ja për Novacionin").	Komuniteti ndërkombëtar i novacionit është i hapur të përqafojë mundësitë për punë në Shqipëri.

4. MODALITETET E ZBATIMIT

4.1. Marrëveshja e financimit

Për zbatimin e këtij Veprimi, parashikohet lidhja e një marrëveshjeje financimi me Republikën e Shqipërisë.

4.2. Vetëm për mbështetjen buxhetore [Zbatimi i komponentit të mbështetjes buxhetore]

N.A.

4.3. Modalitetet e zbatimit

Komisioni do të garantojë respektimin e rregullave dhe procedurave përkatëse të BE-së për dhënien e financimeve palëve të treta, përfshirë procedurat e rishikimit sipas rastit dhe përputhshmërinë e veprimit me masat shtrënguese të BE-së[27].

4.3.1. Menaxhim Direkt (Grante)

N.A.

4.3.2. Menaxhim Direkt (Çmime)

N.A.

4.3.3. Menaxhim Direkt (Prokurim)

N.A.

4.3.4. Menaxhim indirekt me delegim te subjekti(et) (p.sh. organizatë e Shtetit Anëtar, vend i tretë donator, agjenci e specializuar e BE-së (tradicionale / rregullatore), organizatë ndërkombëtare)

Ky Veprim mund të zbatohet me menaxhim indirekt me Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH, (GIZ) si organizatë kryesore dhe me Agjencinë Suedeze të Bashkëpunimit për Zhvillim (SIDA) si partnere. Zbatimi përfshin Produktet 1 – 4. Subjekti është zgjedhur bazuar në kriteret më poshtë: (i) ekspertiza sektoriale në rritjen e kapaciteteve të ekosistemeve të novacionit; (ii) kapacitetet teknike në zbatimin e projekteve në fushën e krijimit të *startup*-eve novatore; (iii) ekspertiza në hartimin dhe menaxhimin e skemave të grantit dhe nën-granteve; (iv) kapacitetet financiare dhe gatishmëria për të dhënë bashkëfinancim; dhe (v) kapacitete të vërtetuara të GiZ dhe SIDA në zbatimin e kënaqshëm të programit "BE-ja për Novacionin – Faza I", në rritjen e koordinimit dhe efektivitetit të asistencës dhe shfrytëzimi i avantazheve krahasuese të donatorëve dhe ekspertiza në sektor. Mundësia e kontributit financiar 10% si bashkëfinancim do të negociohet me subjektet e besuara si në rastin e programit "BE-ja për Novacionin - Faza I". Nëse subjekti i përzgjedhur duhet të zëvendësohet, shërbimet e Komisionit mund të përzgjedhin një subjekt zëvendësues duke zbatuar të njëjtat kritere përzgjedhjeve si më lart. Nëse subjekti zëvendësohet, vendimi i zëvendësimit duhet të jetë i arsyetuar.

4.3.5. Menaxhimi indirekt me një përfitues IPA III

N.A.

4.3.6. Kontributi për <emri i Instrumentit Miks Rajonal/Platformës>

N.A.

4.3.7. Garancitë buxhetore

N.A.

4.3.8. Ndryshime nga menaxhimi direkt në modalitetin indirekt (dhe anasjelltas) për shkak të rrethanave përjashtimore (një alternativë, opsioni i dytë)

Në raste përjashtimore dhe me miratimin e Komisionit Evropian, ndryshimi nga menaxhimi indirekt në direkt (dhe anasjelltas) është i mundur, ashtu si edhe ndryshimet në modalitetet e menaxhimit dhe prokurimit.

[27] www.sanctionsmap.eu Vini re se harta e sanksioneve është një mjet TI për identifikimin e regjimeve sanksionuese. Sanksionet burojnë nga aktet ligjore të publikuara në Gazetën Zyrtare (GZ). Në rast mospërputhjeje mes akteve ligjore të publikuara dhe përditësimeve në faqen e internetit, mbizotërojnë versionet e publikuara në GZ.

4.4. Shtrirja e pranueshmërisë gjeografike për prokurimet dhe grantet

Pranueshmëria gjeografike në kuptimin e vendit të vendosjes për pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit dhe të dhënies së granteve si dhe në kuptimin e origjinës së artikujve të blerë, sipas aktit bazë dhe dispozitave të dokumenteve kontraktuale, zbatohet sipas dispozitës së mëposhtme:

- Zyrtari përgjegjës autorizues i Komisionit mund të zgjerojë pranueshmërinë gjeografike në rast urgjence apo mungese të shërbimeve në tregjet e vendeve apo territoreve përkatëse, apo në situata të tjera të justifikuara siç duhet, ku aplikimi i rregullave të pranueshmërisë do ta bënte realizimin e këtij Veprimi të pamundur ose tejet të vështirë.

4.5. Buxheti indikativ

Komponentët e Buxhetit Indikativ	**Kontributi i BE-së (në EUR)**	**Kontributi indikativ i palës së tretë (monedhë e identifikuar)**
Produkti 1: Zhvillohen kapacitetet e ekosistemit të *startup*-eve dhe novacionit	1 600 000	N.A.
Produkti 2: Përmirësohet aksesi në financime: skema e grantit	4 600 000 (përfshirë 600,000 për kostot e menaxhimit)	N.A.
Produkti 3: Promovohet dhe zbatohet modeli "Spiralja e Katërfishtë"	3 400 000	N.A.
Produkti 4: Promovohet Shqipëria si ekosistem i *startup*-eve dhe novacionit dhe destinacion për novatorët dhe sipërmarrësit vendas dhe ndërkombëtarë Që konsiston në:	400 000	N.A.
Menaxhim indirekt me Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH, (GIZ) si organizatë kryesore dhe me Agjencinë Suedeze të Bashkëpunimit për Zhvillim (SIDA) si partnere - cf. seksioni 4.3.4	**10 000 000**	N.A.
Vlerësimi, (cf. seksioni 5.3)	mbulohet nga një tjetër vendim	N.A.
Auditi/Verifikimi i shpenzimeve (cf. Seksioni 6)	mbulohet nga një tjetër vendim	N.A.
Komunikimi dhe vizibiliteti (cf. Seksioni 7)	0	N.A.
Kontingjencat	0	N.A.
Totali	**10 000 000**	

4.6. Struktura organizative dhe përgjegjësitë

Veprimi përfaqëson vazhdim të programit "BE-ja për Novacionin - Faza I" në kuadrin e IPA 2017, të zbatuara me menaxhim indirekt nga këto subjekte të besuara: the Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH, (GIZ) i organizatë kryesore dhe Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit për Zhvillim (SIDA) i organizatë partnere. Përgjegjësitë e subjekteve të besuara për këtë Veprim (BE-ja për Novacionin II) përcaktohen në Përshkrimin e Masës dhe në Marrëveshjen e Kontributit.

Delegacioni i BE-së në Shqipëri mbikëqyr zbatimin e Veprimit dhe organizon vlerësime dhe monitorime bazuar në rezultate, sipas rastit.

Homologu kryesor gjatë zbatimit të Veprimit është Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) si Përfituese Kryesore e Veprimit. Parashikohet përfshirje e madhe edhe e palëve të tjera kombëtare: Kryeministria – Drejtoria e Zhvillimit të Politikave dhe Prioriteteve, Sektori i Zhvillimit të Politikave dhe Qeverisjes së Mirë; Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes; Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes; Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit (MARS); Ministri i Shtetit për Diasporën dhe Agjencia Kombëtare për Diasporën; institucioni i varësisë i MFE-së,

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA); si dhe agjencia e varësisë e MARS-it – Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Novacionit (AKKSHI). MFE do të koordinohet ngushtë me to gjatë zbatimit të aktiviteteve. Veprimi zbatohet dhe monitorohet në përputhje me dispozitat e Kodit Evropian të Sjelljes për Partneritetet, i zbatueshëm për të gjitha Veprimet e IPA III.

Koordinatori Kombëtar IPA (KKIPA) ka përgjegjësinë për koordinimin e përgjithshëm të programimit IPA dhe është homologu kryesor i Komisionit Evropian për të gjithë procesin e planifikimit strategjik, koordinimin e programimit, monitorimin e zbatimit, vlerësimin dhe raportimin e asistencës IPA III në nivel programi.

Për koordinimin e përgjithshëm të politikave dhe asistencës së huaj, Qeveria e Shqipërisë ka ngritur një strukturë ndërinstitucionale dhe operacionale për menaxhimin e zbatimit të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) përmes përqasjes sektoriale dhe ndërsektoriale; SPI shërben si sistemi kryesor që përcakton instrumentet dhe mekanizmat për planifikim të integruar të politikave publike. Urdhri nr. 157, datë 22.10.2018 i Kryeministrit rishikoi Grupet e Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP-et) si dhe strukturat e komiteteve drejtuese sektoriale për zbatimin e përqasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale që merren me menaxhimin dhe koordinimin e politikave në fusha prioritare dhe sektorë me rëndësi të veçantë, si dhe me programimin ndërsektorial përmes krijimit të një mekanizmi menaxhimi sektorial /ndërsektorial.

GMIP "Konkurrueshmëria dhe Investimet" siguron koordinimin institucional për këtë Veprim. Grupi tematik (GT) për Konkurrueshmërinë dhe Novacionin siguron bashkëpunimin në nivel teknik, përfshirë me partnerët për zhvillim, brenda sektorëve specifikë të fushës së politikave përkatëse. Komitetit Monitorues Sektorial për Konkurrueshmërinë garanton një sistem cilësor monitorimi dhe raportimi për sektorin.

5. MONITORIMI DHE RAPORTIMI I PERFORMANCËS/REZULTATEVE

5.1. Monitorimi i brendshëm

Aktivitetet e Veprimit do të monitorohen përmes një sistemi monitorimi bazuar në rezultate (MBR). Monitorimi kuptohet si një vëzhgim dhe regjistrim i vazhdueshëm dhe sistematik i progresit të projektit. Objektivat shqyrtohen rregullisht bazuar në treguesit, ndërsa arritjet e projektit vlerësohen nga këndvështrimi i palëve kryesore. MBR gjurmon të gjithë procesin e ndryshimit që nxitet nga projekti dhe është pjesë e pandashme e menaxhimit të projektit. MBR mundëson dialog të rregullat mbi rezultatet, bazuar në të dhëna, si dhe ndihmon në përmirësimin e cilësisë dhe orientimit të rezultateve. Projekti ndjek metodikën e 6 hapave për përgatitjen dhe përdorimin e sistemit MBR.

1. Shqyrton/rregullon modelin e rezultateve.
2. Sqaron kërkesat që duhet të plotësojë sistemi MBR.
3. Bën rezultatet të matshme.
4. Siguron monitorim të hollësishëm dhe harton modelin/formularin MBR.
5. Mbledh dhe analizon të dhënat.
6. Përdor rezultatet e MBR-së.

Sistemi i monitorimit të brendshëm të Veprimit mbledh dhe analizon të dhëna sasiore dhe cilësore, si dhe përditësohet çdo 6 muaj. Kur është e mundur, palët dhe institucionet partnere do të përfshihen në aktivitete monitorimi si pjesë e pandashme e zhvillimit të kapaciteteve, në përputhje me parimet Kodit Evropian të Sjelljes për Partneritetet.

5.2. Rolet dhe përgjegjësitë për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave

Për të drejtuar zbatimin e Veprimit, do të ngrihet një Komitet Drejtues i Projektit (KDP). KDP do të përfshijë përfaqësues nga palët kryesore të interesit, të cilët janë edhe anëtarë të GMIP dhe strukturave GT, si edhe nga KKIPA dhe EUD. Komiteti do të monitorojë nga afër përmbushjen e objektivave dhe rezultateve të Veprimit. KKIPA do të ketë rol monitorues në përmbushjen e objektivave në nivelin e Veprimit. Koordinimi i përbashkët dhe takimet e bashkëpunimit në nivel teknik do të garantojnë lidhje të forta dhe sinergjitë ndërmjet produkteve të ndryshme të Veprimit.

Raportimi për zbatimin e Veprimit fillon me raportin konceptual brenda tre muajsh nga fillimi. Pastaj vazhdon me:

- **Raportin narrativ** 6 mujor/vjetor që përmbledh progresin sipas planit operacional dhe treguesve, duke dokumentuar sfidat dhe planin operacional për vitin në vazhdim.
- Përveç raporteve narrative, **raportet financiare** do të deklarojnë shpenzimet aktuale të kryera dhe angazhimet ligjore në lidhje me periudhën përkatëse të raportimit.

Raporti përfundimtar, që përshkruan arritjet e projektit përkundër treguesve, si dhe jep një përmbledhje të masave të marra për të garantuar qëndrueshmërinë dhe përshkallëzimin e aktiviteteve dhe rezultateve.

Raporti narrativ dhe raporti përfundimtar i përcillen edhe **Komitetit Drejtues të Projektit (KDP).** Komiteti sugjerohet të mblidhet të paktën një herë në vit që të mbikëqyrë dhe të vlerësojë drejtimin përgjithshëm dhe kuadrin e politikave të projektit. Gjithashtu, KPD do të vlerësojë progresin e zbatimit të projektit dhe do t'u japë rekomandime drejtuesve të projektit në përputhje me planet operacionale dhe produktet e përcaktuara. Anëtarët e Komitetit do të marrin, rishikojnë dhe diskutojnë mbi raportet dhe vlerësimet e jashtme të monitorimit, sipas rastit.

Sistemet e monitorimit sektorial janë aktualisht të kufizuara. Veprimi synon të mbështetë përmirësimin e mbledhjes, ruajtjes dhe analizimit të të dhënave në nivel sektorial, si edhe të kontribuojë në forcimin e raportimit.

5.3. Vlerësimi

Nisur nga rëndësia dhe natyra e Veprimit, konsulentë të pavarur të kontraktuar prej Komisionit do të kryejnë një vlerësim përfundimtar për këtë Veprim në tërësi apo komponentë të tij.

Vlerësimi kryhet për qëllime të nxjerrjes së mësimeve, veçanërisht në lidhje me Fushën e Mbështetjes 2, si edhe për të vlerësuar ndikimin e aktiviteteve të propozuara në lidhje me pjekurinë dhe ekspozimin e ekosistemit të novacionit, duke hedhur themelet për planifikimin e aktiviteteve të mëtejshme në mbështetje të novacionit në Shqipëri në fazën e radhës që do të mbështetet nga IPA III. Gjithashtu, vlerësimi do të ketë qëllime llogaridhënieje në nivele të ndryshme (përfshirë rishikimin e politikave), duke pasur parasysh sidomos zbatimin e modelit "Spiralja e Katërfishtë" si mjet për të mbështetur tranzicionin e gjelbër dhe dixhital në Shqipëri.

Komisioni informon partnerin zbatues të paktën tre muaj përpara datave të planifikuara për misionet e vlerësimit. Partneri zbatues bashkëpunon në mënyrë efikase dhe efektive me ekspertët vlerësues si dhe u ofron atyre, ndër të tjera, të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, si edhe akses në ambientet dhe aktivitetet e projektit.

Raportet e vlerësimit u vihen në dispozicion vendit partner dhe palëve kryesore të interesit. Partneri zbatues dhe Komisioni analizojnë përfundimet dhe rekomandimet e vlerësimeve dhe, sipas rastit, vendosin bashkërisht mbi masat ndjekëse dhe rregullimet e nevojshme që mund të përfshijnë edhe riorientimin e projektit.

6. AUDIT

Pa cenuar detyrimet e zbatueshme në kuadrin e kontratave të nënshkruara për zbatimin e këtij Veprimi, Komisioni mundet që mbi bazën e një vlerësimi risku të kontraktojë kryerjen e auditeve të pavarura apo verifikimin e shpenzimeve për një ose disa kontrata apo marrëveshje.

7. KOMUNIKIMI DHE VIZIBILITETI

Vizibiliteti i financimeve të BE-së dhe komunikimi mbi objektivat dhe ndikimin e Veprimeve janë detyrim ligjor për të gjitha Veprimet e financuara nga BE-ja, siç përcaktohet ne kërkesat në fuqi të komunikimit dhe vizibilitetit të BE-së.
Në veçanti, përfituesit e fondeve të BE-së pranojnë origjinën e fondeve të BE-së dhe garantojnë vizibilitetin e duhur të tyre përmes masave më poshtë:

- të gjitha dokumentet dhe materialet e komunikimit që lidhen me zbatimin e fondeve dhe faqja zyrtare e internetit si dhe mediat sociale, nëse ka, duhet të përmbajnë në vend të dukshëm një pohim që nënvizon se fondet janë dhënë nga BE-ja;
- promovon masat dhe rezultatet e tyre, duke dhënë informacion të shënjestruar, proporcional, koherent dhe efektiv për audiencat e ndryshme, përfshirë median.

Masat e vizibilitetit dhe komunikimit zbatohen, sipas rastit, nga administratat kombëtare, subjektet e ngarkuara, kontraktorët dhe përfituesit e granteve. Detyrimet kontraktuale të përshtatshme përfshihen në marrëveshjet e financimit, në marrëveshjet e delegimit dhe në kontratat e prokurimit dhe ato grant.

Masat bazohen në një Plan specifik Komunikimi dhe Vizibiliteti, që hartohet dhe zbatohet në përputhje me kërkesat në fuqi të BE-së për komunikimin dhe vizibilitetin. Plani duhet të përmbajë ndër të tjera një narrativë komunikimi dhe mesazhe kryesore për Veprimin, të përshtatura sipas audiencave të synuara (palët e interesit, shoqëria civile, publiku i gjerë, etj.).

Veprimi (Rezultati / Produkti 4) do të fokusohet në promovimin e ekosistemit jo vetëm në rang kombëtar por edhe ndërkombëtar, përmes aktiviteteve në shkallë të gjerë, fushatave dhe organizimeve që synojnë t'i japin vëmendjen dhe fokusin e nevojshëm zhvillimit të ekosistemit të novacionit në Shqipëri. Shqipëria është vend i vogël dhe

ekosistemi është në hapat e parë. Rritja dhe zhvillimi i tij ka nevojë për talente/palë ndërkombëtare që t'u bashkohen përpjekjeve dhe të kontribuojnë, prandaj ky do të jetë hapi i radhës. Aktivitetet përfshijnë:

1) Krijimin e narrativës dhe brandit për ekosistemin shqiptar (krijimi i ambasadorëve krenarë të ekosistemit shqiptar dhe shembujve të sipërmarrësve dhe palëve të ekosistemit që janë të suksesshëm)
2) Marrëdhënie me publikun për Shqipërinë (me fokus ndërkombëtar): me fokus të veçantë në vendosjen e Shqipërisë në hartën e ekosistemeve globale të *startup*-eve, qëllimi është që të theksohet fakti që Shqipëria është "tokë e mundësive" dhe që komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun të shënjestrojnë të huajt, në mënyrë që ekosistemi shqiptar dhe mundësitë që ofron të njihen më mirë jashtë vendit (artikuj në mediat dhe bloge ndërkombëtare për të tërhequr nomadët dixhitalë dhe talentet që të punojnë brenda ekosistemi të vendit; safare të ekosistemit; udhëzuesi i ekosistemit shqiptar);
3) Fushata komunikimi dhe aktivitete ndërgjegjësimi për të sjellë konceptet e novacionit, *startup*-eve dhe sipërmarrjes më afër publikut të gjerë, që ato të bëhet më të njohura, të pranuara dhe të kërkuara si një mundësi jete që qytetarët të bëhen sipërmarrës. Fokus i veçantë do t'i kushtohet sipërmarrëseve femra në fusha si Gratë në Teknologji dhe Gratë në Shkencë.
4) Trajnime dhe ndërgjegjësime të medias mbi përfitimet e novacionit dhe teknologjisë së avancuar, duke e bërë median vendore një aleat dhe promovues të informuar të zhvillimeve më të fundit të ekosistemit, në mënyrë që media të jetë partner kryesor në pranimin e përgjithshëm të zhvillimeve teknologjike nga shoqëria e gjerë.

Masat e vizibilitetit dhe komunikimit specifike për këtë Veprim janë komplementare me aktivitetet e gjera të komunikimit që zbatohen direkt nga shërbimet e Komisionit Evropian dhe/ose Delegacioni i BE-së. Komisioni Evropian dhe Delegacioni i BE-së duhet të informohen plotësisht mbi planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve specifike të vizibilitetit dhe komunikimit, sidomos ato që kanë të bëjnë me narrativën e komunikimit dhe mesazhet kryesore.

8. QËNDRUESHMËRIA

Veprimi është krijuar që të maksimizojë qëndrueshmërinë dhe të rritë "për të maksimizuar qëndrueshmërinë dhe për të rritur pronësinë nga palët e interesuara të ekosistemit të novacionit, duke u mbështetur në besimin dhe mirëkuptimin e ekosistemit shqiptar të novacionit të krijuar në fazën e parë të programit "BE-ja për Novacionin". Edhe pse palët e interesuara publike kanë personel dhe kapacitete të kufizuara, angazhimi i tyre në fazën e parë të "BE-ja për Novacionin" tregoi se ato janë plotësisht të përkushtuar ndaj Veprimit. Partnerët e duhur dhe palët e interesuara do të përfshihen në çdo aktivitet që nga faza e projektimit, si dhe në monitorimin e vazhdueshëm të Veprimit. Për shembull, aktorët kryesorë do të përfshihen në hartimin e skemave të granteve për *startup*-et dhe OMN-të, dhe një organ institucional do të caktohet si partner me Menaxherin e Fondit që të fitojë përvojë në drejtimin e një Fondi të tillë, duke marrë parasysh nevojën për të nxitur gradualisht kapacitetet nëpërmjet përvojës praktike dhe për të siguruar aftësinë e tyre për të ofruar këtë shërbim në të ardhmen. OMN-të-të shqiptare do të fitojnë përvojë në ofrimin e shërbimeve të reja, nën mentorimin e ekspertëve të Veprimit, edhe përtej periudhës së zbatimit; ndërsa bashkëpunimi me OMN dhe shoqata të huaja mund të konsolidojë operacionet e tyre brenda ekosistemit të novacionit. Së fundi, përveç skemave të financimit në kuadër të Veprimit, mbështetja e dhënë për startup-et, ekipet e kërkimit sipërmarrës dhe OMN-të për të pasur akses në fonde të tjera (në aplikimet për skemat e granteve të jashtme, skemat e kredive, programet e BE-së, etj.) synon të garantojë që ndikimi i Veprimit të jetë shumë më i madh dhe me efekte të dobishme përtej periudhës së zbatimit të tij.

SHTOJCA 1A – TABELA PËRMBLEDHËSE E BUXHETIT

Emërtimi i Programit: Plani Vjetor i Veprimit në favor të Shqipërisë për vitin 2021
Përfituesi IPA III: Republika e Shqipërisë
Referenca OPSYS e Programit: SCR.DEC.043666.01

Programi		Menaxhim Direkt								Menaxhim Indirekt							TOTALI		
		Grante			Prokurim			Mbështetja Buxhetore	TOTALI MD	Menaxhim Indirekt me Subjekte të Besuara						TOTALI MI			
Dritarja	Veprimi	Kontributi i BE-së	Kontributi i Palës së Tretë	Totali	Kontributi i BE-së	Kontributi i Palës së Tretë	Totali	Kontributi i BE-së	Kontributi i BE-së	Kontributi i BE-së	Kontributi i Palës së Tretë	Totali	Kontributi i BE-së	Kontributi i Palës së Tretë	Totali	Kontributi i BE-së	Kontributi i BE-së	Kontributi i Palës së Tretë	Totali
Dritarja 1	BE-ja për Drejtësinë	500 000	-	500 000	7 500 000	-	7 500 000		8 000 000			-			-	-	8 000 000	-	8 000 000
	BE-ja për të Drejtat e pronësisë – Faza II			-	10 000 000		10 000 000		10 000 000			-			-	-	10 000 000	-	10 000 000
Totali Dritarja 1		500 000	-	500 000	17 500 000	-	17 500 000	-	18 000 000	-	-	-		-	-	--	18 000 000	-	18 000 000
Dritarja 2				-			-					-			-	-	-	-	-
				-			-					-			-	-	-	-	-
Totali Dritarja 2		-	-	-	-	-	-			-	-	-		-	-	-	-		-
Dritarja 3	BE-ja për Natyrën			-	500 000		500 000		500 000	5 500 000		5 500 000			-	5 500 000	6 000 000	-	6 000 000
	BE-ja për EQ&RrGJ			-	1 000 000		1 000 000		1 000 000	29 900 000		29 900 000			-	29 900 000	30 900 000	-	30 900 000
Totali Dritarja 3		-	-	-	1 500 000	-	1 500 000	-	1 500 000	35 400 000		35 400 000	-	-	-	35 400 000	36 900 000	-	36 900 000
Dritarja 4	BE-ja për Novacionin - Faza II	-		-			-		-	10 000 000		10 000 000				10 000 000	10 000 000	-	10 000 000
				-			-		-			-			-	-	-	-	-
Totali Dritarja 4		-	-	-	-	-	-	-	-	10 000 000		10 000 000	-	-	-	10 000 000	10 000 000	-	10 000 000
TOTALI i Programit		500 000	-	500 000	19 000 000	-	19 000 000	-	19 500 000	45 400 000		45 400 000	-	-	-	45 400 000	64 900 000	-	64 900 000

SHTOJCA II – KUSHTET E PËRGJITHSHME

Pasqyra e lëndës

Pjesa I: Dispozitat e zbatueshme për aktivitetet për të cilat përfituesi IPA III është autoritet kontraktues në kuadrin e MIVP-së
Neni 1 - Parime të përgjithshme
Neni 1a - Prokurimi dhe dhënia e granteve
Neni 1b – Përjashtimi dhe sanksionet administrative
Neni 2 - Komunikimi dhe Vizibiliteti
Neni 3 - Kontrollet *ex-ante* për procedurat e granteve dhe prokurimit dhe kontrollet *ex-post* për kontratat dhe grantet që do të kryhen nga Komisioni
Neni 4 - Llogaritë bankare, sistemet e kontabilitetit dhe shpenzimet e pranuara
Neni 5 - Dispozitat pagesat e kryera nga Komisioni për përfituesin IPA III
Neni 6 - Ndërprerja e pagesave
Neni 7 - Rikuperimi i fondeve
Neni 7a – Korrigjimet financiare dhe mbyllja

Pjesa II: Dispozitat e zbatueshme për mbështetjen buxhetore
Neni 8 – Dialogu mbi politikat
Neni 9 - Verifikimi i kushteve dhe disbursimi
Neni 10 – Transparenca e mbështetjes buxhetore
Neni 11 - Rikuperimi i mbështetjes buxhetore

Pjesa III: Dispozitat e zbatueshme për këtë Marrëveshje Financimi në tërësi, pavarësisht metodës së zbatimit
Neni 12 - Periudha e ekzekutimit, periudha e zbatimit operacional dhe afati i kontraktimit
Neni 13 - Lejet dhe autorizimi
Neni 14 - Kërkesat e raportimit
Neni 15 - Të drejtat e pronësisë intelektuale
Neni 16 - Konsultimi ndërmjet përfituesit IPA dhe Komisionit
Neni 17 - Ndryshimet ligjore të Marrëveshjes së Financimit
Neni 18 - Pezullimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi
Neni 19 - Zgjidhja e kësaj Marrëveshjeje Financimi
Neni 20 – Ligji i zbatueshëm, zgjidhja e mosmarrëveshjeve
Neni 21 - Masat kufizuese të BE-së

Pjesa I: Dispozitat e zbatueshme për aktivitetet për të cilat përfituesi IPA III është autoritet kontraktues në kuadrin e MIVP-së

Neni 1 - Parime të përgjithshme

(1) Qëllimi i Pjesës I është të përcaktojë rregullat për zbatimin e detyrave të besuara për ekzekutimin e buxhetit siç përshkruhet në Shtojcën I, si dhe të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet e përfituesit IPA III dhe të Komisionit në kryerjen e këtyre detyrave.

Pjesa I zbatohet për detyrat e ekzekutimit të buxhetit që i janë besuar përfituesit IPA III vetëm në lidhje me kontributin e BE-së, ose të kombinuar me fondet e përfituesit IPA III ose fondet e një pale të tretë, në rastin kur këto fonde zbatohen në bashkëfinancim të përbashkët.

(2) Përfituesi IPA III mbetet përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë Marrëveshje Financimi dhe në Marrëveshjen Financiare Kuadër të Partneritetit (MFKP). Në zbatim të neneve 6, 18, 19 dhe 21, Komisioni rezervon të drejtën të ndërpresë pagesat dhe të pezullojë dhe/ose zgjidhë këtë Marrëveshje Financimi.

(3) Përfituesi IPA III respekton kontributin minimal të specifikuar në Shtojcën I. Në rastin e kontributeve si nga përfituesi IPA III ashtu edhe nga BE-ja, kontributi i përfituesit IPA III vihet në dispozicion njëkohësisht me kontributin korrespondues të BE-së.

(4) Për qëllimet e zbatimit të nenit 25 të MFKP-së për mbrojtjen e të dhënave, të dhënat personale duhet:

- të përpunohen në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe transparente në lidhje me subjektin e të dhënave;
- të mblidhen për qëllime të specifikuara, të qarta dhe të ligjshme, si dhe të mos përpunohen më tej në çfarëdo mënyre që nuk është në pajtim me këto qëllime;
- të jenë të mjaftueshme, relevante dhe të kufizuara në masën që është e nevojshme për qëllimet për të cilat përpunohen;
- të jenë të sakta dhe, sipas rastit, të përditësohen;
- të përpunohen në një mënyrë që garanton sigurinë e përshtatshme të të dhënave personale; dhe
- të ruhen në një formë që mundëson identifikimin e subjekteve vetëm gjatë periudhës që është e nevojshme për qëllimet për të cilat përpunohen të dhënat personale.

Të dhënat personale në dokumentet që ruhen nga përfituesi IPA III , në përputhje me pikën 2 të nenit 1a, duhet të fshihen sapo të skadojnë afatet e përcaktuara në atë pikë.

Neni 1a - Prokurimi dhe dhënia e granteve

(1) Pa cenuar nenin 18(5) të MFKP-së, detyrat e përcaktuara në pikën 1 të nenit 1 realizohen nga përfituesi IPA III në përputhje me procedurat dhe dokumentet standarde të miratuara dhe të publikuara nga Komisioni për prokurimin dhe kontratat grant në veprimet e jashtme, veçanërisht me udhëzuesin praktik për procedurat e kontraktimit për veprimet e jashtme të Bashkimin Evropian (PRAG) që janë në fuqi në kohën e shpalljes së procedurës në fjalë, si dhe në përputhje me standardet e vizibilitetit dhe komunikimit të përcaktuara në nenin 2(2).

Përfituesi IPA III realizon procedurat e prokurimit dhe dhënies së grantit, lidh kontratat përkatëse dhe garanton që të gjitha dokumentet e nevojshme për gjurmën e auditit të jenë në gjuhën e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

(2) Pa cenuar nenin 49 të MFKP-së, përfituesi ruan të gjitha dokumentet shoqëruese financiare dhe kontraktuale që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi ose që nga një datë më e hershme nëse procedura e prokurimit, thirrja për projekt-propozime apo procedurës e granteve direkt është shpallur përpara hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi, deri pesë vjet nga data e mbylljes së programit. Përfituesi IPA III ruan veçanërisht sa më poshtë:

(a) Procedurat e prokurimit:

i) Parashikimi me provë të publikimit të njoftimit për prokurim, si dhe çdo korrigjim;

ii) Emërimi i komisionit të kualifikimit;

iii) Raporti i kualifikimit (duke përfshirë shtojcat) dhe aplikimet;

iv) Prova e publikimit të njoftimit të aplikantëve të kualifikuar;

v) Letrat për aplikantët e skualifikuar;

vi) Ftesa për tender ose dokument të barasvlershëm;

vii) Dosja e tenderit, duke përfshirë shtojcat, sqarimet, procesverbalet e takimeve, provën e publikimin;

viii) Emërimin e komisionit të vlerësimit;

ix) Relacioni i hapjes së tenderit, duke përfshirë shtojcat;

x) Raporti i vlerësimit / negociatave, duke përfshirë shtojcat dhe ofertat e dorëzuara;[1]

xi) Njoftimet;

xii) Shkresa përcjellëse për dorëzimin e kontratës;

xiii) Shkresat drejtuar kandidatëve jofitues;

xiv) Njoftimi i fituesit /anulimit, duke përfshirë provën e publikimit;

xv) Kontratat e nënshkruara, ndryshimet në to, klauzolat shtesë, raportet e zbatimit dhe korrespondenca përkatëse.

(b) Thirrjet për projekt-propozime dhe grantet direkte:

i) Emërimi i komisionit të vlerësimit;

ii) Raporti i hapjes dhe administrativ, duke përfshirë shtojcat dhe aplikimet e dorëzuara;[2]

iii) Shkresat drejtuar aplikantëve të kualifikuar dhe të skualifikuar, pas vlerësimit të projektit konceptual;

iv) Raporti i vlerësimit të projektit konceptual;

v) Raporti i vlerësimit të aplikimit të plotë ose raporti i negociatave, bashkë me shtojcat përkatëse;

vi) Kontrolli i kritereve kualifikuese dhe dokumenteve mbështetëse;

vii) Shkresat drejtuar aplikantëve fitues dhe jofitues me një listë rezervë të miratuar pas vlerësimit të plotë të aplikimeve;

viii) Shkresa përcjellëse për dorëzimin e kontratës grant;

ix) Njoftimi i fituesit /anulimit me provë të publikimit;

x) Kontratat e nënshkruara, ndryshimet në to, klauzolat shtesë, raportet e zbatimit dhe korrespondenca përkatëse.

Gjithashtu, dokumentet financiare të përcaktuara në pikat 2(a) dhe 2(b) plotësohen me të gjitha dokumentet mbështetëse përkatëse siç kërkohet nga procedurat e përcaktuara në pikën 1, si edhe me të gjithë dokumentacionin përkatës që ka të bëjë me pagesat, rikuperimet dhe shpenzimet operacionale, për shembull raportet e projektit dhe raportet e kontrolleve në terren, marrjen në dorëzim të furnizimeve dhe punimeve, garancitë dhe raportet e inxhinierëve mbikëqyrës.

(3) Operacionet e bashkëfinancuara nga BE-ja në kuadrin e këtij Programi mund të përfitojnë fonde nga një organizatë ndërkombëtare, Shtet Anëtar, vend i tretë ose organizatë rajonale.

Neni 1b – Përjashtimi dhe sanksionet administrative

(1) Gjatë zbatimit të procedurave dhe dokumenteve standard të miratuara dhe të publikuara nga Komisioni për prokurimet dhe kontratat grant, përfituesi IPA II garanton që asnjë prokurim apo kontratë grant e financuar nga

[1] Eliminimi i ofertave jofituese pesë vjet pas mbylljes së procedurës së prokurimit.
[2] Eliminimi i ofertave jofituese tre vjet pas mbylljes së procedurës së grantit.

BE-ja të mos i jepet një operatori ekonomik apo aplikanti për grant nëse operatori ekonomik apo aplikanti për grant, qoftë vetë ose një person me tagra përfaqësimi, vendimmarrjeje apo kontrolli mbi të, gjendet në një nga situatat e përjashtimit të përcaktuara në procedurat përkatëse dhe dokumentet standarde të Komisionit.

(2) Përfituesi IPA III informon menjëherë Komisionit kur një kandidat, ofertues apo aplikant gjendet në njërën nga situatat e përjashtimit sipas pikës (1) ose ka kryer parregullsi dhe mashtrim sipas nenit 51(5) të MFKP-së ose ka shfaqur mangësi të theksuara në respektimin e detyrimeve kryesore në lidhje me zbatimin e një kontrate apo granti të financuar nga buxheti i BE-ë.

(3) Gjatë procedurave të prokurimit dhe kontratave të grantit, përfituesi IPA III mban parasysh informacionin që përmban sistemi EDES (Sistemi i Diktimit të Hershëm dhe Përjashtimit) i Komisionit. Aksesi në informacion mund të sigurohet përmes pikave ndërlidhëse ose përmes konsultimit duke përdorur këto mjete: (Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Zyrtari Kontabël i Komisionit, MO15, B-1049 Bruksel, Belgjikë dhe me e-mail drejtuar BUDG-C01-EXCL- DB@ec.europa.eu duke vënë në dijeni Komisionin përmes adresës Së përcaktuar në nenin 3 të Kushteve të Veçanta). Çdo kontratë ose grant i lidhur me një kontraktues apo përfituesi granti që gjendet në situatën e përjashtimit në momentin e lidhjes së kontratës, përjashtohet nga financimet e BE-së dhe mund të zbatohet mekanizmi i korrigjimeve financiare sipas nenit 7a.

(4) Kur përfituesi III vihet në dijeni për situatën e përjashtimit sipas pikë (1) në zbatimin e detyrave të përcaktuara në Shtojcën I, përfituesi IPA II vendos - në zbatim të kushteve të legjislacionit të brendshëm - refuzimin e operatorit ekonomik apo aplikantit për grant nga procedura në fjalë dhe përjashtimin e tij nga procedurat e ardhshme të prokurimit dhe grantit. Përfituesi IPA III mundet edhe të vendosë penalitete financiare proporcionale me vlerën e kontratës në fjalë. Refuzimet, përjashtimet dhe/ose penalitetet financiare vendosen pas procedurës së kundërshtimit që i garanton të drejtën e mbrojtjes personit në fjalë. Përfituesi IPA III njofton Komisionin sipas pikës (2) të këtij neni.

Neni 2 - Komunikimi dhe Vizibiliteti

(1) Në përputhje me nenin 24 të MFKP-së, përfituesi IPA II merr masat e nevojshme për të garantuar vizibilitetin e financimit të BE për aktivitetet që i janë besuar atij, si dhe përgatit një plan koherent për aktivitetet e komunikimit dhe vizibilitetit, i cili duhet t'i paraqitet Komisionit për miratim brenda 2 muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

(2) Këto aktivitete komunikimi dhe vizibiliteti duhet të jenë në përputhje me Manualin e Vizibilitetit dhe Komunikimit për Veprimet e Jashtme të BE-së të miratuara dhe të publikuara nga Komisioni, i cili është në fuqi në kohën e aktiviteteve.

Neni 3 - Kontrollet *ex-ante* për procedurat e granteve dhe prokurimit dhe kontrollet *ex-post* për kontratat dhe grantet që do të kryhen nga Komisioni

(1) Komisioni mund të ushtrojë kontrolle *ex-ante* për procedurat e prokurimit dhe granteve për fazat si më poshtë:

(a) miratimi i njoftimeve të kontratës(ave) për prokurim dhe çdo korrigjim i tyre;

(b) miratimi i dosjeve të tenderit dhe udhëzimeve për aplikantët për grantet;

(c) miratimi i përbërjes së Komisioneve të Vlerësimit;

(d) miratimi i raporteve të vlerësimit, vendimeve të refuzimit dhe përzgjedhjes së fituesit[3];

(e) miratimi i dosjeve të kontratave dhe aneks-kontratave.

(2) Në lidhje me kontrollet *ex-ante,* Komisioni vendos:

(a) të kryejë kontrolle *ex-ante* për të gjitha dosjet, ose

(b) të kryejë kontrolle ex-ante në disa dosje të tilla të përzgjedhura, ose

(c) të heqë dorë plotësisht nga kontrollet *ex-ante.*

(3) Nëse Komisioni vendos të kryejë kontrolle *ex-ante* në përputhje me pikën 2(a) ose (b), informon përfituesin IPA III

[3] Për kontratat e shërbimit, ky hap përfshin kontrolle *ex-ante* në lidhje me miratimin e listës së të kualifikuarve.

për dosjet e përzgjedhura për kontrollet *ex-ante*. Përfituesi IPA III i paraqet Komisionit të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm menjëherë pasi informohet se një dosje është përzgjedhur për kontroll *ex-ante*, jo më vonë se momenti i dorëzimit për publik të njoftimit të kontratës apo të udhëzimeve për aplikantët.

(4) Komisioni mund të vendosë të kryejë kontrolle *ex-post* për procedurat e granteve që nuk kanë qenë objekt i kontrollit *ex-ante* (brenda 6 muajsh nga nënshkrimi i kontratës).

(5) Komisioni mund të vendosë të kryejë kontrolle *ex-post* në çdo kohë - përfshirë auditimet dhe kontrollet në terren - për çdo kontratë dhe grant të dhënë nga përfituesi IPA III që rrjedh nga kjo Marrëveshje Financimi. Përfituesi IPA III i paraqet Komisionit të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm menjëherë pasi informohet se një dosje është përzgjedhur për kontroll *ex-post*. Komisioni mund të autorizojë një person apo subjekt që të kryejë kontrollet *ex-post* për llogari të vet.

Neni 4 - Llogaritë bankare, sistemet e kontabilitetit dhe shpenzimet e pranuara

(1) Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi, Organi Kontabël dhe Organi i Ndërmjetëm për Menaxhimin Financiar (ONMF) i përfituesit IPA që është Autoriteti Kontraktues për Programin, hap të paktën një llogari bankare në monedhën Euro. Balanca bankare totale për Programin është shuma e balancave të të tilla llogarive bankare të Programit që mbahen Organi Kontabël dhe të gjithë ONMF-të pjesëmarrëse në përfituesin IPA III. Raportimi për të gjitha llogarite bankare që kanë lidhje me secilin program, regjistrohet përmes sistemit IPA-APP[4].

(2) Përfituesi IPA III përgatit dhe i paraqet Komisionit planet e parashikimit të disbursimeve gjatë periudhës së zbatimit të Programit, duke ndjekur modelin në germën (d) të Shtojcës III. Këto parashikime përditësohen dhe paraqiten bashkë me çdo kërkesë për fonde sipas nenit 5(1) dhe (3), me raportin financiar vjetor të përcaktuar në nenin 14(2) dhe me parashikimin e kërkesë-pagesave të mundshme sipas nenit 33(3) të MFKP-së. Plani i parashikimit të disbursimeve bazohet në nevojat reale dhe aktuale dhe mbështetet nga një analizë e hollësishme e dokumentuar (përfshirë kontraktimet e planifikuara dhe kalendarin e pagesave për çdo kontratë), e cila i vihet në dispozicion Komisionit me kërkesë të tij.

(3) Plani fillestar për parashikimin e disbursimeve duhet të përmbajë një përmbledhje të parashikimit vjetor të disbursimeve për të gjithë periudhën e zbatimit, si dhe parashikimet mujore të disbursimeve për 12 muajt e parë të Programit. Planet e mëvonshme duhet të përmbajnë përmbledhje të parashikimit vjetor të disbursimeve për balancën gjatë periudhës së zbatimit të Programit, si dhe parashikimet mujore të disbursimeve për 14 muajt pasues.

(4) Përfituesi IPA III krijon dhe mban një sistem kontabël në përputhje me Klauzolën 4(3)(a) të Shtojcës A të MFKP-së, i cili përmban të paktën të dhëna për kontratat e menaxhuara në kuadrin e Programit të parashikuara në Shtojcën IV.

(5) Në zbatim të nenit 57(2) të MFKP-së, shpenzimet e pranuara në sistemin kontabël që mbahet sipas seksionit 4 të këtij neni, duhet të jenë kryer, pranuar dhe paguar dhe të korrespondojnë me shpenzimet aktuale të vërtetuara me dokumente mbështetëse dhe duhet të përdoren, kur është e nevojshme, për të likuiduar parafinancimin e paguar nga përfituesi IPA III sipas kontratave vendore.

Neni 5 - Dispozitat pagesat e kryera nga Komisioni për përfituesin IPA III

(1) Çdo kërkesë për parafinancim duhet të përmbajë deklaratën e shpenzimeve për Programin, si edhe shumat e kontraktuara dhe të disbursuara si dhe shpenzimet e pranuara.

(2) Kërkesa e parë për parafinancim mbulon 100% disbursimet e parashikuara për vitin e parë të planit të parashikimit të disbursimeve sipas nenit 4(2). Kjo kërkesë për parafinancim duhet të mbështetet me mandate bankare për të gjitha llogaritë bankare të Programit, sipas rastit.

(3) Përfituesi IPA III paraqet kërkesë-pagesat për parafinancim kur balanca totale bankare e Programit bie nën nivelin e parashikimit të disbursimeve për pesë muajt pasues të Programit.

(4) Çdo kërkesë për parafinancim duhet të përmbajë:

a) Balancat bankare për Programin në fundin e afatit të kërkesës;

[4] IPA-APP është aplikacion TI i dedikuar që është zhvilluar nga DG NEAR për të zëvendësuar instrumentin iPerseus që përdorej për të monitoruar zbatimin e fondeve të para-anëtarësimit në kuadrin e menaxhimit indirekt nga vendet përfituesve (MIVP).

b) Mandatet bankare të përditësuara për të gjitha llogaritë bankare të Programit, nëse ka;

c) Parashikimin e disbursimeve për Programin për 14 muaj nga afati i kërkesës sipas nenit 4(2);

d) Raportimin në IPA-APP.

(5) Për çdo parafinancim të mëvonshëm, përfituesi IPA III mund të kërkojë shumën totale të disbursimeve të parashikuara për 14 muaj pas afatit të kërkesës, minus balancat e përcaktuara në pikën 4(a) në datën e afatit të kërkesës për fonde, plus ndonjë shumë të financuar nga përfituesi IPA III sipas pikës 6 e cila nuk është rimbursuar ende.

Komisioni rezervon të drejtën për të reduktuar çdo pagesë të mëvonshme parafinancimi nëse balanca totale bankare e mbajtur nga përfituesi IPA III në kuadrin e këtij Programi tejkalon parashikimin e disbursimeve për 14 muajt pasues.

(6) Kur pagesa reduktohet sipas pikës 5, përfituesi IPA II duhet të financojë Programin nga burimet e veta deri në shumën e reduktimit. Përfituesi IPA III mund të kërkojë më pas rimbursimin e atyre fondeve si pjesë e kërkesës së radhës për fonde të parashikuar në pikën 5.

(7) Sipas nenit 33(1) të MFKP-së, Komisioni rezervon të drejtën të kryejë pagesa të pjesshme brenda kufijve të fondeve që ka. Sapo fondet vihen në dispozicion sërish, Komision paguan menjëherë pjesën e mbetur.

(8) Komisioni ka të drejtë të rikuperojë balancat e tepërta bankare që kanë mbetur pa u përdorur për më shumë se 12 muaj. Para ushtrimit të kësaj të drejte, Komisioni fton përfituesin IPA III të japë arsyet e vonesës në disbursimin e fondeve dhe të provojë nevojën e vazhdueshme për ato fonde gjatë dy muajve pasues.

(9) Interesat e gjeneruara nga llogaritë bankare që përdoren për këtë Program nuk i takojnë Komisionit.

(10) Sipas nenit 33(4) të MFKP-së, nëse Komisioni e ndërpret afatin për kërkesë-pagesën për më shumë se dy muaj, përfituesi IPA III mund t'i kërkojë Komisionit një vendim nëse ndërprerja do të vazhdojë.

(11) Pasqyra përfundimtare e shpenzimeve e certifikuar sipas nenit 36(1)(a) të MFKP-së i dorëzohet ZKA-së jo më vonë se 16 muaj fundit të periudhës së zbatimit operacional.

Neni 6 - Ndërprerja e pagesave

(1) Pa cenuar pezullimin ose zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje Financimi sipas neneve 18 dhe 19 përkatësisht, si dhe pa cenuar nenet 38 dhe 39 të MFKP-së, Komisioni mund të ndërpresë pagesat pjesërisht ose plotësisht, nëse:

(a) Komisioni ka konstatuar ose ka shqetësime serioze se përfituesi IPA III ka kryer gabime thelbësore, parregullsi apo mashtrim që vë në dyshim ligjshmërinë apo rregullsinë e transaksioneve në fjalë gjatë zbatimit të Programit, ose nuk ka përmbushur detyrimet në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, duke përfshirë detyrimet lidhur me zbatimin e Planit të Vizibilitetit dhe Komunikimit.

(b) Komisioni ka konstatuar se ka shqetësime serioze se përfituesi IPA III ka kryer gabime sistematike dhe të përsëritura, parregullsi, mashtrim apo shkelje të detyrimeve në kuadrin e kësaj apo ndonjë tjetër Marrëveshje Financimi, me kusht që ato gabime, parregullsi, mashtrim apo shkelje të keni ndikim material në zbatimin e Marrëveshjes së Financimit apo të vënë në dyshim besueshmërinë e sistemit e kontrollit të brendshëm të përfituesit IPA IIIII ose ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve në fjalë.

Neni 7 - Rikuperimi i fondeve

(1) Përveç rasteve të përcaktuara në nenin 40 të MFKP-së, Komisioni mund të rikuperojë fonde nga përfituesi IPA III siç parashikon Marrëveshja Financiare, veçanërisht në rastet e mëposhtme:

(a) mosarritja e rezultateve dhe mospërdorimi i produkteve për qëllimin e synuar sipas Shtojcës I;

(b) shpenzime të papranueshme;

(c) mosrespektim i normës së bashkëfinancimit, sipas Shtojcës I;

(d) shpenzime të paguara si rezultat i gabimeve, parregullsive, mashtrimit apo shkeljes së detyrimeve në zbatimin e Programit, veçanërisht në procedurat e prokurimit dhe dhënies së granteve;

(e) dobësi ose mangësi në sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të përfituesit IPA III, që rezultojnë në korrigjimin financiar.

(2) Në përputhje me legjislacionin e brendshëm, ZKA rikuperon kontributin e BE-së që i është paguar përfituesit IPA II nga marrësit e fondeve, të cilët kanë qenë në një nga situatat e përcaktuara në pikën 1, germat b) ose d) të këtij neni, apo ato të përcaktuara në nenin 41 të MFKP-së. Fakti që ZKA nuk arrin të rikuperojë një pjesë apo të gjitha fondet, nuk e pengon Komisionin të rikuperojë fondet nga përfituesi IPA III.

(3) Shumat e paguara në mënyrë të parregullt ose të rikuperuara nga përfituesi IPA III, shumat nga garancitë financiare, të performancës dhe parafinancimit të paguara mbi bazën e procedurave të prokurimit dhe dhënies së granteve, shumat nga penalitetet financiare të vendosura nga përfituesi IPA III ndaj kandidatëve, ofertuesve, aplikantëve, kontraktuesve ose përfituesve të granteve të pagueshme në favor të përfituesit IPA III, ose përdoren sërish për Programin, ose i kthehen Komisionit.

Neni 7a – Korrigjimet financiare dhe mbyllja

Përveç neneve 42, 43 dhe 47 të MFKP-së, Komisioni jep orientime shtesë për shqyrtimin dhe pranimin e procedurës së llogarive, përfshirë korrigjimet financiare dhe mbylljen.

Pjesa II: Dispozitat e zbatueshme për mbështetjen buxhetore

Neni 8 – Dialogu mbi politikat

Përfituesi IPA III dhe Komisioni zotohen që të angazhohen në dialog të rregullt konstruktiv në nivel të përshtatshëm për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

Neni 9 - Verifikimi i kushteve dhe disbursimi

(1) Komisioni verifikon kushtet për pagesën e kësteve nën komponentin e mbështetjes buxhetore, siç përcaktohet në Lidhjen e Shtojcës I.

(2) Nëse Komisioni konstaton se nuk janë përmbushur kushte për pagesat, e informon pa vonesë përfituesin IPA III për këtë fakt.

(3) Kërkesat për disbursim të paraqitura nga përfituesi IPA III janë të pranueshme për financimin e BE-së, nëse janë në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Shtojcën I dhe Lidhjen përkatëse dhe janë paraqitur gjatë fazës së zbatimit operacional.

(4) Përfituesi IPA III zbaton rregulloret kombëtarë për kursin e këmbimit valutor, në mënyrë jodiskriminuese për të gjitha disbursimet nën komponentin e mbështetjes buxhetore.

Neni 10 – Transparenca e mbështetjes buxhetore

Përfituesi IPA III bie dakord që Komisioni të publikojë këtë Marrëveshjeje Financimi dhe çdo ndryshimi të saj, përfshirë me mjete elektronike, si dhe informacionin bazë për mbështetjen buxhetore që Komisioni e çmon të nevojshme. Përmbajtja e publikimit do të jetë në përputhje me ligjet e BE-së të zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 11 - Rikuperimi i mbështetjes buxhetore

Të gjitha disbursimet e mbështetjes buxhetore apo pjesë të tij mund të rikuperohen nga Komisioni, me respektimin e duhur të parimit të proporcionalitetit, nëse Komisioni konstaton se pagesa ka qenë e pavlefshme për shkak të një parregullsie të rëndë që i atribuohet përfituesit IPA III, veçanërisht nëse përfituesi IPA III ka dhënë informacione të pabesueshme ose të pasakta apo nëse ka pasur korrupsion apo mashtrim.

Pjesa III: Dispozitat e zbatueshme për këtë Marrëveshje Financimi në tërësi, pavarësisht metodës së zbatimit

Neni 12 - Periudha e ekzekutimit, periudha e zbatimit operacional dhe afati i kontraktimit

(1) Periudha e ekzekutimit është periudha gjatë së cilës zbatohet Marrëveshja e Financimit dhe përfshin periudhën e zbatimit operacional dhe fazën e mbylljes. Kohëzgjatja e periudhës së ekzekutimit përcaktohet në nenin 2(1) të Kushteve të Veçanta dhe fillon me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi dhe mbaron në datën e fundit për zbatimin e Marrëveshjes së Financimit.

(2) Periudha e zbatimit operacional është periudha gjatë së cilës kryhen të gjitha aktivitetet operacionale të mbuluara me kontrata prokurimi, kontrata grant dhe marrëveshje kontributi. Kohëzgjatja e kësaj periudhe përcaktohet në nenin 2(2) të Kushteve të Veçanta dhe fillon me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

(3) Autoriteti Kontraktues e respekton periudhën e ekzekutimit operacional kur lidh dhe zbaton kontrata prokurimi, kontrata granti dhe marrëveshje kontributi në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

(4) Pa cenuar nenin 29(2)të MFKP-së, shpenzimet e lidhura me aktivitetet janë të pranueshme për financimin e BE-së vetëm nëse janë kryer gjatë periudhës së zbatimit operacional. Shpenzimet e kryera para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi nuk janë të pranueshme për financimin e BE-së, përveç kur parashikohet ndryshe në nenin 7 të Kushteve të Veçanta.

(5) Në zbatim të nenit 29(3)(b) të MFKP-së dhe pa cenuar nenin 28 të saj dhe nenin 7 të Kushteve të Veçanta, shpenzimet e mëposhtme të kryera nga përfituesi IPA III nuk janë të pranueshme për financim në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje Financimi:

a) tarifat bankare, shpenzimet e garancive dhe tarifa të ngjashme;

b) gjobat dhe penalitetet financiare;

c) shpenzimet gjyqësore;

d) humbjet nga kursi i këmbimit të valutës;

e) borxhet dhe tarifat e shërbimit të borxhit (interesi);

f) provizionet për humbje, borxhe apo detyrime potenciale në të ardhmen;

g) kreditime ndaj palëve të treta, përveç kur parashikohet ndryshe në Kushtet e Veçanta;

h) interesi negativ që aplikohet nga bankat apo institucione të tjera financiare.

(6) Kontratat e prokurimit, kontratat grant dhe marrëveshjet e kontributit lidhen jo më vonë se tre vjet nga lidhja e Marrëveshjes së Financimit, me përjashtim të rasteve më poshtë:

(a) ndryshime në angazhimet ligjore të lidhura tashmë, të cilat nuk rezultojnë në rritje të kontributit të BE-së;

(b) angazhimet ligjore që nënshkruhen pas zgjidhjes së parakohshme të një kontrate prokurimi ekzistuese;

(c) angazhime ligjore në lidhje me auditimin dhe vlerësimin, të cilat mund të nënshkruhen pas periudhës së zbatimit operacional

(d) ndryshim të subjektit zbatues.

(7) Një kontratë prokurimi, kontratë granti apo marrëveshje kontributi që nuk ka rezultuar në ndonjë pagesë brenda dy viteve nga nënshkrimi i saj, zgjidhet automatikisht dhe fondet e saj tërhiqen, përveç rasteve të mosmarrëveshjeve gjyqësore në gjykata apo organe arbitrazhi.

Neni 13 - Lejet dhe autorizimi

Pa cenuar nenin 27 të MFKP-së, autoritetet përgjegjëse të përfituesit IPA lëshojnë në kohën e duhur çdo lloj lejeje dhe/ose autorizimi që kërkohet për zbatimin e Programit, në përputhje me legjislacionin e brendshëm.

Neni 14 - Kërkesat e raportimit

(1) Për qëllimet e kërkesave të përgjithshme të raportimit pranë Komisionit, të përcaktuara në nenin 59 të MFKP-së në lidhje me raportin vjetor të zbatimit të asistencës IPA III, KKIPA përdor modelin e vënë në dispozicion nga Komisioni.

(2) Për qëllimet e nenit 60 të MFKP-së, KKIPA i dorëzon Komisionit një raport përfundimtar mbi zbatimin e aktiviteteve në kuadrin e menaxhimit indirekt të këtij Programi nga përfituesi IPA III, jo më vonë se 16 muaj nga mbarimi i periudhës së zbatimit operacional. KKIPA përdor modelin e vënë në dispozicion nga Komisioni.

(3) Për qëllimet e nenit 61(1) të MFKP-së, ZKA paraqet në format elektronik, deri më 15 janar të vitit financiar vijues, një kopje të të dhënave që mbahen në sistemin kontabël sipas nenit 4(4). Kjo kopje shoqërohet me një raport financiar përmbledhës të nënshkruar dhe të paaudituar sipas germës (c) të Shtojcës III.

(4) Për qëllimet e kërkesave specifike të raportimit në kuadrin e menaxhimit indirekt sipas neneve 61(2)(a) dhe 61(3) të MFKP-së, ZKA i përfituesit IPA përdor modelet e përcaktuara në germat (a) dhe (b) të Shtojcës III.

Neni 15 - Të drejtat e pronësisë intelektuale

(1) Kontratat e financuara në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje Financimi garantojnë që përfituesi IPA III të fitojë të gjitha të drejtat e nevojshme të pronësisë intelektuale në lidhje me teknologjinë e informacionit, studimet, skicat, planet, publicitetin dhe çdo material tjetër të përgatitur për qëllime planifikimi, zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi.

(2) Përfituesi IPA III garanton që Komisioni ose çdo organ apo person i autorizuar prej Komisionit do të ketë akses dhe të drejtën të përdorë materiale të tilla. Komisioni i përdor këto materiale vetëm për qëllimet e veta.

Neni 16 - Konsultimi ndërmjet përfituesit IPA dhe Komisionit

(1) Përfituesi IPA III dhe Komisioni konsultohen bashkë përpara se çdo mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin apo interpretimin e Marrëveshjes së Financimit të ndiqet më tutje sipas nenit 20.

(2) Nëse Komisioni konstaton probleme në kryerjen e procedurave në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, ai vendos të gjitha kontaktet e nevojshme me përfituesin IPA III për të rregulluar situatën dhe për të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm.

(3) Konsultimi mund të rezultojë në një ndryshim ligjor, pezullim ose zgjidhje të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

(4) Komisioni informon rregullisht përfituesin IPA III mbi zbatimin e aktiviteteve të përshkruara në Shtojcën I, të cilat nuk janë në Pjesën I të këtyre Kushteve të Përgjithshme.

Neni 17 - Ndryshimet ligjore të Marrëveshjes së Financimit

(1) Çdo ndryshim ligjor i kësaj Marrëveshjeje Financimi bëhet me shkrim, si dhe me shkëmbim letrash.

(2) Nëse përfituesi IPA III kërkon një ndryshim ligjor, kërkesa i paraqitet Komisionit të paktën tre muaj para se ky ndryshim ligjor planifikohet të hyjë në fuqi, me përjashtim të rasteve të justifikuara siç duhet.

(3) Komisioni mund të bëjë ndryshime ligjore në dokumentet e Shtojcave III dhe IV pa bërë ndryshim ligjor në këtë Marrëveshje Financimi. Përfituesit IPA III informohen me shkrim për çdo ndryshim ligjor të tillë dhe hyrjen e tij në fuqi.

Neni 18 - Pezullimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

(1) Marrëveshja e Financimit mund të pezullohet në rastet e mëposhtme:

(a) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi nëse përfituesi IPA III shkel një detyrim sipas kësaj Marrëveshjeje Financimi;

(b) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi nëse përfituesi IPA III shkel një detyrim të përcaktuar në procedurat dhe dokumentet standarde të renditura në nenin 18(2) të MFKP-së;

(c) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi nëse përfituesi IPA III nuk përmbush

kërkesat për t'i besuar detyrat e zbatimit të buxhetit;

(d) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi nëse përfituesi IPA III vendos të pezullojë ose të pushojë procesin e aderimit/anëtarësimit në BE;

(e) Komisioni mund të pezullojë këtë Marrëveshje Financimi nëse përfituesi IPA III shkel një detyrim në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut, parimet demokratike dhe shtetin e së drejtës dhe në raste të rënda korrupsioni apo nëse përfituesi IPA III është fajtor për shkelje të rëndë profesionale të faktuar me prova të qarta. Shkelja/kundërvajtja e rëndë profesionale nënkuptohet si në vijim:

- shkelje e ligjeve ose akteve normative të zbatueshme, ose të standardeve etike të profesionit të cilit i përket një person ose subjekt;
- sjellje e gabuar e një personi ose subjekti që ka ndikim në kredibilitetin e vet profesional, kur kjo sjellje është me keqdashje apo pakujdesi e rëndë.

(f) Marrëveshja e Financimit mund të pezullohet në rastet e forcës madhore, siç përcaktohet më poshtë. "Forcë madhore" nënkupton çdo situatë ose raste të paparashikueshme dhe të jashtëzakonshme përtej kontrollit të palëve që pengon secilën në përmbushjen e detyrimeve të tyre, që nuk i atribuohet një gabimi apo pakujdesie nga ana e tyre (ose nga kontraktuesit, agjentët apo të punësuarit e tyre) dhe që rezulton e pakapërcyeshme me gjithë kujdesin e duhur. Defektet në pajisje ose materiale apo vonesat në furnizimin e tyre, mosmarrëveshjet në punë, grevat ose vështirësitë financiare nuk mund të pretendohen se përbëjnë forcë madhore. Secila palë nuk mund të konsiderohet se ka shkelur detyrimet, nëse pengohet në përmbushjen e tyre nga një forcë madhore për të cilën e ka informuar siç duhet palën tjetër. Secila palë që përballet me forcë madhore informon palën tjetër pa vonesë, duke i deklaruar natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektet e parashikueshme të problemit, si dhe merr të gjitha masat për të minimizuar dëmet e mundshme. Nëse forca madhore prek vetëm në një pjesë të Programit, pezullimi i Marrëveshjes së Financimit mund të jetë i pjesshëm. Asnjëra palë nuk mbahet përgjegjëse për shkelje të detyrimeve në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, nëse pengohet në përmbushjen e tyre nga forca madhore, me kusht që të marrë masa për minimizimin e dëmeve të mundshme.

(2) Komisioni mund të pezullojë këtë Marrëveshje Financimi pa njoftim paraprak.

(3) Komisioni mund të marrë të gjitha masat e nevojshme paraprake para se të ndodhë pezullimi.

(4) Në rastin kur njoftohet pezullimi, duhet të tregohen pasojat për kontratat e prokurimit, kontratat grant dhe marrëveshjet e kontributit që janë në proces apo pritet të nënshkruhen.

(5) Pezullimi i Marrëveshjes së Financimit nuk i cenon të drejtën Komisionit që të ndërpresë pagesat dhe të zgjidhë këtë Marrëveshje Financimi sipas neneve 6 dhe 19.

(6) Palët e rifillojnë zbatimin e Marrëveshjes së Financimit menjëherë sapo e lejojnë kushtet dhe pasi merret miratimi paraprak me shkrim i Komisionit. Kjo nuk cenon mundësinë për t'i bërë ndonjë ndryshim ligjor kësaj Marrëveshjeje Financimi, i cili mund të jetë i nevojshëm për ta përshtatur Programin me kushtet e reja të zbatimit, duke përfshirë, nëse është e mundur, zgjatjen e periudhave të zbatimit operacional dhe ekzekutimit, ose zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje Financimi sipas nenit 19.

Neni 19 - Zgjidhja e kësaj Marrëveshjeje Financimi

(1) Nëse problematikat që çuan në pezullimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi nuk janë zgjidhur brenda periudhës maksimale prej 180 ditësh, secila palë ka të drejtë ta zgjidhë Marrëveshjen e Financimit pas një njoftimi brenda 30 ditëve.

(2) Në rastin kur njoftohet zgjidhja, tregohen pasojat për kontratat e prokurimit dhe grantit si dhe marrëveshjet e kontributit që janë në proces ose do të nënshkruhen.

(3) Zgjidhja e kësaj Marrëveshjeje Financimi nuk përjashton mundësinë që Komisioni të kryejë korrigjime financiare sipas neneve 43 dhe 44 të MFKP-së.

Neni 20 – Ligji i zbatueshëm, zgjidhja e mosmarrëveshjeve

(1) Kjo Marrëveshje interpretohet dhe zbatohet sipas të drejtës së BE-së.

(2) Nëse një mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin, zbatimin apo vlefshmërinë e Marrëveshjes nuk arrihet të zgjidhet me konsultim, ajo referohet tek Gjykata e Përhershme e Arbitrazhit sipas Rregullave të Arbitrazhit të vitit 2012, sipas kushteve të mëposhtme:

(a) Përbërja e trupit gjykues

Për pretendimet mbi 500 000 Euro: trupi gjykues përbëhet nga tre arbitra. Secila palë cakton një arbitër brenda 40 ditësh kalendarike pas dërgimit të njoftimit të arbitrazhit. Dy arbitrat e caktuar prej palëve caktojnë vetë një arbitër të tretë që të veprojë si arbitër kryesues.

Për pretendimet nën 500 000 Euro: trupi gjykues përbëhet nga vetëm një arbitër, përveç se kur palët bien dakord ndryshe.

Nëse trupi gjykues nuk krijohet brenda 80 ditësh kalendarike pas dërgimit të njoftimit të arbitrazhit, secila palë mund t'i kërkojë Sekretariatit të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit ose një autoriteti të paanshëm të pranuar bashkërisht që të caktojë arbitrin(at) e nevojshëm.

(b) Selia

Selia e trupit gjykues së arbitrazhit është Hagë, Holandë.

(c) Gjuha

Gjuha e punimeve të arbitrazhit është anglishtja, ose një gjuhë tjetër zyrtare e BE-së e pranuar bashkërisht nga palët. Provat mund të paraqiten në gjuhë të tjera, nëse palët bien dakord.

(d) Procedura

Në punimet e arbitrazhit nuk pranohen rekurset për masa të ndërmjetme, ndërhyrjet e palëve të treta apo opinionet *amicus curiae*.

Nëse njëra palë i kërkon trupit gjykues të trajtojë një informacion apo material si konfidencial, vendimi merret në formën e një urdhri të arsyetuar dhe pasi dëgjohet pala tjetër (10 ditë kalendarike për të paraqitur parashtrimet). Trupi gjykues shqyrton arsyet e kërkesës, natyrën e informacionin dhe të drejtën për mbrojtje gjyqësore efektive. Trupi gjykues, në veçanti, mund:

- ta kushtëzojë publikimin me disa detyra specifike; ose
- të vendosë që informacioni/materiali të mos bëhet publik, por të urdhërojë përgatitjen e një versioni apo përmbledhjeje jokonfidenciale të informacionit apo materialit, i cili të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për t'i mundësuar palës tjetër shprehjen e qëndrimeve të veta në mënyrë kuptimplotë.

Nëse trupit gjykues i kërkohet ta shqyrtojë çështjen në dhomë këshillimi, vendimi merret pasi dëgjohet pala tjetër (10 ditë kalendarike për të depozituar parashtrimet). Trupi gjykues merr parasysh arsyet e kërkesës dhe kundërshtimet e palës tjetër (nëse ka).

Nëse trupit gjykues i kërkohet interpretimi apo aplikimi i të drejtës së Bashkimit Evropian, trupi gjykues i ndalon punimet dhe i kërkon "Presidentit të Gjykatës së Lartë të Parisit (Président du Tribunal de grande instance de Paris, 'juge d'appui'), sipas neneve 1460 dhe 1505 të Kodit të Procedurës Civile të Francës që t'i kërkojë një vendim paraprak Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian në përputhje me nenin 267 të Traktatit të Funksionimit të BE-së (TFBE). Punimet para gjykatës së arbitrazhit rifillojnë sapo merret vendimi nga gjyqtari mbështetës (*juge d'appui)*. Vendimi i Gjykatës së Drejtësisë dhe i gjyqtarit mbështetës është detyrues për trupin gjykues.

Vendimi i arbitrazhit është i formës së prerë dhe detyrues për palët, si dhe zbatohet prej tyre pa vonesa.

Megjithatë, secila palë mund të kërkojë rishikimin e këtij vendimi nga Gjykata e Apelit e Hagës (*Gerechtshof Den Haag*) mbi bazën e legjislacionit të brendshëm. Në këtë rast, vendimi nuk konsiderohet i formës së prerë deri në përfundim të procedurës. Vendimi i gjykatës rishikuese është detyrues për trupin gjykues.

(e) Shpenzimet

Shpenzimet e arbitrazhit konsistojnë në:

- tarifat dhe shpenzimet e arsyeshme të arbitrave;
- shpenzimet e arsyeshme të ekspertëve dhe dëshmitarëve, të cilat miratohen nga trupi gjykues; dhe

- tarifat dhe shpenzimet e Sekretariatit të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit për punimet e arbitrazhit (p.sh. kateringu, puna e punonjësve të administratës, salla, përkthimi).

Tarifat e arbitrave nuk tejkalojnë:

- 30 000 Euro për çdo arbitër, nëse shuma e kundërshtuar është nën 1 000 000 Euro;
- 15% të shumës së kundërshtuar kur kjo shumë është mbi 1 000 000 Euro. Në çdo rast, tarifa e arbitrave nuk tejkalon 300 000 Euro.

Shpenzimet e arbitrazhit përballohen përgjysmë nga palët, përveç kur bien dakord ndryshe.

Palët i përballojnë vetë shpenzimet e tyre për përfaqësim ligjor dhe shpenzime të tjera që i kryejnë në lidhje me arbitrazhin.

(f) Privilegjet dhe imunitetet

Marrëveshja për ndjekjen në arbitrazh sipas Rregullave të Arbitrazhit të vitit 2012 të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit nuk përbën dhe nuk mund të interpretohet si heqje dorë nga privilegjet ose imunitetet që gëzon secila palë.

Neni 21 - Masat kufizuese të BE-së

(1) Përkufizime

(a) "Masat kufizuese të BE-së" nënkupton masat shtrënguese të miratuara në zbatim të Traktatit të Bashkimit Evropian (TBE) ose të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE).

(b) "Person i Kufizuar" nënkupton çdo subjekt, individ apo grup që i përcaktuar nga BE-ja si objekt i Masave Kufizuese të BE-së[5].

(2) Në të gjitha marrëdhëniet e tyre, Palët pranojnë që në kuadrin e të drejtës së BE-së të mos u japin Personave të Kufizuar fonde apo burime ekonomike të BE-së, qoftë drejtpërdrejt apo tërthorazi ose në dobi të tyre.

(3) Përfituesi IPA III garanton që asnjë transaksion në lidhje me fondet e BE-së të mos bëhet drejtpërdrejt ose tërthorazi në favor të personave/subjekteve që janë objekt i sanksioneve të BE-së. Përfituesi IPA III zotohet ta respektojë këtë detyrim:

(a) duke verifikuar në listën e sanksioneve të BE-së përpara se të nënshkruajnë apo të kryejnë pagesa në kuadrin e marrëveshjeve përkatëse, çdo Kontraktues, Përfitues Granti dhe Marrës Përfundimtar me të cilët Përfituesi IPA III ka ose pritet të ketë marrëdhënie kontraktuale direkte (marrës direkt), me qëllim që të konstatojë nëse ky marrës/përfitues është Person i Kufizuar.

(b) duke verifikuar përmes mjeteve të tjera të përshtatshme (që mund të përfshijnë verifikime *ex-post)* mbi bazën e një vlerësimi risku, që asnjë subjekt që është Person i Kufizuar të mos përfitojë tërthorazi fonde të BE-së.

(4) Përfituesi IPA njofton menjëherë Komisionin nëse konstaton se ndonjë marrës/përfitues (direkt ose indirekt) i fondeve të BE-së është Person i Kufizuar.

(5) Pa cenuar detyrimin në pikën 3 më lart, nëse Komisionin konstaton se përdorimi i asistencës financiare të BE-së në kuadrin e IPA III rezulton ose ka rezultuar në shkelje të masave kufizuese të BE-së, shumat korresponduese nuk janë të pranueshme për asistencë financiare të BE-së në kuadrin e IPA III. Kjo nuk i cenon të drejtat që Komisioni mund të ketë për pezullimin apo anulimin e masës së prekur nga kjo shkelje, për rikuperimin e fondeve të BE-së që ka kontribuuar Komisioni, për pezullimin ose zgjidhjen e kësaj marrëveshjeje financimi.

(6) Përcaktimi i masave korrigjuese bëhet në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Masat korrigjuese zbatohen vetëm për fondet e BE-së të cilat i janë vënë në dispozicion apo kanë shkuar në favor të një marrësi/përfituesi gjatë periudhës që ka qenë Person i Kufizuar.

(7) Kjo klauzolë nuk cenon përjashtimet e përcaktuara në Masat Kufizuese të BE-së.

[5] www.sanctionsmap.eu. Vini re se harta e sanksioneve është një mjet TI për identifikimin e regjimeve sanksionuese. Sanksionet burojnë nga aktet ligjore të publikuara në Gazetën Zyrtare (GZ). Në rast mospërputhjeje midis akteve ligjore të publikuara dhe përditësimeve në faqen e internetit, mbizotërojnë versionet e publikuara në GZ.

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2022 - Numri: 167
Datë: 2022/12/14 16:16:12
913b7496-722d-4b00-b7aa-77d7a190a662

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 560 lekë